

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT PËR TERRITORIN E BASHKISË ELBASAN

Titulli: Strategjia e Zzhvillimit për Territorin e Bashkisë Elbasan

Autorësia dhe kontributet:

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Elbasan me mbështetjen teknike të projektit PLGP të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, nën drejtimin e kryetarit të Bashkisë Elbasan, Z. Qazim Sejdini.

Grupi i punës: Zenel Bajrami, Malvina Disha, Rudina Toto, Dritan Shutina, Anila Gjika, Merita Toska, Elton Stafa, Sotir Dhamo, Besnik Aliaj, Iris Hyka, Renisa Muka, Ada Lushi, Arta Alla, Besmira Dyca, Teida Shehi, Rajmond Hazballa, Diamanta Vito, Etleva Kenuti, Silvi Jano, Imeldi Sokoli, Gerti Delli, Ani Shtylla, Kejt Dhrami, Eneida Çela, Endri Demneri, Fiona Imami, Fabjola Meçaj, Godiva Rrëmbeci, Ingrid Xhafa, Aida Ciro, Erialda Zekthi, Mariana Proko, Laureta Memo, Marvis Avllazagaj, Denis Djaloshi, Petrit Lamçaj, Dritan Sherali, Gladiola Çala, Marsida Musta, Roland Hoxhallari, Lila Karaj, Qemal Tusha, Maksi Gega.

Realizimi grafik: Renisa Muka, Iris Hyka, Ada Lushi, Sonia Jojic.

Redaktimi letrar: Lumnije Hasa.

Shtypur në: Shtypshkronja Pegi.

ISBN: 978-9928-200-54-9

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Elbasan me mbështetjen teknike të Projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Çështjet e analizuara në këtë dokument janë diskutuar dhe për to është rënë dakord me grupet e interesit të Bashkisë Elbasan, në proceset e konsultimit publik, në përputhje me detyrimet ligjore, sipas Ligjit nr.107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.

PREAMBUL

Në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Elbasan, dëshiroj të përshëndes grupin e punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të territorit të bashkisë sonë, si një hap i parë drejt Planit të Përgjithshëm Vendor për Planifikimin e Territorit.

Iniciativa e ndërmarrë nuk ka ardhur vetëm si nevojë për të përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse. Ajo vjen mbi të gjitha si nevojë e Bashkisë, për instrumente largpamëse, vizionare dhe novatore, që do ta udhëheqin zhvillimin e territorit të saj gjatë viteve në vazhdim. Në këtë mënyrë, ne synojmë të garantojmë rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve tanë përmes zhvillimit të qëndrueshëm të territorit dhe përmes kthimit të kësaj Bashkie në një vend tërheqës për biznesin dhe konkurues i denjë në rajon.

Duke qënë të ndërgjegjshëm për sfidat që parashtron procesi i planifikimit dhe mbi të gjitha i kontrollit të zhvillimit të territorit, synojmë që përmes hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të Planifikimit të Territorit, t'i kapërcejmë me sukses ato dhe të krijojmë mundësi për nxitje të zhvillimit ekonomik, ruajtje të vlerave dhe pasurive natyrore e territorit të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm. Për të realizuar këtë, stafi i Bashkisë do të jetë i përkushtuar në plotësimin, përmbushjen ligjore dhe zbatimin e instrumenteve/ dokumenteve dhe udhëheqjen e zhvillimit drejt përmbushjes së vizionit tonë të përbashkët.

Sipas ligjit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan, përbëhet prej tre dokumenteve bazë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit:

1. Strategjia e Zhvillimit të Territorit,
2. Plani i Zhvillimit,
3. Rregullorja e Planifikimit.

Përmes këtij dokumenti, ju paraqesim Strategjinë. Strategjia ravijëzon mundësitë e ardhshme strategjike të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor, të ndërlidhura dhe me ndikim të ndërsjellë në territorin e Bashkisë Elbasan e më gjerë në rajon.

Së fundmi, dua të falenderoj të gjitha institucionet, të cilat janë treguar bashkëpunuese gjatë procesit të hartimit të strategjisë, veçanërisht Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, ministritë e linjës, njësitë administrative të bashkisë, si dhe të gjithë aktorët e përfshirë gjatë proceseve të konsultimeve publike. Falenderoj USAID-in për mbështetjen që na ofron përmes Programit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), si dhe grupin e punës të përbërë nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit Bashkia Elbasan, dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, për punën cilësore të realizuar deri më tani.

Kryetari i Bashkisë

Qazim SEJDINI

PARATHËNIE

Që prej qershorit 2015, qeverisja vendore në Shqipëri është përfshirë nga reforma administrative-territorial. Si rezultat, janë krijuar 61 bashki të konsoliduara, të cilat përballen me sfidat e pushtetit vendor, të shumëfishuara si pasojë e rritjes së sipërfaqes dhe kompleksitetit territorial, shtimit të detyrave të reja nga reforma e decentralizimit dhe nevojës gjithmonë në rritje për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike.

Në këto kushte, Bashkia e Elbasanit, për t`iu përgjigjur sa detyrimeve ligjore, aq edhe sfidave reale, ka punuar intensivisht për të përgatitur Strategjinë e Zhvillimit të saj. Duke pasur parasysh që, jo vetëm konceptualisht, por edhe ligjërisht është pranuar nga palët se planifikimi i territorit përmban njëkohësisht edhe dimensionin strategjik dhe atë rregullator, kjo strategji përbën hapin e parë të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Elbasan.

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të territorit hartohet nga Bashkia Elbasan me mbështetjen teknike të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në kuadër të Projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP). Përmbajtja e dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit të territorit mbështetet në Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij. Veçanërisht, si bazë referuese është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

Megjithatë, për shkak të natyrës mjaft komplekse dhe shumë dimensionale që ka ky dokument, duke mbuluar nevoja të territorit urban dhe rural, gjatë hartimit të tij janë referuar edhe akte të tjera ligjore e nënligjore si dhe dokumente udhëzuese. Ndër më të rëndësishmet janë:

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar";
- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar";
- Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë";
- Vendimet e KKT-së në 3 vitet e fundit, në lidhje me përcaktimin e çështjeve, zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare;
- Manuali teknik " Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri"; etj.

Metodologjia e ndjekur gjatë hartimit të këtij dokumenti është mbështetur mbi përcaktimet ligjore për sa i përket strukturës së instrumenteve (dokumenteve të planifikimit) dhe procesit që duhet të ndiqet. Kështu, për nga ana përmbajtësore, ky dokument përmban kapitullin e analizave, duke veçuar këtu analizën e metabolizmit, por edhe analiza territoriale dhe social-ekonomike, që hapin shtegun për analizat e thelluara në vijim të hartimit të Planit. Më pas, paraqiten përfundimet përfshirë edhe analizën e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve, si dhe hapa drejt një vizioni rajonal, për kontekstin më të gjerë, në të cilin ndodhet Bashkia e Elbasanit.

Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vizionin lokal të zhvillimit territorial, mjedisor e social-ekonomik, së bashku me objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit. Më pas, është hartuar plani i veprimit me afate kohore dhe konsiderata financiare si dhe një listë e projekteve prioritare e strategjike të zhvillimit lokal territorial, për të cilat bashkia ka gatishmërinë të aplikojë për fonde dhe të përgatitë projekte teknike.

Ky dokument ndërtohet jo vetëm mbi bazën e analizave shkencore e territoriale, por edhe të nevojave dhe dëshirave të shprehura nga banorë dhe grupet e ndryshme të interesit në Bashkinë Elbasan. Gjatë periudhës së hartimit të tij, janë realizuar të paktën 3 dëgjesa publike, nga një për çdo fazë të hartimit të dokumentit (nisma, analiza, vizioni), si dhe janë kryer takime të ngushta me ekspertë vendorë, përfaqësues të biznesit e aktorë të tjerë që operojnë në këtë territor. Po ashtu, janë realizuar shumë vizita në terren e institucione publike me qëllim grumbullimin sa më të efektshëm të informacionit dhe krijimin e bazës së të dhënave në sistemin gjeografik të informacionit.

Në vijim, Bashkia e Elbasanit do të punojë ngushtësisht me Projektin PLGP për të kaluar në hapat ligjorë e teknikë të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të territorit (përdorimi i tokës, infrastrukturat, mjedisi) dhe të rregullores së tij. Finalizimi i planit të përgjithshëm të territorit do të jetë një nga arritjet më të para të një bashkie të re, të krijuar pas reformës territoriale dhe me dëshirën e vullnetin për t'iu përgjigjur nevojave edhe afatgjata të qytetarëve si dhe për të përballur sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. SFIDAT E BASHKISË ELBASAN 16
1.1 Tendencat kryesore të zhvillimit të pas viteve `90të 17
1.1.1 Policentrizmi 18
1.2 Territori dhe mjedisi 20
1.2.1 Vlerësim i kushteve fizike 20
1.2.2 Metabolizmi i territorit 21
1.2.3 Mjedisi, ekosistemet dhe ndotja 32
1.3 Zhvillimi ekonomik 45
1.4 Situata social-ekonomike 51
1.4.1 Demografia 51
1.4.2 Analiza social-ekonomike 57
1.5 Përdorimi i tokës dhe infrastrukturat 64
1.5.1 Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës 64
1.5.2 Rrugët dhe transporti 66
1.5.3 Furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza 69
1.5.4 Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta 71
1.6 Rëndësia kombëtare në territor 73
1.7 Financat vendore 76
1.8 Qeverisja dhe përgjegjësia sociale 79
1.8.1 Decentralizimi i Qeverisjes dhe Strukturat Përkatëse 79
1.8.2 Vështirësitë e Qeverisjes Vendore 80
1.8.3 Perceptimet qytetare në lidhje me qeverisjen e tyre vendore, format e organizimit komunitar dhe bashkësia e OJF-ve, instrumente të transparencës, etj.. 81
1.9 Procese dhe dokumente planifikimi 81
1.10 Mbi drejtimin e zhvillimit 84
1.10.1 Koncepti rajonal i zhvillimit 84
1.11 Përfundime dhe rekomandime, analiza SWOT 93
1.11.1 Përfundime dhe rekomandime 93
1.11.2 Analiza SWOT 97
2. VIZIONI I TË ARDHMES PËR ELBASANIN 98
2.1 Objektiva dhe Programe 99

2.2 Konsiderata financiare 102
3. PLANI I VEPRIMIT 104
3.1 Plani i veprimit 104
3.2 Sistemet e territorit 113
4. PROJEKTET PRIORITARE TË ZHVILLIMIT 116
SHËNIME DHE REFERENCA 160

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Pozicioni gjeografik i Bashkisë Elbasan. 17
Figura 2: Fazat e zhvillimit të vendbanimeve në vite. 18
Figura 3: Shtimi i sipërfaqes së ndërtuar 1990 - 2013 18
Figura 4: Zonat Funksionale Urbane në Shqipëri 19
Figura 5: Mbivendosja e izokroneve 45' - Zonat e integrimit të mundshëm 20
Figura 6: Harta e fluksit të energjisë në rajon 22
Figura 7: Harta e fluksit të ujit në rajon (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore). 23
Figura 8: Fluksi i energjisë në Bashkinë Elbasan 25
Figura 9: Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur
për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale 26
Figura 10: Fluksi i ujit në Bashkinë Elbasan 27
Figura 11: Prodhimet Bujqësore (në kton), Bashkia Elbasan 2014 28
Figura 12: Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton), në Bashkitë:Elbasan, Lushnjë,
Fier, Berat dhe Kuçovë 28
Figura 13: Fluksi i ushqimit në Bashkinë Elbasan 29
Figura 14: Prodhimet bujqësore për periudhën 2012-2013-2014 (në kton), Qarku Elbasan 29
Figura 15: Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton), në Qarkun: Elbasan, Fier dhe Berat 29
Figura 16: Prodhimet bujqësore për periudhën 2012 - 2013-2014 (në kton), Qarku Elbasan 30
Figura 17: Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton), në Qarkun: Elbasan, Fier dhe Berat 30
Figura 18: Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Elbasan 31
Figura 19: Burimet ujore dhe akuiferët e Elbasanit (Baseni i Shkumbinit, lumenjtë kryesorë
dhe akuiferët) 33
Figura 20: Harta e marrjes së kampioneve për monitorim në Shkumbin 33
Figura 21: pH i ujërave të Shkumbinit. 34
Figura 22:Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe Oksigjeni i Tretur në Shkumbin 34
Figura 23: Lënda e ngurtë pezull dhe e tretur në Shkumbin 34
Figura 24: Amoniaku, nitratet dhe nitritet në Basenin e Lumit Shkumbin 34
Figura 25: Metalet e rënda në Basenin e Lumit Shkumbin 35
Figura 26: Metalet e Rënda në Basenin e Lumit Shkumbin 35
Figura 27: Klasifikimi dhe shtrirja e akuiferëve në Qarkun e Elbasanit 36
Figura 28: Ndotja e ajrit nga zona industriale, Elbasan 38
Figura 29:Vatrat e nxehta mjedisore në territorin e Bashkisë Elbasan 41

Figura 30: Harta e ndërveprimit ekonomik në ZF Elbasan: Përqendrimi i bizneseve dhe drejtimi i lëvizjes për punë. 47
Figura 31: Ndërmarrjet ekonomike në Bashkinë Elbasan. 48
Figura 32: Klasifikimi në ekonomi agrare ose ekonomi aglomeruese, Bashkia Elbasan 49
Figura 33: Zonat ekonomike në Bashkisë Elbasan 51
Figura 34: Struktura e popullsisë 52
Figura 35: Struktura Moshore, Bashkia Elbasan, 2015 54
Figura 36: Niveli arsimit në Bashkinë Elbasan, i krahasuar me Qarkun dhe mesataren kombëtare . . . 57
Figura 37: Niveli arsimor përfundimtar fillor dhe 8 ose 9 vjeçar, i mesëm dhe i lartë, INSTAT, 2015 (Censusi) 57
Figura 38: Shpërndarja e institucioneve arsimore parauniversitare në Bashkinë Elbasan 58
Figura 39: Punësimi sipas nivelit arsimor në Bashkinë Elbasan. 59
Figura 40: Papunësia në Bashkinë Elbasan. 60
Figura 41: Papunësia në Bashkinë Elbasan, sipas njësive administrative 60
Figura 42: Burimi i të ardhurave të NJEF-së sipas njësive administrative në Bashkinë Elbasan 62
Figura 43: Sistemet territoriale në Bashkinë Elbasan 65
Figura 44: Sistemi Urban 65
Figura 45: Sistemi Infrastrukturor. 65
Figura 46: Sistemi Bujqësor 65
Figura 47: Sistemi Hidrografik 65
Figura 48: Sistemi Natyror 65
Figura 49: Sistemet Territoriale, Bashkia Elbasan 66
Figura 50: Përdorimi i tokës sipas kategorive kryesore (km²) 66
Figura 51: Mbivendosje të përdorimit të tokës, Bashkia Elbasan 66
Figura 52: Transporti ndërqytetës (nisja nga Bashkia Elbasan) 67
Figura 53: Ndarja e rrugëve sipas kodit rrugorë 68
Figura 54: Zona e mbulimit me shërbimin e ujësjellësit. 69
Figura 55: Zona e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura 71
Figura 56: Rëndësia Kombëtare në territor, Bashkia Elbasan 75
Figura 57: Kontributi i njësive administrative në ecurinë e të ardhurave totale (pikë %, majtas); Kontributi sipas burimit në të ardhurat totale (pikë %, djathtas) 77

Figura 58: Kontributi sipas burimeve (pikë %, majtas) dhe i programeve
(pikë %, djathtas) në shpenzimet totale 78
Figura 59: Shpenzimet totale dhe sipas përdorimit dhe funksioneve. 79
Figura 60: Plani Rregulues i Bashkisë Elbasan, 1942 82
Figura 61: Plani Rregullues i Bashkisë Elbasan, 1983. 82
Figura 62: Zonimi funksional në perspektivë 84
Figura 63: Kriteret e përcaktimit të rajonit të studimit 85
Figura 64: Sistemi urban dhe infrastruktura 86
Figura 65: Sistemi natyror 86
Figura 66: Analiza historike 87
Figura 67: Koncepti rajonal 87
Figura 68: Potenciali turistik dhe zonat në presionin e ndotjes mjedisore 88
Figura 69: Koncepti i zhvillimit të rajonit-rrjeti rrugor. 90
Figura 70: Koncepti i zhvillimit të rajonit-korridoret e lëvizjes dhe hierarkia e qendrave 91
Figura 71: Koncepti i zhvillimit të rajonit-nënrajonet e lëvizjes 91
Figura 72: Koncepti i zhvillimit të rajonit-Ndërthurja e sistemeve dhe qendërsive 92
Figura 73: Harta e vizionit, Bashkia Elbasan 98
Figura 74: Qendërsitë dhe fashat e Zhvillimit. 99
Figura 75: Skema e Zhvillimit Ekonomik. 100
Figura 76: Skema natyrore dhe zhvillimi i turizmit 101
Figura 77: Skema e Lidhjeve Infrastrukturore. 102
Figura 78: Ndryshimi i mundshëm i sistemeve territoriale, sipas propozimeve. 114
Figura 79: Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore. 117
Figura 80: Rehabilitimi dhe ndërtimi i pjesshëm i rrugës Tregan-Trepsenisht-Shelçan
dhe rehabilitimi i rrugës Çekrez-Blerimad-Stërstan-Gjinar 119
Figura 81: Përmirësimi i kryqëzimeve rrugore 121
Figura 82: Shtimi dhe përmirësimi i sitemit të ujësjellës-kanalizimeve. 123
Figura 83: Ndërtimi i ujësjellësit të ri të Fush Buallit 125
Figura 84: Rehabilitimi i urave 127
Figura 85: Programi për zhvillimin e transportit automobilistik (BRT) 129
Figura 86: Programi për zhvillimin e transportit hekurudhor 131

Figura 87: Përdorimi i energjisë gjeotermale 133
Figura 88: Ndërtimi i tregjeve dhe pikave të grumbullimit. 135
Figura 89: Rehabilitimi dhe rigjenerimi i ish-fabrikës së konservimit dhe zonës së metalurgjikut 137
Figura 90: Konsolidimi i fashës me karakter ekonomik-bujqësor (SME) 139
Figura 91: Rehabilitimi i shtratit të lumit Shkumbin 141
Figura 92: Rehabilitimi i shtratit të lumenjve Zaranika, Manazdere, Papër, Gostrimë dhe Gostimë . . . 143
Figura 93: Rehabilitimi i parkut të qytetit, Krasta 145
Figura 94: Rehabilitimi i venddepozitimit pranë varrezave të qytetit. 147
Figura 95: Përmirësimi i infrastrukturës dhe ndërtimi i objekteve arsimore. 149
Figura 96: Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në njësitë administrative
Bradashesh, Papër, Gracen, Tregan, Shushicë, Zavalinë 151

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Ndarja administrative e Bashkisë Elbasan 16
Tabela 2: Rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe banesave 2011 25
Tabela 3: Bilanci i Energjisë Elektrike, 2011 25
Tabela 4: Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale 26
Tabela 5: Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Elbasan 28
Tabela 6: Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për Qarkun e Elbasan 30
Tabela 7: Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik. 43
Tabela 8: PBB për frymë e Qarkut të Elbasanit në raport me nivelin kombëtar 46
Tabela 9: Struktura e PBB ndër vite 46
Tabela 10: PBB për frymë e Qarkut të Elbasanit ndër vite në raport me nivelin kombëtar 46
Tabela 11:VSHB sipas degëve të ekonomisë në Qarkun Elbasan. 47
Tabela 12: Produktiviteti në sektorin e Industrisë dhe të Shërbimeve 47
Tabela 13: Ndërmarrjet sipas aktiviteti ekonomik në Qarkun Elbasan. 48
Tabela 14: Ndërmarrjet ekonomike në bashkinë Elbasan. 48
Tabela 15: Prodhimi sipas kulturave bujqësore. 49
Tabela 16: Prodhimet blegtorale në Bashkinë Elbasan dhe në Qarkun Elbasan. 49
Tabela 17: Punësimi sipas sektorëve ekonomik në Bashkisë Elbasan. 50
Tabela 18: Niveli i punësimit sipas sektorëve ekonomike 50
Tabela 19: Popullsia në Bashkinë Elbasan sipas të dhënave të gjendjeve civile, 2015 52
Tabela 20: Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015 52
Tabela 21: Popullsia sipas gjinisë Bashkia Elbasan, për vitet 2011-2015 53
Tabela 22: Raporti gjinor për Bashkinë Elbasan, 2011-2015. 53
Tabela 23: Popullsia rezidente, sipas grup-moshave 54
Tabela 24: Koeficientët e varësisë. 55
Tabela 25: Popullsia e Bashkisë Elbasan, 2011-2031 56
Tabela 26: Numri i institucioneve arsimore dhe raporti nxënës/ mësues 58
Tabela 27: Punësimi sipas sektorëve ekonomikë, sipas njësive administrasive të Bashkisë Elbasan 59
Tabela 28: Punësimi sipas nivelit arsimor sipas njësive administrative të Bashkisë Elbasan. 60
Tabela 29: Treguesit e shërbimit shëndetësor në Bashkinë Elbasan 61
Tabela 30:Varfëria në Qarkun e Elbasanit. 62

Tabela 31: Infrastruktura rrugore e Bashkisë Elbasan sipas kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë . . 67
Tabela 32: Mbulimi me sisteme të furnizimit me ujë në zonën rurale, Elbasan 70
Tabela 33: Bilanci i kërkesës për ujë dhe rezervuare në Bashkinë Elbasan 71

1. SFIDAT E BASHKISË ELBASAN

Bashkia Elbasan shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Pas Reformës Administrative-Territoriale, të miratuar në maj të vitit 2014 Bashkisë së vjetër të Elbasanit i janë bashkuar edhe 12 njësi të tjera administrative. Aktualisht Bashkia Elbasan përbehet nga 13 njësi administrative, Bashkia e vjetër e Elbasanit, Komuna Bradashesh, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Labinot-Mal, Komuna Funarë, Komuna Gracen, Komuna Tregan, Komuna Shushuicë, Komuna Shigjan, Komuna Gjinar dhe Komuna Zavalinë.

Sipërfaqja e Elbasanit është 872 km², nga 7,9 km² që ishte para Reformës Administrative-Territoriale, 2014. Pra sipërfaqja e bashkisë është rritur përafërsisht 110 herë. Ndryshimi i kufirit territorial është sfidë për bashkinë në zhvillimin e mëtejshëm të saj.


Bashkia Elbasan shtrihet në pozicion mjaft strategjik. Kufizohet nga rrugë të rëndësishme kombëtare. Largësia nga Aeroporti Nënë Tereza është 62.5 km, nga Port i Durrësit 83 km, nga pika kufitare e Qafë Thanës 65 km dhe nga pika kufitare e Kapshticës 150 km[3]. Nga pikëpamja e mjedisit, përshkohet nga lumenj të shumtë si Shkumbini, Manazdere, Papër, Gostrima dhe Zaranika. Qyteti dhe zona industrial (zona e ish-metalurgjikut) shtrihen përgjatë luginës së Shkumbinit. Në territorin e Elbasanit ndodhen edhe zona të mbrojtura si Sopoti, Stravja dhe Kuturmani. Territori ka kryesisht karakter kodrinor-fushor. Duke qenë se shtrirja që ka kjo bashki është e madhe, ka larmi relievesh. Temperatura mesatare luhatet nga 6.7°C-11°C në janar, në 23.4°C-31.2°C në korrik, ndërsa shpejtësia e erës luhatet nga 1.2 m/s në verë. deri në 2.1-2.4 m/s në dimër.

Tabela 1: Ndarja administrative e Bashkisë Elbasan

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km²)[1]	Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre[2]
Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	22.2	Qyteti Elbasan
		Bradashesh	56	Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrilë, Shtemaj, Ulën, Katund i Ri, Fikas, Petresh, Shëmhill, Shijon, Reçan, Gurabardh
		Papër	102	Papër, Broshkë, Murras, Valas, Vidhas, Pajun, Bizhutë, Papër-Sallak, Vidhas-Hasgjel, Lugaj, Jatesh, Balldre, Ullishtaj
		Labinot-Fushë	49	Labinot-Fushë, Godolesh, Griqan i Sipërm, Griqan i Poshtëm, Xibrakë, Mengel
		Labinot-Mal	105.7	Labinot-Mal, Guri Zi, Sericë, Lamollë, Benë, Lugaxhi, Qafë, Qerret, Shmil, Dritas
		Gjergjan	27.9	Gjergjan, Bujaras, Gjonmë, Kështjellë, Kodër Bujaras, Muriqan, Thanë
		Gjinar	89.1	Gjinar, Lleshan, Valesh, Pashtresh, Derstilë, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat
		Gracen	56.8	Gracen, Plangaricë, Tërbaç, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajengë, Mamel, Dopaj
		Funarë	76.6	Branesh, Bixëlle, Prec e Sipërme, Cerujë, Korrë, Mollagjesh, Krrabë e Vogël, Prec e Poshtme, Stafaj
		Shushicë	106.6	Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush-Buall, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Vale, Vreshtaj
		Shirgjan	21.6	Shirgjan, Bathës, Bujqës, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr, Mjekës
		Tregan	57.4	Tregan, Blerimas, Bizhdan, Cikallesh, Gurisht, Kacivel, Kyçyk, Muçan, Shinavlash, Shilbatër, Trepsenisht, Tudan
		Zavalinë	101.1	Zavalinë, Seltë, Kamiçan, Joronishtë, Nezhan, Burrishtë

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 1: Pozicioni gjeografik i Bashkisë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

1.1 TENDENCAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË PAS VITEVE `90TË


Tendencat e zhvillimit në Bashkinë Elbasan kanë ndryshuar shumë pas viteve '90. Lëvizja e lirë e njerëzve bëri që popullsia të zhvendosej drejt qendrave urbane duke ndikuar në shtrirjen e qyteteve dhe shtimin e sipërfaqes së ndërtuar. Edhe në Elbasan ndodhi i njëjti fenomen: rënia e sistemit komunist solli ndryshime në aspektin ekonomik, territorial dhe mjedisor. Prirjet kryesore ekonomike para viteve '90 në Elbasan ishin të orientuara drejt industrisë së rëndë (Kombinati Metalurgjik, Kombinati i Përpunimit të Drurit, etj.) dhe zonat rurale, të cilat sot janë pjesë e bashkisë, më të orientuara drejt bujqësisë. Këto tendenca ndryshuan duke ia lënë vendin sektorit të shërbimeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Në këtë mënyrë u bë një kalim i menjëhershëm nga sektori shtetëror në mbizotërimit të plotë të sektorit privat. Zhvillimi ekonomik, krahas ndryshimeve demografike është kushtëzuar nga faktorë të tjerë që lidhen me perudhën e tranzicionit. Industria e rëndë, sektori kryesor, në të cilën mbështetej zhvillimi ekonomik, kaloi në sektor të fundit të zhvillimit ekonomik. Sektori që zuri vendin e parë në ekonominë e bashkisë ishte ai i shërbimeve dhe ndërmarrjet e vogëla e të mesme, që vazhdojnë të jetë edhe sot sektori kryesor ekonomik.

Rritja e popullsisë rriti presionin e zhvillimit urban. Përqendrimi i popullsisë në qytete solli nevojën e shtimit të ndërtimeve, të cilat u shtuan në shumë pak kohë duke ndryshuar tërësisht pamjen e qytetit. Presioni i lartë i zhvillimit, mungesa e reformës së planifikimit, mungesa e kontrollit të zhvillimit, rikthimi i pronës tek njerëzit dhe lëvizjet e lira ishin ndër faktorët kryesor që sollën pamjen që kemi sot në qytete. Në Bashkinë Elbasan u ndërtuan banesa individuale nga banorët që u zhvendosën duke krijuar zonat informale. Në këto zona një problem kryesor ishte mungesa e infrastrukturës publike dhe fakti se shumë ndërtime u ngritën në toka bujqësore. Zhvillimi i vendbanimeve ka tre momente kohore të rëndësishme:

- Para viteve 1990,
- Deri në vitin 2007,
- Deri në vitin 2013,


Nga viti 1990 deri në vitin 2007 sipërfaqja e vendbanimeve në Bashkinë Elbasan është rritur me 20,2 %, pra, rritja e sipërfaqes së vendbanimeve në vit ka qenë përafërsisht 1,3 % në vit. Nëse krahasojmë shtimin e vendbanimeve deri në vitin 2007, vëmë re që në njësinë administrative Bradashesh dhe në qytetin e Elbasanit ka më shumë vendbanime të shtuara, ndërsa në njësitë administrative Funarë, Gjinar, Gracen, Labinot Mal, Shirgjan, Tregan dhe Zavalinë shtimi më i lartë i vendbanimeve është para viteve '90.

Figura 2: Fazat e zhvillimit të vendbanimeve në vite



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 3: Shtimi i sipërfaqes së ndërtuar 1990 - 2013



Shtimi i vendbanimeve në periudhën 2007-2013 ka pësuar rënie krahasuar me shtimin e vendbanimeve nga viti 1991-2007.

Shtimi i popullsisë përveç rritjes së dendësisë në territoret ekzistuese, kërkoi shtimin e territoreve të reja në zonën urbane. Krijimi i këtyre zonave të reja ka nevojë për ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturave të nevojshme.

Ashtu siç u theksua më lart, presioni i zhvillimit gjatë periudhës së tranzicionit dhe papërgatitja e institucioneve qendrore dhe vendore për t'iu përgjigjur këtij zhvillimi nëpërmjet planifikimit, solli zhvillim të pakontrolluar duke shkaktuar probleme mjedisore si dhe pamundësi për investime private dhe publike. Në vijim do të evidentohen një pjesë e problemeve, potencialet dhe mundësitë e Bashkisë Elbasan nëpërmjet analizave. Mbështetur në këto analiza janë përcaktuar projektet për zhvillimin e territorit të cilat mund të kapitalizohen nga bashkia apo palët private të interesuara që kanë interes të zhvillojnë jetën dhe biznesin e tyre në territor.

1.1.1 Policentrizmi


Shtrirja territoriale, dendësia e banimit, komunikimi për punë e shërbime dhe vazhdimësia e zonës së banuar në dy dekadat e fundit, e kanë klasifikuar Elbasanin (para ndarjes territoriale) si qendër aglomerati[4]. Elbasani, së bashku me katër njësitë vendore që e rrethonin atë para reformës territoriale (Bradashesh, Labinot Fushë, Shirgjan dhe Shushicë) krijojnë aglomeratin e Elbasanit. Të pesta këto njësi përfshihen aktualisht në Bashkinë e Elbasanit (e krijuar nga trembëdhjetë ish-njësi vendore) dhe përmbajnë 79% të popullsisë[5] së bashkisë pas reformës.

Ky lloj zhvillimi territorial, nëse shoqërohet edhe me disa parametra të tjerë morfologjikë e funksionalë (PBB, numri i udhëtarëve me transport publik, numri i studentëve, etj.) përcakton llojin e modelit policentrik ose jo të territorit përkatës. Studimi i policentrizmit bazohet në rëndësinë e tij si objektiv i BE[6], fillimisht i prezantuar nga nga Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor (European Spatial Development Perspective-ESDP)[7] dhe më pas i zbërthyer në politikën e Bashkimit Evropian (BE) për zhvillim rajonal, në politikën e transportit, etj. Sipas këtyre dokumenteve, "sistemet policentrike janë më efikase, më

	Bradashesh	Elbasan	Funarë	Gjergjan	Gjinar	Gracen	Labinot Fushë	Labinot Mal	Papër	Shirgjan	Shushicë	Tregan	Zavalinë
Vitet 2008-2013	175,485	407,647	12,877	130,707	40,623	11,445	67,355	37,229	53,158	225,057	172,916	56,877	5,171
Deri në vitin 2007	6,788,216	5,742,482	400,635	1,101,098	255,637	277,517	866,861	334,168	1,522,206	1,271,856	1,361,389	295,891	134,543
Para viteve '90	1,300,040	3,442,757	491,221	1,173,788	1,233,628	580,270	856,991	1,462,225	762,209	1,913,080	1,298,900	914,154	826,803

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 4: Zonat Funksionale Urbane në Shqipëri



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015


të qëndrueshme dhe territorialisht më të balancuara se sa ato monocentrike, apo të shpërhapura" (ESDP, 1999)[8]. Këto sisteme sigurojnë ekonomi të shkallës, kohezion dhe mbrojtje të mjedisit. Për të studiuar policentrizmin në Shqipëri, Co-PLAN u bazua në hartën e 17 aglomerateve shqiptare të INSTAT, duke shtuar edhe informacionin (e prodhuar nga Censusi 2011) mbi lëvizjet ditore për në punë (baseni i punësimit[9]), e duke krijuar zonat funksionale urbane (ZFU).

Shtatë tregues të policentrizmit morfologjik u analizuan për çdo ZFU, dhe 7 tregues të policentrizmit funksional u përshkruan[10]. Treguesit e policentrizmit morfologjik u kombinuan në 3 indekse dhe këto të fundit u kombinuan në indeksin e policentrizmit. Në këtë këndvështrim, Shqipëria është tejet monocentrike sa i përket indeksit të madhësisë (97 nga 100) dhe të lidhshmërisë (72 nga 100), për shkak të përqendrimit të popullsisë dhe PBB-së (Prodhimi i Brendshëm Bruto) në ZFU-në e Tiranës dhe aksesueshmërisë së lartë të ZFU-ve Tiranë e Laç krahasuar me të tjerat. Por Shqipëria është policentrike (28 nga 100) sa i përket indeksit të vendndodhjes për shkak të shpërndarjes thuajse uniforme në të gjithë territorin të 17 qendrave. Pozicionimi i qendrave, edhe pse funksionalisht flasim për nivel të lartë monocentrizmi, është potencial në favor të mbështetjes së një zhvillimi policentrik në nivel vendi dhe duhet shfrytëzuar si i tillë.

ZFU-ja e Elbasanit nuk mbivendoset me ZFU-të fqinje si rezultat i pozicionimit të aglomeratit të saj, të faktit se në qarkun e madh të Elbasanit, kjo bashki është e vetmja qendër urbane/aglomerati sipas klasifikimit të INSTAT, të numrit të madh të bashkive me natyrë/tipologji rurale që e rrethojnë atë dhe të terrenit të thyer që nuk lejon shtrirjen e basenit të punësimit në thellësi të territorit. Kjo ZFU ka popullsi prej rreth 155,969 banorë ose rreth 51% të popullsisë së qarkut të Elbasanit. ZFU-ja zë rreth 60% të territorit të bashkisë, por banorët e bashkisë së Elbasanit përbëjnë mbi 94% të popullsisë së ZFU-së. Ky fakt dëshmon për një nivel të theksuar monocentrizmi fizik (ai funksional do të zbërthehet në kapitujt në vazhdim të analizës së zhvillimit ekonomik). Nga ana tjetër, nëse shohim hartën e shpërndarjes në territor të vendbanimeve (Figura 2) vihet re se fusha e Cërrikut dhe ajo e Bradasheshit rrethohet nga një unazë lëvizjeje me shumë qendërsi banimi, me një përqendrim të theksuar në qytetin e Elbasanit. Sistemi vendor i vendbanimeve krijon një rrjetë policentrike me potencial të lartë për shkëmbim të funksioneve e shërbimeve, por ende të dobët ekonomikisht dhe nën ndikimin e rrezikut të lartë mjedisor (zona industrial e ish-Kombinatit Metalurgjik, Uzina e Ferrokromit, etj.).

Një tjetër analizë e realizuar është ajo e policentrizmit potencial, e cila tregon mundësinë e një rajoni për të qenë qendër interesi për investime e zhvillim, duke ndryshuar kështu hartën e zhvillimit policentrik e rajonal. Për këtë qëllim, për çdo qendër aglomerati/ZFU-je u vizatua izokroni 45-minutësh (duke bashkuar të gjitha pikat në hartë në të cilat mund të arrihet nga qendra për 45 minuta udhëtim me transport rrugor). Izokroni 45' përcakton hapësirën e lëvizjes së pranueshme ditore vajtje-ardhje për në punë. Çdo bashki është parimisht e interesuar të investojë brenda një hapësire të tillë për të shtuar infrastrukturat dhe shërbimet e për të rritur cilësinë e tyre, në funksion të ekonomisë së shkallës dhe zhvillimit ekonomik. Izokroni 45-minutësh i Elbasanit mbulon pjesën më të madhe të territorit të Elbasanit, shtrihet deri në Gramsh, mbulon thuajse të gjithë Cërrikun e Peqinin (në kufi me qarkun e Fierit) dhe zgjatet përgjatë Shkumbinit deri në Përrenjas. Ky është një nga izokronet me shtrirje më të madhe, por për të njëjtat arsye si për ZFU-në, ka mbivendosje vetëm me izokronin e Lushnjes dhe të Tiranës dhe kjo mbivendosje ndodh jashtë kufijve të bashkisë së Elbasanit.

Figura 5: Mbivendosja e izokroneve 45' - Zonat e integrimit të mundshëm



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Analiza e policentrizmit (aktual e potencial) e paraqet Bashkinë e Elbasanit si një zonë relativisht qendrore nga ana morfologjike (popullsia dhe PBB), por ende periferike nga pikëpamja e policentrizmit potencial. Elbasani ka komunikim ditor të rregullt me Tiranën dhe flukse të konsiderueshme të lëvizjes shtrihen deri në Gramsh e Rrogozhinë, por pengesat natyrore që qëndrojnë mes tij dhe qendrave të tjera të aglomerateve pengojnë fuqizimin e qendërsisë si tipar të kësaj bashkie. Nga ana tjetër, tregues si numrit i studentëve, vlera e shtuar bruto, numri i hoteleve e numri real i lëvizjeve janë në vlera mesatare e të larta, çka përforcon faktin se pozicionimi jo shumë konkurrues (për momentin) mund të thyhet lehtësisht nga interesi i njerëzve për aktivitet ekonomik në Elbasan. Pengesat natyrore po ashtu mund të eliminohen përmes akseve të reja rrugore. Faktikisht, Elbasani ka mundur deri diku të eliminojë "mitin e rrugës" si faktori i vetëm në zhvillim, që do të thotë se investimi në infrastrukturë rrugore mund ta kthejë lehtësisht në një bashki shumë konkurruese edhe përtej rajonit të saj.

1.2 TERRITORI DHE MJEDISI

1.2.1 Vlerësim i kushteve fizike

Bashkia Elbasan, siç u përmend edhe mësipër, shtrihet në zonën qendrore të vendit. Territori i bashkisë përshkohet nga rrjedha e mesme e Lumit Shkumbin dhe degëve të shumta që furnizojnë atë, si Lumi i Gostrimës, Lumi i Zaranikës, Lumi i Kushes dhe Zalli i Papërit. Një pjesë e mirë e tyre pothuajse shkarkohen shumë pranë qytetit të Elbasanit, ku Lumi i Zaranikës është kryesori, i cili kalon nëpër qytet. Gjithashtu, në territorin e Bashkisë Elbasan ka edhe shumë monumente natyrore, si pemë të lashta, si dhe zona të mbrojtura, si Sopoti, Stravaj dhe Kuturmani. I gjithë territorit ka një karakter tipik kodrinor-fushor. Zona fushore ndodhet në njësinë administrative Funar, ku ndodhet fusha e Funarit. Midis fushës së Funarit dhe përroit të Zaranikës ndodhet masivi kodrinor i Letanit, Rrilës, Preçës së Poshtëm, Preçës së Sipërm, Cerunjë, deri tek Qafa e Çoçobonit dhe kodrat e Balëzës. Në këtë zonë kemi një burim natyror që është shkëmbi i Letanit, i cili është tipik gëlqeror dolomite dhe që përdoret si lëndë e parë për Fabrikën e Çimentos[11]. Në njësinë administrative Gjergjan relievi është i kombinuar me fusha dhe kodra, të cilat shtrihen gjatë luginës të Lumit Shkumbin, si fushat e Muriqanit dhe e Thanës, kodrat e Gjomnit, Gjergjanit dhe Bujarasit[12].

Qyteti i Elbasanit është i ndërtuar mbi një pjesë të fushës së Elbasanit në sektorin Labinot-Papër, në një grykë të ndërtuar nga formacione molosike. Në pjesën veriore qyteti kufizohet nga zona kodrinore e fshatit Godolesh, i cili është ndërtuar nga formacione molosike të Pg3 (Palogjeni i sipërm). Në jug kufizohet nga shtrati i Lumit Shkumbin i përbërë nga depozitime lumore copëzore. Në lindje kufizohet nga kodra e Krastës e ndërtuar nga formacione gëlqerore të Cr2 (kretaku i sipërm) dhe në perëndim kufizohet nga fusha e Bradasheshit, e përbërë nga depozitimet poluviale të Lumit Shkumbin[13].

Në lidhje me strukturën dhe morfologjinë, qyteti i Elbasanit është vendosur në një tarracë lumore, ku shkallët janë të formuara nga depozitimet poluviale të Lumit Shkumbin gjatë periudhës kuaternare (Q4 pl), si pasojë e krijimit të shtratit të tij. Kjo tarracë është e ndërtuar nga depozitime të përbëra nga formacione argjilore, konglomeratike aleorolitore me ranore të rrallë. Në prerjen tërthore të depozitave vërehen alternime të këtyre depozitimeve.

Këto lloj formacionesh litologjike dëshmojnë se kemi të bëjmë me formacione gjeologjike të një qëndrueshmërie mekanike të vogël. Duke pasur parasysh këtë fenomen gjeologjik të zonës, rekomandohet që për të gjitha

ndërtimet duhet të gërmohen themele deri në thellësinë ku formacioni është i njëtrajtshëm dhe me qëndrueshmëri të lartë. Kjo thellësi luhatet, ku madhësia e saj rritet nga pjesa veriore në atë jugore të zonës së qytetit, si dhe më pak nga lindja në perëndim[14]. Megjithatë ky është një rekomandim që do të plotësohet më tej gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, kur të përcaktohen zonat ndërtimore të Bashkisë.

Bashkia Elbasan, sipas ndarjes klimatike në Shqipëri, bën pjesë në zonën mesdhetare kodrinore dhe nën-zonën mesdhetare kodrinore qendrore. Kjo bashki ka një larmi relievesh dhe shtrirja e saj e gjerë veri-jug ndikon në regjimin e elementeve klimatike. Temperatura mesatare luhatet nga 6.7°C-11°C në janar, në 23.4°C - 31.2°C në korrik[15].

Për sa i takon erërave, Elbasani karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë (rreth 53%) dhe shpejtësi minimale 1.2 m/s gjatë verës dhe shpejtësi mesatare maksimale 2.1–2.4 m/s në dimër. Erërat që fryjnë nga verilindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4.7 m/s. Nëse periudha e dimrit dominohet nga erërat verilindore, gjatë periudhës së pranverës erërat kanë drejtim jugperëndimor, i cili vazhdon edhe gjatë periudhës së verës. Gjatë stinës së vjeshtës erërat forcohen me drejtim veriperëndimor, por ndikimi i tyre është i papërfillshëm.

Pjesa më e madhe e reshjeve bien gjatë stinës së vjeshtës dhe dimrit (65.8% e reshjeve totale) dhe më pak në periudhën e verës dhe pranverës (34.2% e reshjeve totale) për shkak të aktivitetit ciklonik. Sasia totale e reshjeve vjetore është rreth 1,148 mm shi në vit, ndërsa maksimumi i reshjeve në 24 orë është 134.9 mm. Muaji më i lagësht i vitit është nëntori me 141 mm, kurse muaji me i thatë është korriku me 25 mm shi. Në territorin e Bashkisë Elbasan reshjet e dëborës janë të rralla me një mesatare 1.2 ditë në vit me reshje[16].

Rrezatimit diellor karakterizohet nga një sasi vjetore rreth 1,448.5 kWh/m^2, ku vlera më e ulët ndodh në muajin Dhjetor me 50.1 kWh/m^2, dhe vlera më e lartë në korrik me 202.1 kWh/m^2. Gjatë gjithë vitit kemi afërsisht 2,441 orë me diell, ku vetëm korriku numëron rreth 326 orë me diell, ndërsa dhjetori vetëm 111 orë të tilla[17].

1.2.2 Metabolizmi i territorit

Analiza e Metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas Nenit 2 të VKM nr. 671 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", metabolizmi i territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Flukset e analizuara janë: fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve. Flukset analizohen nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në analizim. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në një sistemin urban (uji që analizon fluksi i ujit), vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve), sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore, menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

- **Energjia në Rajon**


Rajon që përbëhet nga bashkitë: Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnje, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajgurore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, Përrenjas, Librazhd, Pogradec[18], ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: ***Bankers Petroleum*** (Patos-Marinëz), ***TransAtlatic*** (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), ***Sherwood*** (Kuçovë), ***Transoilgroup*** (Visokë); ***Phoenix*** (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë pjesë të rëndësishme. Po ashtu, energjia hidrike vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore e energjisë.

Lumenj si Shkumbini, Osumi, Devolli përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluar dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike, vazhdon të mbetet burim kryesor energjie për konsumatorët familjarë por edhe për bizneset industritë apo institucionet.

Burimet alternative të energjisë si dielli, era, energjia gjeotermale shfrytëzohen shumë pak. Potencialet që ka për t'u përdorur këto energji janë të mëdha. Energjia e erës ka potencial të përdoret në ultësirën perëndimore, Divjaka, Rrogozhina dhe Fieri (zona veri-perëndimore) mund të përdoret për prodhimin e energjisë.

Energjia diellore është potencial thuajse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë. Rrezatimi arrin vlera nga 1,450

Figura 6: Harta e fluksit të energjisë në rajon




(Burimi: Energjia e Erës AKBN)

Vijë e pandërprerë tregon frekuencat e erës
Vijë e ndërprerë tregon shpjetësinë e erës

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP[20], 2015

Figura 7: Harta e fluksit të ujit në rajon (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore)



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP[21] 2015

kwh/m² deri në 1,650 kwh/m² [19]. Numri i lartë i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore.

Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Elbasan gjenden burime gjeotermale, temperatura e të cilëve arrin >80 °C. Përdorimi i kësaj energjie përveç efekteve pozitive, ka ndikim në mjedis dhe ekosistem, por nëse përdoren teknologjitë e duhura këto pasoja janë minimale. Nga përdorimi i energjisë gjeotermale efektet më të shpeshta negative janë ndotja e ajrit (nga gazërat që çlirohen) dhe ndotja e tokës.

- **Uji në Rajon**

Rajoni është i pasur më ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Shkumbini, Seman, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenj të më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë, në këtë zonë janë propozuar të ndërtohen pjesa më e madhe e HEC-eve.

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuifere ndërkokrrizore me përcjellshmëri të lartë uji, të cilat dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorime të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifere me porozitet karst-çarje dhe përcjellshmëri uji shumë të ndryshueshme shumë të lartë e të lartë, gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) dhe në pjesën jugperëndimore të Bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore janë cënuara nga ndotja. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferet karst-çarje ndikojnë në përçimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.

- **Analiza e Metabolizmit në Bashkinë Elbasan**

Analiza e metabolizmit të territorit në Bashkinë e Elbasanit merr në konsideratë disa faktorë kryesorë, që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Elbasani ka në sipërfaqe prej 872 m² dhe popullsi 144,382 banorë[22]. Flukset e analizuara në kuadër të analizës së metabolizmit janë: energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analizimi për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin fluks, me qëllim të kuptuarin e problemeve mjedisore dhe humbjeve.

- **Fluksi i energjisë**

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e Bashkisë Elbasan. Ky fluks tregon edhe për energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat kanë konsum më të lartë duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat janë të mbishfrytëzuara.

Potencialet energjetike dhe prodhimi i energjisë në territorin e Bashkisë Elbasan: Territori i Elbasanit shtrihet në një zonë me pasuri ujore, sipërfaqësore dhe nëntokësore. Për këtë arsye ka dhe një shfrytëzim të lartë të ujërave të lumenjve për prodhimin e energjisë hidrike. Gjithashtu, parashikohet që mbi Lumin Shkumbin të ndërtohen hidrocentrale të vegjël (>1MW) dhe hidrocentrale të mëdhenj (<50MW), që do të rrisin më shumë nivelin e shfrytëzimit të ujërave sipërfaqësore. Por prodhimi i energjisë nuk duhet kufizuar vetëm në energji hidrike, sepse ka potencial për t'u mbështetur edhe në energji të tjera alternative.

Elbasani ka potencial për të prodhuar energji gjeotermale, pasi në territorin e kësaj bashkie gjenden burimet termale të Kozani-8 dhe burimet e Lixhave të Treganit.

Territori i Elbasanit është pjesë e zonës gjeotermale Kruja, e cila shtrihet në rreth 180km dhe ka një gjerësi 4-5 km. Pusi Kozani-8, shtrihet 8km në veriperëndim të Elbasanit. Temperature e ujit që del nga një horizont në thellësinë 1,816-1,837m ka temperaturë që arrin deri në 80°C. Fuqia që mund të insalohet në këtë burim është 2,070kW. Prurjet e përgjithshme janë 10.31l/sek, ndërsa faktori i kapacitetit termik 1.93 MWt. Burimet termale të Lixhave të Treganit kanë temperaturë dhe debite të larta, (55-60)°C dhe prurje të përgjithshme përkatësisht 15 dhe 18 l/sek. [23].

Shqipëria ka një rrezatim diellor të konsiderueshëm për t'u përdorur si burim energjie. Elbasani ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,550 kW/m² në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të Elbasanit luhatet nga 1,615 në muaj (dhjetor) deri në 6,520 në muaj (korrik)[24]. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% dhe shfrytëzohet për prodhimi e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me panele fotovoltaike[25].

Konsumi i energjisë dhe Iloji i energjisë së përdorur për ngrohje: Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan[26] dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011, sipas INSTAT, numri mesatar i personave në një familje është 4 anëtarë. Numri i Njësive Ekonomike Familjare është **722, 600 familje** (Tabela 2). Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në një vit është:

Konsumi i energjisë elektrike nga familjet **(2,587,535)**/nr. e familjeve **(722, 600) =** Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 MWh). Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzojmë nr. e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike.

Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në Qarkun Elbasan, nga njësi ekonomike familjare (NjEF), vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. 77% të NjEF-ve në Qarkun Elbasan përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (13%) dhe më pas nga energjia elektrike (7%)[27].

Tabela 2: Rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe banesave 2011

Popullsia banuese gjithsej	**2,821,977**
Numri gjithsej i Njësive Ekonomike Familjare	**722,600**


Burimi: INSTAT, 2011 dhe përpunime të autorëve

Tabela 3: Bilanci i Energjisë Elektrike, 2011

Emërtimi	Energjia (MWh)
Energji në dispozicion (Burimet)	**7,532,055**
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Konsumi i energjisë elektrike	**7,210,731**
Humbjet në rrjet	2,179,157
Familjet	**2,587,907**
Të tjera	2,443,667

Burimi: INSTAT, 2011

Figura 8: Fluksi i energjisë në Bashkinë Elbasan




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN[28], 2015

Tabela 4: Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	73,044	31,564	41,480
Dru	56,004	15,750	40,254
Energji elektrike nga rrjeti	4,883	4,646	237
Gaz	9,655	9,095	560
Lloj tjetër energjie(panel diellor, qymyr, naftë, etj.)	203	125	78
Pa ngrohje	2,299	1,948	351

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Figura 9: Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale



Burimi: INSTAT, 2011 dhe përpunime të autorëve

- **Fluksi i ujit**

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit nga burime sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e Bashkisë Elbasan dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, ***imbotilim (uji i mbushur në shishe)***, dhe përdoret nga banorët, bizneset, industritë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast, territorin e Bashkisë Elbasan) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor[29].

Qyteti, zona industriale, zona ekonomike dhe tokat bujqësore, ku ndodhin zhvillimet më të mëdha shtrihen mbi shtresa nëntokësore ujëmbajtëse.

Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 22.7 km² në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan[30]. Në ujërat sipërfaqësore të Elbasanit bëjnë pjesë lumenjtë Shkumbin, Zaranika, Papër, përrenjtë dhe degëzimet e tyre si dhe të gjitha kanalet ujitëse.

Territori i Elbasanit është i pasur me ujëra nëntokësore. Qyteti i Elbasanit, zonat ekonomike dhe industriale shtrihen mbi akuiferë me porozitet ndërkokrrizore dhe përcjellshmëri uji shumë të lartë-të lartë. Burimet e ujërave nëntokësore ndodhen kryesisht në këto shtresa nëntokësore. Edhe shpimet janë bërë në këto shtresa. Sasia e ujit që shfrytëzohet nga burimet ujore është 1,441.1-2080.09 l/sek. (Harta Hidrografike, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - SHGJSH)[31].


Për të kuptuar përdorimin e ujit nga qytetarët dhe bizneset, i referohemi studimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujërave të zeza. Nga të dhënat e marra nga ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve, Bashkia e Elbasanit ka mbulim të mirë të shërbimit të ujësjellësit[32]. Të gjitha njësive administrative iu ofrohet shërbimi i ujësjellësit, përveç njësisë Funar, e cila nuk mbulohet me shërbimin e ujësjellësit. Në zonat që nuk ofrohet ky shërbim, banorët e sigurojnë ujin nëpërmjet puseve individuale, burimeve ose krojeve malore. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Elbasan sha[33], shfrytëzon tre pellgje ujëmbajtëse nëntokësore, në Mengel, Krastë e Vogël dhe Frigoriferi. Sasia totale e ujit që shfrytëzohet nga këto pellgje është 910 l/sek, ku pellgu ujëmbajtës Mengel shfrytëzohet 63% (280 l/sek), pellgu ujëmbajtës Mengel shfrytëzohet 107% (385 l/sek) dhe pellgu ujëmbledhës Krasta e vogël shfrytëzohet 68% (325 l/sek)[34].

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat UK Elbasan dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për popullsinë, numrin e banorëve për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Konsumi mesatar ditorë i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë[35].

- **Fluksi i ushqimit**

Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Elbasan, analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për përthithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku. Në këtë rast për të

Figura 10: Fluksi i ujit në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN[36], 2015

llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturat ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport. Sipas të dhënave të Bashkisë Elbasan, në territorin e kësaj bashkie prodhohen bujqësore (kryesisht drufrutorë) dhe blegtorale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik[37].

Toka bujqësore në Bashkinë Elbasan zë një sipërfaqe prej 17,600 ha, ndërsa zona natyrore, e cila mund të përdoret për mbjelljen e pemëve frutore, zë një sipërfaqe prej 62,900 ha[38]. Kjo tregon që Bashkia Elbasan ka territor të përshtatshëm për kultivimin e pemëve frutore dhe të perimeve të ndryshme.

Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat të INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Sasia e produkteve që konsumohet (treg dhe eksport) është më e lartë se sasia e produkteve që prodhohen në territorin e Bashkisë Elbasan. Kjo ndodh sepse një pjesë e produkteve që konsumohen nuk prodhohen në territorin e Elbasanit. Arsye tjetër është se burimi i të dhënave është i ndryshëm. Prodhimet janë përcaktuar nga INSTAT, ndërsa të dhënat për treg dhe eksport janë marrë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

- **Fluksi i mbetjeve**


Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia e Elbasanit para ndarjes territoriale). Edhe në këtë territor shërbimi ofrohen në nivelin 60-70%. Venddepozitimi i mbetjeve në Elbasan ndodhet 75 m larg brigjeve të Lumit Shkumbin në pjesën jugore të qytetit. Ky venddepozitim është klasifikuar si jo sanitar, mbetjet të cilat depozitohen aty janë mbetje të ngurta urbane, por edhe mbetje te tjera.

Tabela 5: Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Elbasan

Përbërës Niveli I		Përbërës Niveli II	Prodhim	Njësia hapësinore	Burimi i të dhënave
Prodhim Bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	6,490	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Perime (ton)	15,613	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Patate (ton)	4,833	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Fasule (ton)	583	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Bimë industriale (ton)	1,269	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Foragjere (ton)	107,125	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
	Prodhime në serra	Perime (ton)		Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
	Drufrutorë	Pemë frutore (ton)	5,864	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Ullinj (ton)	1,899	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Agrume (ton)	985	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Rrush gjithsej (ton)	784	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
Prodhimi blegtoral	Prodhim blegtoral	Qumësht (ton)	50,212	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Mish (ton)	2,425	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Lesh (ton)		Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Vezë (kokrra)	15,340,000	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Mjaltë (ton)	261	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan


Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 11: Prodhimet Bujqësore (në Kton), Bashkia Elbasan 2014




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 12: Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në Kton), në Bashkitë: Elbasan, Lushnjë, Fier, Berat dhe Kuçovë




Burimi: Bashkia Elbasan, Fier, Berat, Lushnje, Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Figura 13: Fluksi i ushqimit në Bashkinë Elbasan




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN[39], 2015

Figura 14: Prodhimet bujqësore për periudhën 2012-2013-2014 (në Kton), Qarku Elbasan



Burimi: INSTAT 2014, përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 15: Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në Kton), në Qarkun: Elbasan, Fier dhe Berat



Burimi: INSTAT 2014, përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Tabela 6: Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për Qarkun e Elbasan

Përbërës Niveli I		Përbërës Niveli II	HYRJE	POTENCIALET PRODHUESE	
			Prodhim	Treg	Eksport
Prodhim Bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	93,095		
		Perime (ton)	75,165	500,128	31,560
		Patate (ton)	31,756		
		Fasule (ton)	4,509		
		Bimë industrial (ton)	2,007		
		Foragjere (ton)	666,154		
	Prodhime në serra	Perime (ton)	5,522	56,924	13,170
	Drufrutorë	Pemë frutore (ton)	28,470	209,821	15,210
		Ullinj (ton)	14,833	60,960	1,850
		Agrume (ton)	1,666	15,370	260
		Rrush gjithsej (ton)	25,492	218,940	5,600
Prodhimi Blegtoral	Prodhim blegtoral	Qumësht (ton)	142,254	177,361	300,432
		Mish (ton)	17,100	33,818	
		Lesh (ton)	391		
		Vezë (kokrra)	77,559,272	46,318,000	
		Mjaltë (ton)	329	2,212	


Burimi: INSTAT (Prodhime) dhe MBZHRAU (Treg dhe Eksport) 2014; Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 16: Prodhimet bujqësore për periudhën 2012 - 2013-2014 (në Kton), Qarku Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 17: Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në Kton), në Qarkun: Elbasan, Fier dhe Berat



Burimi: Bashkia Elbasan, Fier, Berat, Lushnje, Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Në territorin e Bashkisë së Elbasan operojnë gjashtë kompani ricikluese. Kompania GDS sh.p.k operon në diferencimin dhe grumbullimin e mbetjeve të paketimit. Kompania KURUM, e cila ndodhet në Bradashesh, dhe Kompania Larti sh.p.k, riciklojnë metale. Një tjetër kompani, Gold Plus sh.p.k, grumbullon skrap. Në Bashkinë Elbasan operojnë edhe kompani për riciklimin e vajrave dhe nënprodukteve të tyre, Impuls-95 sh.p.k. dhe kompania Dritan Elezi, për përpunimin e mbetjeve të ndërtimit[40].

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Elbasan, jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg[41]. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Elbasanit. Sasia e gjeneruar në zonën urbane të qytetit të Elbasanit arrin në vlerën 1,604-3,197 ton/vit për km².

Ndotja që iu shkaktohet ujërave nëntokësore nga mbetjet urbane është e lartë për shkak të depërtimit të lëngut të ndotur të mbetjeve nga vend depozitimi (jo sanitar) i vendosur pranë shtratit të lumit, pra në zonën ku akuiferi afrohet maksimalisht me sipërfaqen e tokës. Po ashtu, shpimet për puse dhe gropa septike në territor ulin nivelin e filtrimit të ndotjes para mbërritjes në shtresat nëntokësore dhe rritin ndotjen në ujërat nëntokësore.


Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e Bashkisë Elbasan është përafërsisht 75 %, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 46.5%, 14.3% plastika dhe 13.4% letra. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin e këtij procesi[42].

- **Përfundime**

Sasia e energjisë së konsumuar për ngrohje në Qarkun Elbasan është e lartë, ku 77% e NjFE-ve, përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, 13 % përdorin gazin dhe 7% përdorin energjinë elektrike. Nëse përdoren të gjitha burimet alternative të energjisë, do të kemi një konsum më të ulët të energjisë që përftohet nga drutë e zjarrit apo energjia elektrike. Elbasani ndodhet ndërmjet izolinave 1,450-1,550 kW/m², energji potenciale për t'u përdorur për ngrohjet e banesave. Elbasani shtrihet në zonën gjeotermale Kruja dhe ka potencial për përdorimin e energjisë gjeotermale nëpërmjet burimeve gjeotermale të Kozani-8 dhe Llixhave të Treganit. Fuqia që mund të instalohet në pusin Kozani-8 është e konsiderueshme, 2,070kW. Energjia e eksportuar në nivel kombëtar përbën vetëm 8,6% të energjisë së importuar. Ky është një tregues që përveç humbjeve në rrjet, burimet alternative të energjisë nuk shfrytëzohen.

Sistemi i furnizimit me ujë mbulon 100% të popullsisë në qytetin e Elbasanit, por ky shërbim nuk shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Sistemi i furnizimit me ujë është pjesërisht konvencional (kryesisht në zonën urbane dhe një pjesë në zonat rurale). Ky sistem duhet të shtrihet në zonat ku mbulimi me ujë është problematik (ofrohet shërbimi pjesërisht ose nuk ofrohet fare), ndërsa një pjesë (në rastet kur është e mundur) mund të përdoren puset. Kërkesa aktuale për ujë në Bashkinë Elbasan është 1,699 m³/orë, ndërkohë që sasia e ujit të prodhuar është 2,875 m³/orë, pra gati dyfishi i kërkesës. Ky është një tregues

Figura 18: Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN[43], 2015

i kapaciteteve të larta prodhuese të ujit të pijshëm. Një menaxhim më i mirë i ofrimit të shërbimit do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Zona ujëmbajtëse shtrihet përgjatë qytetit të Elbasanit, ku ndodhin aktivitetet më të mëdha industriale, ekonomike dhe sociale. Kjo rrit mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe ndotjes së tokës.

Fluksi i ushqimit tregon që në territorin e Elbasanit produktet bujqësore që kanë prodhime të larta janë drithërat perimet, foragjerët dhe drufrutorët. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme bujqësore janë: drithërat, perimet e serave, fasulet, duhani, foragjerët, drufrutorët (vreshta, ullinj, pjeshkë). Prodhimin më të lartë nga produktet blegtorale e ka qumështi.

1.2.3 Mjedisi, ekosistemet dhe ndotja

- **Burimet Ujore Sipërfaqësore**

Bashkia e Elbasanit ka një rrjet të pasur hidrik. Territori i bashkisë përshkohet nga baseni i Lumit Shkumbin, i cili mbetet trupi ujor kryesor në bashki. Ai përshkon Bashkinë e Elbasanit nga lindja në perëndimi në një gjatësi prej 39 km. Lumi hyn në bashki nga fshatrat Labinot Fushë e Shushicë, vazhdon ndërmjet fshatrave Mjekës e Bradashesh dhe Papër dhe del nga territori i bashkisë për të vazhduar në drejtim të qytetit të Cërrikut. Brenda territorit të bashkisë, Shkumbini mbledh ujërat e një sërë lumenjsh të ndryshëm si Lumi i Garës që kalon në Labinot Fushë, Përroi i Manazders, Përroi i Zaranikës, Përroi i Baltëzës, Përroi i Kushes, Zalli i Papërit, të cilët ndodhen në anën e majtë të Lumit Shkumbin sjell me vete edhe ujërat e një numri të madh lumenjsh jashtë territorit të bashkisë (Lumit të Gjuraqit, vazhdim i degëzimeve Shmill dhe Shpell në degëzimin e tij djathtas, Zallit të Kostenjës (ish Lumi i Lunikut), degëzimi i Mesit, dhe Zallit të Qarrishtës (ose Rrapunit). Ky i fundit bashkohet në veri me Zallin e Gjurait, afër Librazhdit. Pjesa jugore e bashkisë preket edhe nga degë të Lumit Devoll (Baseni i Semanit). Ky degëzim është Përroi i Zallit të Gostimës (ndërmjet Gostimës dhe Stermenit), dhe Zalli i Kaçivelit të cilët shërbejnë si degë ushqyese kryesore të Devollit. Përveç lumenjve, bashkia ka edhe një numër liqenesh e rezervuarësh siç janë Liqeni i Treganit, ujëmbledhësi i Funarës dhe burimet termale në Tregan. Ndër rezervuarët dallohen tre ujëmbledhës në zonën e Funarit të rrethuar me kodra të veshura me pyje pishe. Në zonën e Funarit mund të përmendim edhe liqenet e Seferanit, Merhojës, etj.


Si rrjedhojë e mangësive në menaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, në rrjedhën e mesme dhe të ulët të Shkumbinit, zona ripariane ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë të gjithë brezat e bimësisë së nevojshme si bimët e ulëta deri tek ato të larta, ose nuk ekziston). Në disa raste, zona ripariane është kultivuar si tokë bujqësore. Kjo ka ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Kjo është shumë e rëndësishme duke ditur se akuiferi kokrrizor dhe me kapacitet të lartë ujëmbajtës shtrihet veçanërisht poshtë qytetit të Elbasanit dhe fushave të Bradasheshit e Cërrikut. Gjithashtu, gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës. Për më tepër, dëmtime të zonës ripariane, të shkaktuara nga proceset gjeologjike e gërryese të vetë lumit si dhe ato nga ndërhyrja e njeriut në territor nëpërmjet bujqësisë e urbanizimit, janë vënë re përgjatë gjithë shtrirjes së trupit ujor në Bashkinë Elbasan duke filluar në Labinot Fushë, e cila është edhe hyrja e Lumit Shkumbin në territorin e bashkisë e deri në daljen e tij në Papër.

Duke pasur si qëllim përcaktimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në disa lumenj të Shqipërisë qendrore dhe lidhjen e kësaj cilësie me përdorimin e tokës në territorin e bashkisë apo jashtë saj, Co-PLAN[44] kreu edhe monitorimin e cilësisë së ujërave të basenit të Shkumbinit, në 11 pika të tij. Disa nga pikat e monitorimit[45] dhe disa parametra kimikë[46] janë të përbashkët me monitorimet që kryen Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Për interpretimin e rezultateve janë marrë parasysh si standardet shqiptare ashtu edhe direktiva të ndryshme të Bashkimit Evropian.

Lidhur me rezultatet, nga monitorimi i kryer u vu re se ujërat e Lumit Shkumbin janë alkalinë (pH >7)[47] në të gjitha pikat e monitorimit, brenda dhe jashtë territorit të bashkisë (Figura 21), gjetje kjo që përputhet me rezultatet e monitorimit të ujërave nga AKM[48].


Në Lumin Shkumbin, thellësia e depërtimit të dritës nuk përbën problem sepse thellësia e lumit është e vogël pothuajse gjatë gjithë rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit. Njëkohësisht, lumi ka ujëra të rrjedhshme të cilat kanë aftësi të pastrohen me shpejtësi. Përçueshmëria elektrike është brenda parametrave mjedisorë (nën 500 μhos/cm)[49] me përjashtim të pikave 10-11 që përkojnë me segmentin lumor nga Rrogozhina deri në grykëderdhje, të cilat tregojnë vlera më të larta se normat e lejuara duke krijuar një mjedis të papërshtatshëm ujor për zhvillimin e biodiversitetit. Vlerat tregojnë qartë një lidhje të drejtpërdrejtë të përçueshmërisë elektrike me pH-in, ku ujërat bazikë kanë vlera brenda normave të lejuara mjedisore.

Figura 19: Burimet ujore dhe akuiferët e Elbasanit (Baseni i Shkumbinit, lumenjtë kryesorë dhe akuiferët



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN (burimet ujore), 2015 dhe SHGJSH (akuiferët)

Figura 20: Harta e marrjes së kampioneve për monitorim në Shkumbin



Burimi: Co-PLAN, PLGP 2015

Figura 21: pH i ujërave të Shkumbinit




Figura 22: Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe Oksigjeni i Tretur në Shkumbin




Figura 23: Lënda e ngurtë pezull dhe e tretur në Shkumbin





Figura 24: Amoniaku, nitratet dhe nitritet në Basenin e Lumit Shkumbin



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Vlerat e NBO_5[50] janë brenda normës[51] në të gjitha pikat e monitorimit, rezultate të cilat ndryshojnë me gjetjet e AKM[52] vetëm për segmentin Toplias- grykëderdhje, ku vlerat janë të një cilësie të tretë. Megjithatë, duke pasur parasysh derdhjen e ujërave të zeza në lumë, vlerat e NBO_5 tregojnë qartë nevojën për ta analizuar këtë parametër në lidhje me faktorë të tjerë që ndikojnë vlerat e këtij parametri në ujërat e lumenjve (vendndodhja e burimeve kryesore të ndotjes në lumë si industria, pikat e derdhjes së ujërave të zeza të zonave të banuara, përmbajtja e metaleve të rënda në ujë, etj.). Prania e klorinës dhe metaleve të rënda në ujë ngadalëson, ose zvogëlon ndjeshëm NBO_5, sepse pengon aktivitetin e mikro-organizmave.

Lënda e ngurtë pezull është <2 mg/l në të gjitha pikat e monitorimit dhe shumë më e ulët se vlerat mjedisore[53]. Të njëjtën ecuri ndjek edhe lënda e ngurtë e tretur, por që ka vlera më të larta krahasuar me lëndën pezull. Kjo lidhet me burimet e lëndës së ngurtë të tretur që janë erozioni i tokës, mbetjet, ujërat e bardha, dhe gërryerja e brigjeve të lumit. Vlerat më të larta të lëndës së ngurtë të tretur vihen re në segmentin e lumit nga Ura e Rrogozhinës deri në grykëderdhje, dhe kjo mund të vijë si rezultat i grumbullimit nga rrjedha e mësipërme, por edhe nga gërryerja e tokës bujqësore.

Shkumbini ka përmbajtje brenda normave[54] të lejuara të **nitrateve** ($N\text{-}NO_3$) dhe përmbajtje të lartë të **nitriteve**[55] ($N\text{-}NO_2$) duke filluar nga Ura e Cërrikut deri në grykëderdhje (Figura 24). Përmbajtja e **amoniakut** ($N\text{-}NH_4$) paraqitet e lartë në Urën e Cërrikut ndërkohë që në pikat e tjera të monitorimit përmbajtja është brenda normave të lejuara[56]. Në rast se bazohemi në standardet e përdorura nga AKM[57], vlerat e nitrateve, nitriteve dhe amoniakut janë brenda normave të lejuara në të gjitha pikat e monitorimit me përjashtim të pikës së Rrogozhinës, ku vlerat e amoniakut dhe nitriteve klasifikohen si të kategorisë së tretë (gjendje e moderuar). Krahasuar ndërmjet tyre, Shkumbini ka përmbajtje të lartë nitrati, të ndjekur nga amoniaku dhe nitritet. Azoti së bashku me përbërësit e tij është një ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por i mbipërdorur në bujqësi si pleh kimik dhe për shkak të derdhjeve industriale, të ujërave të zeza e të gropave septike, gjë që shkakton ndotjen e ujërave të lumenjve. Sulfatet në Shkumbin janë në nivele të ulëta krahasuar me vlerat e lejuara[58]. Prania e tyre rritet gradualisht nga Kombinati Metalurgjik deri në grykëderdhje të Shkumbinit edhe pse vlerat mbeten gjithmonë brenda normave.

Nivele të larta të ndotjes në Shkumbin hasen për sa i përket bakterieve koliforme dhe metaleve të rënda. Koliformet janë mbi nivelin e lejuar (200 Cfu/100ml)[59] në të gjitha pikat e monitorimit.

Rezultatet e monitorimit janë tregues të nevojës për monitorim të mëtejshëm të ujërave të Shkumbinit për të përcaktuar nëse ujërat e tij janë të përshtatshme për ujitje dhe not.

Metalet e rënda janë monitoruar në dy pika monitorimi (përpara Uzinës së Metalurgjikut dhe tek Ura e Papërit) të cilat janë në territorin e Bashkisë. Ujërat janë të ndotur me plumb (Pb), kadmium (Cd), nikel (Ni), arsenik (As), hekur (Fe), bakër (Cu), dhe krom (Cr)[60].

Figura 25: Metalet e rënda në Basenin e Lumit Shkumbin





Figura 26: Metalet e Rënda në Basenin e Lumit Shkumbin



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Ndërkohë, vlerat e zinkut (Zn) dhe të arsenikut (Hg) janë brenda parametrave mjedisorë.

- **Përfundimet**

Rezultat e analizave dhe studime të mëparshme tregojnë se ujërat e Shkumbinit nuk janë në nivelin e duhur mjedisor për përdorim në bujqësi dhe argëtim, sidomos pas kalimit të lumit në Librazhd e më tej. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit në Elbasan. Një tjetër faktor që vlen të studiohet për Shkumbinin (nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit) është mundësia e ndërprerjes së rjedhës së tij nga pengesat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et) në degëzimet e tij. HEC-et që ndërpresin Shkumbinin në prodhim, në ndërtim, ose të projektuara, ndodhen jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë. Sipas riverwatch.eu[61], janë së paku 7 HEC-e ekzistuese, 7 në ndërtim dhe mbi 56 të planifikuara në Shkumbin dhe degët e tij furnizuese. Këto HEC-e kanë kapacitete të ndryshme nga më pak se 1MW deri mbi 50MW. Shumë prej HEC-eve të vogla janë planifikuar në degët kryesore të Shkumbinit që depërtojnë deri në burimet e tij në Shebenik-Jabllanicë (zonë e mbrojtur) dhe në Valamare. HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e erozionit detar, për shkak të uljes së sasisë së sedimentit të transportuar (HEC si pengesë fizike) në grykëderdhje, zvogëlimin e materialeve të ngurta të transportuara në det, si dhe në pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rjedhën e lumit mbas pengesës. Për më tepër, ato ndikojnë në tjetërsimin e ekosistemit (jo vetëm lumor) të zonës në të cilën ndërtohen. *Si rrjedhojë, rivlerësimi i ndërtimit të këtyre HEC-eve, dhe mundësisht shmangia e disa prej tyre, përfshirë edhe projekte për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të zeza dhe mbetjeve industriale) apo rehabilitimin e tij, duhet të kenë përparësi për bashkinë. Në këto projekte, Elbasani duhet të krijojë nisma bashkëpunimi me bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Shkumbinit me qëllim menaxhimin e integruar të këtij baseni dhe zonave përreth.*


- **Burimet Ujore Nëntokësore[62]**

Qarku i Elbasanit ka një rrjet të pasur pellgjesh ujore nëntokësore (akuiferë) (Figura 19). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës. Në Bashkinë

e Elbasanit mbizotërojnë akuiferët ndërkokrrizorë me përcjellshmëri të lartë dhe mesatare të ujit. Akuiferët ndërkokrrizor dhe me çarje-karst dallohen për kapacitet të lartë ujëmbajtës dhe përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë të industrisë, bujqësisë, dhe Bashkisë së Elbasanit, Peqinit, Belshit dhe Gramshit (Figura 27).

Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët) është formuar nga grumbullimi i zhavorreve dhe materialeve të tjera nga Lumi Shkumbin dhe Devoll[63]. Në këtë akuifer dallohen zona me përcjellshmëri shumë të lartë-të lartë të ujit (zona Vidhas-Bujqës), zona me përcjellshmëri të lartë të ujit, e cila përfshin Fushën e Elbasanit (nga Fushë-Labinoti deri në Papër[64]), zona me përcjellshmëri mesatare dhe të ulët të ujit që përfshin Fushën e Peqinit dhe Luginën e Devollit (nga Gramshi në Dëshiran). Ky akuifer ka lidhje hidraulike të mirë të ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë dhe rezerva uji të konsiderueshme për shfrytëzim. Ujërat nëntokësorë ushqehen kryesisht nga Lumi Shkumbin dhe kullohen në perëndim drejt Rrogozhinës-Karinë[65]. Nga ky akuifer furnizohen me ujë të pijshëm Bashkinë e Peqinit, Belshit dhe Gramshit nëpërmjet shpimeve. Një pjesë e mirë e qytetit të Elbasanit shtrihet mbi akuiferin ndërkokrrizor të ndodhur përgjatë Lumit Shkumbin, nga Miraka deri në Papër (Figura 19). Në territorin juglindor të bashkisë ndodhen pjesë të konsiderueshme të akuiferit me porozitet çarje-karst, me përcjellshmëri të ndryshueshme nga shumë e lartë në të ulët të ujit (p.sh. Masivi Karbonatik i Polisit) me shtrirje nga Llënga në afërsi të Librazhdit-Hotolisht në veri. Dukuria e karstit në këto akuiferë është e zhvilluar, ndërsa ujëmbajtja e tyre është e konsiderueshme. Nga ky akuifer dalin shumë burime (Burimi i Llëngës, Burimet e Radiçinës, Burimet e Bërzheshtës në Librazhd dhe Burimi i Gjurajt në Librazhd). Burimi i Grigjanit ka furnizuar rrethin e Elbasanit me ujë për më se tridhjetë vjet dhe del 2.5 km në lindje-verilindje të fushës së Mengelit në kuotën 200 m. Burimi i Byshekut (Shushicë) shfrytëzohet për furnizimin e centralizuar të disa fshatrave dhe objekteve blegtorale.

Figura 27: Klasifikimi dhe shtrirja e akuiferëve në Qarkun e Elbasanit



Burimi: SHGJSH, 2014

Përveç furnizimit me ujë të popullsisë, akuiferët shërbejnë edhe për furnizimin me ujë të industrisë, ujitjen e tokave bujqësore dhe furnizimin me ujë të qytetarëve. Akuiferët shfrytëzohen edhe ilegalisht duke rrezikuar ndotjen e tyre. Akuiferët ndërkokrrizor dhe me çarje-karst dallohen për një kapacitet të lartë ujëmbajtës. Këta akuiferë, të gjendur drejtpërdrejt mbi vendbanimet urbane, janë shumë të ndjeshëm ndaj ndotjes mjedisore nga pus-shpimet për ujë, derdhja e ujërave të zeza, mbetjet e industrisë dhe ato urbane, si dhe aktiviteti bujqësor. Akuiferi nuk përkon me kufijtë administrativ dhe ndotjet mund të shkaktohen nga zona të ndryshme. ***Gjithsesi, Bashkia e Elbasanit duhet të krijojë një inventar të hollësishëm të territoreve dhe pikave burimore (brenda territorit të saj) me rrezik ndotjeje për akuiferet dhe mbi këtë bazë të ndërmarrë projekte parandaluese dhe rehabilituese. Njëkohësisht, lipset që kjo bashki të bashkëpunojë me bashkitë e tjera për mbrojtjen e akuiferëve nga ndotja e shkaktuar përtej kufijve të saj.***

- **Ajri**

Para viteve '90-të, zona e Elbasanit ishte një ndër qendrat më të mëdha të industrisë së rëndë në vend. Ndonëse në ato vite konsiderohej si një nga zonat më të ndotura, përsëri edhe në ditët e sotme normat e ndotjes së ajrit janë akoma të larta dhe shqetësuese për zonën. Ato janë pikë referimi dhe krahasuese jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Evropën.

Në 2014, AKM ka montoruar[66] cilësinë e ajrit urban në Elbasan nëpërmjet matjes së parametrave PM_{10}, $PM_{2.5}$, NO_2, SO_2 , O_3, CO dhe Benzene, në tre stacione. Në bazë të rezultateve të nxjerra, AKM raporton se nga të dhënat e monitoruara, cilësia e ajrit urban në qytetin e Elbasanit nuk është e një niveli shumë të mirë. Ndotësit kryesore të cilësisë së ajrit urban në Elbasan janë pluhurat me diametër 10 dhe 2.5 mikrometër (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) dhe NO_2 në stacionet e trafikut. Një shqetësim jo i vogël për qytetin e Elbasanit mbetet përmbajtja e metaleve të rënda në përbërjen e aerosolit (metalet e rënda që gjenden si pjesë përbërëse e grimcave PM_{10} dhe $PM_{2.5}$. Me përmbajtje të lartë, mbi nivelin e lejuar gjendet plumbi (Pb), mbi nivelin e lejuar prej 1 µg/m3 dhe metale tw tjera (K, Fe, Zn). Më konkretisht, nga monitorimet e kryera rezulton se:

- **PM_{10}:** Vlerat mesatare vjetore e PM_{10} në Elbasan tejkalon vlerën kufi të BE-së prej 40µg/m^3 në tre stacione monitorimi në stacionin e Elbasanit. Vlera më e lartë ditore është monitoruar në muajin Prill dhe është 142.55 µg/m^3 nga 50 µg/m^3 që është standarti ditor i BE-së. Nga monitorimi rezulton një numër i lartë ditësh ku tejkalohet standarti ditor i BE-së (50 µg/m^3) që korrespondon me 63% (57 ditë) të ditëve të monitoruara.

- **Përbërjen e aerosoleve (PM_{10})**: në stacionin e Elbasanit, vihen re që për disa nga elementet e normuar janë matur përqendrime mjaft të larta, p.sh. në disa nga mostrat e matura përqendrimi i plumbit (Pb) është mbi nivelin e lejuar prej 1 µg/m3. Disa elemente (Ca, Ti) kanë vlera të përqendrimit në nivele të përafërta me të njëjtët elementë në stacionet e Tiranës, ndërsa disa elementë të tjerë (K, Fe, Zn, Pb) janë në përqendrime mjaft më të larta (rreth 100 herë më të larta se në Tiranë) pasi lidhen me shkarkimet e industrisë metalurgjike.
- **SO_2 (Dioksid Squfuri)**: Vlerat ditore dhe orare të monitoruara të SO_2 janë brenda normave[67]
- **NO_2 (Dioksid Azoti)**: vlerat e këtij parametri në stacionin e Elbasanit janë brenda normave të lejuara (32.67 µg/m³ kundrejt standardit të BE-së) dhe nuk vihen re orare ku këto vlera janë jashtë normës.
- **O_3 (Ozoni)**: në Elbasan, vlerat janë brenda normave
- **CO (Monoksidi i Karbonit)**: rezulton të jetë brenda vlerave të lejuara
- **C_6H_6 (Benzeni)**: vlerat e monitoruara mbeten gjithmonë brenda normave

Për sa i përket cilësisë së ajrit në katër vitet e fundit (2011-2014), AKM raporton se:

- Është rritur përmbajtja e SO_2 në pikat e monitoruara edhe pse mbetet brenda vlerave të lejuara e monitoruara;
- Edhe për NO_2 vihet re një rritje e përmbajtjes edhe pse sërish mbetet brenda normave.
- Ndërkohë që vihet re një ulje e përmbajtjes së O_3 në krahasim me standardin 8-orarësh dhe ditor të BE-së. Vlerat më të larta vihen re gjatë muajve të nxehtë të vitit.

Sot, burimet kryesore të ndotjes së ajrit në qytetin e Elbasanit janë:

- ***Ndotja nga mjetet e transportit***, numri i të cilave është shtuar ndjeshëm në dy dekadat e fundit. Sasia e gazeve që çlirojnë në ambjent këto mjete në trajtën e CO[68] nuk është i vogël. Kjo sasi varet nga vjetërsia e mjeteve të përdorura dhe shkalla e amortizimit të motorrave të tyre. Në rastet, kur cilësia e karburantin të përdorur nuk është shumë e mirë, rritet sasia e ajrit të ndotur në atmosferë, duke e ngarkuar ajrin me gazra helmuese nga djegia jo e mirë e karburantit.
- ***Ndotja nga pluhurat dhe gazrat***, që dalin nga veprimtaria e firmave të ndërtimit, që operojnë në qytet dhe në të gjithë zonën urbane;
- ***Ndotja nga pluhurat dhe gazrat e operatorëve*** të mëdhenj industrialë në periferinë e qytetit, të tilla si "KURUM Steel", "Fabrika e Çimentos ECF", që emetojnë sasira të konsiderueshme pluhurash e gazesh, të cilët, të favorizuar nga kushtet atmosferike, shndërrohen në ndotës të mëdhenj të qytetit. Kompleksi Metalurgjik i ndërtuar 4 km në vijë ajrore nga qyteti i Elbasanit, është një burim i mirëfilltë i ndotjes së ajrit si me gazëra dhe me pluhura. Aktualisht në këtë kompleks, përveç Uzinës së Çelikut dhe petëzimit, ka një sërë aktivitetsh të tjera private që kanë të bëjnë me linja të karakterit të prodhimit kimik (si ajo e prodhimit të SO_2 dhe një linjë e prodhimit të polisterolit), si dhe linja të tjera të karakterit depozitues apo përpunues (grumbullim-shitje gazit të lëngët, apo linja të përpunimeve mekanike). Zhvillimi i këtyre aktiviteteve çon në ndotjen e ajrit me komponime kimike si SO_2[69], CO[70], NO_X[71], pluhura të respirueshme, ngarkesa pluhurore të ajrit etj. Gazi sulfuror në prezencë të lagështisë kalon në acid sulfhidrik (H_2S), acid që ka ndikimet e tij në ujrat sipërfaqësorë dhe nëntokësore, duke ndikuar ndjeshëm në biodiversitetin e zonës. I njëjti fenomen shfaqet dhe me tretjet e N e NOx që mund të shoqërohen me formimin e amonjakut apo të acideve nitrore dhe që kanë po të njëjtat ndikime.

Në territorin e Bashkisë Elbasan janë edhe dy fabrika të tjera, të cilat kontribuojnë në prodhimin e ndotësve të ajrit si Fabrika e Punimeve Karbonike dhe Fabrika e Tullave Refraktare, ku destinacioni i secilës është kthyer në tulla ndërtimore. Masa që përpunon Fabrika e Karbonit është e natyrës së pekut, të marrë nga distilimi i katranit të koksit. Siç dihet, ky katran ka në përbërje të tij me qindra komponentë organikë, ku spikasin ato me natyrë fenolike dhe ato të natyrës se benzopirenit (lëndë kancerogjene). Pra, gjatë përpunimit termik të këtij peku, përveç komponentëve të tjera që çlirohen në ajër, janë dhe këto dy elemente tepër të dëmshëm.

Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe Uzina Kimike e Mjekës, e cila ndodhet 4 km larg qytetit të Elbasanit në vijë ajrore, e vetmja uzinë e sintezës organike industriale në rang vendi, nëse ajo do të punonte plotësisht. Aktualisht sot në këtë uzinë punojnë vetëm dy reparte, ku vetëm njëri prej tyre përbën rrezik për ndotjen e ajrit, pasi aty bëhet shkatërrimi nga municione të lehta me djegie dhe gjatë saj gazrat që shkarkohen në atmosferë kanë në përbërjen e tyre CO, CO_2[72], N_2O.

Mbetjet urbane janë një burim tjetër i ndotjes së ajrit dhe në territorin e Bashkisë Elbasan ka shumë venddepozitime jo-sanitare, ndërkohë që një ***landfill*** po ndërtohet në territorin e uzinës metalurgjike. Venddepozitimi në qytetin e Elbasanit ndodhet vetëm 2 km larg qendrës së qytetit, ku në të shumtën e rasteve kemi fenomenin e djegies së

Figura 28: Ndotja e ajrit nga zona industriale, Elbasan



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015

mbetjeve dhe çlirimin e gazeve të dëmshëm si CH_4[73], CO_2 etj. Shpesh herë qyteti mbulohet nga reja e smogut dhe erërat e pakëndshme, kryesisht gjatë periudhës së verës, ku temperaturat janë shumë të larta[74].

Nga studimet e stafit të bashkisë[75] rezulton se ndikimi i operatorëve industriale ndaj ndotjes totale është rreth 83%, kurse ndikimi i bizneseve të tjera dhe i mjeteve të transportit të qytetit është vetëm rreth 17%.

Zona industriale, veçanërisht firma "Kurum" e prodhimit të çeliqeve është ndër ndotësit kryesorë me PM_{10}, ashtu siç raportohet edhe nga të dhënat e raportit të fundit të gjendjes së mjedisit për vitin 2014, ku vlera e PM_{10} në Elbasan tejkalonte normën e lejuar të BE-së (norma 40μg/m^3) edhe pse efektiviteti i kapjes së pluhurit në ndërmarrjen e mësipërme është rritur vitet e fundit. Kjo rritje mesatare prej vetëm 3% është e pamjaftueshme për të përmirësuar gjendjen.

- **Përfundime**

Nga të dhënat e fundit të Raportit të Gjendjes së Mjedisit për vitin 2014, vlerat mesatare vjetore të PM^{10} për qytetin e Elbasanit janë (45μg/m^3) mbi normën e lejuar të BE (40 μg/m^3). Vlerat e SO_2 nuk i kalojnë normat e lejuara të BE, ndërsa niveli i NO_2 (32 μg/m^3) është shumë pranë normave të BE-së (40 μg/m^3) pa i tejkaluar ato. Ndotësit e tjerë si O_3, $PM_{2.5}$ C_6H_6 janë brenda normave të lejuara dhe shpesh herë në sasi shumë të vogla. Nisur nga këto të dhëna, problem për qytetin e Elbasanit dhe zonat përreth tij mbeten vlerat mbi normat e lejuara të grimcave PM_{10}, si dhe vlerat të NO_2, të cilat janë shumë afër normës së lejuar dhe që në periudha të ndryshme të vitit por edhe të ditës mund të kalojnë vlerën e lejuar.

- **Biodiversiteti, peizazhi dhe zonat e mbrojtura**

Fauna: Zona e Bashkisë Elbasan është shumë e pasur me botë shtazore, e cila gjatë dy dekadave të fundit është dëmtuar si rezultat i gjuetisë së shfrenuar, ku shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes. Kjo zonë është e populluar nga specie si ariu, kaprolli, ujku, lepuri, dhelpra, kunadhe, baldosa, thëllëza e fushës dhe e malit, rosat e egra turtujt, pëllumbat e egër, guguçet (e famshmja kumria e Elbasanit), dhe nga të dhënat rezultojnë të zhdukur derri i egër, dhia e egër, fazani, lejlekët, pelikanët etj.

Që kjo zonë të mos vazhdojë të humbët speciet e faunës, duhet të merren masa të forta për rehabilitimin e kafshëve të zhdukura të cilat konsistojnë në:

- *Ndërprerjen e gjuetisë sportive për minimumi 5 vjet,*
- *Rikrijimi i kushteve për afrimin e kafshëve dhe shpendëve të larguar për mungesë të këtyre kushteve në kohë dhe sistem.*

Flora: Zona e Elbasanit ka pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen lumenjtë, liqenet (zona e Dumresë), zona e mesme dhe e lartë malore, kodrat e ullinjve që rrethojnë qytetin, shkurret mesdhetare, pyjet gjethe gjerë, ato halore dhe përzierjet me kullota.

Gjatë dy dekadave të fundit zona është përballur me problem të shumta, si shpyllëzimet, prerje e ullinjve në pjesën verilindore të qytetit të Elbasanit, ndërtimet në zonat e gjelbëruara, si dhe urbanizimi i zonave të gjelbra në brendësi të qytetit. Pas vitit 1997 në këtë zonë dëmet e mëdha janë ndjerë shumë, ku rreth 1,100 ha janë zhdukur nga prerja e pyllit me plepa, vërrinj, rrape, shelgje, e të tjera lloje shumë të qëndrueshme ndaj ndotjes industriale dhe me ndikim të madh për uljen e ndotjes. Ajo që ka mbetur sot është Pylli Aluvial i Shushicës, i cili ruhet si Monument Natyre.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit, projektligji i ri "Për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor", i cili ndodhet në Kuvend për miratim, do t'ju krijojë bashkive mundësi financiare për mirëmenaxhimin pyjeve dhe menaxhimin e nevojave për ngrohje të qytetarëve shqiptare. Ky Moratorium 10-vjeçar, do të ndalojë prerjen e pyjeve në mënyrë të pakontrolluar nga kompani dhe individë të ndryshëm.

NJA Funarë: Bimësia natyrore përbëhet nga shkurre mesdhetare (shkozë, dushk) në jug dhe në pyjet e ahut në veri. Kjo zonë shërben për gjuetinë e kafshëve të egra, sidomos e derrit të egër. NJA Gjinar: Zona ka male që janë të veshura me pyje të ahut e të pishës, si pyjet e ahut të Skalatrës, të Bukanikut, Zavalinës, pishat e Gjinarit, etj.; që janë dhe zona gjuetie të kafshëve të egra, si derri, kaprolli, lepuri, ariu. Maja më e lartë është ajo e Bukanikut (1,831 m). NJA Labinot Mal, Papër, Shirgjan, Shushicë: Burimet natyrore janë të mëdha si pyjet e ahut, të pishës, të dushkut, shkozës e në zonat e ulta shkurre mesdhetare (që shfrytëzohen).

- **Zonat e mbrojtura**

Bashka Elbasan karakterizohet nga zona me vlera të mëdha natyrore dhe piktoreske, për të cilat duhet treguar një kujdes i veçantë, falë edhe statusit që ata kanë. Të tilla zona mund të përmendim, si Busheku, Rrapi Bezistanit, Zona e Llixhave sidomos ajo e Hidrait, Gurra Labinotit, Ulliri i qejfit, etj. Një zonë e një rëndësie të veçantë është edhe ajo e Dumresë (në Qarkun e Elbasanit dhe në kufi me Bashkinë e Elbasanit), e cila karakterizohet nga 56 liqene me origjine karstike, ku ndër kryesorët përmendim Liqeni i Merhoit, liqeni i Stefanit, Gjoli i degës, Cestijes Cepes, etj. Flora dhe fauna e kësaj zonë karakterizohet nga pyje natyrale, zambakët e liqeneve, shpezët si rosa apo patat, bajzat dhe mbi të gjitha pelikanët që tashmë pothuajse janë në zhdukje.

Një tjetër dukuri pasuri e veçantë natyrore janë edhe ligatinat, të cilat kanë vlera biologjike, ekonomike dhe sociale shumë të madhe për zonën. Në zonën e Elbasanit ligatinat ndodhen në pellgjet e lumenjve që e përshkojnë qytetin, të cilat janë pronësi dhe administrohen nga shteti. Në këtë kontekst përmendim ligatinat përgjatë pellgut ujëmbledhës të Lumit Shkumbin, liqenet e Belshit dhe rezervuarët artificialë në zonë.

Lumi Shkumbin, i cili kalon në territorin e qytetit të Elbasanit merr ujërat e degëve të përroit të Zaranikës dhe Manazderës dhe gjatë gjithë rrjedhës së tij konstatohet që ai ka një furnizim nëntokësor të fuqishëm. Dukë qenë që lugina e Lumit Shkumbin mbledh ujërat e lartësive mbi 2000 m të Valmarës dhe Çermenikës, shpjegon edhe faktin që prurjen më të madhe e ka në muajt prill dhe maj, ku edhe lumi del nga shtrati, duke përmbytur dhe gërryer tokat përgjatë bregut, kryesisht në pjesën jugore të qytetit.

Rezervat Natyror i Menaxhuar[76]

Qafë Bushi. Sipërfaqe aktuale e kësaj zonë është 500 ha në lartësinë deri në 1,100 m mbi nivelin e detit, dhe pjesa perëndimore e tij përfshihet në territorin e ***Bashkisë Elbasan në NJA Labinot Mal.*** Ndonëse kjo zonë është më se e dëmtuar dhe e mbishfrytëzuar, ajo paraqet vlera të një zonë me përfaqësim të gjerë të pyllit të dushkut, të florës dhe faunës së tij. Kryesisht është përdorur si rezervat për gjuetinë e derrit të egër (***sus scrofa***), lepurit, thëllëzës, etj. Aktualisht kjo zonë nuk ka një plan menaxhimi.

Sopoti. Sipërfaqe aktuale e kësaj zone është 300 ha në lartësinë deri në 1,600 m mbi nivelin e detit, dhe pjesa perëndimore e tij përfshihet në territorin e ***Bashkisë Elbasan në NJA Zavalinë.*** Në këtë zonë ka një sërë habitatesh, si pyje, kullota subalpine dhe alpine, liqene akullnajore, kanione, maja, etj. Kjo zonë karakterizohet edhe nga shumë bimë endemike dhe subendemike, ku veçohet Hypericum albanicum dhe Lilium albanicum, si dhe kombinimi i pyjeve me ah dhe bredh, të vendosura në një terren pak të pjerrët, ku hasim edhe kullotat alpine të bimësisë së çeltirave që i japin këtij territori një bukuri të veçantë. Gjithashtu, zona përbën edhe një bërthamë dhe biokorridor shumë të rëndësishëm për rruazorët e mëdhenj si ariun, rrëqebullin, dhinë e egër, kaprollin, etj. Aktualisht kjo zonë nuk ka një plan menaxhimi.

Kuturmani. Sipërfaqe aktuale e zonës është 3,600 ha me lartësinë deri në 1,100 m mbi nivelin e detit, ku vetëm një sipërfaqe e vogël në perëndim të tij përfshihet në territorin e ***Bashkisë Elbasan në NJA Labinot Mal***. Zona është pjesërisht e dëmtuar dhe e mbishfrytëzuar, por ajo paraqet vlera të përfaqësimit të gjerë të pyllit të dushkut, florës dhe faunës së tij. Ai njihet si rezervati për gjuetinë e derrit të egër, lepurit, thëllëzës etj. Aktualisht kjo zonë nuk ka një plan menaxhimi.

Monumente Natyre

Dushku i Lleshanit ndodhet në fshatin Lleshan, pranë rrugës për ***në Gjinar***, në një lartësi rreth 1,000 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një dru lisi të veçuar, me formë të rregullt dhe në gjendje të mirë. Lartësia e tij është rreth 21 m, diametri i trungut 120 cm, perimetri i trungut 240 cm. Ka 32 degë me një perimetër të përgjithshëm rreth 92 m. Mosha e tij është 250 vjeçare. Ka qenë gjithnjë si pikë takimi për banorët e fshatit. Vlerat e tij janë shkencore (biologjike), didaktike, estetiko-turistike.

Pisha e Fushë Kuqes ndodhet në fshatin Gjinar të ***NJA Gjinar***, në lartësinë 920-1,000 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore pishe e zezë prej 2 ha. Forma e sipërfaqes pyjore është trapezoidale. Përbëhet nga drurë të vjetër dhe të rinj, me lartësi 18-20 m, ndërsa diametri i trungjeve arrin deri 38cm. Mosha e tyre është 149-158 vjet. Ka vlera biologjike, didaktike, estetiko-turistike dhe klimaterike. Deri në fundin e viteve '80 aty funksiononte pika turistike e Gjinarit.

Dushku i Kishës Gjinar gjendet pranë kishës së ***fshatit Gjinar***, 900 metra mbi nivelin e detit. Përfaqëson një dru lisi të veçuar, me formë të rregullt ombrellore dhe ka dëmtime të ndjeshme nga faktorët natyrorë, kryesisht nga shkarkimet atmosferike. Lartësia e tij është 22 m, diametri e perimetri i trungut janë përkatësisht 210 cm dhe 670 cm. Ka 9 degë që formojnë kurorën me perimetër 82 m. Mosha e tij është 300 vjeçare.

Lisat e Pashtreshit gjenden në pjesën lindje-juglindje të fshatit Pashtresh, të ***NJA Gjinar***. Përfaqëson një grup drurësh prej lisi, në një sipërfaqe të vogël në formë rrethore. Drurët janë të rregullt, me trup të drejtë e të ruajtur relativisht mirë. Lartësia e tyre është 16-18 m, ndërsa diametri i trungjeve është 68-70 cm. Lartësia mbi nivelin e detit është rreth 700 m. Kanë moshë 200-250 vjeçare. Pranë tyre është një kishë gati e rrënuar.

Rrobulli i Zeleshnjës gjendet pranë fshatit Zeleshnjë, ***NJA Gjinar***, në lartësinë 1,650-1,700 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore 1.5 ha rrobulli. Kjo zonë njihet edhe me emrin pylli i staneve të Verçës. Lartësia e drurëve është 18-20 m, me diametër të trungjeve në 35-40 cm, ndërsa mosha e tyre është 100-120 vjeçare. Aktualisht këto pyje janë gjendje të mirë dhe janë të rrethuar me livadhe dhe pylli me pisha dhe ahe.

Rrapi i Gurrës së Labinotit ndodhet në pjesën perëndimore të fshatit Labinot Mal, në ***NJA Labinot Mal***. Ai përfaqëson një dru rrapi të veçuar, me një kurorë të rregullt dhe ruhet në gjendje të mirë edhe nga vetë banorët e zonës, ku në shumë raste ka shërbyer edhe si pikë takimi apo vend pushimi për ta. Pranë rrapit ndodhet edhe burimi ujor karstik i Gurrës së Labinotit. Ai ndodhet në lartësinë 820 m mbi nivelin e detit, me lartësi 16 m. Diametri i trungut është 94 cm, ndërsa perimetri i tij është 294 cm. Ka mbi 20 degë që formojnë kurorën me perimetër 42 m. Mosha e monumentit është 110 vjeçare. Vizitohet sipas degëzimit të rrugës kombëtare Elbasan-Librazhd, duke filluar nga Labinot-Fushë deri në Labinot-Mal[77].

Pylli aluvial i Shushicës ndodhet përgjatë shtratit të Lumit Shkumbin afër fshatit Shushicë në ***NJA Shushicë***. Në këtë pyll aluvial gjejmë shoqërime bimësh më tepër higrofile (shelgje, rapisht), mjaft të dendur dhe në gjendje natyrore. Si i tillë ka vlera të veçanta, edhe pse me moshë të re (rreth 9-10 vjeçare). Vizitohet duke marrë rrugën Elbasan-Shushicë.


Rrapët e Byshekut ndodhen në fshatin Shushicë të ***NJA Shushicë***, në të majtë të Lumit Shkumbin, rreth 175 m mbi nivelin e detit. Ato përfaqësojnë një grup drurësh prej rrapi në një sipërfaqe prej 0,4 ha. Lartësia e drurëve është 18-22 m. Diametri i trungjeve është 50-87 cm, por edhe më shumë, ndërsa mosha e tyre është 500-600 vjeçare. Pranë tyre ka burime me ujë dhe sistemime e rregullime në dobi të vizitorëve ditorë nga Elbasani, etj. Pronësia është shtetërore dhe në përgjithësi gjendja e drurëve është e mirë. Ka drurë të dëmtuar nga faktorë natyrorë, nga mosha e madhe, por edhe zgavrim trungu nga zjarret e vënë nga vizitorët e pakujdesshëm.

Frashëri i Madh Polis-Valë ndodhet në fshatin Polis Valë në ***NJA Shushicë***. Ai është një dru me moshë të vjetër, mbi 20 m i lartë, i zhvilluar mjaft mirë në mes të shkurreve të përfaqësuara nga shkoza. Vizitohet duke marrë rrugën Elbasan ose Librazhd-Polis-Val[78].

Llixhat e Hidrajt sot janë monument natyre dhe gjenden në pjesën e sipërme të përroit të Llixhave, rreth 200 m mbi nivelin e detit në ***NJA Tregan***. Këto burime termominerare, të cilat arrijnë temperaturën rreth 400 gradë, kanë përmbajtje kripërash dhe gazrash të tretura në to. Këto ujëra janë përdorur me kohë për kurimin e sëmundjeve të poliartritit, artritit, reumatizmës, etj. Kjo zonë është e përshtatur me shërbim hotelerie dhe shërbim të rregullt mjekësor. Gjatë këtyre 10 viteve të fundit mjediset janë shtuar dhe kushtet janë përmirësuar. Shumë pranë llixhave ndodhet edhe pylli me dushqe, i cili është në gjendje të mirë.

Mështekna e Zavalinës ndodhet në afërsi të fshatit Zavalinë ***NJA Zavalinë*** lartësinë 1,000-1,170 m mbi nivelin e detit. Ajo ka një sipërfaqe 7.5 ha me pyje mështekne, të cilat kanë një moshë 130 vjeçare. Lartësia e tyre është rreth 16 m, diametri i trungut arrin deri 22 cm. Është në pronësi të shtetit dhe ruhet ende mirë, përveç disa prerjeve të paligjshme që janë kryer nga mesi i viteve '90.

Figura 29: Vatrat e nxehta mjedisore në territorin e Bashkisë Elbasan



Burimi: UNECE, 2012; Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Mani i Zi i Joronishtit ndodhet në qendër të fshatit Joronisht në ***NJA Zavalinë***, i cili është një dru mani i veçuar. Askush nuk mban mend si është gjendur ai aty, por gjithnjë ai ka qenë vendi ku grumbulloheshin banorët e fshatit për takime, kuvende, etj. Mani ka lartësi 8 m, diametër të trungut 72 cm, ka 4 degë që formojnë kurorën ombrellore me perimetër 26 m. Perimetri i trungut është 226 cm, ndërsa mosha është 320 vjeçare. Është në pronësi private dhe ruhet relativisht mirë. Vizitohet sipas rrugës Elbasan-Zavalinë-Joronisht[79].

Burimi i përroit të Kushes ndodhet në fshatin Gjorme, në lindje të Autostradës Tiranë – Elbasan. Uji buron nga një lartësi 10-15 metra nga disa ballkone shkëmbore dhe është i rrethuar me rrepe të ngjashme me Byshekun. Aktualisht nuk ka rrugë automobilistike që mund të krijojë aksesueshmëri me këtë monument natyre[80].

- **Vatrat e nxehta mjedisore**

Elbasani ka dy vatra të nxehta mjedisore, që janë Uzina e Shkrirjes së Ferrokromit dhe Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera. Në Elbasan ndodhet edhe Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës edhe pse nuk është renditur si vatër e nxehtë, pasi ndikimi i saj në popullsi, në turizëm dhe në biodiversitet nuk përbën një rrezik të lartë.

Kombinati Metalurgjik i Elbasanit është përcaktuar si një ndër 35 vatrat e nxehta mjedisore të vendit tonë[81] sepse mbart 400,000 m^3 mbetje industriale të rrezikshme. Për përcaktimin e llojit të ndotjes dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes që ky kombinat ka shkaktuar në mjedis, janë kryer shumë studime[82], të cilat kanë arritur se në Kombinatin Metalurgjik toka në brendësi dhe përreth kombinatit është ndotur me metale të rënda si Cd[83], Zn[84], Cu[85], etj. Nga studimi i kryer nga Tota et al. në vitin 2007, rezulton se ndotja me metale të rënda (Cd, Zn, dhe Cu) e tokës bujqësore përreth Kombinatit Metalurgjik[86] me rreze shtrirjeje 2-5 km përreth kombinatit është e theksuar. Toka bujqësore në Papër, Bradashesh dhe përreth Metalurgjikut është ndotur me Cr[87]. Një studim tjetër[88] ka monitoruar ndotjen e qytetit të Elbasanit në pika të ndryshme të qytetit për të parë largësinë, të cilën era ka transportuar ndotjen nëpërmjet pluhurit. Sipas këtij studimi, për metalet e rënda si Cr[89], Ni[90], dhe Pb[91], ndikimi në mjedis është më i lartë nëpërmjet ajrit sesa tokës. Ndotja më e lartë me Cr është në zonën Veri-perëndimore ku ndodhet edhe Metalurgjiku. Vlerat më të larta të Fe gjenden në pjesën jugore, afër unazës së qytetit e cila shpjegohet me transportin e skorieve të Fe-Ni nëpërmjet kësaj rruge. Të gjitha vlerat e Fe janë më të larta se standardet mjedisore. Toka është ndotur me Cr, Zn dhe Fe ndërsa nëpërmjet ajrit është ndotur mjedisi me Fe[92], Mn[93], Zn, Cr, Ni dhe Pb.

Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera (NFIM) ndodhet në Balëz. Sipas raportit të UNECE-s, në Balëz ruhen 30 ton cianur. Me VKM nr. 843, datë 14 dhjetor 2015, kjo ndërmarrje është shndërruar në Qendër të Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme dhe është në varësi të ministrisë së industrisë. Qendra ka si qëllim ofrimin e shërbimeve për identifikimin, "grumbullimin, përgatitjen për eliminimin, depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme".

Sipas AKM-së, deri më tani, janë kryer studimet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe planet e veprimit për rehabilitimin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, dhe kostot e vlerësuara për rehabilitimin dhe monitorimin e Uzinës së Shkrirjes së Ferrokromit.

Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës në të cilat është bërë edhe asgjësimi i lëndëve plasëse si mjedhojë e të cilit është ndotur zona përreth me lëndë plasëse dhe metale të rënda si Pb, Cr, Cu, Mn në nivele shumë të larta. Sipas AKM, prania e lëndëve plasëse është vënë re edhe në llumin e kanaleve të shkarkimit të ujërave industriale[94].

Duke pasur parasysh rreziqet që paraqesin vatrat e nxehta mjedisore për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nevojitet që të merren masa për pastrimin dhe rehabilitimin e tyre.

- **Ndryshimet Klimatike**

Ndonëse Shqipëria është një nga vendet që nuk ka një kontribut të konsiderueshëm në emetimin e gazeve të efektit serrë, ajo si shumë vende të tjera të botës pëson efektet e ngrohjes globale. Nga kërkimet e shumta dhe analizimi i treguesve të klimës, të tillë si temperatura, reshjet, ekstremitetet klimaterike dhe thatësirat, sektorët më të prekur në vendin tonë janë:

- ***Bujqësia***-Parashikimet për klimë tregojnë për rritjen e mëtejshme të temperaturave në vendin tonë dhe uljen e nivelit të reshjeve, të cilat do të bëhen gjithmonë më të paqëndrueshme, duke u shoqëruar me dukuritë e përmbytjeve masive apo thatësirave. Këto dukuri do të çojnë uljen e prodhimtarisë bujqësore, ku si fillim do të dëmtohen ndjeshëm kulturat e ullinjve dhe vreshtave si dhe kultura të tjera bazë të bujqësisë. Kjo prishje e rregullsisë të sistemit të prodhimit të produkteve bujqësore do të ketë një ndikim negativ në jetesën e popullsisë. Për këtë arsye duhet të adaptohen masa për bujqësinë, me qëllim që ajo të përballojë ndryshimet klimatike.
- ***Energjia***-Në lidhje me sektorin e energjisë, vendi jonë me burimet energjetike që ka (hidrocentralet) e ka të vështirë që nga njëra anë të përmbushë kërkesat për energji elektrike dhe nga ana tjetër të sigurojë burim të vazhdueshëm (ujor) për të përmbushur në vazhdimësi kërkesat e tregut. Nisur nga fakti se vendi mbështetet tek energjia ujore për furnizimin me energji, fenomenet drastike të ndryshimeve klimatike (thatësirat apo mungesa e reshjeve) do ta vendosnin në krizë sektorin e prodhimit të energjisë elektrike. Për këtë arsye vendi ynë duhet të shikojë alternativa të tjera për të diversifikuar burimet e furnizimit me energji elektrike, si rritjen e tregtimit rajonal të energjisë si dhe zbatimin e formave alternative të prodhimit të energjisë brenda vendit (energjia alternative nga BRE[95]).
- ***Biodiversiteti***, toka dhe ekosistemet ujore-Shqipëria, si shumë vende të Ballkanit perëndimor, nën vazhdën e ndryshimeve klimatike është dhe do vuajë ndikimin në lidhje me: i) rritjen e temperaturave vjetore; ii) rritjen e nivelit të detit deri në 20-24cm deri në vitin 2050[96] dhe për pasojë rritjen e erozionit detar dhe rritjen e nivelit të ujërave të lumenjve. Nëse këto dukuri do të ndodhin realisht në 40 vitet e ardhshme, praktikisht tokat të cilat janë zona bregdetare apo afër tyre do të përmbyten dhe tokat bujqësore në brendësi të territorit, ku kalojnë lumenjtë do të përmbyten. Të gjitha këto dukuri do të shkaktojnë një presion shumë të madh në burimet ujore, duke modifikuar zinxhirin e jetës në këto mjedise, çka do të sjellë ndryshimin e habitateve dhe pakësimin burimeve natyrore.

Nëse ujërat e Lumit Shkumbin, do të pësonin rritje të nivelit të tyre, tokat bujqësore dhe vendbanimet që shtrihen përgjatë tij do të pësonin dëmtime të shumëta. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e pengesave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekur edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu, duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës. Nga ana tjetër, në kushtet e një skenari negativ të përmbytjeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, territori i Bashkisë Elbasan mund të kthehet në një nga territoret kryesore pritëse të popullsisë së zhvendosur.

- **Tokat dhe Bujqësia**

Sipas klasifikimit të ***Censusi*** 2011, Bashkia e Elbasanit ka Elbasanin si qendër me rëndësi kombëtare, 4 njësi vendore në periferi të aglomerateve (Bradashesh, Labinot-Fushë, Shirgjan dhe Shushicë), 3 njësi bujqësore të përziera fushore (Gjergjan, Paper e Tregan), një njësi bujqësore të përziera malore (Zavalin) dhe 4 njësi bujqësore malore (Funar, Gjinar, Labinot Mal, dhe Gracen).

Sipas Tabelës 7, të paktën 21% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë, por shifra mund të jetë edhe më e lartë,

nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë.

Bashkia e Elbasanit nuk ka sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore që mund të shërbejnë për kultivimin intensiv të bimëve. Megjithatë, bashkia përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e drithërave (grurit, misrit), pemëtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, demi dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për ullishtat të cilat janë një traditë e trashëguar ndër shekuj, sidomos në pjesën veriore dhe veri-perëndimore të qytetit, në territorin kodrinor të bashkisë, buzë përrenjve të Manazderes dhe Zaranikës. Kohët e fundit, bashkia ka zhvilluar edhe turizmin malor dhe ka shtuar veprimtaritë e saj ekonomike lidhur me Llixhat në njësinë administrative Tregan. Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e maleve të Kërrabës e Labinotit. Kultivimi i tokës së këtyre zonave krijon vetvetiu erozion të tokës nëse praktikat e kultivimit të saj nuk janë të qëndrueshme. Shkaqet e erozionit lidhen me: 1) kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezulton në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene të motit; 2) mënyra e kultivimit të tokës, në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës; 3) djegie të mbetjeve të bimëve të kultivuara, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tokën; 4) tarracim të papërshtatshëm, me zhveshje të tokës; 5) prerje të pyjeve, etj. Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmenaxhimit, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[99]. Përveç erozionit, tokat e rajonit të Elbasanit janë të rrezikuara potencialisht nga shkarjet dhe shembjet[100], një formë e erozionit gjeologjik. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) identifikon si shkaqe të shkarjeve të tokës në bashki relievin e thyer, reshjet, dëmtimin e bimësisë natyrore, braktisjen e tokave bujqësore etj. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, rrezikut i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[101].

Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e Lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve[102]. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e tyre, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit të tyre. Të dhënat tregojnë se vlera mesatare e tokës së gërryer luhatet nga 0.5-0.8 ton/vit për çdo metër linear të shtratit të Lumit të Shkumbinit[103].

Tabela 7: Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik[97]

Kodi	Bashkia	Tipologjia	Sip. km^2 [98]	Banorë
23	Bradashesh	Njësitë vendore në periferi të aglomerateve	56	10,901
44	Funar	Njësi vendore bujqësore malore	76.6	2,162
41	Gjergjan	Njësi vendore bujqësore e përzier fushore	27.9	5,223
44	Gjinar	Njësi vendore bujqësore malore	89.1	3,543
23	Labinot-Fushë	Njësitë vendore në periferi të aglomerateve	49	7,191
44	Labinot-Mal	Njësi vendore bujqësore malore	105.7	5,391
41	Papër	Njësi vendore bujqësore e përzier fushore	102	6,468
23	Shirgjan	Njësitë vendore në periferi të aglomerateve	21.6	7,445
23	Shushicë	Njësitë vendore në periferi të aglomerateve	106.6	8,895
41	Tregan	Njësi vendore bujqësore e përzier fushore	57.4	3,093
42	Zavalinë	Njësi vendore bujqësore e përzier malore	101.1	1,653
44	Gracen	Njësi vendore bujqësore malore	56.8	2,233
12	Qyteti i Elbasanit	Qendër me rëndësi kombëtare	22.2	80,185
Gjithsej			872	144,382

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Përgjatë shtratit të këtij lumi është vënë re se humbet rreth 500-800 m^3 tokë në vit në një hapësirë prej 1,000 metër linear. Shkaqet lidhen me devijimin e rrjedhës së ujit të këtyre lumenjve për shkak të shfrytëzimit të inerteve ose mbushjes së shtratit të tyre me mbetje urbane. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e këtyre lumenjve është i lartë teksa mirëmbajtja e lumenjve është lënë pas dore. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme[104]. ***Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët të BE-së për Bujqësinë***[105].

- **Përfundime**

Bashkia e Elbasanit përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore) të cilat përdoren për prodhimin e drithërave (grurit, misrit), pemëtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për ullishtat të cilat janë një traditë e trashëguar ndër shekuj, sidomos në pjesën veriore dhe veri-perëndimore të qytetit, në territorin kodrinor të bashkisë. Kohët e fundit, bashkia ka zhvilluar edhe turizmin malor dhe ka shtuar veprimtaritë e saj ekonomike lidhur me Llixhat, në njësinë administrative të Treganit. Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e maleve të Kërrabës, Labinotit dhe Gjinar-Zavalinë.

Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i përrenjve e lumenjve që përshkojnë territorin e bashkisë dhe më tej i bashkohen Shkumbinit. Në këtë rrjet, Shkumbini është boshti kryesor i cili përshkon territorin e bashkisë nga lindja në perëndim. Ndërsa nga njëra anë Elbasani ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Shkumbinit, me rëndësi për zhvillimin e bashkisë, nxori në pah problematikat e këtij lumi që vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumit nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Shkumbinit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e këtyre lumenjve përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e tyre të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Nëse nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Shkumbinit, nga burim uji për bujqësinë, ky lum mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. Si rrjedhojë, është e nevojshme që bashkia dhe organet kompetente të menaxhimit të ujërave në nivel rajonal të ndërmarrin nisma për projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lumë, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efikas të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera (dhe organet e nivelit qendror) që preken nga Shkumbini, për menaxhimin e integruar të këtij lumi.

Përveç mbrojtjes së burimeve ujore, bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së degradimit të tokës që në Elbasan është fenomen i zakonshëm për shkak të tokave të buta dhe me pjerrësi të theksuar. Ky fenomen theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi nga banorët duke shkaktuar erozion, shkarje dhe shembje të tokës. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, rreziku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[106]. Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e Lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve[107]. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit të tyre. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë teksa mirëmbajtja e lumit është lënë pas dore. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme[108]. Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e bashkisë pa cenuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore edhe në toka kodrinore si ato të Elbasanit. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së[109].

Në ajrin e territorit të Bashkisë Elbasan shumë ndotës si PM_{10}, LNP, $PM_{2.5}$ janë mbi normat e lejuara, ndërsa vlerat e ndotësve NOx dhe SOx janë shumë pranë normave të

lejuara. Ky nivel i lartë i ndotësve në ajër shpjegohet me burimet e shumta të ndotësve që operojnë territorin e bashkisë, si ish industria metalurgjike, fabrika e çimentos, industri të tjera të prodhimit të tullave, mjetet motorike që lëvizin në bashki, industria e ndërtimit etj. Nga të dhënat e fundit të Raportit të Gjendjes së Mjedisit për vitin 2014, vlerat mesatare vjetore të PM_{10} për qytetin e Elbasanit janë (45µg/m^3) mbi normën e lejuar të BE (40 µg/m^3). Vlerat e SO_2 nuk i kalojnë vlerat e lejuara të BE, ndërsa vlerat për NO_2 (32 µg/m^3) nuk i tejkalojnë normat e BE-së (40 µg/m^3), por janë shumë afër tyre. Ndotësit e tjerë si O_3, $PM_{2.5}$ C_6H_6 janë brenda normave të lejuara dhe shpesh herë në sasi shumë të vogla. Nisur nga këto të dhëna, problem për qytetin e Elbasanit dhe zonat përreth tij mbeten vlerat mbi normat e lejuara të grimcave PM_{10}, si dhe vlerat të NO_2, cilat janë shumë afër normës së lejuar, të cilat në periudha të ndryshme të vitit, por edhe të ditës mund të kalojnë vlerën e lejuar.

Bashkisë Elbasan është shumë e pasur me botë shtazore, e cila gjatë dy dekadave të fundit është dëmtuar si rezultat i gjuetisë së shfrenuar, ku shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes. Që kjo zonë të mos vazhdojë të humbët speciet e faunës, duhet të merren masa të forta për rehabilitimin e kafshëve të zhdukura të cilat konsistojnë në: i) Ndërprerjen e gjuetisë sportive për të paktën 5 vjet; ii) Rikrijimi i kushteve për afrimin e kafshëve dhe shpendëve të larguar për mungesë të këtyre kushteve në kohë dhe sistem. Zona e Elbasanit ka pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen lumenjtë, liqenet (zona e Dumresë), zona e mesme dhe e lartë malore, kodrat e ullinjve që rrethojnë qytetin, shkurret mesdhetare, pyjet gjethe gjerë, ato halore dhe përzierjet me kullota. Në të gjithë territorin e sotëm të bashkisë (pas reformës territoriale), ndodhen shumë zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme si, të cilat paraqesin një pasuri natyrore me potencial të lartë për zhvillimin e turizmit malor dhe atij kulturor. Një kujdes i veçantë i duhet treguar nga organet kompetente, pasi një pjesë e tyre janë lënë shumë pas dore, duke humbur dita ditës vlerat që ato mbartin.

Sipas të dhënave të nxjerra nga kërkimet e shumta në lidhje me ngrohjen globale dhe efektet e saj në territor, edhe për Bashkinë Elbasan sektorët që do të preken më shumë janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore. Bashkia Elbasan nuk është një territor bregdetar, por në të kalojnë ujërat e Lumit Shkumbin, të cilat në kushtet e rritjes së nivelit do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë rrjedhës së tij apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e pengesave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekur edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës. Nga ana tjetër, në kushtet e një skenari negativ të përmbytjeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, territori i Bashkisë Elbasan mund të kthehet në një nga territoret kryesore pritëse të popullsisë së zhvendosur.

1.3 ZHVILLIMI EKONOMIK

Analiza e zhvillimit ekonomik trajton pirjet kryesore të zhvillimi të Bashkisë Elbasan në aspektin ekonomik, duke u mbështetur në të dhëna si Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), Vlera e Shtuar Bruto (VSHB), ndërmarrjet ekonomike që operojnë territorin e bashkisë, punësimin sipas sektorëve, etj. Ndryshimi i kufirit administrativ, me reformën administrative në maj 2014, edhe pirjet e zhvillimit ekonomik kanë ndryshuar. Fakti që territori i Elbasanit është rritur disa herë dhe territoret të cilat janë përfshirë kanë karakter rural, ka sjell ndryshime në vendosjen e prioriteteve për zhvillimin ekonomik.

- **Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)**

Produkti i Brendshëm Bruto është një tregues i vlerës së tregut të të gjithë të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuar në një vend. PBB përfshin prodhimet dhe shërbimet aktuale, të destinuara për treg dhe ato të prodhuara për konsum vetjak nga të gjitha njësitë rezidente, që veprojnë në territorin e një shteti.

Referuar të dhënave të INSTAT, PPB për frymë në nivel kombëtarë është 460 mijë lekë, ndërsa në Qarkun e Elbasanit 346 mijë lekë, pra rreth 25% më i ulët në raport më PPB për frymë në nivel kombëtar. Pesha që zë PBB e Qarkut Elbasan në vlerën e përgjithshme të PBB-s kombëtare vlerësohet 7.9%, çka tregon për rëndësinë e Elbasanit në ekonominë kombëtare. Qarku i Elbasanit është qarku i katërt për nga rëndësia ekonomike.

Duke u mbështetur në të dhënat e mëposhtme (Tabelat 8 dhe Tabela 9) PBB për frymë në Qarkun e Elbasanit ka ardhur duke u rritur në mënyrë graduale nga viti 2000 deri në 2008. Në vitin 2009 kemi një rritje prej 1.5%, rritja me e madhe e PBB dhe në vitin 2010 është shënuar rritja më e madh me 6.6% për periudhën 2000-2010. PBB për frymë, në vitin 2012 ka pësuar një rënie me 1.9%.

- **Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) dhe produktiviteti i sektorëve**

Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB, llogaritet si diference midis prodhimit

dhe konsumit të ndërmjetëm. Vlerën e Shtuar Bruto më të lartë, në Qarkun e Elbasanit, e ka sektori i shërbimeve me 43.50%, ku 23.60% e zënë shërbimet e tjera dhe 16.30% tregti, hotele, restorante. Sektori i dytë me VSHB-në më të lartë është bujqësia me 34.10%, më pas renditet industria me 14.20% dhe i fundit renditet ndërtimi me 8.20%.

Vlera e produktivitetit llogaritet si raport i vlerës së VSHB-së të sektorit me numrin e punonjësve në atë sektor. Nga Tabela 12, produktivitetin më të lartë e ka sektori i industrisë me 3.72, më pas vjen bujqësia me produktivitet 2.8 dhe të fundit për nga produktiviteti renditen shërbimet me 1.68.

Në Figurën 30 paraqitet lëvizja e të punësuarve nga njëra zonë tjetrën, e cila është tregues i ndërveprimin ekonomik ndërmjet zonave. Qendrat urbane janë ofruese të infrastrukturave, shërbimeve dhe punësimit ndërsa qendrat rurale janë furnizuese me produkte bujqësore dhe me fuqinë punëtore (Raporti i Zonave Funksionale, f. 164). Ndërveprimi më i madh ndodh ndërmjet Elbasanit dhe Shirgjanit dhe Elbasanit dhe Labinot Fushës, ku lëvizja e të punësuarve është 27-40%. Ndërveprimi ekonomik është mesatar (12-26%) ndërmjet Elbasan-Gjinar, Elbasan-Zavalinë, Elbasan-Shushicë, Elbasan-Labinot Mal, Elbasan-Funarë, Papër-Bradashesh, Tregan-Elbasan. Zonat rurale si Gracen-Bradashesh, Funarë-Bradashesh, Shirgjan-Tregan, Shirgjan-Zavalinë kanë ndërveprim më të ulët ndërmjet tyre, 3-11% e të punësuarve.

Në territorin e Elbasanit ndodhen 7 pika grumbullimi, për produktet bujqësore, gjashtë pika grumbullimi ndodhen në Bradashesh (fshati Balëz) dhe një në Gjergjan (fshati Muriqan). Në qytetin e Elbasanit ndodhen katër tregje, dy tregje fruta perimesh (250 vende) një ndër të cilët është treg rajonal, një treg industrial (225 vende) dhe një treg shumice (42 vende).

- **Prirjet e ndërmarrjeve ekonomike**

Bizneset sipas llojit të aktivitetit ndahen në prodhues të mirash dhe shërbimesh. Ndërmarrjet aktive që prodhojnë të mira përbëjnë 86% dhe prodhuesit e shërbimeve 14%. Nga viti 2013 deri në vitin 2014 ka pasur një ndryshim me 0.2 % tkurrje të prodhuesve të të mirave kundrejt prodhuesve dhe shërbimeve. Prodhuesit e të mirave ndahen në 3 kategori: a) bujqësia, b) pyjet dhe peshkimi, c) industria dhe ndërtimi. Bujqësia pyjet dhe peshkimi, që vlerësohen 1.4 %, në vitin 2014 ka pësuar një rritje me 0.2% krahasuar me vitin 2013. Sektori i Industrisë dhe i ndërtimit kanë pësuar ulje me 0.2% nga vitit 2013 në vitin 2014. Prodhuesit e shërbimeve ndahen në 5 kategori: a) tregti, b) transport, magazinim, c) akomodim, shërbime sociale, d) informacion komunikim dhe e) shërbime të tjera. Sektori më i zhvilluar në kategorinë e shërbimeve është tregtia, i cili nga 42.6% në vitin 2013 është rritur në 42.7% në vitin 2014. Sektori i transportit dhe magazinimit ka pësuar tkurrje me 0.6%, nga 10.8% në vitin 2013 në 10.2% në vitin 2014. Akomodimi dhe shërbimet sociale janë rritur nga 15.5% në vitin 2013 në 15.9% në vitin 2014.

Tabela 8: PBB për frymë e Qarkut të Elbasanit në raport me nivelin kombëtar

Vendi	Struktura e PBB	PBB për frymë në lekë	Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së (%)
Shqipëria	100%	460,436	100
Qarku Elbasan	7.9%	346,054	75.2

Burimi: INSTAT 2012

Tabela 9: Struktura e PBB ndër vite

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005
PBB për frymë në lekë	128,307	143,553	150,502	169,194	188,137	211,835
Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2012
PBB për Frymë në lekë	230,213	243,640	278,698	286,865	352,000	346,054

Burimi: INSTAT 2012

Tabela 10: PBB për frymë e Qarkut të Elbasanit ndër vite në raport me nivelin kombëtar

Viti	2008	2009	2010	2011	2012
Qarku Elbasan	68.1%	69.4%	76.1%	77.3%	75.2%

Burimi: INSTAT 2012

Tabela 11: VSHB sipas degëve të ekonomisë në Qarkun Elbasan

	Bujqësi & Peshkim	Industri total	Industri nxjerrëse	Industri përpunuese	Ndërtim	Shërbime total	Tregti, hotele, restorante	Transport	Postë dhe telekomu-nikacion	Shërbime të tjera
VSHB	34.10%	14.20%	1.60%	12.60%	8.20%	43.50%	16.30%	2%	1.50%	23.60%

Burimi: INSTAT 2012

Tabela 12: Produktiviteti në sektorin e Industrisë dhe të Shërbimeve

Sektori	VSHB sipas sektorit	Numri i punonjësve për sektor	Produktiviteti
Industria	59,818	16,067	3.72
Shërbimet	68,135	40,328	1.68
Bujqësia	144,037	51,436	2.8

Burimi: INSTAT 2012

Sektori i informacionit dhe komunikimit nuk ka pësuar ndryshime, ndërsa sektori i shërbimeve të tjera është rritur me 0.3% nga viti 2013 në vitin 2014.

Në Figurën 31 shohim që sektori me peshën kryesore në Bashkinë Elbasan është tregtia me rreth 45 % të bizneseve, kryesisht bizneset të vogla (njësi të e vogla tregtare). Në territorin e Elbasanit ka shumë biznese të mëdha, të cilat merren me eksport dhe import mallrash të ndryshme. Shërbimet janë sektori tjetër më i zhvilluar me vlerën 41.1%, shërbimet që takohen më shumë janë hotele, bare, restorante, biznese transporti apo shërbime të tjera. Në total hotelet, baret dhe restorantet zënë 14.6% ndërsa transporti dhe komunikacioni 12.9% dhe shërbimet e tjera 13.9%. Një sektor tjetër i rëndësishëm është industria me 10.7% të bizneseve. Në këtë sektor kemi të bëjmë me biznese të mëdha siç mund të jenë fabrikat, por ka dhe biznese të vogla si punishtet industriale. Sektori i ndërtimit zë 2.2% të totalit të bizneseve, ndërsa sektori i bujqësisë zë 0.7%. Sektori i ndërtimit ka pësuar ulje vitet e fundit.


- **Prirjet e bujqësisë**

Sektori ekonomik i bujqësisë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Bashkisë Elbasan. Në zonat rurale bujqësia përbën sektorin primar të ekonomisë, ku pjesa më e madhe e popullsisë janë të punësuar në këtë sektor.

Në Qarkun e Elbasanit sektori kryesor ekonomik është sektori bujqësor (Tabela 18). Ky qark ka rreth 10.4 % të tokës bujqësore në rang kombëtar dhe 11.7 % të tokës pyjore dhe kullotave në rang kombëtarë çka dëshmon për potencialin bujqësor dhe natyror që ka.

Të ardhurat nga bujqësia në qark vlerësohen me 6.5% të të ardhurave totale të bujqësisë (në rang kombëtar) dhe të ardhurat nga blegtoria vlerësohen 9.6% të të ardhurave totale blegtorale (në rang kombëtar). Gjithashtu, të

Figura 30: Harta e ndërveprimit ekonomik në ZF Elbasan: Përqendrimi i bizneseve dhe drejtimi i lëvizjes për punë



Burimi: Raporti i Zonave Funksionale Ministria e çështjeve vendore, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

ardhurat nga produktet e ndryshme bujqësore vlerësohen me 4.1 % të totalit dhe të ardhurat nga produktet të ndryshme blegtorale vlerësohen me 20.7% të totalit. Këto të dhëna na ndihmojnë të kuptojmë se Qarku i Elbasanit ka një potencial të madh bujqësor dhe kryesisht është i orientuar drejt sektorit blegtoral kundrejt atij bujqësor[110].

Në Tabelën 15 paraqitet sasia e prodhimit të kulturave të ndryshme bujqësore në Bashkinë Elbasan. Prodhimet me sasinë me të lartë janë drithërat dhe pemët frutore. Duke qenë se Elbasani ka sipërfaqe të konsiderueshëm natyrore, ka potencial për mbjelljen e pemëve frutore.

19% e prodhimeve blegtorale të Qarkut Elbasan, prodhohen në Bashkinë Elbasan. Prodhimi i qumështit është produkti me prodhimin më të lartë në Bashkinë Elbasan dhe produkti i dytë blegtoral më sasinë më të lartë të prodhimit janë vezët. Edhe prodhimi i mjalti zë peshë kryesore ndër prodhimet blegtorale, ku 87% e sasisë totale që prodhohet në qark, prodhohet në territorin e Bashkisë Elbasan.

- **Turizmi në Bashkinë Elbasan**

Turizmi në Bashkinë e Elbasanit nuk është ndër sektorët kryesorë ekonomik, por mund të themi se ka potenciale


Tabela 13: Ndërmarrjet sipas aktiviteti ekonomik në Qarkun

	Prodhues shërbimesh total	Tregtia	Transport, magazinim	Shërbime		
				Akomodim, shërbime sociale	Informacioni, komunikacioni	Shërbime të tjera
2013	6,385	3,172	806	1,156	156	1,095
2013	85.80%	42.60%	10.80%	15.50%	2.10%	14.80%
2014	6,705	3,354	800	1,253	168	1,190
2014	86%	42.70%	10.20%	15.90%	2.10%	15.10%

	Të mira			
	Prodhues të mirash total	Bujqësi, Pyje, Peshkim	Industria	Ndërtimi
2013	1,057	90	768	199
2013	14.20%	1.20%	10.30%	2.70%
2014	1,094	107	794	193
2014	14%	1.40%	10.10%	2.50%

Burimi: INSTAT Vjetari Statistikor, 2015

Figura 31: Ndërmarrjet ekonomike në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT Vjetari Statistikor, 2015

Tabela 14: Ndërmarrjet ekonomike në Bashkinë Elbasan

Njësia administrative / Bashki	Bujqësia dhe Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbimet			Shërbime Total
					Hotele, kafe, restorante	Transporti, Komunikacioni	Shërbime Të tjera	
Elbasan	8	347	90	1788	479	425	570	1474
Bradashesh		67	5	97	48	35	23	106
Funarë	4			2		9		12
Gjergjan		7		21	6	13		22
Gjinar		3		6	4	14	4	22
Gracen	7	4		8	13	8	7	28
L. Fushë		11		48	25	16	6	47
L. Mal						12		16
Papër		13		31	27	14	5	46
Shirgjan	7	30	10	53	28	17	16	61
Shushicë		17		36	15	23	6	44
Tregan				9	29	10	8	47
Zavalinë								6
Bashkia Elbasan	26	499	105	2,099	674	596	645	1931
	0.70%	10.70%	2.20%	45%	14.60%	12.90%	13.90%	41.40%

Burimi: INSTAT, 2012

të mira për zhvillimin e tij dhe të kthehet në një burim ekomomik që gjeneron të ardhura falë burimeve turistike që ka. Rreth 72% e sipërfaqes së bashkisë vlerësohet si zonë natyrore[111]. Në Elbasan ndodhen 3 rezervate strikte të menaxhuara (Sopoti, Kuturmani dhe Qaf Bushi), të cilat janë kategorizuar si rezervat strikt i menaxhuar. Kjo bashki ka edhe 12 monumente natyrore, ndër të cilat dhe Llixhat e Treganit (Llixhat e Hidrajt)[112]. Në Bashkinë Elbasan ndodhen një numër i konsiderueshëm i monumenteve të trashëgimisë kulturore, 14 nga 25 gjithsej, ndodhen në qytetin e Elbasanit, ndër të cilat 9 janë objekte kulti dhe 6 kala të epokave të ndryshme[113]. Në territorin e bashkisë ndodhen rreth 51 hotele nga të cilat 25 ndodhen në njësinë administrative të Treganit[114]. Një numër shumë i vogël i tyre ndodhen në qytetin e Elbasanit (vetëm 5)[115].

- **Klasifikimi sipas llojit të ekonomisë**

Në Tabelën 17 vërehet se në qytetin e Elbasanit 49.2% janë të punësuar në sektorin e shërbimeve, 19.8 % në tregti, 18.6 %, në sektorin e industrisë, 7.5 % në ndërtimi dhe 2.3 % në bujqësi.

Tabela 15: Prodhimi sipas kulturave bujqësore

	Sipërfaqe ha	Rendimenti kv/ha	Prodhimi kv
Drithëra buke gjithsej	1,798.1	410.5	64,898
Perime gjithsej	650.3	19,836.5	156,133
Patate	311	1,975	48,330
Fasule direkte gjithsej	293	259	5,826
Kultura industriale	220	3,103	12,685
Duhan	220	3,103	12,685
Foragjere gjithsej	5,685	188.4	1,071,254

Burimi: Burimi: Drejtoria e Statistikave Bashkia Elbasan, nëntor 2015

Tabela 16: Prodhimet blegtorale në Bashkinë Elbasan dhe në Qarkun Elbasan

	Bashkia Elbasan	Qarku Elbasan
Qumësht Total (ton)	50,212	142,000
Mish Total (ton)	2,425	17,000
Vezë (000\ kokrra)	15,340	77,600
Mjaltë prodhim (ton)	261	300


Burimi: Drejtoria e Statistikave Bashkia Elbasan nëntor 2015 (të dhënat në nivel bashkie), INSTAT 2014, (të dhënat e Qarkut)

Në njësinë administrative të Bradasheshit 35.5 % e të punësuarve punojnë bujqësi, 18.5% në sektorin e shërbimeve,14% në sektorin e industrisë, 8.3 % në ndërtimi dhe 7.8 % në tregti. Duke pasur parasysh se 15.9% e ekonomisë është e papërcaktuar, raportet ndërmjet sektorëve ekonomikë mund të ndryshojnë. Në njësitë administrative Funarë, Gjergjan, Shushicë, Gracen, Tregan, Gjinar, Zavalinë, Shirgjan, Labinot-Mal, Labinot-Fushë dhe Papër, sektori me përqindjen më të lartë të të punësuarve është bujqësia, në të gjitha rastet me mbi 50 %. Në total, sektori i parë në Bashkinë Elbasan, për sa i përket punësimit, janë shërbimet me 51.4%, i dyti renditet sektori bujqësor me 27.7% dhe në fund sektori industrial me 20.9%. Në Qarkun e Elbasanit këto prirje ndryshojnë, sektori bujqësor ka 47.7% të të punësuarve, më pas vijnë shërbimet me 37.4 % dhe në fund renditet industria me 14.9%. Prirjet në nivel kombëtar janë të përafërta me ato në Bashkinë Elbasan. Sektor i parë janë shërbimet me 53.5%, më pas vjen bujqësia me 26.1 % dhe në fund industria me 20.4%.

Zonat ekonomike në Bashkinë Elbasan mund të ndahen në 3 kategori: zonat ekonomike industriale, zonat ekonomike të shërbimeve (zonat me përqendrim të lartë të bizneseve) dhe zonat ekonomike bujqësore.

Zonat ekonomike të shërbimeve janë zonat ndahen në A, C, D, F dhe G, (Figurën 33). Këto zona kanë dhe përqendrimin më të madh të bizneseve. ***Zona A,*** është zona përgjatë rrugës nacionale Rrogozhinë-Elbasan (pjesa

Figura 32: Klasifikimi në ekonomi agrare ose ekonomi aglomeruese, Bashkia Elbasan



Burimi: INSTAT, 2012;Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Tabela 17: Punësimi sipas sektorëve ekonomik në Bashkisë Elbasan

Njësia administrative	Total	Bujqësia	Tregtia	Ndërtim	Industri	Shërbime	E papërcaktuar
Elbasan	100	2.3	19.8	7.5	18.6	49.2	2.6
Bradashesh	100	35.5	7.8	8.3	14	18.5	15.9
Funar	100	85	0.5	3.2	0.8	7.2	3.3
Gjergjan	100	65.5	5	8	4.5	12.2	4.8
Gjinar	100	71.4	3.5	3.6	3	15.5	3
Gracen	100	87.8	0.2	2.4	1.4	7.3	1
L.Fushë	100	50.4	6.2	10.3	10.5	19.2	3.5
L.Mal	100	81	1	1.9	1.2	7.4	7.5
Papër	100	57.7	6.9	8.6	5.8	16.3	4.6
Shirgjan	100	49.3	8.4	15.2	7.8	15.3	4
Shushicë	100	63.8	5.3	10.7	3.6	10.8	5.7
Tregan	100	67.6	2	6	3.2	12.9	8.2
Zavalinë	100	77.4	2	2	1.2	15.9	1.4

Burimi: INSTAT, 2012

Tabela 18: Niveli i punësimit sipas sektorëve ekonomike

Njësia	Bujqësi	Industri	Shërbime
Bashkia Elbasan	27.7%	20.9%	51.4%
Qarku Elbasan	47.7%	14.9%	37.4%
Shqipëria	26.1%	20.4%	53.5%

Burimi: INSTAT, 2011

nga Papëri deri në Bradashesh), e cila karakterizohet nga biznese të mëdha dhe të vogla. ***Zona C,*** përfshin rrugën kryesore të qytetit të Elbasanit, nga hyrja (pjesa perëndimore) e deri në dalje (pjesa lindore). Veçanërisht në pjesën hyrëse dhe dalëse të qytetit janë përqendruar biznese të mëdha, siç janë njësitë e prodhimit, punishtet ose karburantet, ndërsa në brendësi të qytetit kemi kryesisht njësi tregtare të vogla dhe të mëdha. ***Zona D,*** ndodhet në pjesën lindore të Bashkisë Elbasan, vazhdon përgjatë aksit rrugor nacional Elbasan-Pogradec dhe përfundon në dalje të qytetit në kufi me njësinë administrative Labinot-Fushë. Karakterizohet nga biznese prodhuese, punishte dhe njësi tregtare. ***Zonat F dhe G,*** në ndryshim me zonat e tjera, janë më të vogla në sipërfaqe dhe kanë karakter me rural. ***Zona F*** është zona shtrihet përgjatë rrugës që lidh Njësinë Administrative Shirgjan dhe Gjergjan, ndërsa ***zona G*** shtrihet përgjatë rrugës që lidh njësinë administrative Shirgjan dhe Tregan. Këto zona karakterizohen nga biznese të vogla, të cilat janë të vendosura kryesisht në akset kryesore rrugore.


Zonat ekonomike Industriale janë zonat B dhe E (Figura 33). Në sektorin e industrisë janë të punësuar rreth 20.9% e popullsisë. Në Bashkinë Elbasan kemi industri e rëndë përpunuese, siç është industria e përpunimit të metaleve e cila përbëhet nga disa sektorë: sektori i përpunimit dhe i prodhimit të hekurit dhe çelikut, sektori i riciklimit dhe përpunimit të metaleve të ndryshme dhe sektori pasurimit të kromit. Gjithashtu në Elbasan ndodhet edhe fabrika e prodhimit të çimentos dhe fabrika e përpunimit të drurit dhe e magazina të ndryshme. ***Zona B,*** ish Kombinati Metalurgjik në Njësinë Administrative Bradashesh, ku ndodhen industritë e përpunimit të metalit. Një ndër bizneset më të mëdha në këtë zonë është Fabrika e Përpunimit të Metalit "Kurum". ***Zona E*** kufizohet me qytetin e Elbasanit dhe Lumin Shkumbin. Në këtë zonë industriale ndodhet industria e përpunimin e drurit dhe magazina të ndryshme.

Zonat Ekonomike bujqësore, ndodhen përgjatë luginës së Lumit Shkumbin në Njësitë Administrative Papër, Shirgjan, Gjergjan dhe Labinot Fushë. Njësitë administrative Funarë, Gjinar, Gracen, Labinot Mal, Tregan, Shushicë, Zavalinë kanë sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë, por sipërfaqet e tokave bujqësore janë më të vogla si pasojë e relievit kodrinor-malor.

- **Përfundime**

Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë në Bashkinë Elbasan vlerësohet 25% më pak sesa PBB për frymë në

Figura 33: Zonat ekonomike në Bashkisë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

nivel kombëtar. Në vlera absolute PBB e Elbasanit është 7.9% e PBB kombëtare. Qarku i Elbasanit është qarku i 4-t për sa i përket kontributit në PBB kombëtare.

Sektori që ka vlerën e shtuar bruto me të lartë janë shërbimet 43.5% më pas është bujqësia me 34.1% dhe industria me 14.2% ndërsa produktivitetin më të lartë e ka sektori i industrisë.

Ndërveprimi ekonomik midis njësive administrative tenton të jetë i qendërzuar nga Elbasani në drejtim të njësive të tjera administrative dhe anasjelltas.

Në Bashkinë Elbasan ndodhen 7 pika të grumbullimit të produkteve bujqësore nga të cilat 6 janë njësinë administrative Bradashesh dhe një në njësinë administrative Gjergjan. Njësitë administrative, si Shirgjani, Papëri, Tregani dhe Labinot Fusha që shtrihen përgjatë luginës së Shkumbinit dhe kanë më shumë prodhime bujqësore (si pasojë e terrenit), duhet të kenë pika të grumbullimit të produkte bujqësore.

Situata e tregjeve në Bashkinë Elbasan nuk është e mirë. Në të operojnë rreth 5 tregje me një kapacitet prej 517 vende, të cilat ndodhen vetëm në qytetin e Elbasanit. Këto tregje janë të pamjaftueshme për të furnizuar qytetin e Elbasanit me produkte. Gjithashtu vërehet mungesa e tregjeve më të vogla nëpër qendrat e njësive administrative.

Njësitë ekonomike në Qarkun Elbasan janë të orientuar drejt shërbimeve dhe tregtisë ku 42.7% e subjekteve merren me tregti dhe 43.3% janë subjekte që kanë për bazë shërbimet e ndryshme. Situata është e përafërt dhe në Bashkinë Elbasan ku 45% e subjekteve merren me tregti dhe 41.4 % e subjekteve kanë për bazë shërbimet, ndërsa 10.7% e subjekteve janë industriale.

Bujqësia është një sektor me peshë në ekonominë e Bashkisë Elbasan. Zonat që kanë më shumë përparësi në zhvillimin bujqësorë janë njësitë administrative përgjatë luginës së Lumit Shkumbin si pasojë e terrenit më fushor që kanë raport me njësitë e tjera që kanë një potencial më të moderuar për zhvillim bujqësor (terren kodrinor-malor).

Turizmin për momentin luan rol minimal në ekonominë e Elbasanit, por si sektor ka potenciale të mëdha zhvillimi. Turizmi kulturor, malor dhe natyror mund të luajnë rol kyç në ekonomi në disa zona të bashkisë.

Për sa i përket klasifikimit të ekonomive të njësive administrative të Bashkisë Elbasan mund të themi se të gjitha njësitë administrative janë ekonomi agrare përveç qytetit të Elbasanit që është ekonomi aglomeruese. Në total Bashkia Elbasan është një ekonomi e orientuar drejt shërbimeve me 51.4 %, me pas bujqësia 27.7 % dhe industria me 20.9 %

Aktivitetet kryesore ekonomike në Bashkinë e Elbasanit ndodhin përgjatë luginës së Shkumbinit. Për këtë situatë ndikon aksi kombëtar Rrogozhinë-Elbasan-Pogradec, që ndodhet në këtë luginë dhe i ofron akses të mirë këtyre zonave ekonomike.

1.4 SITUATA SOCIAL-EKONOMIKE

1.4.1 Demografia

Sipas të dhënave të Bashkisë Elbasan, numri i popullsisë ka pësuar rritje nga viti në vit. Kjo rritje ka ndodhur thuajse në të gjitha njësitë administrative që bëjnë pjesë në territorin e bashkisë, me përjashtim të Njësive Administrative Gjinar, Zavalinë dhe Funar, të cilat kanë pësuar ulje të popullsisë.

Bashkia Elbasan, është qendra me e rëndësishme demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan, përfshin nën juridiksionin e saj administrativ qytetin e Elbasanit dhe 13 njësitë administrative, Labinot Mal, Funarë, Labinot fushë, Bradashesh, Gracen, Shushicë, Papër, Shirgjan , Gjergjan, Gjinar, Tregan dhe Zavalin.

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Elbasan banojnë rreth 48% e popullatës rezidente të Qarkut Elbasan, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 52% ‰ është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Peqin, Belsh, Cërrik, Gramsh, Prrënjas, Librazhd, përkatësisht me

Tabela 19: Popullsia në Bashkinë Elbasan sipas të dhënave të gjendjeve civile, 2015

		Nr. popullsisë			
		2012	2013	2014	2015
1	Elbasan	125, 419	125, 790	126, 789	127, 420
2	Bradashesh dhe Gracen	15, 152	15, 383	15, 449	15, 540
3	Labinot Fushë	6, 479	6, 562	6, 643	6, 681
4	Labinot Mal	5, 670	5, 694	5, 694	5, 691
5	Shushicë	10, 856	10, 951	11, 069	11, 164
6	Tregan	4, 439	4, 447	4, 508	4, 555
7	Gjinar dhe Zavalinë	6, 897	6, 880	6, 855	6, 858
8	Gjergjan	7, 736	7, 798	7, 851	7, 881
9	Papër	8, 990	9, 066	9, 170	9, 211
10	Shirgjan	10, 117	10, 127	10, 311	10, 408
11	Funarë	3, 105	3, 109	3, 096	3, 071
	Bashkia Elbasan	204, 860	205, 807	207, 435	208, 480


Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Tabela 20: Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative	Viti 2011	Viti 2015
Bashkia Elbasan	147,037	144,382
Elbasan	81,659	80,185
Labinot Mal	5,490	5,391
Funarë	2,202	2,162
Labinot Fushë	7,323	7,191
Bradashesh	11,102	10,901
Gracen	2,274	2,233
Shushicë	9,059	8,895
Papër	6,586	6,468
Shirgjan	7,581	7,445
Gjergjan	5,319	5,223
Gjinar	3,609	3,543
Tregan	3,150	3,093
Zavalin	1,683	1,653
Qarku Elbasan	306,939	301,397

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të autorit, 2015

Figura 34: Struktura e popullsisë



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të autorit, 2015

9%, 7%, 9%, 8%, 8%, dhe 11% e popullatës gjithsej të qarkut. Popullata rezidente e Bashkisë Elbasan, si rrjedhoje e ndarjes së re administrative, është rritur me rreth 80% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim të vitit 2015, prej 144,382 banorë[116].

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqendruar kryesisht në qytetin e Elbasanit, me rreth 56%, të saj ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndare në 13 njësi administrative. Nga këto, veçohet njësia administrative Bradashesh me rreth 8% të popullatës së bashkisë ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të njësive administrative "lëviz" në intervalin (2-6)% të popullatës gjithsej të bashkisë.

Popullsia e Bashkisë Elbasan, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 2,700 banorë, ose me 2% me pak, rënie e cila si dukuri tashmë është e pranishme pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përjashtuar këtu Qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve '90. Shkaqet e rënies së popullsisë në Bashkinë Elbasan lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model-profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit.

Tabela 21: Popullsia sipas gjinisë Bashkia Elbasan, për vitet 2011-2015

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bashkia Elbasan	**147,037**	**73,977**	**73,060**	**44,382**	**72,987**	**71,395**
Elbasan	81,659	41,084	40,575	80,185	40,105	40,080
Labinot Mal	5,490	2,762	2,728	5,391	2,754	2,637
Funarë	2,202	1,108	1,094	2,162	1,080	1,082
Labinot Fushë	7,323	3,684	3,639	7,191	3,694	3,497
Bradashesh	11,102	5,586	5,516	10,901	5,658	5,244
Gracen	2,274	1,144	1,130	2,233	1,168	1,065
Shushicë	9,059	4,558	4,501	8,895	4,479	4,416
Papër	6,586	3,314	3,273	6,468	3,284	3,183
Shirgjan	7,581	3,814	3,767	7,445	3,765	3,680
Gjergjan	5,319	2,676	2,643	5,223	2,645	2,577
Gjinar	3,609	1,816	1,793	3,543	1,929	1,615
Tregan	3,150	1,585	1,565	3,093	1,568	1,525
Zavalinë	1,683	847	836	1,653	858	795
Qarku Elbasan	**306,939**	**154,426**	**152,513**	**301,397**	**153,389**	**148,008**

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Raportit gjinor i popullsisë së Bashkisë Elbasan, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Rrjedhimisht, mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra*100) tregon së për vitin 2015 ky raport është rritur në favor të popullatës së meshkujve, krahasuar me situatën e raportit gjinor për vitin 2011, (102 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015, nga 101 në vitin 2011).

Nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme, gjithnjë në favor të popullatës së meshkujve (104) dhe kjo situatë është akoma më e theksuar në nivel ish-komunash, ku ky tregues arrin vlerën maksimale edhe 119 (119 meshkuj për çdo 100 femra), si në rastin e njësisë administrative Gjinar. Aktualisht, për vitin 2015, struktura urban/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 31%:61%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukture urban/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2015, rreth 57% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullate urbane. Një tjetër faktor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj.

Një tjetër tregues rëndësishëm demografik, struktura moshore e popullatës dhe mosha mesatare e re, tregojnë se aktualisht popullata e Bashkisë Elbasan vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë tregon së 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç dhe 20% grupmosha (0-14) vjeç. Këto të dhëna shumë optimiste evidentojnë se bashkia/qarku ka potencial të lartë të popullsisë në moshë punë që mund të jetë ekonomikisht aktive.

Tabela 22: Raporti gjinor për Bashkinë Elbasan, 2011-2015

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative	Koeficienti gjinor në %	
	2011	2015
Bashkia Elbasan	101	102
Elbasan	101	100
Labinot Mal	101	104
Funarë	101	100
Labinot Fushë	101	106
Bradashesh	101	108
Gracen	101	110
Shushicë	101	101
Papër	101	103
Shirgjan	101	102
Gjergjan	101	103
Gjinar	101	119
Tregan	101	103
Zavalinë	101	108
Qarku Elbasan	101	104

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit


Analiza e strukturës moshore të popullatës në Bashkinë Elbasan tregon se popullata e kësaj grupmoshë është e

Tabela 23: Popullsia rezidente, sipas grup-moshave

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Elbasan	**147,037**	**30,001**	**101,841**	**15,195**	**144,382**	**29,459**	**100,002**	**14,921**
Elbasan	81,659	15,235	57,621	8,804	80,185	14,959	56,581	8,645
Labinot Mal	5,490	1,473	3,466	550	5,391	1,447	3,404	540
Funare	2,202	409	1,501	292	2,162	401	1,474	286
Labinot Fushë	7,323	1,916	4,825	582	7,191	1,882	4,738	572
Bradashesh	11,102	2,426	7,706	970	10,901	2,382	7,567	953
Gracen	2,274	529	1,494	251	2,233	520	1,467	247
Shushicë	9,059	2,214	6,024	821	8,895	2,174	5,915	806
Papër	6,586	1,490	4,466	631	6,468	1,463	4,385	619
Shirgjan	7,581	1,646	5,166	770	7,445	1,616	5,073	756
Gjergjan	5,319	988	3,789	542	5,223	970	3,721	532
Gjinar	3,609	675	2,511	422	3,543	663	2,466	415
Tregan	3,150	664	2,159	327	3,093	652	2,120	321
Zavalinë	1,683	336	1,112	234	1,653	330	1,092	230
Qarku Elbasan	**306,939**	**64,755**	**210,885**	**31,299**	**301,397**	**63,586**	**207,077**	**30,734**

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Figura 35: Struktura Moshore, Bashkia Elbasan, 2015



Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

pranishme me të njëjtat nivele (66-71%) në të gjitha njësitë administrative (urbane dhe rurale). Gjithsesi, ndërmjet tyre, ka edhe ndryshime nga të cilat duhen veçuar njësitë administrative Funar dhe Zavalinë, të cilat kanë nivelin më të lartë të grupmoshës së të moshuarve (+65 vjeç) me 13-14% dhe njësinë administrative Labinot Mal nivelin më të lartë të grupmoshës së re (0-14), me 27%.

Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, llogariten treguesit e varësisë, që janë shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike. Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe mjedhimisht të ndikojnë përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.

Treguesit e varësisë klasifikohen në: treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave [(0-14)+ (+65)] /(15-65) ndaj popullsisë në moshë punë; treguesi varësisë së të rinjve, (raporti i gupmoshës (0-14)/(15-65); dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës (+65)/ (15-65). Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, "mbulohen"/përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë përkatësisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu, interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhe të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve është "sinjal" për ndarje fondesh e investimesh për të

lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë.

Konkretisht, për Bashkinë Elbasan, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si më poshtë:

Tabela 24: Koeficientët e varësisë

Koeficientët e varësisë, qarku, bashkia, njësi administrative	KOEFICIENTËT E VARËSISË, 2011-2015		
	Varësia totale	Varësia e të rinjve	Varësia e të moshuarve
Bashkia Elbasan	**44**	**29**	**15**
Elbasan	42	26	15
Labinot mal	58	43	16
Funarë	47	27	19
Labinot Fushë	52	40	12
Bradashesh	44	31	13
Gracen	52	35	17
Shushicë	50	37	14
Papër	47	33	14
Shirgjan	47	32	15
Gjergjan	40	26	14
Gjinar	44	27	17
Tregan	46	31	15
Zavalinë	51	30	21
Qarku Elbasan	**46**	**31**	**15**

Burimi: Të dhënat për qarqet nga INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Mbështetur në këta tregues konstatojmë se treguesi i varësisë totale për Bashkinë e Elbasanit shënon vlerën 44 (44 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +vjeç) "përballohen" nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjeç), ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët për gjithë periudhën (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë së bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i "dividendit demografik" dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

Nëse bashkia/qarku do të përfitojë nga ky "dividend demografik", kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikëbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçante edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat më pas do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike, por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale flet për ekzistencën e "dividendit demografik". Analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme të numrin të personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 15%) dhe një rënie të grup-moshave të reja, (nga 60% në 29%) duke demonstruar qartazi për "shenjat" në hyrjen në një faze të re demografike të popullsisë, atë "të plakjes". Rritja e grupmoshës (+65) shoqërohet me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas njësive administrative.

Tabela më poshtë tregojnë numrin e popullsisë për periudhën 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme*. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e Bashkisë Elbasan, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme, e cila si mesatare vjetore për gjatë periudhës 2015-2031 llogaritet të jetë rreth 1%, ndërkohë që rënia e popullsisë në 2031 , e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe, rreth 17%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente gjatë periudhës 2015-2031 është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

** Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në "trendin" që kanë pësuar treguesit demografik të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracioni dhe migracion, INSTAT ka ndërtuar skenarët e parashikimeve për popullsinë. Bazuar në këto përllogaritjeve janë ndërtuar 3 skenarë të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes së ulët, (lindje të ulta, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme (lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi(demografik, financiar-buxhetor,) rekomandohet përdorimi i të dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë. Gjithashtu, vlen të theksohet se parashikimet për popullsinë në rastin e qarqeve janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare dhe vetëm në nivel qarku, pra nuk ka llogaritje në nivel njësie administrative. Mbështetur në të dhënat e popullsisë për komunat, bashkitë dhe peshën e tyre përkatëse ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur "parashikimet për popullsinë në nivel bashkie dhe njësie administrative për periudhën 2016-2031.*

Tabela 25: Popullsia e Bashkisë Elbasan, 2011-2031

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative, 2011-2031	2011	2015	2016	2021	2026	2031
Bashkia Elbasan	147,037	144,382	139,248	132,372	126,017	119,893
Elbasan	81,659	80,185	77,334	73,515	69,985	66,584
Labinot Mal	5,490	5,391	5,199	4,942	4,705	4,476
Funare	2,202	2,162	2,085	1,982	1,887	1,795
Labinot Fushë	7,323	7,191	6,935	6,593	6,276	5,971
Bradashesh	11,102	10,901	10,514	9,995	9,515	9,052
Gracen	2,274	2,233	2,154	2,048	1,949	1,854
Shushicë	9,059	8,895	8,579	8,155	7,764	7,387
Papër	6,586	6,468	6,238	5,930	5,645	5,371
Shirgjan	7,581	7,445	7,180	6,825	6,498	6,182
Gjergjan	5,319	5,223	5,037	4,788	4,558	4,337
Gjinar	3,609	3,543	3,417	3,249	3,093	2,942
Tregan	3,150	3,093	2,983	2,836	2,700	2,569
Zavalinë	1,683	1,653	1,594	1,515	1,442	1,372
Qarku Elbasan	306,939	301,397	290,680	276,326	263,059	250,275

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2011-2031argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

- **Përfundime**

Sipas të dhënave të INSTAT, Bashkia e Elbasanit në 1 janar 2015 regjistroi një numër popullsie rezidente prej 144 mijë banorë, prej të cilëve 73 mijë meshkuj dhe 71 mijë femra. Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 56% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 46% si popullsi rurale. Sipas strukturës moshore rreth 69% e popullatës i përket grupmoshës (15-64) vjeç dhe 20% grupmoshës 19 vjeç. Këta tregues demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.

Por nëse iu referohemi të dhënave të gjendjes civile, vëmë re që popullsia e Bashkisë Elbasan ka pësuar rritje në të gjitha njësitë administrative. Sipas bashkisë, ky fakt mbështetet edhe nga rritja e numrit të votuesve nga viti në vit. Në ndarjen e popullsisë sipas gjinisë, raporti meshkuj femra qëndron në raporte thuajse të barabarta. Pjesa më e madhe e popullsisë është përqendruar në qytetin e Elbasanit dhe në njësitë me terren të butë dhe që kanë akses të mirë. Zonat malore kanë numër më të vogël banorësh.

Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.

Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarqeve është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.

Sipas parashikimeve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.

Popullsia rezidente e Bashkisë Elbasan deri në vitin 2021 do të ketë një tregues të varësisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin "divident demografik".

Për të përfituar nga ky "divident demografik", kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e vendor për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

1.4.2 Analiza social-ekonomike


- **Arsimi**

Figura 36 tregon raportin (në përqindje) të personave që kanë kryer arsimin përfundimtar sipas tre kategorive kryesore të arsimit, ndaj popullsisë 15 vjeç e lart, për Bashkinë e Elbasanit, krahasuar me qarkun dhe nivelin e përgjithshëm kombëtar. Niveli i përgjithshëm i arsimit bazë përfundimtar (fillor dhe 8 ose 9-vjeçar) në Bashkinë Elbasan është relativisht më i lartë (53.9%), nëse krahasohet me mesataren kombëtare prej 52.1%[117]. Megjithatë, përqindja e popullsisë që zotëron nivel arsimor përfundimtar të mesëm dhe të lartë në Bashkinë Elbasan është relativisht më e vogël se popullsia në rang kombëtar, përkatësisht 29.9% dhe 10.8 % e popullsisë në bashki me 31.4 % dhe 11.8 % e popullsisë në rang kombëtar. Gjithashtu, shkalla e analfabetizmit në Bashkinë Elbasan (3.5%), edhe pse krahasueshmërisht e ngjashme me bashkitë e tjera, është relativisht më e lartë se mesatarja në rang vendi (2.8%).

Këto të dhëna tregojnë se popullsia që përbën forcën e punës në këtë bashki është relativisht më pak e kualifikuar se ajo që ofrohet nga bashkitë e tjera dhe për pasojë vështirëson konkurrencën në tregun e punësimit kombëtar ose të paktën në rajonin perëndimor/qendror të Shqipërisë[118]. Fuqia punëtore në njësitë rurale të bashkisë, me nivele të larta të arsimit bazë të përfunduar, por jo me nivele të larta të arsimit të mesëm apo universitar, rezulton të ketë kualifikime jo mjaftueshmërisht konkurruese për tregun e punësimit brënda Bashkisë Elbasan.


Për sa i përket ***shpërndarjes së institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Elbasan***, aktualisht ka 97 kopshte, 127 shkolla 9-vjeçare, dhe 23 shkolla të mesme (të përgjithshme dhe profesionale), shpërndarja e të cilave sipas secilës njësi administrative mund të shihet lehtësisht në grafikun e mëposhtëm[119] (Figura 38).

Figura 36: Niveli arsimit në Bashkinë Elbasan, i krahasuar me qarkun dhe mesataren kombëtare




Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi) dhe përpunime të autorëve

Figura 37: Niveli arsimor përfundimtar fillor dhe 8 ose 9 vjeçar, i mesëm dhe i lartë, INSTAT, 2015 (Censusi)



Burimi: INSTAT, 2011; Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 38: Shpërndarja e institucioneve arsimore parauniversitare në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT, 2011; Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Qyteti i Elbasani (ish-bashkia e vjetër para reformës territoriale) zotëron numrin më të madh të institucioneve arsimore si kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme. Kjo është edhe njësia me numrin më të madh të popullsisë dhe dendësisë së vendbanimeve. Në njësitë si Bradashesh, Gjergjan, Gracen, Shushicë dhe Tregan nuk ka shkolla mesme. Në njësitë e tjera administrative si Funarë, Labinot-Fushë, Papër dhe Zavalinë ka nga një shkollë të mesme për njësi, por në këto njësi arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar zhvillohen në të njëjtin objekt fizik. Gjithashtu edhe në qytetin e Elbasanit, 4 shkolla të mesme janë të bashkuara me ato 9-vjeçare[120]. Për të kuptuar më shumë mbi situatën në sektorin e arsimit në Bashkinë Elbasan, është analizuar edhe cilësia e këtij shërbimi të ofruar duke marrë parasysh dy tregues: gjendjen e infrastrukturës dhe raportin mësues/nxënës.

Gjendja e infrastrukturës së institucioneve arsimore, nga vlerësimi i gjendjes infrastrukturore të të gjitha institucioneve arsimore (kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme) rezulton se kanë nevoja të mëdha për investime, që shkon nga nevojat prioritare për mirëmbajtje deri në rikonstruksion i plotë.

Raporti fëmijë/edukatorë rezulton të jetë më i lartë se mesatarja kombëtare prej 18.25[121], ku në Bashkinë Elbasan një edukator kujdeset për më shumë se 19 fëmijë[122] Mesatarja e Bashkimit Evropian e raportit nxënës/mësues për shkollat fillore është afërsisht 13.4, kurse për shkollat e mesme është 11.8. Në Shqipëri, ky raport në rang kombëtar është afërsisht 19 për shkollat 9-vjeçare dhe 15 për shkollat e mesme[123]. Nga të dhënat e publikuara nga Ministria Arsimit 2015, pothuaj se në të gjitha ***shkollat 9-vjeçare të Bashkisë Elbasan*** ka një ***raport nxënës/ mësues*** (13.89), të ngjashëm më standardet evropiane dhe përgjithësisht më mirë se mesatarja kombëtare (Tabela 26). Megjithatë, në disa njësi administrative, si Shirgjani, Labinot Fushë, numri i mësuesve për nxënës është shumë here më i madh, gjë që mund të ketë implikimet e veta në uljen e cilësisë së këtij shërbimi. Për sa i përket shkollave të mesme, Bashkia Elbasan ka një raport 17.07, relativisht më i lartë krahasuar me mesataren kombëtare dhe mesataren në BE. Njësitë më problematike shfaqen Elbasani, Funari, Labinot-Fusha, Shirgjani.

Tabela 26: Numri i institucioneve arsimore dhe raporti nxënës/ mësues

	Kopshte	Raporti fëmijë/ edukator	Shkolla 9-vjeçare	Raporti nxënës/ mësues Shkolla 9-vjeçare	Shkolla të mesme	Raporti nxënës/ mësues Shkolla e mesme
Elbasan	32	19.01	26	16.65	15	17.61
Bradashesh	11	19.56	12	13.11		
Papër	10	20.90	11	11.60	1	15
Gracen	3	15.33	10	7.75		
Funarë	2	17.50	7	7.96	1	18
Labinot-Mal	5	18.33	12	11.37	2	9.74
Labinot-Fushë	7	24.25	9	11.78	1	17.57
Shushicë	6	23.38	9	13.37		
Shirgjan	3	19.75	6	13.13	1	18.65
Gjergjan	4	18.80	5	10.81		
Tregan	5	14.00	8	10.68		
Gjinar	6	17.33	7	8.55	1	14.3
Zavalinë	3	12.33	5	9.81	1	10
TOTAL	97	19.21	127	13.89	23	17.07

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015[124]

- **Punësimi**

Numri i banorëve në moshë pune, që i përket grupmoshës 15-64 vjeç përbën rreth 69 % të popullsisë së Bashkisë së Elbasanit. Rreth 57 % e kësaj popullsie është banuese në qytetin e Elbasanit (INSTAT, 2015). Këto të dhëna janë optimiste, pasi evidentojnë se Bashkia Elbasan ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomikisht aktive, por përqendrimi i më shumë se gjysmës së kësaj popullsie vetëm në zonën urbane të bashkisë dëshmon se performanca ekonomike e bashkisë është kushtëzuar mjaftueshëm nga zhvillimet që ndodhin në qytetin e Elbasanit.


Për të kuptuar dinamikat në tregun e punës në Bashkinë Elbasan është e nevojshme të analizohen sektorët ekonomikë me numrin më të madh të të punësuarve. Në qytetin e Elbasanit, numri më i madh i të punësuarve është në sektorin e shërbimeve me 49.19% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve (Tabela 27). Në degën e industrisë është punësuar 18,6 %, kurse në ndërtim punon vetëm 7.52 % e të punësuarve[125]. Si mund të shihet në Tabelën 26, pjesa e popullsisë që ndodhet në pjesën më rurale të bashkisë është punësuar kryesisht në bujqësi.

Punësimi sipas nivelit arsimor shërben për të kuptuar nivelin e edukimit të forcës aktive të punësuar në Bashkinë Elbasan (Figura 39). Kështu, 42.1% e të punësuarve kanë arsim bazë 8-9 vjeçar, përkundrejt 38.1 % të të punësuarve në rang kombëtar me të njëjtin nivel arsimor. Në të njëjtin drejtim, numri i të punësuarve në Bashkinë Elbasan me arsim të mesëm, profesional dhe të lartë është më i ulët se ai në rang kombëtar. Këto të dhëna dëshmojnë se forca punëtore në Bashkinë Elbasan është më pak e kualifikuar se ajo në nivel kombëtar. Ndërtimi i shkollave të mesme të profilizuara dhe nxitja e të rinjve të ndjekin arsim të mesëm profesional shihen të domosdoshme për kualifikimin e mëtejshëm të fuqisë punëtore.

Në bazë të të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, ***niveli i papunësisë*** në Bashkinë Elbasan është 32.1 %, relativisht më i lartë se ai në rang kombëtar (29.3%).

Papunësia në lidhje me raportin gjinor në Bashkinë Elbasan është 36.3% për femrat dhe 29.6 % për meshkujt (INSTAT, Censusi 2011). Kjo prirje konfirmohet në nivel qarku dhe në nivel kombëtar. Megjithatë, në përgjithësi, prirja e papunësisë në Bashkinë Elbasan nuk është i njëjtë për të gjitha njësitë administrative. Qyteti i Elbasanit për shkak

Figura 39: Punësimi sipas nivelit arsimor në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi) dhe përpunime të autorëve

Tabela 27: Punësimi sipas sektorëve ekonomikë, sipas njësive Bashkia Elbasan

	Bujqësi, pyje dhe peshkim	Tregti me shumicë dhe pakicë	Ndërtim	Industri	Shërbime	E papërcaktuar
Bradashesh	35.51 %	7.75 %	8.33 %	14.00 %	18.51 %	15.89 %
Elbasan	2.35 %	19.78 %	7.52 %	18.60 %	49.19 %	2.56 %
Funarë	85.04 %	0.51 %	3.17 %	0.76 %	7.22 %	3.30 %
Gjergjan	65.49 %	5.04 %	8.02 %	4.48 %	12.22 %	4.76 %
Gjinar	71.36 %	3.48 %	3.64 %	3.03 %	15.45 %	3.03 %
Gracen	87.80 %	0.20 %	2.36 %	1.38 %	7.28 %	0.98 %
Labinot Fushë	50.38 %	6.24 %	10.30 %	10.45 %	19.17 %	3.46 %
Labinot Mal	81.02 %	1.00 %	1.91 %	1.18 %	7.36 %	7.54 %
Papër	57.67 %	6.93 %	8.65 %	5.79 %	16.31 %	4.65 %
Shirgjan	49.30 %	8.42 %	15.19 %	7.78 %	15.32 %	3.99 %
Shushicë	63.84 %	5.34 %	10.68 %	3.59 %	10.81 %	5.74 %
Tregan	67.62 %	2.01 %	6.04 %	3.19 %	12.92 %	8.22 %
Zavalinë	77.40 %	2.00 %	2.00 %	1.20 %	15.9 %	1.40 %


Burimi: INSTAT, 2015

Tabela 28: Punësimi sipas nivelit arsimor sipas njësive administrative të Bashkisë Elbasan

	Me arsim fillor, 8 ose 9- vjeçar	Me arsim të mesëm dhe profesional	Me arsim të lartë
Elbasan	20.68 %	44.70 %	33.55 %
Bradashesh	65.99 %	27.23 %	5.30 %
Papër	69.60 %	24.71 %	4.90 %
Gracen	84.25 %	12.60 %	3.00 %
Funarë	78.45 %	18.00 %	2.80 %
Labinot-Mal	77.02 %	18.26 %	3.40 %
Labinot-Fushë	68.87 %	24.21 %	5.90 %
Shushicë	73.20 %	20.40 %	4.40 %
Shirgjan	62.78 %	30.38 %	5.90 %
Gjergjan	69.40 %	26.31 %	3.70 %
Tregan	74.66 %	20.30 %	4.50 %
Gjinar	58.64 %	31.82 %	7.90 %
Zavalinë	60.89 %	25.20 %	10.90 %


Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Figura 40: Papunësia në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi) dhe përpunime të autorëve

Figura 41: Papunësia në Bashkinë Elbasan, sipas njësive administrative



Burimi: INSTAT, 2011 (Census)

të karakterit urban ka dhe një treg pune më dinamik dhe të lëvizshëm. Kurse njësitë e tjera administrative, me një nivel shumë të lartë të punësuarve në sektorin bujqësor, me një treg të akomoduar pune dhe pothuaj të pandryshueshëm, karakterizohen nga një nivel shume i ulët i papunësisë. Niveli më i madh i papunësisë në Bashkinë Elbasan është në qytetin e Elbasanit me 37.4 %. Disa nga njësitë administrative me nivelin më të ulët të papunësisë janë Funara me 5.6 %, Labinot-Mali me 14 % dhe Zavalina me 14.3 %. Shifrat reflektojnë një dukuri shqetësuese për punësimin e të rinjve në këto njësi. Në njësinë e Elbasanit, 67.5% të rinj të moshave 15-24 vjeç janë të papunë. Përveç Funarës (12 %), e njëjta pririe konfirmohet pothuajse për të gjitha njësitë e tjera.

- **Shëndetësia**

Sektori i shërbimit shëndetësor në Bashkinë Elbasan përbëhet nga 1 spital rajonal i cili do të zgjerohet, 1 spital kombëtar Psikiatrik, 14 qendra shëndetësore dhe 81 ambulanca/qendra konsultore.

Shqipëria është një nga vendet e Ballkanit me numrin më të vogël të stafit mjekësor, me 1.14 mjekë për 1,000 banorë (OBSH, 2014) ose 1 mjek për 887 banorë[126]. Kurse, mesatarja në BE është 3.4 mjekë për 1,000 banorë ose 1 mjek për 295 banorë[127]. Në bashkinë e Elbasanit ky raport është 4 herë më i ulët, ku një mjek i shërben statistikisht 1,266 banorëve[128]. Mungesa e stafit mjekësor është edhe më e theksuar në njësitë administrative (ish-komunat para reformës territoriale) të Funarës, Gjergjanit, Labinot-Fushës, Labinot Malit, Papërit, Shushicës, etj., ku raporti banorë/mjekë shkon më tepër se 2,500, pothuaj 10 herë më shumë se mesatarja e BE-së. Megjithatë, kjo analizë nuk merr parasysh rrezen e shpërndarjes së mjekëve. P.sh., një mjek mbulon mbi 13 mijë banorë në qytetin e Elbasanit[129] dhe lihen pothuaj të pambuluara zona të tëra banimi në njësitë rurale të Bashkisë.

Në të gjithë bashkinë, trendet e ***lindshmërisë dhe vdekshmërisë*** vijnë duke u ulur, gjë që sygjeron të fillohet planifikimi për një popullsi në plakje[130]. Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria renditet si vendi i parafundit me tregues për vdekshmërinë foshnjore më negative në Ballkan, me 7.9 foshnja të vdekura/1,000 lindje krahasuar me mesataren e BE-së, e cila është 3.7/1,000 lindje[131]. Për qytetin e Elbasanit ky tregues është 42 vdekje foshnjore për 3894 lindje ose 10.8 vdekje për 1,000 lindje[132], një tregues shumë i lartë për një zonë urbane. Për zonat rurale dhe kryesisht në njësitë e tjera administrative, vdekshmëria foshnjore është zakonisht edhe më e lartë[133]. Ky është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar kushtet e institucioneve shëndetësore në lidhje me faktorët e higjienës, infrastrukturës (aksesit në qendra shëndetësore

Tabela 29: Treguesit e shërbimit shëndetësor në Bashkinë Elbasan

Njësia	Qendra shëndetësore	Ambulanca	Raporti banorë/ ambulanca	Nr. Mjekësh	Raport banorë/ mjekë	Shtretër	Raporti shtretër/ banorë
Elbasan	4	12	6682	86	932	400	200
Bradashesh	1	14	778	4	2725	13	838
Funarë	1	7	308	1	2162		
Gjergjan	2	6	870	2	2611		
Gjinar	1	6		2	1771		
Gracen	1	5	446	2	1116		
Labinot Fushë	1			3	2397		
Labinot Mal		6	898	2	2695		
Papër	1	12	539	3	2156		
Shirgjan				3	2481		
Shushicë	1	8	1111	3	2965		
Tregan		11	281	2	1546	13	237
Zavalinë	1			1	1653		
TOTAL	14	81	1412	114	1266	426	339

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

dhe gjendja fizike e institucioneve), dhe nivelit të arsimit dhe informacionit të duhur për nënat shtatzëna.


Numri i personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Elbasan është pothuajse i njëjtë me atë në nivel kombëtar. Rreth 6.3 % e popullsisë banuese në Bashkinë e Re të Elbasanit ose rreth 9,100 persona kanë deklaruar se kanë të paktën një aftësi të kufizuar[134]. Numri më i madh i personave me aftësi të kufizuar i përket atyre që vuajnë nga kufizimet në lëvizje me 3.7 % në nivel bashkie. Në disa njësi administrative si Zavalinë (15.25%), Gracen (10.88), Gjinar (9.44%), ka një numër të madh personash me të paktën një aftësi të kufizuar. Këto janë të dhëna shumë të rëndësishme statistikore, pasi tregojnë se sa i domosdoshëm është planifikimi për lehtësimin e pengesave fizike për personat me aftësi të kufizuara.

- **Mirëqenia ekonomike**

Në Bashkinë Elbasan, rreth 13.5 % të ***familjeve marrin ndihmë sociale*** dhe përfitime (transferta të tjera) nga shteti në krahasim me 11.7 % të familjeve në rang vendi[135]. Në nivel qarku, ky numër shfaqet edhe më i lartë me 15.16 % të familjeve përfituese. Burimi i të ardhurave të NjEF-së nga puna e paguar ose vetëpunësimi është më i ulët në nivel bashkie dhe qarku, përkatësisht 51.8 % dhe 54.60 % krahasuar me nivelin kombëtar me 56.4 %. Burimi i të ardhurave nga të gjitha llojet e pensioneve për Bashkinë e Elbasanit është 31.7 %, pothuaj në të njëjtat nivele si ato kombëtare. Nga ana tjetër, 10.1 % e familjeve në Bashkinë së Elbasanit kanë si burim të ardhurash dërgesat nga jashtë shtetit përkundrejt 8.6 % të familjeve në rang kombëtar. Ky nivel është edhe më i lartë në nivel qarku, ku 12.98 % të familjeve që jetojnë Qarkun Elbasan kanë si burim të ardhurash para të dërguara nga jashtë shtetit

Këto të dhëna tregojnë se afërsisht gjysma e popullsisë siguron të ardhura jo nga puna e paguar ose vetëpunësimi, por nga shteti në formën e ndihmave sociale dhe pensioneve ose nga para të dërguara nga jashtë shtetit. Në disa njësi administrative në Bashkinë Elbasan, burimi i të ardhurave të NJEF-ve nga ndihma ekonomike sociale dhe përfitime të tjera është disa herë më e lartë se mesatarja kombëtare. Kështu, p.sh., numri i familjeve që përfitojnë ndihmë sociale në disa njësi si Graceni (20.56%), Funarë (32.5%), Labinot Mal (35.76%), Gjinar (25.65%), Zavalinë (34.45%) është mesatarisht 4 ose 5 herë më i lartë se në njësitë e tjera të bashkisë. Në njësitë Papër (4.93%), Shushicë (5.47%), Tregan (6.08%), numri i familjeve që përfitojnë ndihmë sociale është i vogël, por në këto njësi numri i familjeve që sigurojë të ardhura nëpërmjet dërgesave nga jashtë është edhe më i larti në bashki. As gjysma e familjeve në Funarë (37.27%), Gracen (44.35%), Labinot Mal (41.33), Gjinar

Figura 42: Burimi i të ardhurave të NJEF-së sipas njësive administrative në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT, 2011 (Census)

(48.17%) nuk sigurojnë të ardhurat nëpërmjet punës së paguar apo vetëpunësimit, gjë që dëshmon për një nivel të ulët të ardhurash në përgjithësi në këto njësi.

- **Varfëria**

Të dhënat për Qarkun e Elbasanit tregojnë se përqindja e varfërisë është 10.7 % në krahasim me 14.3 % të varfërisë në nivel kombëtar[136]. Bashkia Elbasan përbën qendrën e Qarkut të Elbasanit, i cili konsiderohet si një nga qarqet me shkallën më të ulët të varfërisë në vend. Hendeku i varfërisë tregon se sa larg janë individët nga linja e varfërisë. Qarku Elbasanit ka një hendek varfërie 2.3 %, relativisht më të ulët se ai kombëtar me 2.9%. Ky hendek varfërie prej 2, 3 % do të thotë se shuma e përgjithshme që do t'u duhej të varfërve për të arritur nivelin e linjës së varfërisë është e barabartë me popullsinë shumëzuar me 2.3 % të linjës së varfërisë[137]. Treguesi tjetër është ashpërsia e varfërisë, që tregon pabarazisë midis të varfërve. Qarku Elbasan me 0.8 % nivel ashpërsie shfaqet relativisht më mirë se niveli kombëtar me nivelin 1%.

- **Përfundime dhe Rekomandime**

Bashkia e Elbasanit rezulton të jetë bashkia me performancën më të lartë brenda qarkut të Elbasanit, nëse analizohen tregues të tillë si niveli arsimor, cilësia e shërbimit shëndetësor, niveli i punësimit apo mirëqenia ekonomike. Megjithatë, për zhvillimin e njëtrajtshëm ekonomik dhe social të territorit të bashkisë dhe kapërcimit të sfidave të shumta është e nevojshme ndërmarrja e disa masave prioritare.

Tabela 30: Varfëria në Qarkun e Elbasanit

Qarku	Treguesit e varfërisë		
	Përqindja	Hendeku (%)	Ashpërsia (%)
Elbasan	10.7	2.3	0.8
Shqipëria	14.3	2.9	1,0

Burimi: Vjetari statistikor,2015

Arsimi: Aktualisht në Bashkinë Elbasan shërbejnë 97 kopshte, 127 shkolla 9-vjeçare, dhe 23 shkolla të mesme për një popullsi prej 144,382 banorë. Shpërndarja e këtyre institucioneve në të gjithë territorin mbetet një problem që ka nevojë të trajtohet. Shumica e shkollave dhe kopshteve, veçanërisht në njësitë administrative me karakter rural (me përjashtim qytetin e Elbasanit), kanë një infrastrukturë të dobët fizike, janë pjesërisht të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike dhe një pjesë e mirë e tyre nuk i plotësojnë standardet minimale të sipërfaqes së objektit/oborrit apo terreneve sportive për fëmijë.

Rekomandime:

- Të ndërtohet të paktën një shkollë e mesme në çdo njësi administrative të Bashkisë Elbasan që nuk e ka një të tillë, si Bradshesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë dhe Tregan.
- Të shqyrtohet mundësia e ndërtimit të një shkolle të mesme shumëfunksionale profesionale (të ketë disa profile të ndryshme) në qytetin e Elbasanit, pasi shkollat e mesme ekzistuese nuk e mbulojnë plotësisht këtë zonë me shërbim.
- Duke marrë në konsideratë dhe raportin e vogël të edukatorëve për fëmijë, këshillohet që bashkia e Elbasanit të ndërmarri një studim më të thelluar të numrit ekzistues të fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç, shpërndarjes së tyre në territor dhe aksesit në kopshte.

- Të bëhet një inventarizim i hollësishëm i mjeteve didaktike ekzistuese në kopshte dhe shkolla dhe të kryhet pajisja e tyre sipas nevojave.
- Të përmirësohet infrastruktura fizike e institucioneve arsimore veçanërisht të kryhet rikonstruksion i plotë në shkollën 9-vjeçare Bodin, në njësinë administrative Gracen; në një kopsht dhe 2 shkolla 9-vjeçare Bradashesh; në 3 shkolla 9-vjeçare në Funar (si në shkollën Preç e Poshtme, Cerujë, Kërrabë e Vogël); 2 kopshte dhe 1 shkollë fillore në Zavalinë, përkatësisht në Burrishtë dhe Kamiçan; 3 shkolla 9-vjeçare në Tregan (përkatësisht në Kaçivel, Kaçivel i Poshtëm dhe Shënavlash); 3 shkolla 9-vjeçare në Gjergjan (Gjergjan, Kodra Bujaras, Bujaras), etj. Në çdo njësi administrative të Elbasanit ka nevojë për rikonstruksion të pjesshëm për një sërë shkollash dhe kopshtesh.

Punësimi: Elbasani është ndër ato bashki, ekonomia e të cilës është dëmtuar rëndë nga tranzicioni, gjë që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në shkallën e maturimit të tregut të punësimit dhe si rrjedhojë në shkallën e papunësisë. Shpërndarja e punësimit sipas sektorëve tregon përqendrim më të lartë të punësimit në zonat urbane në industri dhe shërbime, përkundrejt bujqësisë si burimi kryesor i punësimit në zonat rurale. Shkalla e papunësisë në Bashki është 32.1 % dhe vërehet se ka pabarazi të theksuara në këtë tregues mes qytetit të Elbasanit (37.4 %) dhe 12 njësive të tjera administrative (me shkallë më të ulët të papunësisë si p.sh., 5.6 % në Funarë; 14.1% në Labinot Mal, 14.3% në Zavalin, etj). Papunësia te të rinjtë mbetet një nga problemet e menjëhershme për t'u trajtuar. Pjesa më e madhe e të punësuarve zotërojnë nivel arsimor bazë në zonat rurale dhe arsim të mesëm dhe të lartë në qytetin e Elbasanit.

Rekomandime:

- Shkalla e papunësisë në bashkinë e re të Elbasanit është relativisht e lartë dhe për të përballuar kërkesat e larta për punësim, bashkia duhet të ndërmarrë politika për zhvillimin e përgjithshëm dhe me ritme të shpejta ekonomike.
- Në kushtet e territorit të ri, me disa qendërsi urbane dhe karakter të theksuar bujqësor dhe malor, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal është një hap urgjent për t`u ndërmarrë për bashkinë e Elbasanit. Bashkia duhet të luajë një rol aktiv në mbështetje të zhvillimit rural, krahas atij urban.
- Me dobësimin e sektorëve ekonomik si industria apo ndërtimi në vitet e fundit, shumica e të punësuarve në qytetin e Elbasanit është përqendruar në sektorin e shërbimeve. Për këtë arsye, bashkia duhet të nxisë rritjen e shpejtë të bizneseve private, duke ndjekur politika fiskale stimuluese, duke vënë në dispozicion të qytetarëve burime potenciale, si trashëgimia historike p.sh., për zhvillimin e bizneseve të reja private në këtë fushë, duke rritur investimet publike nëpërmjet mekanizmave të ndryshme si përdorimi i fondeve publike, kredive, granteve apo projekte me donator të ndryshëm, etj.
- Në kushtet ku norma e papunësisë është shumë e lartë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç dhe me decentralizimin e procesit të menaxhimit të sektorit të arsimit parauniversitar dhe kalimin e tij si kompetencë e bashkisë, Bashkia Elbasan duhet me prioritet të drejtojë forcën ekonomike aktive drejt arsimit dhe formimit profesional, në shërbim të tregut lokal të punës. Prioritet duhet t'i jepet kurseve dhe trajnime afatshkurtra të të rinjve dhe forcimi i partneritetit publik-privatë në të gjitha sektorët ekonomik.

Shëndetësia: Shërbimi shëndetësor ofrohet në Bashkinë Elbasan nga një spital rajonal, nga spitali kombëtar psikiatrik, nga 14 ambulanca dhe 81 qendra shëndetësore[138]. Edhe pse shpërndarja e këtyre institucioneve është relativisht e mirë dhe mbulon pjesën më të madhe të territorit, mungesa e stafit të nevojshëm mjekësor dhe shpërndarja jouniformë e tyre është një dukuri që duhet adresuar. Zgjerimi i spitalit rajonal dhe pajisja me teknologjitë e nevojshme do ndikojë pozitivisht në shërbimin shëndetësor që do t'iu ofrohet qytetarëve të Elbasanit. Vdekshmëria foshnjore rezulton të jetë e lartë në të gjithë bashkinë dhe veçanërisht në zonat rurale. Rreth 6.3 % e popullsisë banuese në Bashkinë e re të Elbasanit ose rreth 9,100 persona kanë deklaruar se kanë të paktën një aftësi të kufizuar.

Rekomandime:

- Përgjithësisht, ambulancat dhe qendrat shëndetësore shfaqin një infrastrukturë fizike të dobët. Nevojitet ndërhyrja e menjëhershme për rikonstruksionin e tyre, veçanërisht e 4 ambulancave jo-funksionale, 2 në Bradashesh dhe 2 në Papër. Për më tepër, nevojitet ndërhyje dhe rikonstruksion i pjesshëm në njësinë administrative Gjinar (qendra shëndetësore ka pasur rikonstruksion të pjesshëm); Tregan (2 ambulanca janë gjendje të amortizuar fizike); në Gjergjan; Shushicë (qendra shëndetësore në Qafë është komplet e amortizuar); Zavalinë, etj.
- Kategori si gratë dhe vajzat, të rinj me probleme sociale dhe persona me aftësi të kufizuar nuk ndihmohen nga institucione të posaçme të shërbimit social. Megjithatë, në Bashkinë Elbasan operojnë rreth 328 kujdestarë të shërbimeve sociale. Me gjithë dinamikën e zhvillimeve socio-ekonomike, kështillohet ndërtimi/forcimi i kapaciteteve të institucioneve ekzistuese për ofrimin e

shërbimit përkatës social dhe ndërtimi i institucioneve të posaçme për ofrimin e këtyre shërbimeve.

- Për përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimin shëndetësor është e domosdoshme rritja e numrit të ambulancave në mënyrë që të arrihet një tregues mesatar të paktën një ambulancë për rreth 6,000 banorë.
- Për të përmirësuar raportin mjek-banorë është prioritare rritja e numrit të mjekëve në shërbimin shëndetësor parësor, që i shërbejnë drejtpërdrejtë banorëve të bashkisë së Elbasanit.

Mirëqenia ekonomike: Bashkia Elbasan bën pjesë në prefekturën e Elbasanit, e cila ka një nivel varfërie ndër më të ulët në vend, me 10.8 %. Megjithatë, analiza e burimit të të ardhurave për njësi ekonomike familjare tregon se afërsisht gjysma e familjeve që jetojnë Bashkinë Elbasan nuk siguron të ardhura nga puna e paguar ose vetëpunësimi, por nga shteti në formën e ndihmave sociale dhe pensioneve ose nga para të dërguara nga jashtë shteti, në formë remitancash.

Rekomandime:

- Duke marrë parasysh pabarazitë mes zonës urbane dhe asaj rurale të bashkisë, është i domosdoshëm zhvillim i njëtrajtshëm ekonomik me rritme të larta rritje për të gjithë bashkinë, por duke konsideruar karakteristikat e veçanta fizike, sociale dhe ekonomike për secilën njësi specifike.
- Rritja e punësimit dhe e trajnimi profesional i forcës punëtore shihen si masa prioritare për rritjen e mirqënies ekonomike.
- Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë dhe me specifikisht ngritja e kapaciteteve bashkiake për të aplikuar për fonde, grante dhe programe, sidomos nga programet e Bashkimit Europian për zhvillimin rural dhe rajonet më pak të zhvilluara shihet si prioritet.

1.5 PËRDORIMI I TOKËS DHE INFRASTRUKTURAT

1.5.1 Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës

Metodologjia e përdorur nga grupi i punës për analizën e përdorimit të tokës është mbështetur në Vendim nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", kreu III, seksioni I, neni 77. Përdorimi i tokës dhe strukturave në të ndahet në 14 kategori bazë, duke përfshirë edhe 3 kategori të tjera të cilat janë menduar të arsyeshme të shtohen në metodologji dhe janë: Banim i përzier, Shërbime i përzier dhe Miks Miks, të cilat janë rezultat i përzierjes së 2 apo më shumë kategorive bazë të parashikuara nga VKM nr. 671.

Leximi i territorit fillimisht është bërë sipas sistemeve territoriale ekzistuese, të cilat janë përcaktuar në VKM nr. 671, neni 73:


- Sistemi urban (UB);
- Sistemi natyror (N);
- Sistemi bujqësor (B);
- Sistemi ujor (U);
- Sistemi infrastrukturor (IN).

Duke u mbështetur në analizën e sistemeve territoriale, vëmë re se sipërfaqen më të madhe e zë sistemi natyror, përafërsisht 72% të territorit. Sistemi natyrorë është i përqendruar në skajet e territorit të bashkisë, duke qenë se këto zona përshkruhen nga sisteme kodrinore dhe pjesërisht malore Po ashtu, sistemi natyror ndërthuret me zonat e mbrojtura që ndodhen në territorin e bashkisë. Sistemi bujqësor renditet i dyti, duke zënë afërsisht 21% të territorit dhe ndodhet përgjatë shtratit të Lumit Shkumbin, në fushën e Elbasanit, zonë të cilën janë përqendruar zhvillimet urbane, industriale dhe ekonomike. Në pjesën jugore të territorit sistemi urban ndërthuret me sistemin natyror dhe me sistemin urban. Sistemi urban i cili zë 3.5% është përqendruar kryesisht në qytetin e Elbasanit. Ky sistem evidentohet edhe përgjatë akseve kryesore rrugore siç është rruga Elbasan-Librazhd, rruga Cërrik-Shirgjan, segmenti Papër-Bradashesh-Elbasan dhe në njësitë administrative që kanë distancë të vogël me qytetin e Elbasanit si Bradasheshi, Shirgjani dhe Labinot Fushë. Në pjesën verilindore dhe jugperëndimore të Bashkisë Elbasan sistemi urban është pikësor dhe ndërthuret me sistemin natyror dhe sistemin bujqësor.

Sipërfaqja totale e Bashkisë Elbasan është 872 km². Kategoria që zë sipërfaqen më të madhe në territor është ajo natyrore 628.6 km² dhe e dyta është kategoria bujqësore me 176,7 km². Në territorin e Elbasanit ka edhe sipërfaqe të konsiderueshme ujore që në total zënë një sipërfaqe prej 40.8 km². Kategoria e përdorimit banim zë një sipërfaqe totale 18.4 km² dhe është e përqendruar kryesisht në pjesën e qytetit ndërsa në fshatra zë më pak sipërfaqe dhe ka shpërhapje më të madhe. Kategoria industri dhe ekonomi zë 3.5 km² të të gjithë sipërfaqes së Elbasanit dhe është më e përqendruar përgjatë akseve kryesore dhe në njësinë administrative Bradashesh.

Thuajse në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan gjejmë mbivendosje të përdorimit të tokës. Mbivendosjet më të

Figura 43: Sistemet territoriale në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

shpeshta janë ndërmjet kategorive banim-bujqësi, banim-natyrore, banim-industri dhe ekonomi dhe bujqësi-industri dhe ekonomi, përdorime të veçanta (zona e varrezave) me banim. Mbivendosja e banimit me zonat natyrore dhe banimit me zonat bujqësore është e pranishme thuajse në të gjithë territorin, për arsye se urbanizimi i territorit ka ndodhur si në zonat e qyteteve ashtu edhe fshatrave në mënyrë të pa kontrolluar. Në njësitë administrative Gracen dhe Zavalinë ka mbivendosje të zonave natyrore me banimi, duke qenë se këto njësi shtrihen kryesisht në territor kodrinor. Njësitë administrative Shushicë dhe Shirgjan shtrihen në terren fushor dhe kanë sipërfaqe me toka bujqësore. Në këto njësi mbivendosen banimet me tokat bujqësore. Zonat industriale dhe ekonomike mbivendosen me ato bujqësore. Ish Kombinati Metalurgjik në njësinë administrative Bradashesh është i vendosur në tokë bujqësore. Zona që ka pasur presion më të madh zhvillimi është përgjatë Lumit Shkumbin, për arsye të karakterit fushor që ka kjo zonë. Pranë Lumit Shkumbin janë vendosur zona me karakter ekonomik duke krijuar mbivendosje të zonave industriale me sipërfaqet ujore

- **Përfundimet**

Analiza e përdorimit të tokës evidenton përdorimin kryesor të tokës, që është kategoria natyrore dhe zë përafërsisht 72% të territorit. Toka bujqësore zë sipërfaqe

Figura 44: Sistemi Urban




Figura 45: Sistemi infrastrukturor




Figura 46: Sistemi bujqësor




Figura 47: Sistemi hidrografik



Figura 48: Sistemi natyror






Figura 49: Sistemet Territoriale, Bashkia Elbasan




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 50: Përdorimi i tokës sipas kategorive kryesore (km²)



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 51: Mbivendosje të përdorimit të tokës, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

të konsiderueshme duke u renditur e dyta me 21%. Por në territorin e Elbasanit janë shumë të pranishme edhe përdorimet konfliktuale siç janë banim-industri, pranë zonës së metalurgjikut, pranë Fabrikës së Çimentos apo pranë ish Fabrikës së Drurit. Konflikte të tjera janë ndërmjet kategorive bujqësi dhe industri, siç ndodhin në fushën e Elbasanit, ku vendoset metalurgjiku dhe fabrika të tjera.

1.5.2 Rrugët dhe transporti

- **Infrastruktura rrugore dhe transporti**

Bashkia Elbasan shtrihet në një pozicion gjeografik të favorshëm për sa i përket infrastrukturave të transportit rrugor dhe hekurudhor. Territori i Bashkisë Elbasan përshkruhet nga korridore rrugore me rëndësi ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale. Nga infrastrukturat rrugore më të rëndësishme që kalojnë Bashkinë e Elbasanit janë:

- **Korridori VIII** është korridori i vetëm Pan-Evropian që kalon në Shqipëri. Ky korridor fillon në portin e Durrësit (porti më i madh i vendit) ku më pas kalon në Kavajë, Rrogozhinë ku është duke u ndërtuar bajpasi, i cili do të kaloj në pjesën jugore të qytetit të Rrogozhinës, më pas kalon në Elbasan, si pjesë e këtij korridori në Elbasan do të ndërtohet bajpasi që pritet kalojë në periferi të qytetit. Më pas ky korridor vazhdon në Përrenjas, ku ngjitet drejt Ohrit, pastaj shkon në Shkup, vazhdon në Sofje, Burgas dhe përfundon në Varna.

Në bashkinë e Elbasanit kalojnë rrugët shtetërore:

- ***Rruga Shtetërore 7 (SH7)*** fillon në Rrogozhinë dhe përfundon tek rrethrrotullimi i Elbasanit.
- ***Rruga Shtetërore 3 (SH3)*** fillon në Tiranë dhe përfundon në Korçë. Kjo rrugë është 150 km e gjatë. Duhet theksuar që ky itinerar kalon nga rruga e vjetër e Elbasanit (rruga e Kërrabës) ku bashkohet me rrugën Shtetërore 7 në rrethrrotullimi tek Metalurgjiku. Një pjesë e këtij itinerari shkon në Ohër si pjesë e Korridorit VIII, e cila quhet ***Route E852***, kurse itinerari tjetër shkon në drejtim të Korçës ku është pjesë e Route E86. Në bashkinë e Përrenjasit ndahet ***Route E852*** me ***Route E86*** [139].
- ***A3***- Autostrada Tiranë-Elbasan ka sjellë një lidhje me optimal ndërmjet Tiranës dhe Elbasanit. Kjo autostradë e cila është ende në ndërtim, do të jetë pjesë e boshtit qëndror jugor që pritet të ndërtohet[140].
- ***Boshti qendror jugor*** është një nga investimet

infrastrukturore më të rëndësishme që pritet të ndërtohet në vendin tonë pas Rrugës së Kombit. Kjo infrastrukturë ndërthuret me Korridorin VIII në aksin verior me Tiranën (Autostrada A3), i cili më pas nis nga Papër (sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030 të publikuar nga AKPT) ku vazhdon në drejtim të Cërrikut-Kuçovës-Beratit-Memaliajt. Me anën e bajpasit në Memaliaj bëhet dhe lidhja e drejtpërdrejt me korridorin tjetër me rëndësi ndërkombëtare, Korridori i Kaltër, i cili është një tjetër korridor ndërkombëtar që nis në Itali (Trieste) dhe vazhdon në Kroaci, Mal të Zi, në Shqipëri dhe përfundon në Kallamat të Greqisë. Boshtit qendror jugor (Elbasan-Tepelenë) në vitin 2016 do t'i jepet një rëndësi edhe më e madhe, sepse kjo infrastrukturë do të sjellë një lidhje më optimale ndërmjet Shqipërisë qendrore dhe jugore. Ky korridor është i gjatë rreth 180 km ku vetëm 10% është i ndërtuar 15% është duke u planifikuar si dhe ngelet për t'u planifikuar edhe 75%[141].


Sipas informacioneve të marra nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) në Bashkinë e Elbasanit janë duke u rindërtuar disa rrugë si rruga Elbasan-Banjë, e cila nis në Papër vazhdon në Cërrik dhe përfundon në Banjë. Ky itinerar ka një distancë prej 16,085 km. Një tjetër rrugë që është duke u rikonstruktuar është Elbasan-Cërrik me gjatësi 12,465 km. Rikonstruksioni i këtyre rrugëve si dhe vendosja e sinjalistikës horizontale dhe vertikale do të bëjë të mundur një lidhje më të mirë të Bashkisë Elbasan me Bashkinë e Cërrikut, Gramshit dhe më tej.

Transporti ndërqytetës: Nga analiza e transportit ndërqytetës (interurban), sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lëvizshmërinë më të shpeshtë Bashkia e Elbasanit e ka me Tiranën dhe Lushnjën. Nga skema e paraqitur më poshtë shohim që Bashkia Elbasan ka 21 orare që shkojnë drejt Tiranës dhe 7 orare drejt Lushnjes në ditë, kjo tregon lidhjet e shpeshta që kanë këto bashki me njëra tjetrën. Kjo analizë është matur me anë të numrit të orareve që nisen nga Elbasani drejt vendeve të tjera të vendit. Për t'u theksuar është dhe lidhja që ka me Durrësin me 6 orare në ditë.

Nga informacionet e marra nga Instituti i Transporteve, autobusët ndërqytetës nisen nga 4 sheshe të cila janë: Sheshi Tre Urat në pronësi shtetërore, sheshi të Ura e Zaranikës në pronësi shtetërore por që nuk shfrytëzohet, sheshi i Valmit (taksive) në pronësi shtetërore si dhe sheshi tek Namazgjaja, i cili ka një kapacitet prej 35 deri 40 autobusësh dhe është në pronësi komunitetit Mysliman.

Analiza e infrastrukturës rrugore bazuar tek Kodit rrugor i Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit të gjitha rrugët

Figura 52: Transporti ndërqytetës (nisja nga Bashkia Elbasan)



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Përpunoi:Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

automobilistike në territorin e Shqipërisë klasifikohen si më poshtë:

A. Autostradë

B. Rrugë ndërqytetëse kryesore

C. Rrugë ndërqytetëse dytësore

D. Rrugë urbane kryesore

E. Rrugë urbane dytësore

F. Rrugë lokale[142]


Nga analiza së infrastrukturës rrugore në Bashkinë Elbasan ka **1681 km rrugë lineare**[143]. Nga plani rregullues i Elbasanit, në vitin 2005, në qytetin e Elbasanit shtriheshin **140** km rrugë lineare, pra infrastruktura rrugore është rritur **afërsisht 12 herë** në krahasim më Bashkinë e Elbasanit para reformës territorial (Maj 2014).

Tabela 31: Infrastruktura rrugore e Bashkisë Elbasan sipas kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë

Gjatësia e rrugës (km)	Ekzistuese
Autostradë	29
Rruge ndërqytetëse kryesore	84
Rruge ndërqytetëse dytësore	242
Rruge urbane kryesore	46
Rruge urbane dytësore	322
Rrugë lokale	958
Total	1681

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015 (Sipërfaqe e matur në GIS)

Figura 53: Ndarja e rrugëve sipas kodit rrugorë



Burimi: Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Nga Tabela 31, shohim që shtrirjen lineare më të vogël e ka autostrada me 29 km linear, në të cilën bën pjesë autostrada Tiranë-Elbasan. Ndërsa shtrirjen më të madhe lineare e zënë rrugët lokale, me 1533 km linear, të cilat shtrihen në periferi të qytetit dhe mbizotërojnë njësitë administrative me karakter rural.

Aktualisht Bashkia Elbasan ka 946.4 ha, nga 136.7 ha në 2005, sipas Planit Rregullues të Elbasanit në 2005. Në total **rrugët rurale (809.7 ha)** zënë një sipërfaqe më të madhe se **rrugët urbane (136.7 ha).** Kjo ndodh sepse në territorin e Elbasanit ka më shumë njësi administrative që kanë karakter rural, por në vazhdim duhet t'iu jepet përparësi këtyre rrugëve.

Gjendja e mbulesës së infrastrukturës rrugore në përgjithësi nuk i plotëson standardet optimale ku mund të përmendim që në Bashkinë e Elbasanit ka **329 rrugë të shtuara dhe 1352 janë të pashtruara**. Kjo ndodh për arsye se pjesa më e madhe e rrugëve janë rrugë lokale, pra rrugë në të cilat nuk janë bërë shumë investime.[144]

Gjatë periudhës **2005-2013** në Bashkinë e Elbasanit, **janë shtruan dhe rikonstruktuar 10.36 km**, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH). Investimet janë bërë në Shushicë-2 km, Elbasan-1 km, Funarë-4.6 km dhe Tregan-2.76. Në qytetin e Elbasanit janë rikonstruktuar Rruga Mbretërore (0.74 km) si dhe Rruga "Shefqet Daiu" (0.3 km) [145].

Përveç infrastrukturës rrugore, një tjetër infrastrukturë e rëndësishme është dhe ajo hekurudhore, e cila kalon mes për mes qytetit të Elbasanit. Hekurudha në qytetin e Elbasanit vjen nga Bashkia e Rrogozhinës, ku më pas kalon në Librazhd dhe përfundon në Pogradec. Gjendja e hekurudhës nuk është e mirë. Në afërsi të qendrës së qytetit të Elbasanit ndodhet stacioni hekurudhor, i cili nuk është në gjendje të mirë.

- **Përfundime**


Bashkia Elbasan shtrihet në një pozicion strategjik të favorshëm dhe në territorin e saj kalojnë rrugë të rëndësishme kombëtare, si Korridori VIII. Pjesë e këtij korridori është dhe bajpasi i qytetit, i cili pritet të ndërtohet.

Për sa i përket transportit ndërqytetës Bashkia e Elbasan ka lëvizshmëri më të lartë me qytetin e Tiranës dhe Lushnjes.

Sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030, Papëri do të bëhet një nyje logjistike mjaft e rëndësishme, sepse në këtë nyje kalon boshti qendror jugor, i cili nis në Tirana dhe përfundon në bajpasin e Memaliajt, ku bashkohet me Korridorin e Kaltër që vjen nga Levani (Fier).

Si pasojë e reformës territoriale, Bashkisë së Elbasanit i është shtuar sipërfaqja e rrugëve. Si pasojë, në këtë

Figura 54: Zona e mbulimit me shërbimin e ujësjellësit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Valu-ADD, 2015; Përpunoi: Co-PLAN

bashki mbizotërojnë rrugët lokale, një pjesë e të cilave kanë nevojë për ndërhyrje përmirësimi infrastrukture dhe rehabilitim total në disa akse.

1.5.3 Furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza

- **Furnizimi me ujë**

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimet e ujërave të ndotur (KUN) në Bashkinë Elbasan ofrohet nga shoqëria UK Elbasan Shtetet Anëtare, ndërsa për zonën rurale ky shërbim ofrohet nga U Elbasan Fshat sha. Në një pjesë të zonës rurale këto shërbime administrohen nga vetë njësitë administrative (ish-komunat) ndërsa në zona të tjera vetadministrohen nga banorët. Sistemet e grumbullimit të largimit të ujërave të zeza nuk ekzistojnë zonën rurale, ndaj është zgjidhur në mënyrë individuale nga banorët, kryesisht me gropa septike.

Shërbimi i ofruar në zonën e qytetit mbulohet në nivelin 100%. Shoqëria UK Elbasan sha, furnizohet me ujë nga tre pellgje ujëmbajtëse (Mengel, Frigoriferi, Krasta e Vogël) dhe sasia totale e ujit që shfrytëzohet nga këto pellgje është 910 l/sek. Uji merret nëpërmjet 9 puseve (6 puse kesonë dhe 3 puse thellësie).

Siç u tha edhe më lart, në zonat rurale shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet nga ndërmarrja U Elbasan Fshat sha *(Bradashesh, Gjinar, Gjergjan, Labinot Mal, Labinot Fushë, Papër, Shirgjan, Shushicë, Tregan, Zavalinë)*, por jo në të gjithë ish-komunat ekzistojnë sisteme të furnizimit me ujë. Në këto raste banorët e sigurojnë vetë ujin nëpërmjet puseve individuale apo krojeve natyrore.

Gjendja aktuale në Bashkinë Elbasan për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm është pozitive. Kërkesa aktuale për ujë në këtë bashki është 1,699 m³/orë ndërkohë që sasia e ujit të prodhuat është 2,872, pra është me një bilanc total + 1,176 m³/orë. Pavarësisht bilancit pozitiv, popullsia nuk shërbehet me ujë 24 orë në ditë.

- **Përfundime**

Bashkia Elbasan ka aktualisht sasi të konsiderueshme që merren nga pusshpimet në Mengel, Kraste e Vogël dhe Frigoriferi për plotësimin e kërkesës aktuale për ujë duke pasur parasysh që humbjet teknike në sistem nuk janë më të mëdha se 35%.

Në rreth 39% të popullsisë që banon në zonën rurale të Bashkisë Elbasan nuk ka sisteme të ndërtuara të furnizimit me ujë.

Më problematike në drejtim të plotësimit të kërkesës për ujë paraqiten njësitë administrative Gjinar, Shushicë, Tregan, Shirgjan, Gjergjan, Funarë, Gracen dhe Labinot Mal.

Tabela 32: Mbulimi me sisteme të furnizimit me ujë në zonën rurale, Elbasan

NjA	Fshati	Sistemi i Furnizimit me Ujë
Bradashesh Ujësjellësi Bradashesh-Balldre Ujësjellësi Petresh	Balëz, Bradasheshi, Karakullaku, Katundi i Ri, Kusarthi, Harvales, Petreshi, Shijoni	me rrjet
	Fikasi, Kozani, Reçani, Rila, Shëmhilli, Shtëmaji, Ulëm, Gura Bardhë	pa rrjet
Funar *(zonë neutrale)*	Bixellej, Cëruj, Kraba Vogël, Mollagjeshi, Preç i Sipërm, Letani, Preç i Poshtëm	pa rrjet
	Branesh, Korrë	me rrjet
Gracen	Bodini, Dopaj, Graceni, Gjorme, Mamël, Pajenga, Plangaricë, Shëngjini, Terbaçi	pa rrjet
Gjinar Ujësjellësi Gjinar	Derstila, Lukan, Maskarthi, Pashtreshi, Pobrati, Gjinari, Kaferri, Lleshani, Valeshi, Xibreshi	me rrjet
	Stërstani	pa rrjet
Gjergjan Ujësjellësi Thanë	Bujaras, Kodër Bujaras	pa rrjet
	Gjergjan, Gjonme, Kështjellas, Muriqan, Thana	me rrjet
Labinot Mal Ujësjellësi Qerret (Shitje me Shumicë, me gravitet)	Guri i Zi, Labinot Mal, Lamollë, Sericë, Benë, Lukaxhi, Qafa, Shmili	pa rrjet
	Labinot Katund, Qerreti	me rrjet
Labinot Fushë Ujësjellësi Xibrakë Ujësjellësi Mengel-Godolesh Ujësjellësi Griqan	Godoleshi, Griqani Poshtem, Mengel, Xibrakë, Labinot Fushë	me rrjet
	Griqani i Sipërm	pa rrjet
Papër Ujësjellësi Vidhas, Ujësjellësi Papër, Ujësjellësi Bradashesh-Balldren	Bizhuta, Broshka, Mamurrasi, Papër, Pajun, Vidhas Hasgjel	pa rrjet
	Papër Sollak, Valasi, Vidhas, Lugaj, Balldre, Jateshi, Ullishtas	me rrjet
Shirgjan Ujësjellësi Shirgjan-Lixhë-Tregan	Bathës, Bujqëz, Kuqani, Kryezjarrthi, Mjekësi, Shirgjani Jagodinë	me rrjet
Shushicë Ujësjellësi Hajdaran, Ujësjellësi Shushicë	Fush Bualli, Polis i Vogel, Polis Vale, Vasjani, Hajdaran, Mliza, Shushica, Vreshtasi, Shelçan	me rrjet
Tregan Ujësjellësi Shirgjan-Lixhë-Tregan	Blerimas, Bizhdani, Kaçiveli, Trepsenishti, Tudani, Shënavlashi, Cikalleshi, Muçani, Shilbartës, Kyçyk, Gurishtë, Tregan-Lixhë	me rrjet
Zavalinë	Burnishta, Kamiçani, Nezhani, Selta	pa rrjet
	Jeronishta, Zavalina	me rrjet

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Valu ADD, 2015

- **Shërbimet e kanalizimeve të ujërave të ndotura**

Qyteti i Elbasanit ka sistem të kombinuar të ujërave të përdorura, pra grumbullon ujërat e reshjeve atmosferike dhe ato të përdorura nga qendrat e banimit. Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura mbulon të gjithë zonën urbane. Grumbullimi dhe largimi i ujërave bëhet me vetërrjedhje, duke qenë se është i favorizuar nga topografia e zonës së shërbimit.

Sistemi i kanalizimeve është në gjendje të keqe fizike, ka çarje dhe rrjedhe të konsiderueshme që infiltrojnë. Ujërat e ndotura të qytetit të Elbasanit nuk trajtohen, gjë që sjell nevojën për trajtimin e tyre. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura është një projekt i domosdoshëm që është menduar të realizohet nga bashkia. Sipas raportit të Valu ADD për infrastrukturat e ujësjellës-kanalizimeve të ujërave të ndotura në planin e zhvillimit urban të Bashkisë Elbasan pas ndarjes territoriale, ***"ITUN do të përbëhet nga njësia e paratrajtimit ose trajtimi parësor, në të cilin eliminohet rreth 30% e ngarkesës biologjike, që pasohet nga trajtimi dytësor ose biologjik në të cilin eliminohet rreth 90% e ngarkesës biologjike të ujërave të ndotura"***.

Në zonën rurale nuk ekzistojnë sisteme të organizuara të ujërave të ndotura. Këto ujëra largohen nga vetë banorët me gropa septike, të cilat nuk respektojnë standardet higjieno-sanitare të gropave septike me apo pa filtrim. Në disa raste, largimi i ujërave bëhet edhe me kanale të

Tabela 33: Bilanci i kërkesës për ujë dhe rezervuare në Bashkinë Elbasan

Njësia Administrative	Popullsia aktuale	kërkesa aktuale për ujë (l/sek)	kërkesa aktuale për ujë (m3/orë)	Sasia e ujit të prodhuar aktualisht (m3/orë)	Bilanci (m3/orë)	Kërkesa për rezervuare (m3)	Volumi i rezervuarit në sisteme (m3)	Bilanci i volumit të rezervuarëve me kërkesën
Elbasan	166,155	283	1,019	1,560	+541	12,200	9,700	-2,500
Labinot Mal	5,495	14	51	10	-41	600	100	-500
Bradashesh	12,227	30	108	504	+396	1,300	1,200	-100
Labinot Fushë	5,812	14	51	198	+147	600	400	-200
Papër	8,862	22	79	403	+324	950	1,100	+150
Shirgjan	8,998	22	79	58	-21	1,250	800	-450
Tregan	4,753	12	43	10	-33	200	100	-100
Gjergjan	7,441	18	65	43	-22	800	250	-550
Gjinar	4,778	12	43	18	-28	500	250	-250
Shushicë	9,994	24	86	54	-32	1050	550	-500
Zavalinë	2,127	5	18	12	-6	200	80	-120
Funarë	3,648	9	32	5	-27	400	0	-400
Gracen	2,657	7	25	0	-25	300	0	-300
Total	192,947	472	1,699	2,872	+1,176	20,350	14,530	-5,820
Total Negativet					-235			-5,970

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Valu ADD, 2015

hapura kulluese, që janë kundërshtim me respektimin e kushteve sanitare të largimit të tyre.

- **Përfundime dhe Rekomandime**

Sistemi i largimit të ujërave të ndotur duhet rehabilituar në mjaft pjesë të tij duke përdorur teknologji të reja të materialeve dhe diametra që i përgjigjen sasisë së ujërave të zeza në funksion të numrit të popullsisë që derdhin ujërat në të.


Të shihet maksimalisht mundësia e ndarjes së sistemit të ujërave të shiut nga ato të zeza, për të cilat duhet ndërtuar impiant i pastrimit të tyre.

Për zonën rurale të ndërtohen gropa septike në përputhje me standardet teknike sikurse dhe në zonat që është e vështirë të ofrohet shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura me sistem kanalizimesh.

1.5.4 Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta

Nga të dhënat e marra për qytetin e Elbasani (bashkia para reformës administrative-territoriale), shërbimi i menaxhimit të mbetjeve deri në vitin 2005 ofrohej nga një kompani private, e cila kishte një kontratë 5 vjeçare. Përveç shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, firma sipërmarrëse ofron edhe shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve.

Figura 55: Zona e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Valu-ADD, 2015; Përpunoi: Co-PLAN

Për të siguruar shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, në qytetin e Elbasanit janë vendosur 572 pika grumbullimi nga të cilat 526 janë kontenierë me kapacitet 1.1 m^3 dhe 1.6 m^3, 46 pika grumbullimi prej betoni, si dhe 70 kosha 25 litra për hedhjen e mbeturinave nga kalimtarët. Të gjithë kontenierët janë vendosur në rrugët që lejojnë futjen e mjeteve për grumbullimin e tyre. Numri i kontenierëve është i pamjaftueshëm për të mbuluar volumin ditor të mbetjeve të prodhuara, ndërsa në disa zona të qytetit është e vështirë të përdoren kontenierë, pasi rrugët janë të ngushta dhe nuk lejojnë futjen e kamionëve të mëdhenj teknologjikë.

Bashkia nuk ka një evidencë të saktë për sasinë e mbetjeve që hiqen çdo ditë, megjithëse në mënyrë të përafërt zyrtarët mendojnë se sipërmarrja e pastrimit largon rreth 105 ton në ditë. Pavarësisht nga sipërfaqja e mbulimit, cilësia e shërbimit nuk është në nivelin e duhur, pasi realizohet me mjete primitive.

Për të realizuar këtë shërbim, kontraktori ka përdorur 6 mjete teknologjike: 4 mjete tip DAF me kapacitet mbajtës 7 ton secili dhe 2 mjete tip Benz me kapacitet 7 dhe 10 ton. Gjithashtu, për zonat ku nuk mund të hyjnë mjetet teknologjike, përdoren 2 mjete me kapacitet 3.5 ton, një mjet me kapacitet 5 ton dhe një mjet me kapacitet 7 ton, si dhe 2 karroca me kuaj. Për lagien e rrugëve përdoret një bot me kapacitet 7,000 litra.

Aktualisht, jo të gjitha zonat e bashkisë mbulohen nga shërbimi i pastrimit. Kjo ka bërë që strategjia e bashkisë për menaxhimin e mbetjeve në përgjithësi të synojë në përmirësimin e këtij të fundit në zonat që marrin shërbim dhe zgjerimin e shërbimit në zonat që nuk mbulohen me pastrim dhe largim mbetjesh urbane.

Venddepozitimi i mbetjeve në Elbasan ndodhet 75 m larg brigjeve të Lumit Shkumbin në pjesën jugore të qytetit, me një prurje ditore 105 ton/ditë dhe i shërben një popullsie prej 128,418 banorë. Ky vend depozitim është i klasifikuar si jo-sanitar (jashtë çdo standardi të lejuar). Në këtë vend depozitim vijnë mbetje të ngurta urbane kryesisht nga zona e qytetit, ndërsa nuk përjashtohet edhe mundësia e depozitimit të mbetjeve të ngurta.

Gjatë këtyre viteve janë bërë disa përpjekje dhe studime fizibiliteti dhe projekte për përcaktimin e një territori të përshtatshëm për ndërtimin e një ***landfill***-i sanitar për depozitimin e mbetjeve në Bashkinë e Elbasanit, i cili është tashmë në ndërtim. Propozimi i parë daton në vitin 1999, ku në sajë të një projektit LIFE për Organizimin dhe Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në 6 qytete të Shqipërisë, bashkia përcaktoi një zonë 3.5 km në perëndim të qytetit të Elbasanit, 0.4 km në perëndim të Fabrikës të Çimentos (ECF) në Grykën e Ligatës. Përveç këtij opsioni, shpesh është diskutuar edhe ndërtimi i tij në zonën e Papërit.

Njësia administrative (NJA) Papër e ofron vetë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për 80% të popullsisë së saj (1.5 ton/ ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e njësisë administrative ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 60 pika grumbullimi me kontenierë të hapur dhe 10 pika grumbullimi me kontenierë të mbyllur. Kjo njësi deklaron se nuk ka pika të hapura për grumbullimin e mbetjeve. Gjithsej në të gjithë njësinë janë të shpërndarë 70 kontenierë me kapacitet 1.1m^3. Grumbullimi i mbetjeve bëhet 3 herë në javë nga një mjet kompaktor, i cili i depoziton mbetjet në vend depozitimin që ndodhet në fshatin Balldren, i cili është jashtë kushteve higjeno-sanitare. Në këtë fushë është një mjet ekskavator, që ndihmon në depozitimin e mbetjeve dhe ngjeshjen e tyre. Ky vend depozitim ndodhet 13 km nga qendra e njësisë administrative. Kjo e fundit aplikon një tarifë pastrimi për familjet prej 600 lekë/vit, e cila gjatë vitit të fundit është mbledhur në masën 75%.

NJA Labinot Fushë ofron shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (0.7 ton/ditë mbetje), por nuk jep të dhëna në lidhje me përqindjen e popullsisë që mbulohet me këtë shërbim, ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Kjo njësi nuk deklaron numrin e pikave të grumbullimit të mbetjeve të shpërndarë në të gjithë territorin. Grumbullimi i mbetjeve bëhet 5 herë në javë me një mjet të hapur, i cili është i papërshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve. NJA deklaron se ka një vend depozitim të autorizuar për mbetjet dhe disa të tjera jo të autorizuara (10 mesatarisht). Vend depozitimi i autorizuar ndodhet 7 km nga qendra e njësisë. Sipas të dhënave të deklaruara, kjo njësi nuk aplikon tarifë pastrimi për familjarët, vetëm për bizneset, dhe gjithashtu nuk deklaron nëse ka një buxhet të dedikuar për shërbimin e mbetjeve.

NJA Gjinar e ofron vetë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për 30% të popullsisë së saj (1 ton/ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e njësisë ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 20 pika të hapura grumbullimi, 20 pika grumbullimi me kontenierë të hapur dhe 4 pika grumbullimi me kontenierë të mbyllur. Gjithsej në të gjithë njësinë janë të shpërndarë 24 kontenierë me kapacitet 1.1m^3 dhe 6 kosha 0.33litra. Grumbullimi i mbetjeve bëhet 2 herë në javë me një mjet kompaktor 5 ton, i cili i depoziton mbetjet në vend depozitimin e njësisë. Ky vend, që është jashtë kushteve higjieno-sanitare, ndodhet 22 km nga qendra e njësisë. Kjo njësi aplikon një tarifë pastrimi për familjet prej 100 lekë/vit, e cila gjatë vitit të fundit është mbledhur në masën 70%.

NJA Zavalinë deklaron se nuk e ofron shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, fshirjes dhe larjes së rrugëve.

NJA Gjergjan e ofron vetë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për 80% të popullsisë së saj (2 ton/ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e njësisë ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 16 pika të hapura dhe 14 pika grumbullimi me kontenierë të hapur. Njësia nuk deklaron të ketë një mjet për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sipas të dhënave, vend depozitimi i mbetjeve për Gjergjanin ndodhet 7 km larg qendrës së saj. Praktikisht ky shërbim nuk ofrohet sipas standardeve dhe njësia nuk ka infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e tij.

NJA Shirgjan e ofron vetë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për 90% të popullsisë së saj (0.8 ton/ ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e njësisë ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 60 pika grumbullimi të hapura. Kjo njësi ofron shërbimin e mbetjeve 2 herë në javë, ku i grumbullon mbetjet nga pikat e grumbullimit me një mjet të hapur 3.5 ton, i cili është i papërshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve. NJA deklaron se aplikon një tarifë pastrimi për familjet prej 600 lek/vit, të cilën deklaron se e ka mbledhur 53% gjatë vitit të kaluar. Vend depozitimi i mbetjeve ndodhet 7 km larg qendrës së njësisë. Edhe kjo njësi, si shumë njësi të tjera administrative, nuk e ofrojnë shërbimin sipas standardeve të kërkuara.

NJA Tregan e ofron vetë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për 35% të popullsisë së saj (1.5-4.5 ton/ditë mbetje), ndërsa thotë që ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve në 8% të territorit të saj. Në të gjithë territorin e njësisë ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 12 pika grumbullimi të hapura dhe 9 pika grumbullimi me kontenierë të hapur. Gjithsej në të gjithë njësinë janë të shpërndarë 10 kontenierë me kapacitet 1.1m^3. Grumbullimi i mbetjeve bëhet çdo ditë në të shumtën e rasteve, ku njësia përdor një mjet të marrë më qira, pasi nuk ka në pronësi një mjet të sajin. Mbetjet pasi grumbullohen depozitohen në vend depozitimin që ndodhet në fshatin Shilbater-Kyçyk, i cili ndodhet 17 km larg qendrës së njësisë.

- **Përfundime**

Në përfundim Bashkia Elbasan ka tashmë në territorin e saj 13 ish-komuna të mëparshme, ku secila prej tyre ka pasur një mënyrë të caktuar të organizimit të shërbimit (private ose publike) dhe infrastrukturën përkatëse. Ndërkohë mund të ketë njësi të tjera, të cilat nuk e kanë ofruar si shërbim dhe nuk kanë as infrastrukturën e përshtatshme për ofrimin e tij. Në këto kushte, Bashkia Elbasan për të siguruar shtrirjen e shërbimit në pjesën më të madhe të territorit, duke mos ulur nivelin e ofrimit të shërbimit, duhet të vlerësojë gjendjen ekzistuese të ofrimit të shërbimit, si nga ana organizative ashtu edhe nga ajo materiale, për të kuptuar se ku duhet të ndërhyjë me investime konkrete dhe ku duhet të riorganizojë vetëm mënyrën e ofrimit të shërbimit.

Për sa i takon zgjidhjes përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, në dalje të qytetit të Elbasanit ka filluar punimet parku trajtimin e mbetjeve, ku së fundmi është përfunduar ndërtimi i landfillit inxhinierik dhe pritet të ndërtohet edhe impianti i djegies (incineratori). Ky park për trajtimin final të mbetjeve do të mund të përmbush kërkesat jo vetëm të territorit të bashkisë, por edhe të bashkive të tjera fqinje. Në kuadër të përqafimit të një qasje sa më të qëndrueshme, Bashkia Elbasan duhet të shqyrtojë edhe mënyrat alternative të trajtimit të mbetjeve, dhe jo vetëm klasiken, ku mbetjet grumbullohen në kontenierë dhe transportohen me mjete në vend depozitimet përkatëse. Objektiv i bashkisë duhet të jetë edhe mbyllja graduale të gjitha vend depozitimet të hapura të mbetjeve.

1.6 RËNDËSIA KOMBËTARE NË TERRITOR

Bashkia e Elbasanit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar, i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo ndodhet në afërsi me zonat ekonomike të Tiranës, Lushnjes dhe Fierit, përshkohet nga akset kryesore lidhëse kombëtare dhe ndërkombëtare, shtrihet përgjatë Lumit Shkumbin, përgjatë të cilit ka zona të mbrojtura natyrore dhe zotëron hapësira industriale që kanë potencial ekonomik për zhvillim të mëtejshëm.

- **Monumente Kulturore**

Krahas kështjellës të qytetit, në bashkinë e Elbasanit ndodhen dhe 57[146] monumente kulture të kategorisë së parë dhe 16 monumente kulture të kategorisë së dytë të cilat administrohen sipas ligjit nr.9048, date 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore". Neni 32 i këtij ligji specifikon që për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistike-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me Vendim të KKT nr. 1, datë 09.09.2015 janë shpallur zona të rëndësisë kombëtare në

planifikim disa monumente kulturore, në Elbasan ndodhën përkatësisht Stacioni Rrugor Ad Quintum në Bradashesh, kisha e Shën Kollit në Shelçan dhe kisha e Shën Gjon Vladimirit në Shijon.

- **Zona të mbrojtura natyrore**

Territori i bashkisë së Elbasanit prek dy zona të mbrojtura natyrore në kufirin lindor të tij. Kuturman-Qafë Bushi është ***park kombëtar*** (Zonë e mbrojtur, kategoria IV) i shpallur me Rregullore të Ministrisë së Brendshme nr.1, datë 27.7.1977 dhe gjithashtu bën pjesë në Rrjetin Emerald. Zona e Sopotit dhe Stravajit janë shpallur ***rezervat natyror të menaxhuar/park natyror*** (Zonë e mbrojtur, kategoria IV) me VKM nr.102 datë 15.01.1996. Këto hapësira të mbrojtura kanë një zonë buferike prej 50 m nga kufiri që kushtëzon zhvillimin.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 676 datë 20.12.2002 përcakton 23 monumente natyrore (Zonë e mbrojtur, kategoria III) të llojit të drurëve të rrallë, liqene, shkëmbinj (Gradishtë), shpella (Gracen), dhe burimet e Llixhave në Tregan.

- **Menaxhim i integruar i burimeve ujore**

Lumi i Shkumbinit shtrihet me një gjatësi rreth 37 km përgjatë territorit të bashkisë së Elbasanit. Të gjitha burimet ujore së bashku me të gjitha brigjet dhe shtretërit e trupave të ujit pa përjashtim, sipas specifikimit të Ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", janë pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore. Për trupat ujorë, ky ligj përcakton largësi sigurie në dy breza në varësi të këndit të bregut më pak ose më shumë se 10%. Zona A shtrihet nga 5 m deri në 20m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta. Zona B shtrihet nga 100m deri në 200m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore.

Sistemet e kanalizimeve dhe kullimit për mbarëvajtjen e tokave bujqësore rregullohen nëpërmjet Ligjit nr. 8518 i datës 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar. Sistemet e kullimit që janë pronë shtetërore mund të kalojnë përdorim apo në pronësi të një federate, organizate ose bordi pa ndryshuar destinacionin vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 9). Sipas Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore[146] dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor" (draft), sistemet dytësore dhe tretësore të ujitjes dhe kullimit i kalojnë administrim bashkive si funksion i vetë.

Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", i ndryshuar, përcakton rregullat e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, duke përfshirë ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale, ujërat nga kullimi i tokave bujqësore dhe ujërat e ndotura të çdo lloji. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, distancat minimale të mbrojtjes nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza janë 200 m për kapacitet më pak se 5,000 banorë dhe 1,000 m për kapacitet 1,000-50,000 banorë.

- **Tokat bujqësore**

Territori i Bashkisë së Elbasanit ka një sipërfaqe modeste prej rreth 176,6 km^2 tokë bujqësore[1]. Sipas legjislacionit në fuqi dhe Ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, specifikohet mbrojtja nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në Vendimin e KM nr. 283, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore". Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

Po ashtu, Ligji nr. 8722 datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, cilëson që në tokat bujqësore mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastrukturë (rrugore, hekurudhore, ajrore, detare), hidrocentrale, varreza si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndërkohë pika 4/5 e nenit 11/1 shpreh që kalimi i tokave bujqësore në kategori të burimeve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas bëhet me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto burime për sipërfaqe deri në 5 ha dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 5 ha.

- **Pyjet, drufrutorët dhe kullotat**

Përcaktuar në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe

shërbimin pyjor", i ndryshuar, "Toka pyjore" janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30%, së bashku me sipërfaqet e tjera që sigurojnë funksionet e pyllit. Bashkia e Elbasanit ka përafërsisht 55 km^2 [148] toka pyjore me pronësi publike dhe private. Fondi pyjor publik zotërohet e administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor dhe organet e qeverisjes vendore. Pjesë e këtij fondi pyjor kombëtar mund të kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore për t'u kthyer në truall për destinacione specifike të parashikuara në ligjin e mësipërm: me miratim të ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe nga 1 deri në 100 ha; dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 100 ha. Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8722, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e burimit të tokës bujqësore vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata. Për të ndryshuar vëllimin e tokës pyjore nevojitet miratimi i organeve të shërbimit pyjor, ndërsa kalimi i burimit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisje vendore, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore dhe miratohet nga ministri përkatës.


Në bazë të Ligjit nr. 7929, datë 11.05.1995, "Për mbrojtjen e drufrutorëve", pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullishtat, pavarësisht se në pronësi të kujt janë, janë pasuri kombëtare dhe mbrohen me ligj nga shteti. Pasuria shtetërore drufrutore e ish-ndërmarrjeve bujqësore, i është dhënë administrim organeve të pushtetit lokal me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 473 datë 14.10.1999.

Fondi kullosor i përbërë nga kullotat dhe livadhet në pronësi publike dhe private është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Ai mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar, e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Heqja e një kullote, apo livadhi nga fondi kullosor, ose ndryshimi i destinacionit për një sipërfaqe kullote bëhet me miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha.

- **Zonat industriale**

Në zonat e Gracen, Tregan, Shushicë, dhe Papër do të ndërtohen stacione energjetikë eolike (me fuqinë e erës)

Figura 56: Rëndësia Kombëtare në territor, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

me specifikat dhe vendndodhje të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 16.8.2013. Sipas VKM nr. 671 datë 29.07.2015, për parqet eolike të prodhimit të energjisë, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, distanca minimale e kufirit të parkut nga kufiri i zonës së banuar është 500 m-2,000 m.

Zona e kombinatit të metalurgjikut është në proces likuidimi dhe privatizimi. Hapësirat e tij prej 60 ha janë ndarë me legjislacion **në parcela më të vogla për lehtësi gjatë** procesit të privatizim. Ky proces **përfshin një fabrikë** nikel-kromi, një fabrike gazi, një fabrike prodhimi druri, një TEC dhe 5 nënzona për prodhimin e çelikut[149]. Sipas VKM nr. 671 datë 29.07.2015, objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, kanë një gjerësi minimale të zonës mbrojtëse sanitare prej 50 m përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj dhe një distancë minimale të mbrojtjes prej 200 m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e teknologjisë së përdorur si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj.

- **Të tjera**

Kullat e telekomunikacionit që janë të larta mbi 25 metra nuk lejohen të ndërtohen e të vendosen brenda zonave të përcaktuara si zona banimi. Distanca e tyre minimale nga kufizimi i pronës më të afërt të ndërtuar është 30 metra.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 29.10.2014, "Për miratimin e rregullores teknike 'Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"', territori i varrezës duhet të kufizohet nga zonat e banuara, nëpërmjet zonës së rezervuar. Në të mund të parashikohet vetëm mbjella e drurëve dhe gjelbërimit, ndërtimi i parkimeve, ose i objekteve në shërbim të varrezave. Për qendrat e banuara, me popullsi mbi 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 100 m linear, për qendrat e banuara me popullsi nëm 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 m linear.

1.7 FINANCAT VENDORE


Për të kuptuar ecurinë e financave vendore në Bashkinë e re të Elbasanit u përdorën të dhëna nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit) pranë Ministrisë së Financave për periudhën 2010-2014. Përdorimi i këtij burimi justifikohet me faktin se arrihen të sigurohen seri kohore për një periudhë pesë vjeçare për të gjitha njësitë administrative përbërëse të Bashkisë Elbasan. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel njësie administrative në monedhë vendase dhe për efekte analize u konsoliduan në nivel bashkie.

Performanca e të ***ardhurave totale*** të Bashkisë Elbasan së re rezulton të ketë ndjekur një prirje përmirësuese veçanërisht në dy vitet e fundit. Rol të rëndësishëm në këtë kontekst luajti përdorimi i huave nga sistemi bankar prej vetë Bashkinë Elbasan. Burimet financiare totale (transfertat ndërqeveritare[150] dhe burimet e veta vendore[151]) në dispozicion të Bashkisë të Elbasanit janë luhatur në nivelin 2.1-2.4 miliard lekë në vit gjatë periudhës 2010-2013. Në vitin 2014 të ardhurat totale shënuan nivelin e 3.2 miliard lekëve, me rritje të ndjeshme krahasuar me një vit më parë. Pas rënies vjetore të shënuar në dyvjeçarin 2011 dhe 2012, të ardhurat totale u zgjeruan ndjeshëm në dy vitet në vijim. Kështu, të ardhurat totale u rritën me rreth 14.2% në vitin 2013 dhe me rreth 32.3% në vitin 2014. Në linja të përgjithshme, përcaktues në performancën financiare të Bashkisë Elbasan rezultojnë të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare. Megjithatë, si pasojë rritjes së nivelit të huamarrjes vendore të Bashkisë Elbasan në vitin 2014, kontributi i të ardhurave vendore rezultoi ndjeshmërisht më i lartë krahasuar me vitet e mëparshme (12.2 pikë përqindjeje nga rreth 1.4 pikë përqindjeje një vit më parë). Në ndarjen sipas njësive administrative përbërëse, kontribuuesi kryesor në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave është njësia administrative Elbasan, e cila përfaqëson mesatarisht 60.3% ndaj totalit të të ardhurave në pesë vitet në analizë. Ndër njësitë e tjera, kontribuuesi kryesor në të ardhura është njësia Bradashesh, e cila përfaqësoi mesatarisht 10.5% të të ardhurave totale në periudhën 2010-2014. Njësitë e tjera përbërëse kontribuojnë përkatësisht me më pak se 4% në të ardhurat totale të Bashkisë Elbasan.

Pamjet grafike tregojnë për një varësi të lartë financiare Bashkisë Elbasan nga burimet ndërqeveritare dhe në veçanti transferta e kushtëzuar. Varësia financiare bën që projektet për investime kapitale të jenë subjekt pothuajse tërësisht i vendimeve të qeverisë qendrore. Përdorimi i instrumentit të huas bankare në vitin 2014 është një mënyrë për të rritur autonominë financiare dhe për të realizuar investime kapitale por, kosto në terma interesash dhe mundësia e ri-pagimit të kryegjësë/principalit nuk duhet të rëndojnë planet e ardhshme për investime kapitale të njësisë së qeverisjes vendore. Krahas kreditimit nga sistemi bankar, përmirësimi i autonomisë financiare vendore do të përbënte përparësi për Bashkinë Elbasan. Përpjekjet duhen orientuar në përmirësimin e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore.

Pavarësia financiare e Bashkisë re Elbasan, matur si raport i të ardhurave vendore ndaj të ardhurave totale, rezulton të jetë përmirësuar megjithëse më ritme të ulëta

Figura 57: Kontributi i njësive administrative në ecurinë e të ardhurave totale (pikë %, majtas); Kontributi sipas burimit në të ardhurat totale (pikë %, djathtas)



Burimi: Ministria e Financave dhe përpunime të autorëve

përgjatë pesë viteve të marra në konsideratë. Raporti i të ardhurave vendore ndaj të ardhurave totale shënoi rritje me rreth katër pikë përqindjeje në harkun kohor të pesë viteve (konkretisht, nga 20.0% në vitin 2010 në 24.0% në fund të vitit 2014). Pas një rritje me rreth 12.4% në vitin 2011, të ardhurat vendore shënuan rënie me rreth 10.6% në vitin pasardhës si pasojë e një performance të dobët në mbledhjen e taksave dhe tatimeve vendore pasojë edhe e ndryshimeve të vazhdueshme në sistemin e taksave vendore nga qeveria qendrore. Ky element vijoi të kontribuojë negativisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave edhe gjatë vitit 2013. Megjithatë, rritja e të ardhurave nga tarifat vendore si dhe përdorimi i instrumentit të huas nga sistemi bankar në vitin 2013 u materializua në rritjen e të ardhurave vendore me rreth 6.6% në terma vjetorë.


Viti 2014 shënon një pikë kthese pozitive në lidhje me të ardhurat nga taksat dhe tatimet vendore. Si pasojë e kontributit të tyre pozitiv dhe përforcuar nga përdorimi i instrumentit të huas nga sistemi bankar, performanca e të ardhurave vendore për vitin 2014 u përmirësua ndjeshëm (+61.5%)[152]. Përjashtuar këtë efekt, rritja vjetore e të ardhurave vendore është rreth 10.5%. Brenda kategorisë së taksave dhe tatimeve vendore kontributin kryesor në vitin 2014 e dhanë të ardhurat nga ***taksa mbi ndërtesat dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin i bizneseve të vogla*** të cilat kanë një peshë ndaj totalit të të ardhurave vendore respektivisht prej 40 dhe 29%. Ndër përbërësit e tjerë të klasifikuar si të ardhura vendore, ***tarifat vendore***, janë elementi i dytë me peshën më të madhe në totalin e të ardhurave vendore (mesatarisht rreth 26.4% ndaj totalit në pesë vitet e fundit). Kontributi i të ardhurave nga tarifat në totalin e të ardhurave vendore rezulton të jetë negativ në vitin 2011, pozitiv dhe në rritje në vitet 2012-2013 dhe pozitiv por në nivel ndjeshëm më të ulët në vitin 2014.

Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare të Bashkisë Elbasan janë element dominues në strukturën e të ardhurave totale. Megjithatë, ndër vite pesha e tyre ndaj totalit duket të ketë shënuar një rënie të lehtë (nga 80.2% në vitin 2013 në 75.8% të totalit të të ardhurave në vitin 2014) në favor të një autonomie disi më të madhe financiare. Pas rënies së shënuar në vitet 2011 dhe 2012, kjo kategori të ardhurash u rrit me rreth 16.2% në terma vjetorë në vitin 2013 dhe rreth 25.0% në vitin 2014. Sipas elementëve përbërës së të ardhurave ndërqeveritare, peshën kryesore e zënë të ardhurat nga transferta e kushtëzuar (mesatarja e 5 viteve është 70.3%) e cila rezulton në rritje përgjatë 5 viteve në analizë[153]. Mesatarisht në pesë vitet e fundit, 84.3% e transfertës së kushtëzuar vjen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë. Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar përfaqësuan mesatarisht rreth 28.3% të të ardhurave ndërqeveritare gjatë pesë viteve në analizë. Të ardhurat nga taksat e ndara rezultojnë një nivel të papërfillshëm ndaj totalit të të ardhurave ndërqeveritare dhe në rënie progresive gjatë viteve 2010-2014.

Shpenzimet totale të kryera nga Bashkia e re e Elbasanit gjatë pesë viteve të konsideruara në këtë analizë rezultojnë të jenë luhatur në vlerën 2.2-3.6 miliardë lekë. Pas një ngushtimi me rreth 5.7 dhe 4.5% në terma vjetorë gjatë viteve 2011 dhe 2012, shpenzimet e kryera nga Bashkia e re Elbasan ndoqën një prirje rritëse në dy vitet në vijim. Shpenzimet totale shënuan vlerën 3.6 miliardë lekë në vitin 2014, në rritje me rreth 42.3% krahasuar me një vit më parë. Kahu i zhvillimeve në shpenzimet totale për vitin 2014 u përcaktua nga shpenzimet e realizuara me fonde të veta[154] (ku përfshihen financimet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve prej rreth 397.1 milionë lek).

Në ndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve, qëllimit të përdorimit të fondeve në dispozicion apo programeve

Figura 58: Kontributi sipas burimeve (pikë %, majtas) dhe i programeve (pikë %, djathtas) në shpenzimet totale



Burimi: Ministria e Financave dhe përpunime të autorëve

buxhetore[155], struktura e shpenzimeve të Bashkisë Elbasan rezulton të dominohet nga shpenzimet për funksionet e ***"mbrojtjes sociale"***, ***"ekonomike"*** dhe të ***"arsimit"***.

Shpenzimet e kryera nga bashkia e re Elbasan gjatë periudhës në analizë përfaqësohen në masën më të madhe nga ato operative dhe të personelit. Këto dy kategori paraqesin elasticitet të ulët ndaj kufizimeve të mundshme buxhetore. Pra, në raste shkurtimesh të buxhetit, përgjithësisht janë shpenzimet kapitale ato që preken më shumë. Sipas njësive administrative përbërëse, njësia Elbasan paraqet nivelin më të lartë të shpenzimeve në secilën prej kategorive të shpenzimeve të konsideruara (investime dhe operative).

Në ndarjen sipas programeve, ***"mbrojtja sociale"*** rezulton programi në të cilin përthithet një pjesë e konsiderueshme e fondeve në dispozicion të Bashkisë Elbasan (mesatarja e pesë viteve të konsideruara është 44.5% ndaj totalit të shpenzimeve të kryera). Shpenzimet për këtë program kanë ndjekur rritje progresive ndër vite dhe për vitin 2014 rezultuan në rreth 1.6 miliard lekë, në rritje me rreth 32.7% në terma vjetorë. Mbi 95% e fondeve të caktuara për mbrojtjen sociale (kryesisht ***ndihmë ekonomike*** dhe ***pagesa për personat me aftësi të kufizuara***) vijnë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës së kushtëzuar. Shpenzimet për këtë program janë kryesisht në trajtën e ***transfertave ndaj familjeve dhe individëve*** dhe të ***personelit për operimin e qendrave të shërbimeve sociale***. Investimet për qendrat sociale zënë një peshë të papërfillshme ndaj totalit të investimeve për pesë vitet e konsideruara.


Programi i dytë me peshën më të madhe në shpenzime përfaqësohet nga ***"çështjet ekonomike"***. Shpenzimet për këtë program përfaqësuan rreth 14.4% ndaj totalit të shpenzimeve të kryera nga Bashkia Elbasan për periudhën 2010-2013. Në vitin 2014, shpenzimet në këtë program rezultuan rreth 1 miliard lekë, rreth 2.5 herë më të larta krahasuar me një vit më parë (ose përfaqësuan rreth 26.3% ndaj totalit të shpenzimeve). Gjatë këtij viti, mbi 90% e fondeve të shpenzuara në këtë program shkuan për realizimin e investime kapitale në infrastrukturën rrugore vendore. Këto investime u financuan me rreth 560 milionë lekë me fonde të veta të Bashkisë Elbasan dhe me rreth 397.1 milion lekë nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi i shpenzimeve që lidhet me ***"Strehimin dhe komoditetin e komunitetit"*** ndaj totalit të shpenzimeve të kryera, rezulton të ketë ndjekur një trajektore rënëse përgjatë viteve konsideruara. Nga rreth 15.2% në vitin 2010, në vitin 2014 shpenzimet në këtë program u tkurrën dhe përfaqësuan rreth 7.4% ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitin 2014, shpenzimet për strehim dhe komoditet të komunitetit rezultuan rreth 268.4 milionë lekë, në rënie me rreth 12.6% në terma vjetorë, si pasojë e tkurrjes së transfertave nga ministria përkatëse dhe/ose Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Në vitin 2014, 82.4% e shpenzimeve në këtë program u realizua me fonde të bashkisë të cilat në masën më të madhe u përdorën për shpenzime operative dhe personeli.

Programi buxhetor ***"shërbime të përgjithshme publike"*** përfaqësoi mesatarisht rreth 18.3% të shpenzimeve totale përgjatë periudhës 2010-2013. Në vitin 2014, shpenzimet për këtë program rezultuan rreth 452.5 milionë lek (pesha ndaj totalit 12.4%), në rritje me rreth 3.1% krahasuar me një vit më parë. Brenda këtij programi, shpenzimet për administratën e bashkisë, komunave dhe institucioneve të varësisë ***"planifikim, menaxhim dhe administrim"*** zënë peshën kryesore ndër vitet e konsideruar. Mbi 95% e fondeve të shpenzuara në këtë program buxhetor vinin nga fondet e veta të bashkisë Elbasan dhe u shpenzuan kryesisht për paga dhe shpenzime të tjera operative.

Programi buxhetor i ***"arsimit"*** zuri rreth 5.8% të shpenzimeve totale të realizuara nga Bashkia e re

Figura 59: Shpenzimet totale dhe sipas përdorimit dhe funksioneve



Burimi: Ministria e Financave dhe përpunime të autorëve

Elbasan gjatë viteve 2010-2013. Në vitin 2014, pesha e shpenzimeve për këtë program ndaj totalit shënoi një rritje të lehtë duke u vlerësuar në 6.9%. Në vlerë, shpenzimet për arsimin rezultuan rreth 251.7 milionë lekë në vitin 2014, pothuajse 2.2 herë më të larta krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes së transfertave të kushtëzuara nga qeveria qendrore. Në këtë program buxhetor, 47.5% e shpenzimeve u financua nga burimet e veta të bashkisë ndërsa 52.5% me anë të transfertës së kushtëzuar. Fondet e veta të Bashkisë Elbasan për vitin 2014 u përdorën kryesisht për mbulimin e shpenzimeve të personelit dhe ato operative. Fondet në trajtën e transfertës së kushtëzuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit u përdorën në masën më të madhe (rreth 90%) për investime kapitale.

- **Përfundime**

Përgjithësisht, Bashkia e re Elbasan paraqet një nivel autonomie financiare të ulët, bazuar në të dhënat financiare për pesëvjeçarin 2010-2014. Burimet financiare orientohen më së shumti në mbulimin e shpenzimeve operative dhe pagave të personelit. Në këtë kontekst, intensifikimi i punës në ndërtimin e një strategjie gjithëpërfshirëse në administrimin e të ardhurave si dhe shfrytëzimi i aseteve në dispozicion/pronësi të Bashkisë do të ndikonte pozitivisht në kahun e të ardhurave. Në kahun e shpenzimeve, nevojitet një lloj ekonomizimi në përdorimin e burimeve financiare në dispozicion, duke evidentuar investimet kryesore me ndikim të gjerë në jetën e komunitetit dhe territorit nën administrim dhe uljen e nivelit të shpenzimeve operative.

1.8 QEVERISJA DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE

1.8.1 Decentralizimi i Qeverisjes dhe Strukturat Përkatëse

Më 29 korrik 2015, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore. Në këtë strategji prezantohet vizioni i Qeverisë Shqiptare për fuqizimin e demokracisë dhe avancimin e procesit të decentralizimit në përputhje me vizionin dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe standardet e Bashkimit Evropian (BE). Me tregues krahasimisht të ulët të decentralizimit fiskal në rajon (me vetëm 2.2% të PPB-së[156]), dhe efiçencë, cilësi dhe standarde të dobëta në ofrim shërbimesh, kjo strategji, e parë në mënyrë holistike bashkë me reformën administrative territoriale dhe Ligjin e ri organik "Për vetëqeverisjen vendore"[157], shihet si një hap përpara për qeverisjen vendore.

Një risi thelbësore e Ligjit të ri organik "Për vetëqeverisjen vendore" është prezantimi i parimit të decentralizimit asimetrik bazuar në parimin e **subsidiaritetit**. Bashkitë me kapacitete njerëzore dhe financiare të përshtatshme kanë mundësi të kërkojnë decentralizimin e kompetencave të caktuara.

Më specifikisht, kjo strategji parashtron katër objektiva strategjikë:

(1) Përmirësimin e efiçencës së përgjithshme të strukturave të qeverisë vendore-konsolidimi financiar

dhe administrativ i 61 bashkive pas adoptimit të ligjit të ri për ndarjen administrative territoriale; dhe mbështetje infrastrukturore dhe institucionale për 12 qarqet dhe 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

(2) Fuqizimi i financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale-që synon reformimin e sistemit të të ardhurave vendore dhe përmirësimin e menaxhimit të financave vendore.

(3) Mundësimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

(4) Fuqizimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Pas miratimit të Ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Mbi ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", qeverisja vendore në Shqipëri është organizuar në dy nivele, ku ***bashkia,*** njësia bazë, përbën nivelin e parë të qeverisë, ndërsa ***qarku*** përbën nivelin e dytë. Në ndryshim nga 373 bashkitë e komunat përpara ndarjes territoriale, aktualisht ka 61 bashki, të cilat përbëhen nga njësi administrative, të organizuara në qytete dhe fshatra. Ndarja në qarqe (12) mbetet në fuqi, ku çdo qark ka mesatarisht 5 bashki. Ndërsa funksionet dhe përgjegjësitë e bashkive janë rishikuar në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore, roli i qarkut mbetet ende i paqartë.

1.8.2 Vështirësitë e Qeverisjes Vendore

Sfidat me të cilat përballen sot 61 bashkitë e krijuara nga ndarja e re administrative-territoriale janë njëherësh të trashëguara, por dhe të lidhura ngushtësisht me reformën territoriale[158], (konsolidim nga 373 në 61 NjQV[159]). Bashkia e Elbasanit, e shtrirë në qendër të vendit, ka pësuar një rritje prej 3,900%, me një territor prej 872.03 km^2 në krahasim me shtrirjen 22.18 km^2 përpara reformës. Nisur nga burimet në dispozicion, dhe konteksti, disa nga vështirësitë më të mëdha të Bashkisë Elbasan mund të përmblidhen si më poshtë:

Territore të reja më të mëdha për planifikim, menaxhim dhe për administrim shërbimesh. Me zgjerimin e territorit (e renditur e shtata në vend për nga madhësia), Bashkisë së Elbasanit do t'i duhet të ofrojë shërbime për një popullsi rreth 1.8 herë më të madhe se më parë, (144,382 banorë [160] në 13 njësi administrative, krahas qytetit të Elbasanit). Në këto kushte, bashkia përballet me nevojën për planifikim urban e rural, shtimin e kërkesës për ofrim shërbimesh, rritjen e rrezes së ofrimit të tyre, si dhe diversifikimin e llojit të shërbimeve të ofruara për shkak të karakterit urban dhe rural dhe zgjerimit të kompetencave (pyjet, kullotat, rrjeti dytësor i kullimit e ujitjes, etj.).

Ndryshim, ose diversifikim i prioriteteve të zhvillimit. Në kushtet e një territori të ri, me disa qendërsi urbane dhe karakter të theksuar malor, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik vendor është një hap urgjent për t'u ndërmarrë. Do të duhet që vizioni, objektivat, programet, projektet prioritare dhe të gjitha dokumentet e lidhura me zhvillimin (përdorimin e tokës, planit të infrastrukturës, rregulloret, etj.) të formulohen dhe të reflektojnë qartësisht karakteristikat e territorit të ri të Bashkisë Elbasan.

Mungesë kapacitetesh institucionale, përfshirë këtu administratën vendore, për të garantuar kryerjen e proceseve në mënyrë efektive dhe efikase. Cilësia dhe aftësimi i burimeve njerëzore të bashkisë mbetet sfidë, sidomos në kushtet ku stafi, veçanërisht ai teknik, do të duhet të kryejë procese të një natyre të diversifikuar dhe shkallë më të gjerë. Me një territor më të madh për të administruar, stafi duhet të aftësohet për të bashkërenduar veprimet për ***13*** njësitë përbërëse të bashkisë, përkatësisht: Elbasan, Bradashesh, Labinot Mal, Labinot Fushë, Funarë, Gjergjan, Gjinar, Gracen, Papër, Shirgjan, Shushicë, Tregan dhe Zavalinë. Mbështetja teknike dhe ngritja e kapaciteteve e deritanishme shpesh ka rezultuar me humbje për shkak të ndryshimit të stafit sipas ndryshimit politik në bashki. Funksionet dhe përgjegjësitë (ekzistuese e të reja) që i kalojnë bashkive në kuadër të strategjisë së decentralizimit dhe ligjit organik, parashtrojnë nevojën për ngritje të kapaciteteve institucionale me fokus në: administrimin e shërbimit përkatës, menaxhim të financave publike, statistikë, planifikim strategjik, shkrim dhe menaxhim projekti, qeverisje territoriale, etj. Trajtimi i kësaj sfide shihet si e lidhur veçanërisht me arritjen e përmirësimit të efiçencës së përgjithshme të strukturës së Bashkisë Elbasan.

Autonomia fiskale: Zgjerimi i portofolit të kompetencave dhe përgjegjësive të bashkisë shoqërohet me sfidën e burimeve të pamjaftueshme. Mes transfertave të pakushtëzuara, të rezultuara si të ulëta, të paqëndrueshme dhe vazhdimisht në rënie me 3,366 lekë/frymë në Bashkinë Elbasan për vitin 2014 (përpara reformës)[161], dhe të ardhurave të veta të bashkisë, do të duhet të përmbushen funksionet e veta dhe ato të përbashkëta. Kjo sfidë nënvizon dhe nevojën për të përmirësuar aftësinë për mbledhjen e të ardhurave, veçanërisht nga taksat dhe tarifat, si p.sh., taksa e pronës, taksa e pastrim-gjelbërimit, etj.

Sfida Mjedisore: Mungesa e një inventari të hollësishëm të territoreve dhe pikave burimore (brenda territorit të saj) me rrezik ndotjeje për tokën bujqësore, ajrin, akuiferet, etj., dhe për pasojë dhe mungesa e projekteve parandaluese dhe rehabilituese. Përtej hartimit të një inventari të plotë dhe projekteve parandaluese apo rehabilituese, do të duhet që njëkohësisht, Bashkia të bashkëpunojë me bashkitë e tjera dhe me institucionet qendrore të mjedisit

dhe të burimeve natyrore për mbrojtjen e tyre nga ndotja e shkaktuar përtej kufijve të saj.

Vështirësi të tjera të Bashkisë Elbasan përfshijnë: ***paqartësi për sa i takon funksioneve dhe kompetencave të përbashkëta,*** pamundësi për t'u përfaqësuar nga një shoqatë bashkish e legjitimuar dhe pranuar nga të gjitha forcat politike, në procese konsultimi dhe dialogu në nivel qeverisje vendore, dhe sigurimi i përfaqësimit të popullsisë në procese të planifikimit dhe buxhetimit me pjesëmarrje (por jo vetëm).

1.8.3 Perceptimet qytetare në lidhje me qeverisjen e tyre vendore, format e organizimit komunitar dhe bashkësia e OJF-ve, instrumente të transparencës, etj.

Bashkia e Elbasanit ka të paktën 21 organizata të regjistruara të shoqërisë civile[162], që mbulojnë një spektër të gjerë çështjesh, përfshirë këtu të drejtat e fëmijëve, të drejtat e gruas, të drejtat e komunitetit Rom, familje në varfëri ekstreme, njerëz më aftësi të kufizuara, etj.

Nisur nga studimet, rezulton që lidhja shoqëri civile-institucione të tjera që operojnë bashki (kryesisht përpara reformës, por dhe gjatë 2014 e në vazhdim), të jetë krahasimisht e mirë. Megjithatë, sfida si mungesa e financimit nga pushteti vendor, ngritja e kapaciteteve të vetë organizatave të shoqërisë civile (OSHC)[163] dhe nevoja për asistencë teknike janë po aq pranishme dhe në këto organizata. Disa nga format më të aplikuara të bashkëpunimit OSHC- Bashki, janë praktikat e buxhetimit me pjesëmarrje prej vitit 2005, dhe buxhetimit gjinor me pjesëmarrje prej vitit 2009, konsultimet në kuadër të hartimeve të dokumenteve strategjikë, etj.

Krahas përfaqësimit përmes aktiviteteve të OSHC-ve, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i qytetarëve në Bashkinë Elbasan sigurohet përmes mekanizmave të mbështetur në kuadër të projekteve nga agjenci donatore, si rasti i Komisioneve Këshillimore Qytetarë Vendore (KKQV) nga Programi për Planifikim dhe Qeverisje Vendore në Shqipëri, financuar nga USAID. KKQV ekziston në Elbasan që prej vitit 2012 dhe aktualisht po reformohet për shkak të ndryshimit territorial. Po ashtu, KKQV (grupim i pavarur dhe që përçon zërin e qytetarëve në procese të ndryshme të qeverisjes vendore në Elbasan) përbën "zemrën" e forumit këshillimor qytetar, që bashkia ka mundësuar të krijohet për të ndjekur dhe konsultuar procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit të saj (forumi këshillimor është detyrim ligjor sipas rregullores së planifikimit të territorit, miratuar në vitin 2015 me VKM nr. 671). Edhe para vitit 2012, Elbasani ka pasur organizime të tilla qytetare, që datojnë së paku në vitin 2002, të rifreskuara me komisionin qytetar për strategjinë e qytetit në vitin 2004-2005, etj.

1.9 PROCESE DHE DOKUMENTE PLANIFIKIMI

Gjatë hartimit të Dokumentit të Politikave të Zhvillimit të Territorit është e rëndësishme të konsiderohen të gjitha planet e hartuara dhe të miratuara më parë. Në metodologjinë që kemi përdorur për hartimin e këtij dokumenti janë vlerësuar dhe marrë parasysh të gjitha parashikimet e rëndësishme që janë bërë në territorin e Bashkisë Elbasan deri më sot, por kemi shqyrtuar këto dokumente duke mbajtur parasysh parashikimet e të gjitha atyre planeve, të cilat kanë ende kuptim pas ndryshimit të dinamikave të zhvillimit që ka pësuar territori.

Sipas listës së Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), nga vendimet e Këshillit të Rregullimit të Territorit dhe Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) në territorin e Bashkisë Elbasan janë:

1. Vendim nr. 6, datë 01.09.1993, Për sheshin e ndërtimit të rezervuarit për rritjen e peshkut në fshatin Kuqan të rrethit të Elbasanit, Miratohen (Sip. 2 ha).
2. Vendim nr. 9, datë 01.09.1993, Për zgjerimin e vijës kufitare të qytetit të Elbasanit, Miratohet (Sip. 40 ha).
3. Vendim nr. 35, datë 19.09.1995, Për vijën kufizuese mbrojtëse të zonës së Gjinarit-Elbasan, Miratohet (Sip. 960 ha).
4. Vendim nr. 19.09.1995, Për vijën kufizuese mbrojtësë të zonë së Lixhave në Elbasan, Miratohet për dy zona me sip. 37 ha dhe 7.5 ha.
5. Vendim nr. 1, datë 23.03.1998, Për shesh dhe Leje Ndërtimi për seksionin Rrogozhinë-Elbasan të Korridorit Lindje-Perëndim, Miratohet sheshi i ndërtimin me sip toke 46.7 ha që shpronësohet, nga e cila 35.3 ha tokë bujqësore dhe 11,4 ha tokë truall. Miraton lejen e ndërtimit.
6. Vendim nr.25 datë 23.03.1998, Për shesh ndërtimi për vend depozitimi dhe trajtimin të mbeturinave të ngurta urbane për qytetin e Elbasanit, Miraton sheshin e ndërtimin me sip 4 ha në komunën Bradashesh pranë Fabrikës së Çimentos.
7. Vendim nr.1, datë 26.01.2001, Për sheshin dhe lejen e ndërtimit për zgjerimin e nënstacioneve Elbasan 400KV dhe Elbasan 220KV, si dhe për linjën elektrike 220KV ndërmjet tyre. Miratohet.

8. Vendim nr. 4, datë 21.05.2001, Për studimin urbanistik të qendrës turistike në zonën turistike të Gjinarit në Qarkun Elbasan, Miratohet (Sip 25,162 ha).
9. Vendim nr. 1, datë 21.08.2002, Për shesh dhe leje ndërtimi për rehabilitimin e rrugës Elbasan-Librazhd, Miratohet sheshi dhe leja e ndërtimit për rrugën me gjatësi 39.4 km dhe për të cilën duhen shpronësuar 81, 523 m² tokë.
10. Vendim nr. 6, darë 19.02.2003, Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit dhe vijën kufizuese të kësaj qendre. Miratohet.
11. Vendim nr. 1, datë 18.12.2004, Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit. Miratohet sipas vendimit.
12. Vendim nr. 6, datë 07.05.2005, Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit. Miratohet.
13. Vendim nr. 8, datë 07.05.2005, Për miratimin e vijës kufizuese dhe detyrës së projektimit për studimin urbanistik të zonës turistike kurative të Llixhave të Elbasanit. Miratohet.
14. Vendim nr. 1, datë 27.12.2005, Për miratimin e detyrës së projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Elbasanit. Miratohet me vërejtje sipas vendimit.
15. Vendim nr. 3, datë 14.08.2007, Për miratimin e projekt-idesë së përgjithshme të studimit për autostradën Tiranë-Elbasan (Vaqarr-Papër). Miratohet.
16. Vendim nr. 1/6, Për miratimin e vijave kufizuese të zonave/ vendbanimeve informale në Qarkun e Elbasanit.
17. Vendim nr. 14, datë 13.01.2009, Ndryshim në studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit dhe rregullores në zbatim të tij. Miratohet.
18. Vendim nr.10, datë 21.07.2009, detyrë projektimi për planin e studimit urbanistik pjesor të kodrës Krasta e Madhe, Elbasan. Miratohet.
19. Vendim nr. 34, datë 10.05.2013, Rivlerësimi i studimit urbanistik të qendrës së Elbasanit. Miratohet.
20. Vendim nr. 3, datë 27.05.2014, leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e stadiumit "Ruzhdi Bizhuta" në Bashkinë Elbasan. Miratohet, konfirmuar.
12. Vendim nr. 3, datë 30.07.2014, leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e linjave të transmetimit të energjisë elektrike 110 kv, Banjë-Cërrik dhe 220 kv, Moglicë-Elbasan, me subjekt kërkues shoqërinë "Devoll Hydropower" Sh.a, për shoqërinë "Devoll Hydropower" Sh.a. Miratohet, konfirmuar.
22. Vendim nr. 3, datë 03.12.2014, leje ndërtimi për uzinën e prodhimit të ferrokromit, në Elbasan. Miratohet, konfirmuar.
23. Vendim nr. 2, datë 29.12.2014, Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Rafineri për prodhimin e bitumeve dhe nën-produkteve të naftës", në Elbasan me subjekt kërkues shoqërinë "R.B.H –Beline" sh.a. Miratohet, konfirmuar.
24. Vendim nr. 1, datë 27.01.2015, Për miratimin e lejes së ndërtimit për "Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë", me vendndodhje në Bashkinë Elbasan dhe subjekt kërkues shoqërinë koncensionare "Albtek Energy" sh.p.k. Miratohet, konfirmuar [164].

- **Para 1990- Studim i qendrave urbane (Plani Rregullues i Vitit 1983 dhe Plani Rregulluesi i Vitit 1942)**
- **Nxitja e Zhvillimit Rajonal Nëpërmjet Objektivave të Mijëvjeçarit**

Figura 60: Plani Rregulues i Bashkisë Elbasan, 1942



Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Figura 61: Plani Rregullues i Bashkisë Elbasan, 1983



Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Përgatitja e këtij raporti u mbështet nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe hartua nga Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit, Këshilli i Qarku Elbasan me asistencë të Qendrës për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC), në vitin 2002. Objektivi kryesor i kësaj nisme ishte lokalizimi i synimeve të treguesve të Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin e Qarkut Elbasan dhe verifikimin e mundësisë të shndërrimit të tyre në instrumente nxitëse të zhvillimit të gjithanshëm rajonal dhe të mobilizimit të burimeve ekonomike e njerëzore në funksion të këtij zhvillimi.

- **Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit Elbasan (2006)**

Ky plan u hartua si dokument kryesor për administrimin e territorit të bashkisë për 15 vitet në vazhdim. Plani i Përgjithshëm Rregullues është pjesë dhe instrument zbatimi i strategjisë së Zhvillimit të Qytetit (Elbasan 2005-2020) dhe pasqyron objektivat e kësaj Strategjie në lidhje me çështjet e zhvillimit urban. Konceptet kryesore ky synon ky plan rregullues janë:

Zgjidhja e problemit të strehimit (përcakton zonat e reja të banimit, përfshin në proces legalizimin e banesave informale në periferi të qytetit duke propozuar përmirësimin e infrastrukturave në këto zona, promovon nismën e dokumentimit të tokës dhe ngritjes së bazës së të dhënave për territorin dhe sistemin vendor të informacionit dhe krijon mundësi për strehim social)

Rritja e cilësisë së jetesë së banorëve (propozon koeficientë të rinj urbanë me qëllim që të përmirësojë kushtet urbane në zonat e banimit duke nxitur sigurimin e hapësirave çlodhëse dhe rekreative, rikonceptimet dhe konsolidimet e zonave të ndryshme në qytet që sjellin rritjen e dendësisë me qëllim shfrytëzimin efecient-ekonomik të tokës dhe të infrastrukturave dhe shërbimeve publike)

Zhvillimin ekonomik të qytetit dhe rajonit të Elbasanit (Plani ka konceptuar shpërndarjen hapësinore të zonave me funksione ekonomike si dhe funksionet e lejuara për çdo zonë. Gjithashtu hartimi i skemës së rrjetit rrugor të propozuar bazohet në krijimin e një strukture të qartë të qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve duke stimuluar kështu iniciativat ekonomike, lidhjen sa më të mirë të territoreve me rajonet përreth saj duke stimuluar fluksin e shkëmbimeve drejt qytetit dhe sidomos përgjatë akseve kryesore rrugore të propozuara. Plani prezanton rikonceptimin hapësinor bazuar në elementët promotor të qytetit dhe veçanërisht në nyjat/akset/fashat gravitacionale të qytetit si elemente gjeneruese të zhvillimit.)

Përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe mbrojtjen e tij (në këtë Plan Rregullues përcaktohen qartë zonat ndotëse, duke rekomanduar një sërë ndërhyrjesh të ndryshme me karakter konservues, rikuperues etj. Propozohet shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet, duke synuar rehabilitimin e zonave të gjelbra të degraduara si p.sh. rasti i fashës së Shkumbinit, Manasderes, Zaranikës, etj., si dhe planifikimin dhe rikuperimin e zonave të gjelbra periferike me karakter park si p.sh., derdhjet e ujërave të zeza në hapësirat ujore, rikuperimi mjedisor i fushës së grumbullimit të mbeturinave në Park të Gjelbër, vendndodhja e impiantit të pastrimit të ujërave të zeza në perëndim të qytetit të Elbasanit etj.).

Krijimin e institucioneve të afta për menaxhimin dhe zbatimin e Planit (këto institucione duhet të organizohen dhe pajisen me kapacitete për zbatimin e planit dhe duhet të jenë të afta të koordinojnë ndërhyrjet e planit në nivel ndërvendor-zona e trajtuar nga plani.)

Detyra e Projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Elbasan, miratuara janar 2006

Detyra e Projektimit është produkt i Bashkisë Elbasan dhe i asistuar nga Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Kjo detyrë projektimi është dokument bazë dhe ligjor për hartimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm. Objektivat kryesorë për hartimin e këtij materiali ishin:

- Grumbullimi dhe sistemimi i të dhënave për të paraqitur sa më saktë gjendjen ekzistuese të qytetit të Elbasanit
- Analiza e situatës ekzistuese mbi bazën e të dhënave të paraqitura
- Parashtrimi i udhëzimeve orientuese mbi zhvillimin perspektiv dhe zgjidhjen e problemeve kryesore urbane, të cilat do të merren parasysh gjatë fazës së hartimit të planit rregullues për periudhën 15-20 vjeçare.

Detyra e Projektimit paraqet problemet ekzistuese duke u mbështetur: në të dhënat urbanistike, të dhënat mbi infrastrukturat, të dhënat socio-ekonomike, të dhënat mjedisore dhe të dhënat të tjera të përgjithshme.

- **2006-2013 Studimi Pjesor i Qendrës**

Studimi pjesor i Qendrës ndahet në Zona Projekti, të cilat janë instrument bazë për studimin e rikualifikimit urban të qendrës së qytetit të Elbasanit. Këto zona të veçanta do të transformohen në mënyrë të tillë që të shërbejnë si pjesë referimi për zbatimin e projektit. Ndarja e qytetit në zona është bërë, në mënyrë që zbatimi i tyre të jetë individual dhe në kohë të ndryshme, por duke qenë harmoni midis tyre. Pra, pavarësisht ndarjes në zona dhe zbatimi në kohë të ndryshme bëhet fjalë për një projekt të vetëm. Normat kryesore që përcaktohen nga plani i rikualifikimit urban janë:

- Skema projektuese
- Parametrat e projektimit bashkangjitur skemës
- Metoda për zbatimin e projektit të përcaktuara për çdo skemë në veçanti
- **Studim Urbanistik Pjesor, Zgjerimi i vijës kufizuese të ndërtimit në fshatrat: Bradashesh, Katund i Ri dhe Kusarth të Komunës Bradashesh, Elbasan (Prill 2007)**

Ky studim urbanistik i hartuar në vitin 2007 ka për qëllim zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit në disa fshatra të komunës Bradashesh, përkatësisht në fshatrat Bradashesh, Katund i Ri dhe Kusarth. Zgjerimi i vijës kufizuese të ndërtimit propozohet për disa arsye, të cilat janë: zhvillimet e vrullshme politiko-ekonomike pas vitit 1990 kanë bërë që kjo zonë të pësojë rritje të popullsisë, ndaj propozimi për zgjerimin e vijës kufizuese është për të plotësuar nevojat për ndërtime të reja dhe njëkohësisht për të shmangur zhvillimin e pakontrolluar (ndërtimet të mos i lihen rastësisë). Sipërfaqja që propozohet të shtohet është 43 ha dhe pozicionohet përkrah rrugëve ekzistuese kryesore. Ky studim pjesor parashikon ndërtimin e rrugëve të reja 3 dhe 5m të gjëra, godina banimi kryesisht ndërtesa njëfamiljare të tipit 'vilë' (2-3 kate) me oborr të gjelbër, ndërtime social ekonomike (dyqanet, bare-restorante, punishtet e vogla artizanale), godina të shërbimit shëndetësor (të cilat do të jenë të nevojshme për shkak të rritjes së popullsisë), kopsht-çerdhe për fëmijët e ciklit parashkollor.

- **Plani Strategjik i Zhvillimit të Qytetit Elbasan (2010-2020)**


Plani Strategjik i Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit përcakton objektivat e zhvillimit të qytetit për një periudhë 10-vjeçare dhe identifikon projektet konkrete kryesore për fusha të ndryshme. Qëllimi i hartimit të këtij plani është të krijojë vlera komunitare afatgjata, mbrojë dhe ruaj burimet ekonomike dhe të nxisë një cilësi jete më të lartë.

- **Strategjia e Zhvillimit Rajonal, Qarku Elbasan 2012-2016**

Ky projekt është financuar nga BE dhe realizuar nën asistencën teknike të PNUD-it, nëpërmjet projektit "Mbështetje e Integruar për Decentralizimin". Kjo është një strategji afatmesme, 5 vjeçare. Kjo strategji mbulon të gjitha fushat që kanë lidhje me të, pavarësisht se cili nivel qeverisjeje është përgjegjës kryesor për këto. Prioritetet e këtij dokumenti janë:

- Forcimi i kapaciteteve të zhvillimit njerëzor për të zhvilluar rajonin
- Zgjerimi i bazës produktive të ekonomisë rajonale
- Zhvillimi i turizmit

Figura 62: Zonimi funksional në perspektivë



Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

- Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor dhe infrastruktura mbështetëse
- Zhvillimi i njerëzve nëpërmjet arsimit
- Shëndeti publik dhe zhvillimi social
- Aksesi dhe ndërlidhja
- **Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM), Segmenti Papër-Vidhas (2014)**

Ky studimi është fokusuar në aktivitetet e seksionit rrugor Vidhas-Papër, pjesë e rrugës kombëtare SH7, të identifikuar dhe të pranuar nga ARRSH. Segmenti sipas studimit është 7.8 km i gjatë. Pjesa e rrugës në shqyrtim duket të jetë e karakterizuar nga konflikti ndërmjet përdoruesve të motorizuar dhe atyre të pa-motorizuara rrugore.

Në territorin e Bashkisë Elbasan janë hartuar gjithashtu:

- **Plani i menaxhimit për pyjet dhe kullotat e fshatit Gjergjan**
- **Studim për menaxhimin e pyjeve në komunat Shushicë, Gjinar, Papër dhe Gracen, Banka Botërore**
- **Strategjia nga ALCDF, komunat Shushicë dhe Funarë**

1.10 MBI DREJTIMIN E ZHVILLIMIT

1.10.1 Koncepti rajonal i zhvillimit

Bashkia e Elbasanit, e pozicionuar në Shqipërinë qendrore, lexohet si pjesë e disa rajoneve, nisur nga kriteret e përdorura në përcaktimin e rajonit. Për shembull, Elbasani


shtrihet në basenin e Lumit Shkumbin dhe bën pjesë në rajonin e zhvillimit të qarqeve Elbasan-Berat-Korçë[165]. Nga pikëpamja historike, territori i sotëm i Elbasanit ka qenë pjesë e disa provincave, principatave, apo vilajeteve. Në periudhën e antikitetit, ky territor shtrihej pjesërisht në provincën përgjatë Via Egnatia (Klodiana-Peqini i sotëm si një nga qendrat kryesore) ku ndodhet edhe Korça e Pogradeci i sotëm[166]. Në shekujt XII-XV territori i Elbasanit shtrihej në shtetin e Arianitit afër kufirit me principatën e Kastriotëve[167]. Para shpalljes së pavarësisë në 1912, Elbasani ishte pjesë e sanxhakut të Elbasanit në vilajetin e Manastirit, së bashku me Korçën. Në vitin 1923 Elbasani bënte pjesë si nënprefekturë në prefekturën e Elbasanit (bashkë me Librazhdin, Peqinin dhe Gramshin) dhe përfshinte rrethin e Elbasanit dhe krahinat Çermenikë, Dumres dhe Shpatë[168]. Aktualisht, Bashkia e Elbasanit është pjesë e qarkut me të njëjtin emër.

Sa më sipër pasqyron natyrën e ndryshueshme të rajonit si territor, në varësi të kritereve që përdoren në përcaktimin e tij. Meqë në Shqipëri nuk kemi rajone administrative/ qeverisëse, për qëllime planifikimi, Elbasani mund të jetë pjesë e rajoneve të ndryshme. Për qëllime të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të territorit të Bashkisë së Elbasanit, rajoni i studimit të tij është konsideruar territori, pikat më të largëta të të cilit janë: Bashkia Elbasan në veri; Bashkia Devoll në lindje; Bashkia Tepelenë në jug; dhe Bashkia Fier në perëndim. Ky rajon planifikimi është përcaktuar mbi bazën e kritereve të shpjeguara më sipër, si edhe të: 1) korridoreve rrugore kombëtare që ndërthuren në territorin e Elbasanit dhe në kufijtë e saj; 2) rrjetit të zonave të mbrojtura natyrore që lidhen brenda këtij rajoni dhe në afërsi të territorit të Elbasanit; 3) zonave të rrezikut mjedisor nga ndotja e përcjellë prej lumenjve dhe ndikimi i zonave naftëmbajtëse; 4) sistemit të tokave bujqësore të Elbasanit, Kuçovës, Fierit dhe Beratit, 5) zhvillimeve historike dhe identiteti në shekuj.

Për të hartuar një vizion zhvillimi për territorin e bashkisë, nevojitet koncepti i zhvillimit të rajonit në të cilin ndodhet Elbasani. Arsyet për këtë renditen si më poshtë:

- Elbasani nuk funksion si një ishull, por si pjesë përbërëse e rajonit të cilit i përket. Ekonomia e Elbasanit dhe pozicionimi i saj në rajon varen nga ekonomitë rrethuese dhe marrëdhënia plotësuese-konkurruese e Elbasanit me këto ekonomi;
- Territori vendor përshkohet nga infrastruktura dhe akse e korridore rrugore, të cilat kanë rëndësi kombëtare dhe/ose rajonale. Çdo vendim për territorin vendor ndikohet nga këto akse e korridore. Një pjesë e mirë e tyre merren të gatshme nga studime dhe projekte e plane kombëtare (si p.sh. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i territorit, planet sektoriale për transportin, energjinë, etj.), por një pjesë janë subjekt propozimi;
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar i territorit si dhe disa plane sektoriale përcaktojnë vendime që prekin drejtpërdrejt ose jo edhe territorin e Bashkisë së Elbasanit dhe çdo vendim të PPV-së së Elbasanit;

Figura 63: Kriteret e përcaktimit të rajonit të studimit



Burimi: Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit: Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


Rajoni i planifikimit që ndikon dhe ndikohet nga zhvillimi në bashkinë e Elbasanit, përmban disa qendra kryesore (Fieri, Lushnja, Berati, Pogradeci dhe Korça) me larmi funksionesh urbane dhe rurale, si edhe disa qendra në zhvillim (Kuçova, Peqini, Librazhdi, Patosi dhe Cërriku), profili i të cilave është në formim. Bashki të tjera si Divjaka, Belshi, Gramshi, Skrapari, Maliqi, Këlcyra, Devolli e Pusteci kanë natyrë të theksuar rurale, me potencial të lartë për zhvillimin e bujqësisë dhe të turizmit. Turizmi mund të marrë forma të ndryshme në këtë rajon, që variojnë nga turizmi bregdetar, në atë ekologjik, natyror, bujqësor, malor dhe historik/kulturor. Kjo larmi mbështetet nga burimet natyrore dhe nga konteksti historik i zhvillimit.

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit, rajoni në të cilin bën pjesë Elbasani ka një karakter zhvillimi që bazohet në kombinimin mes ekonomive bujqësore (prodhuese dhe përpunuese), ekonomisë së turizmit (sipas të gjitha formave të mësipërme), industrisë dhe funksioneve urbane. Sigurimi i baraspeshës mes këtyre ekonomive përbën sfidë për vizionin e ardhshëm të zhvillimit urban e rural të territorit. Faktikisht, për mënyrën se si janë zhvilluar deri më sot, këto ekonomi kanë prodhuar më së shumti konflikte mbi burimet se sa harmoni dhe bashkëjetesë. Është detyrë e konceptit të vizionit rajonal të zhvillimit të territorit që të propozojë se si mund të garantohet baraspesha.

Aktualisht potenciali turistik përfaqësohet nga rrjeti i zonave të mbrojtura natyrore, zona bregdetare dhe malore, qytetet me zona historike dhe/ose të klasifikuara si muze, qytetet kryesore me larmi funksionesh, parqe arkeologjike, një tërësi monumentesh kulture dhe monumentesh natyrore të shpërndara në territor, si dhe vendbanime rurale në funksion të turizmit:


- Bregdeti i Adriatikut nga delta e Shkumbinit deri në deltën e Vjosës;
- Parqe kombëtare[169]:
- Prespa në Korçë e Devoll, me sipërfaqe rreth 277 km^2 (ka edhe status të zonës RAMSAR).
- Mali i Tomorit në Berat, rreth 247 km2, me biodiversitet të pasur, vlera shkencore, peizazhe, estetike, çlodhëse e turistike, historike e kulturore që garantojnë zhvillimin e turizmit ekologjik e kulturor.
- Shebenik-Jabllanicë në Librazhd, 339 km^2, me biodiversitet të pasur, vlera eko-turistike, pyje të virgjëra ahu.
- Divjakë-Karavasta, 222 km^2, me pasuri habitatesh dhe specie të rralla, me vlera historike, kulturore, arkeologjike e potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit (plan menaxhimi në hartim).

Figura 64: Sistemi urban dhe infrastruktura




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 65: Sistemi natyror



Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


Figura 66: Analiza historike



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

- Parqe natyrore apo rezervate natyrore të menaxhuara[170];
- Dardhë-Xhyrë, Sopot, Stavraj, dhe Polis, me sipërfaqe 400-45 ha dhe të gjitha pa plan menaxhimi, si dhe Kuturman (3,600 ha, pjesërisht i dëmtuar dhe i tejshfrytëzuar)-të gjitha në Librazhd,
- Bogova në Skrapar me rreth 330 ha,
- Pishë-Poro në Fier me rreth 1,500 ha, e rrezikuar nga përmbytjet, kripëzimi i tokës, erozioni detar dhe ndotja që sjell delta e Vjosës. Pylli i Levanit në Fier (200 ha) pa plan menaxhimi,
- Gërmenj-Shelegur (430 ha) në Kolonjë, Cangonj në Devoll (250 ha, zonë ndërkufitare) dhe Krastafillak në Korçë (150 ha në gjendje të rënduar dhe pa plan menaxhimi),
- Qafë Bushi Rrëzomë (500 ha dhe e dëmtuar) në Elbasan,
- Balloll në Berat (330 ha), pa plan menaxhimi.
- Peizazhi i mbrojtur Vjosë-Nartë (rreth 197 km^2), i pasur me ligatina, i pakënetëzuar, i rrezikuar nga ndotja që përcjell delta e Vjosës[171];

Figura 67: Koncepti rajonal




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

- Zona e mbrojtur e burimeve të menaxhuara Piskal Shqeri (54 km^2) në Kolonjë, pa plan menaxhimi, me vlera historike, peizazhe, kulturore e turistike[172];
- Parku Arkeologjik i Apolonisë;
- Manastiri i Ardenicës (i Shën Marisë) si monument kulture dhe me territorin natyror të tij si monument natyre;
- Qyteti i Beratit me lagjet muze, mbi 2000-vjeçare, i njohur nga UNESCO, dhe si qendër urbane shumë-funksionale që mund të ofrojë shërbime për plotësimin e zinxhirit të vlerës së turizmit në të gjithë rajonin malor që shtrihet në qarkun e Beratit, e më tej në veri të Përmetit dhe verilindje të Kolonjës;
- Qyteti i Elbasanit me lagjen Kala dhe lagje të tjera me vlera historike, si qendër urbane shumë-funksionale, në presion zhvillimi, me lidhje shumë të mirë me Tiranën dhe me Korçën, përgjatë korridorit 8;
- Qyteti i Peqinit, si një qytet në zhvillim, në territor bujqësor dhe me objekte historike në territorin e tij (kalaja e Peqinit);
- Gjinari, Llixhat në Tregan, lugina e Shkumbinit nga Qukësi deri në burimet e tij në Valamare si zona me potencial për turizëm malor, kombinuar me shërbime specifike si ato që ofrohen nga llixhat, mundësia për ndërtim të pistave të skive në Valamare apo ecje në natyrë përgjatë Shkumbinit nga Qukësi në Lenie;
- Kuçova si territori dhe vendbanimi i parë në Shqipëri, ku janë shfrytëzuar burimet e naftës, me infrastrukturë zonash industriale të trashëguar nga periudha para viteve `90-të dhe me një strukturë tipike të qytetit të ndërtuar gjatë diktaturës komuniste, të ruajtur në ditët e sotme.

Nga leximi i shpërndarjes së potencialeve turistike (të kombinuara me format e tjera të zhvillimit ekonomik, veçanërisht bujqësia), vihet re presioni që shkakton ndotja e mjedisit mbi një pjesë të mirë të këtyre potencialeve dhe territoreve rreth tyre. Kështu, nisur nga analizat e cilësisë së ujërave sipërfaqësore për Shkumbinin, Devollin, Osumin dhe Gjanicën, kemi evidentuar zonat ku shtrihet ndikimi i ndotjes së lumit, sipas pikave kryesore burim ndotjeje në territor. Po ashtu, Figura 68, evidenton edhe zonat kryesore që shfrytëzohen si burime nafte dhe industri e rëndë ndotëse (Patos-Marinza, Kuçova, Ballshi dhe Elbasani/Bradasheshi) dhe drejtimin e presionit të tyre në territor.

Sipas këtij leximi, në basenin e Shkumbinit, zona me presion të lartë të ndotjes nis menjëherë pas qytetit të Elbasanit (derdhja e ujërave të zeza në lumë dhe prania e vend depozitimit të mbetjeve urbane përgjatë tij) dhe vjen duke u intensifikuar deri në derdhje, me pika të nxehta pas Peqinit dhe Rrogozhinës. Në basenin e Seman-Osum-Devoll pika e parë e nxehtë evidentohet menjëherë pas qytetit të Beratit (uzina e baterive, ujërat e zeza dhe mbetjet urbane përgjatë lumit), për t`u intensifikuar pas Urës Vajgurore dhe Kuçovës ku lumi merr me vete edhe ndotjen e naftës, më tej pas zonës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës dhe qytetit të Fierit. Si rezultat i ndotjes së lumit dhe ndikimit të zonave industriale, rrezikohen fusha prodhuese e Fierit dhe ajo e Bubullimës, fusha e Bradasheshit dhe e Cërrikut, tokat bujqësore përgjatë Shkumbinit dhe në Divjakë, më pak masivi kodrinor i Dumresë, dhe sigurisht zonat e mbrojtura përgjatë bregdetit në brendësi apo kufi të të

Figura 68: Potenciali turistik dhe zonat në presionin e ndotjes mjedisore



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

cilave ndodhen deltat e tre lumenjve që përcjellin ndotje (Shkumbin, Seman dhe Vjosë). Këtu vlen të përmendet edhe dalja e gazsjellësit të TAP në plazhin e Semanit, ku do të ndërtohet një stacion kompresimi.

Së fundi, edhe pse një skenar i largët, një nga problemet me të cilat mund të përballet rajoni është përmbytja si rezultat i ndryshimeve klimatike. Kjo përmbytje, në rast se deti ngrihet me një nivel prej 30 cm në 30 vitet e ardhshme, prek territorin bujqësor deri në Fier e Lushnje, i cili në rastin më të mirë nuk arrin më tepër se 50 m mbi nivelin e detit. Në një skenar të tillë, parapërgatitja duhet të jetë lokale dhe rajonale.

Analiza e mësipërme parashtron disa çështje me rëndësi për vizionin e ardhshëm të zhvillimit të rajonit dhe sigurisht edhe të bashkisë:

1. Çfarë karakteri do të kenë qendërsitë urbane të niveleve të ndryshme në rajon?
2. Cili është rrjeti i lëvizjes që i shërben më mirë rajonit nga pikëpamja e zhvillimit dhe lidhshmërisë dhe cila është hierarkia e tij?
3. Çfarë karakteri do të kenë korridoret e lëvizjes dhe cilat janë zonat e fashat e zhvillimit territorial në rajon?
4. Cili është vizioni për mbarështimin e zonave të mbrojtura natyrore?
5. Çfarë masash do të merren për të ndaluar çlirimin e mëtejshëm të ndotjes nga burimet përkatëse dhe depërtimin e saj në territor, veçanërisht në zonat më të rrezikuara, dhe si përkthehen këto masa në vizionin e zhvillimit të rajonit?
6. Cili është pozicionimi midis tre ekonomive të zhvillimit: bujqëssosë, turizmit dhe industrisë dhe si lidhet ky pozicion me vendimmarrjen për zgjerimin e fushës së shfrytëzimit të naftës në Patos-Marinzë dhe për ndërtimin e *landfill*-it në territorin e ish-Metalurgjikut në Elbasan
7. Si do të trajtohet sistemi rrugor rajonal në mënyrë që të mos promovojë zhvillim urban në dëm të tokës bujqësore dhe asaj natyrore?
8. Çfarë parapërgatitjeje mund të realizohet në nivel rajonal për të përballuar skenarët negativë të ndryshimeve klimatike?

Koncepti rajonal i zhvillimit bazohet mbi trajtimin e çështjeve të mësipërme. Ky koncept nuk mund të zgjidhë sfidën e balancës midis tre ekonomive pa një vendimmarrje kombëtare. Megjithatë, duke iu referuar edhe PPK-së, koncepti i vizionit rajonal ndërtohet si më poshtë:

i) **Rajoni mbërthen dy basene të rëndësishme lumore**, në të cilat (historikisht) lumi, si shtylla kurrizore e basenit, ka formuluar marrëdhënien e njeriut/vendbanimeve me natyrën. Pavarësisht se zhvillimet infrastrukturore kanë thyer disa nga pengesat natyrore, duke krijuar lidhje të shpejta të Tiranës me Elbasanin, apo Fierit me Tiranën, **rajoni Shkumbin-Devoll (përfshirë Osumin e Semanin), funksionon si një organizëm, që rrjedh nga lindja në perëndim.**

ii) **Rajoni përshkohet nga një rrjet kombëtar rrugësh**. Korridoret në të cilat rezulton ky rrjet **lidhin qendrat kryesore urbane, thyejnë pengesat natyrore** ose shfrytëzojnë terrenin/topografinë dhe i **japin formë karakterit ekonomik dhe përdorimit të tokës në rajon.** Kështu, Elbasani dhe Korça lidhen në sistem përmes **Korridorit VIII**, i cili shkurton kohën e udhëtimit Tiranë-Korçë edhe përmes segmentit Qukës-Pllogë. Ky korridor ka dy dalje ndërkombëtare-Qafë Thanën për në Maqedoni dhe Kapshticën për në Greqi. **Korridori (Boshti) qendror i jugut** lidh trinomin Kuçovë-Urë Vajgurore-Berat me Elbasanin, Tiranën dhe Sarandën, duke siguruar dalje të shpejtë në Greqi përmes pikave kufitare të Kakavijës dhe Qafë Botës. **Korridori i Kaltër paralel me atë të jugut** vendos në një aks të shpejtë Durrësin, Lushnjën, Fierin dhe Vlorën/Gjirokastrën, ndërsa ruan edhe daljen Fier-Memaliaj përmes luginës së Vjosës.

iii) Lidhja mes qendrave jo kryesore dhe e qendërsive urbane me qendra të nivelit të dytë fuqizohet përmes **akseve rajonale**. Akset rajonale **thyejnë pengesat psikologjike dhe fizike të lëvizjes duke respektuar topografinë dhe luginat e lumenjve**. Këto akse **depërtojnë diagonalisht në territor** dhe lidhen me akset kombëtare duke krijuar orbitale, të cilat rrethojnë zonat malore dhe krijojnë **mundësi aksesi e tranziti për vendbanimet e thella rurale në akset kombëtare. Korridoret rajonale janë boshti i efektit kaskadë të lëvizjes në territor**. Cërriku Gramshi e Maliqi lidhen përmes aksit rrugor (historik) që shtrihet përgjatë luginës së Devollit. Aksi Berat-Skrapar lë pas kanionet e Osumit dhe pasi kalon tangent parkun kombëtar të Bredhit të Hotovës (në veri të tij) bashkohet (duke shfrytëzuar topografinë) me aksin rajonal Korçë-Ersekë. Dy boshtet kombëtare veri-jug lidhen diagonalisht përmes akseve rajonale Ura Vajgurore-Lushnje dhe Ura Vajgurore-Fier.

iv) **Itineraret alternative natyrore/bujqësore/turistike janë zemra e profilit ekonomik të rajonit.** Këto itinerare nuk kanë për qëllim aksesin e shpejtë, por përkundrazi synojnë **të mbërthejnë banorët dhe vizitorët brenda rajonit, të rritin kohën e ndërveprimit të tyre me vlerat natyrore e historike të tij e të fuqizojnë rrjedhshmërinë e aktivitetit bujqësor brenda rajonit. Itinerari**

alternativ që lidh të gjithë rajonin fillon në Kashar përshkon luginën e Pezës dhe degëzohet në dy dalje, në jug të qytetit të Kavajës dhe në daljen perëndimore të qytetit të Peqinit. Më pas itinerari merr karakter fushor dhe pas një depërtimi drejt Vilë-Boshtovës deri në derdhjen e Shkumbinit në Adriatik (mbi lagunën e Karavastasë), kthehet drejt jugut në Divjakë e më pas në perëndim drejt Fier-Sheganit dhe rezervuarit të Murrizit (Thanës).


Itinerari devijon në veri dhe verilindje për të përshkuar Dumrenë deri në Belsh e më pas në Cërrik dhe Shirgjan, ku rifiton karakterin malor dhe depërton drejt Treganit (dhe Llixhave) për të dalë në Gramsh. Segmenti Gramsh-Çorovodë vijon përgjatë Tomoricës, në këmbët e parkut kombëtar të Malit të Tomorit, në lindje të tij. Nga ky moment, itinerari zbërthehet në drejtime të ndryshme për të depërtuar pjesën jugore të Shqipërisë. Ky itinerar **lidh vendbanimet rurale së bashku dhe me akset rajonale, lidh zonën funksionale bujqësore me atë të turizmit malor dhe ekologjik dhe bashkon burime të rëndësishme natyrore e historike me njëra tjetrën.** Të tjera itinerare alternative të rajonit (me të njëjtën natyrë, por më të shkurtra) janë ato Elbasan-Gjinar, Elbasan-Labinot Mal, Qukës-Valamare, Levan-Selenicë dhe Berat-Këlcyrë.

v) **Një rrjet i pasur zonash të mbrojtura natyrore** (një pjesë e të cilave ndodhen brenda Brezit të Gjelbër Evropian) mbështjellin si kurorë të gjithë rajonin, duke shërbyer edhe si kufizuesit natyrorë të tij dhe të dy baseneve lumore. Zonat fillojnë veri të Librazhdit, vijojnë gjatë kufirit lindor të rajonit dhe Shqipërisë, depërtojnë në brendësi të rajonit duke kulmuar me Malin e Tomorit dhe në perëndim përfaqësohen nga brezi Karavasta-Nartë përgjatë bregut të Adriatikut. Brenda rajoni ndodhen edhe një sërë zonash natyrore të mbrojtura (më të vogla në sipërfaqe se kurora mbështjellëse) si dhe qendërsi urbane me vlera historike e kulturore dhe monumente kulture. Për t`iu përgjigjur nevojës që ka Shqipëria për të rritur sipërfaqen e mbrojtur natyrore, në këtë rajon **fuqizohet lugina e Shkumbinit nga Dardhë-Xhyrë në Sopot dhe Gurin e Nikës, deri në Valamare, ndërsa zonave të mbrojtura aktuale u shtohen edhe sipërfaqet e identifikuara rreth tyre si zonat Emerald. I gjithë ekosistemi nga parku kombëtar i Karavastasë deri në atë të Vjosë-Nartë, lidhet si një brez i mbrojtur përgjatë bregut.**

vi) **Ruajtja e aseteve natyrore të rajonit në funksion të qëndrueshmërisë së zhvillimit aftësisë vetë-ripërtëritëse** është një nga objektivat kryesore të këtij koncepti rajonal të zhvillimit. **Bregdeti është një ndër këto asete dhe cilësia e vijës bregdetare është reflektim i shëndetit mjedisor dhe ekonomik të të gjithë rajonit.** Tokat bujqësore të kripëzuara nga jugu i Karavastasë deri në Pishë-Poro shpallen brez i mbrojtur natyror. Në këtë mënyrë ato i shtohen ekosistemit në ruajtje dhe evoluojnë drejt natyralizimit. Përveçse i shton rajonit dhe Fierit një territor të rëndësishëm për zhvillimin e eko-turizmit, ky brez krijon pengesën mbrojtëse mes tokave të Myzeqesë dhe detit dhe trajtohet në nivel kombëtar e vendor me projekte që zbutin erozionin detar dhe mbrojnë tokat bujqësore nga përmbytjet.


vii) **Sistemi bujqësor** që kufizohet nga Rrogozhina në veri, Belshi në veriperëndim, Kuçova e Berati në jug, Fieri në juglindje, depërton përgjatë Shkumbinit deri në Elbasan, dhe ka në qendër Lushnjën, është një nga më të rëndësishmit në Shqipëri. Ka sipërfaqen më të

Figura 69: Koncepti i zhvillimit të rajonit-rrjeti rrugor




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 70: Koncepti i zhvillimit të rajonit-korridoret e lëvizjes dhe hierarkia e qendrave



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 71: Koncepti i zhvillimit të rajonit-nënrajonet e lëvizjes



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


madhe dhe rendimentin më të lartë dhe ka krijuar mekanizma mbrojtës të tokës bujqësore nga fragmentimi urban, ndotja industriale dhe degradimi si pasojë e përmbytjeve dhe mirëmbajtja e sistemit të kullimit dhe ujitjes. **Ruajtja e tokës bujqësore të këtij rajoni është kryefjala e zhvillimit të tij dhe aktiviteti bujqësor fuqizohet përmes aplikimit të bujqësisë organike, konsolidimit të produkteve bujqësore** (në pamundësi të konsolidimit të fermave), **ndërtimit të tregjeve rajonale dhe mbështetjes kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe produktit shqiptar**.

viii) **Rritja inteligjente e zonës urbane dhe e qyteteve si motori i ekonomisë urbane** është një nga shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit. **Qendrat urbane rigjenerohen** përmes projektesh që kanë thelb: densifikimin përmes **mbushjes urbane;** krijimit të **rrjetit arterial të lëvizjes urbane**; **mbrojtjes** së hapësirës natyrore e bujqësore rrethqytetëse nga ndërtimet; krijimit **të zonave të shtrirjes së qytetit në 15-20 vitet** e ardhshme mbi bazën e projektimeve realiste të popullsisë dhe të bollshme për të lejuar zhvillime infrastrukturore e për të shmangur zhvillime të pakontrolluara dhe spekuluese mbi tregun e tokës.

Nga pikëpamja ekonomike qendrat urbane dhe vendbanimet krijojnë një rrjet që funksionon mbi parimin e plotësueshmërisë dhe konkurrueshmërisë. Elbasani evidentohet si një qendër e madhe urbane me karakter shumë-funksional, të ngjashëm me Tiranën, ku presioni për zhvillime urbane dhe ekonomike dikton densifikim dhe zgjerim e ku qytetarët plotësojnë të gjitha nevojat e tyre për shërbime (banim, arsim, kulturë, turizëm, industri, shëndetësi, etj.). **Fieri, Kuçova, Ura Vajgurore dhe Patosi janë qendra me karakter të shumëfishtë**, që lëviz nga prioriteti për zhvillimin e **industrisë, tek turizmi dhe bujqësia**, të gjitha **në një balancë funksionale** dhe ku Fieri përbën qendrën kulmore të kësaj fashe ekonomike. **Lushnja ka karakter të pastër bujqësor** nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, ndërsa qendra urbane e saj ofron shërbimet për të gjithë territorin e bashkisë. Duke ndjekur sa territorin bujqësor dhe atë natyror, **një rrjet qendërsish urbane** (të hierarkive të ndryshme për nga madhësia) **specializohet në ekonomi urbane të bazuara mbi (eko/agro) turizmin dhe më pak bujqësinë si bazë për zhvillimin rural të bashkive Divjakë, Belsh, Gramsh, Skrapar, Berat, Pogradec dhe Korçë.** Këto qendërsi urbane janë **porta hyrëse** për **parqet kombëtare** (zonat e mbrojtura), **brezin kodrinor të zhvillimit rural** (masivet e kodrave rrethuese me lartësi 150-300 me mbi nivelin e detit) dhe zonën malore që shtrihet nga Sopoti në Valamare e deri në Frashër. Veçanërisht **Berati e Korça** të vendosura në perëndim e lindje të kësaj zone malore, janë qendrat kryesore urbane **(porta të turizmit malor),** përmes të cilave aksesohet ky territor dhe që funksionojnë së bashku me të si një organizëm ekonomik e mjedisor.

ix) **Industria** zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e rajonit dhe bashkëjeton me funksionet e tjera të tij. **Balanca mes industrisë, bujqësisë dhe vlerave natyrore të rajonit është e një rëndësie jetësore për garantimin e aftësive vetëripërtëritëse të tij.** Fasha me gravitet ekonomik industrial ndodhet në pjesën jugore të sistemit kryesor bujqësor (me fokus industrinë e naftës), midis Fierit dhe Kuçovës, si dy polet e fashës dhe me një zgjatim drejt Ballshit. Territoret me funksion kryesor industrinë gjenden edhe në fushën e Bradasheshit brenda kufijve të zonës së ish-kombinatit metalurgjik të Elbasanit.

Figura 72: Koncepti i zhvillimit të rajonit-Ndërthurja e sistemeve dhe qendërsive



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Këto territore duhet të pastrohen nga ndotjet industriale të trashëguara nga e kaluara (territore të cilat ende nuk janë pastruar) dhe janë funksion të industrive prodhuese e përpunuese, me teknologji të pastër. Zgjerimi i territorit për kërkime në zonë naftëmbajtëse drejt Bubullimës është në tkurrje. Po kështu janë pastruar edhe të gjitha territoret e tjera industriale në Berat, Lushnje dhe Fier.

1.11 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME, ANALIZA *SWOT*

1.11.1 Përfundime dhe rekomandime

- Rezultat e analizave dhe studime të mëparshme tregojnë se ujërat e Shkumbinit nuk janë në nivelin e duhur mjedisor për përdorim në bujqësi dhe argëtim, sidomos pas kalimit të lumit në qytetin e Librazhdit e më tej. Ujërat e këtij lumi janë të ndotura thellë me metale të rënda. Ujërat e lumenjve duhet të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje.
- Ekziston mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së Lumit Shkumbin nga pengesat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et) në degëzimet e tij. HEC-et që ndërpresin Shkumbinin, në prodhim, në ndërtim, ose të projektuara, ndodhen jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë. Sipas riverwatch.eu[173], janë së paku 7 HEC-e ekzistuese, 7 në ndërtim dhe mbi 56 të planifikuara në Shkumbin dhe degët e tij furnizuese.
- Duhen krijuar nisma bashkëpunimi nga Bashkia Elbasan, me qëllim menaxhimin e integruar të basenit të Lumit Shkumbin.
- Nga të dhënat e fundit të Raportit të Gjendjes së Mjedisit për vitin 2014, problem për qytetin e Elbasanit dhe zonat përreth tij mbeten vlerat mbi normat e lejuara të grimcave PM_{10}, si dhe vlerat të NO_2, cilat janë shumë afër normës së lejuar, të cilat në periudha të ndryshme të vitit, por edhe të ditës mund të kalojnë vlerën e lejuar.
- Bashkia e Elbasanit përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore) të cilat përdoren për prodhimin e drithërave (grurit, misrit), pemëtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i përrenjve e lumenjve që përshkojnë territorin e bashkisë dhe më tej i bashkohen Shkumbinit.
- Përveç mbrojtjes së burimeve ujore, bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së degradimit të tokës që në Elbasan është dukuri e zakonshme për shkak të tokave të buta dhe me pjerrësi të theksuar. Kjo dukuri theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi nga banorët duke shkaktuar erozion, shkarje dhe shembje të tokës. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, rreziku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[174]. Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e Lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve[175].
- Bashkisë Elbasan është shumë e pasur me botë shtazore, e cila gjatë dy dekadave të fundit është dëmtuar si rezultat i gjuetisë së shfrenuara, ku shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes. Që kjo zonë të mos vazhdojë të humbët speciet e faunës, duhet të merren masa të forta për rehabilitimin e kafshëve të zhdukura. Disa nga këto masa mund të jenë ndërprerja e gjuetisë sportive për minimumi 5 vjet dhe rikrijimi i kushteve për afrimin e kafshëve dhe shpendëve të larguar për mungesë të këtyre kushteve në kohë dhe sistem.
- Zona e Elbasanit ka pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen lumenjtë, liqenet (zona e Dumresë), zona e mesme dhe e lartë malore, kodrat e ullinjve që rrethojnë qytetin, shkurret mesdhetare, pyjet gjethe gjerë, ato halore dhe përzierjet me kullota. Në të gjithë territorin e sotëm të bashkisë (pas reformës territoriale), ndodhen shumë zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme si, rezervate natyrore të menaxhuara, monumente kulture, monumente të natyrës, të cilat paraqesin një pasuri natyrore me potencial të lartë për zhvillimin e turizmit malor dhe atij kulturor.
- Sipas të dhënave të nxjerra nga kërkimet e shumta në lidhje me ngrohjen globale dhe efektet e saj në territor, edhe për Bashkinë Elbasan sektorët që do të preken më shumë janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore. Ujërat e Lumit Shkumbin që kalojnë në territorin e Bashkisë Elbasan, në kushtet e rritjes së nivelit do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë rrjedhës së tij apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e pengesave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të përkuar edhe nga erozioni lumor.
- Sasia e energjisë së konsumuar për ngrohje në Qarkun Elbasan është e lartë, 77% e NjFE-ve, përdorin drutë

e zjarrit për t'u ngrohur, 13 % përdorin gazin dhe 7% përdorin energjinë elektrike. Elbasani zotëron energji potenciale alternative si energjia gjeotermale dhe energjia e diellit që duhen konsideruar për t'u përdorur për të reduktuar konsumin e eneregjisë që përftohet nga uji dhe drutë e zjarrit.

- Kërkesa aktuale për ujë në Bashkinë Elbasan është 1,699 m³/orë, ndërkohë që sasia e ujit të prodhuar është 2,875 m³/orë, pra gati dyfishi i kërkesës, ky është një tregues i kapaciteteve të larta prodhuese të ujit të pijshëm. Një menaxhim më i mirë i shërbimit të ofruar do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.
- Fluksi i ushqimit tregon që në territorin e Elbasanit produktet bujqësore që kanë prodhime të larta janë drithërat perimet, foragjerët dhe drufrutorët. Sipas edhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme bujqësore janë drithërat, perimet e serave, fasulet, duhani, foragjerët, drufrutorët (vreshta, ullinj, pjeshkë). Prodhimi më të lartë nga produktet blegtorale e ka qumështi.
- PBB për frymë në Bashkinë Elbasan vlerësohet 25% më pak sesa PBB për frymë në nivel kombëtar. Në vlera absolute PBB e Elbasanit është 7.9% e PBB kombëtare. Qarku i Elbasanit është qarku i 4-t për sa i përket kontributit në PBB kombëtare.
- Sektori që ka VSHB me të lartë janë shërbimet 43.5% më pas është bujqësia me 34.1% dhe industria me 14.2% ndërsa produktivitetin më të lartë e ka sektori i industrisë.
- Në Bashkinë Elbasan ndodhen 7 pika grumbullimi nga të cilat 6 janë Njësinë Administrative Bradashesh dhe 1 në njësinë administrative Gjergjan, por është e nevojshëm që të propozohen pika grumbullimi dhe magazinimi në njësitë administrative që kanë karakter bujqësor, të cilat shtrihen kryesisht përgjatë luginës së Lumit Shkumbin.
- Në Bashkinë Elbasan operojnë rreth 5 tregje me një kapacitet prej 517 vende, të cilat janë përqendruar vetëm në qytetin e Elbasanit. Këto tregje janë të pamjaftueshme për të furnizuar qytetin e Elbasanit me produkte. Gjithashtu, vërehet mungesa e tregjeve më të vogla nëpër qendrat e njësive administrative.
- Njësitë ekonomike në Qarkun Elbasan janë të orientuar drejt shërbimeve dhe tregtisë ku 42.7% e subjekteve merren me tregti dhe 43.3% janë subjekte që kanë për bazë shërbimet e ndryshme. Situata është e përafërt dhe në Bashkinë Elbasan ku 45% e subjekteve merren me tregti dhe 41.4 % e subjekteve kanë për bazë shërbimet, ndërsa 10.7% e subjekteve janë industriale.
- Bashkia Elbasan është një ekonomi e orientuar drejt shërbimeve me 51.4 %, me pas bujqësia 27.7 % dhe industria me 20.9 %.
- Bujqësia është një ndër sektorët me peshën kryesore në ekonominë e Bashkisë Elbasan. Zonat që kanë më shumë përparësi në zhvillimin bujqësorë janë njësitë administrative përgjatë luginës së Lumit Shkumbin, duke qenë se kanë terren fushor.
- Aktivitetet kryesore ekonomike në Bashkinë e Elbasanit ndodhin përgjatë luginës së Shkumbinit. Për këtë situate ndikon aksi nacional Rrogozhinë-Elbasan-Pogradec që ndodhet në këtë luginë dhe i ofron akses të mirë këtyre zonave ekonomike.
- Sipas strukturës moshore të popullsisë së Bashkisë Elbasan rreth 69% e popullatës i përket grupmoshës (15-64) vjeç dhe 20% grupmoshës 19 vjeç, tregues këto që demonstrojnë së popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomikisht aktive.
- Përfshirja e popullsisë aktive në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.
- Procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Në ndarjen e popullsisë sipas gjinisë raporti meshkuj femra qëndron në raporte thuajse të barabarta. Pjesa më e madhe e popullsisë është përqendruar në qytetin e Elbasanit dhe në njësitë me terren të butë (fushor) dhe që kanë aksesueshmeri të mirë. Ndërsa zonat malore kanë numër më të vogël banorësh.
- Nga projeksionet e popullsisë të llogaritura mbi të dhënat e INSTAT, popullsia rezidente e Bashkisë Elbasan deri në vitin 2021 do të ketë një tregues të varësisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin "divident demografik".
- Për të përfituar nga ky "divident demografik", kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e vendor për të mundësuar arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.
- Bashkia e Elbasanit rezulton të jetë bashkia me

performancën më të lartë brenda qarkut të Elbasanit nëse analizohen tregues të tillë si niveli arsimor, cilësia e shërbimit shëndetësor, niveli i punësimit apo mirëqenia ekonomike.

- Aktualisht në Bashkinë Elbasan shërbejnë 97 kopshte, 127 shkolla 9-vjeçare, dhe 23 shkolla të mesme për një popullsi prej 144,382 banorë. Shpërhapja e këtyre institucioneve në të gjithë territorin mbetet një problem që ka nevojë të shqyrtohet. Gjithashtu, duhet përmirësuar infrastruktura fizike e institucioneve arsimorë, të cilat janë evidentuar si problematike.
- Është e nevojshme të ndërtohet të paktën një shkollë e mesme në çdo njësi administrative të Bashkisë Elbasan që nuk e ka një të tillë, si Bradshesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë dhe Tregan.
- Duhet të konsiderohet ndërtimi i një shkolle të mesme profesionale në rajonin 3 në qytetin e Elbasanit, pasi shkollat e mesme ekzistuese nuk e mbulojnë plotësisht këtë zonë me shërbim.
- Duhet vlerësuar situata në rajonin në rajonin 1 dhe 3 të qytetit të Elbasanit për të ndërtuar 2 shkolla 9-vjeçare në qytetin e Elbasanit, pasi në këto zona nuk ka shkolla 9-vjeçare. Për më tepër, ndërtimi i një shkolle 9-vjeçare në rajonin 1 do t'iu shërbente dhe banorëve të rajonit 6.
- Këshillohet që bashkia e Elbasanit të ndërmarri një studim më të thelluar të numrit ekzistues të fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç, shpërndarjes së tyre në territor dhe aksesit në kopshte dhe të ndërtohen kopshte në rast se rezulton të ketë nevojë.
- Të bëhet një inventarizim i hollësishëm i mjeteve didaktike ekzistuese në kopshte dhe shkolla dhe të kryhet pajisja e tyre sipas nevojave.
- Të përmirësohet infrastruktura fizike e institucioneve arsimore veçanërisht të kryhet rikonstruksion i plotë në shkollën 9-vjeçare Bodin, në NjA Gracen; në një kopsht dhe 2 shkolla 9-vjeçare Bradashesh; në 3 shkolla 9- vjeçare në Funarë (si në shkollën Preç e Poshtme, Cerujë, Kërrabë e Vogël); 2 kopshte dhe 1 shkollë fillore në Zavalinë, përkatësisht në Burrishtë dhe Kamiçan; 3 shkolla 9-vjeçare në Tregan (përkatësisht në Kaçivel, Kaçivel i Poshtëm dhe Shënavlash); 3 shkolla 9-vjeçare në Gjergjan (Gjergjan, Kodra Bujaras, Bujaras), etj. Në çdo njësi administrative të Elbasanit ka nevojë për rinkonstruksion të pjesshëm për një sërë shkollash dhe kopshtesh.
- Shpërndarja e punësimit sipas sektorëve tregon përqendrim më të lartë të punësimit në zonat urbane në industri dhe shërbime, përkundrejt bujqësisë si burimi kryesor i punësimit në zonat rurale.
- Shkalla e papunësisë në Bashki është 32.1 % dhe vërehet se ka pabarazi të theksuara në këtë tregues mes qytetit të Elbasanit (37.4 %) dhe 12 njësive të tjera administrative (me shkallë më të ulët të papunësisë
- Papunësia tek të rinjtë mbetet një nga problemet e menjëhershme për t'u trajtuar. Pjesa më e madhe e të punësuarve zotërojnë nivel arsimor bazë në zonat rurale dhe arsim të mesëm dhe të lartë në qytetin e Elbasanit.
- Bashkia duhet të ndërmarrë politika për zhvillimin e përgjithshëm dhe me rritmë të shpejta ekonomike.
- Në kushtet e territorit të ri, me disa qendërsi urbane dhe karakter të theksuar bujqësor dhe malor, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal është një hap urgjent për t`u ndërmarrë për bashkinë e Elbasanit.
- Është e nevojshme që Bashkia të nxisë rritjen e shpejtë të bizneseve private, duke ndjekur politika fiskale stimuluese, për të rritur nivelin e punësimit.
- Bashkia Elbasan duhet me prioritet të drejtojë forcën ekonomike aktive drejt arsimit dhe formimit profesional, në shërbim të tregut lokal të punës. Prioritet duhet t'i jepet kurseve dhe trajnime afatshkurtra të të rinjëve dhe forcimi i partneritetit publik-privatë në të gjitha sektorët ekonomik.
- Shërbimi shëndetësor ofrohet në Bashkinë Elbasan nga një spital rajonal, nga spitali kombëtar psikiatrik, nga 14 ambulanca dhe 81 qendra shëndetësore[176]. Edhe pse shpërndarja e këtyre institucioneve është relativisht e mirë dhe mbulon pjesën më të madhe të territorit, mungesa e stafit të nevojshëm mjekësor dhe shpërndarja jouniformë e tyre është një dukuri e theksuar pothuajse në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.
- Vdekshmëria foshnjore rezulton të jetë e lartë në të gjithë bashkinë dhe veçanërisht në zonat rurale. Rreth 6.3 % e popullsisë banuese në Bashkinë e Re të Elbasanit ose rreth 9100 persona kanë deklaruar se kanë të paktën një aftësi të kufizuar.
- Përgjithësisht, ambulancat dhe qendrat shëndetësore kanë një infrastrukturë fizike të dobët. Nevojitet ndërhyrja e menjëhershme për rikonstruksionin e tyre siç janë evidentuar në analizën social-ekonomike.
- Kategori si gratë dhe vajzat, të rinj me probleme sociale dhe persona me aftësi të kufizuar nuk asistohen nga institucione të posaçme të shërbimit social. Megjithatë, në Bashkinë Elbasan operojnë rreth 328 kujdestarë të shërbimeve sociale. Në këtë situatë këshillohet ndërtimi/forcimi i kapaciteteve të institucioneve ekzistuese për ofrimin e shërbimit përkatës social dhe ndërtimi i institucioneve të posaçme për ofrimin e

këtyre shërbimeve.

- Për përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimin shëndetësor është e domosdoshme rritja e numrit të ambulancave në mënyrë që të arrihet një tregues mesatar të paktën një ambulancë për rreth 6 mijë banorë, duke marrë në konsideratë edhe dendësinë e banimeve.
- Për të përmirësuar raportin mjek/banorë është prioritare rritja e numrit të mjekëve në shërbimin shëndetësor parësor, që i shërbejnë drejtpërdrejtë banorëve të Bashkisë së Elbasanit.
- Analiza e burimit të të ardhurave për NJFE tregon se afërsisht gjysma e familjeve që jetojnë Bashkinë Elbasan nuk siguron të ardhura nga puna e paguar ose vetëpunësimi, por nga shteti në formën e ndihmave sociale dhe pensioneve ose nga para të dërguara nga jashtë shteti, në formë remitancash.
- Duke marrë parasysh pabarazitë mes zonës urbane dhe asaj rurale të bashkisë, është i domosdoshëm zhvillim i njëtrajtshëm ekonomik me ritme të larta rritje për të gjithë bashkinë, por duke konsideruar karakteristikat e veçanta fizike, sociale dhe ekonomike për secilën njësi specifike.
- Rritja e punësimit dhe e trajnimi profesional i forcës punëtore shihen si masa prioritare për rritjen e mirëqenies ekonomike.
- Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë dhe me specifikisht ngritja e kapaciteteve bashkiake për të aplikuar për fonde, grante dhe programe, sidomos nga programet e Bashkimit Evropian për zhvillimin rural dhe rajonet më pak të zhvilluara shihet si prioritet.
- Përdorimin kryesor i tokës në Bashkinë Elbasan është kategoria natyrore dhe zë përafërsisht 72% të territorit. Gjithashtu toka bujqësore zë sipërfaqe të konsiderueshme duke u renditur e dyta me 21%. Ky është një faktor avantazhues për zhvillimin e bujqësisë.
- Në territorin e Elbasanit janë shumë të pranishme edhe përdorimet konfliktuale siç janë banim-industri, pranë zonës së metalurgjikut, pranë fabrikës së çimentos apo pranë ish fabrikës së drurit. Duhet të ndërmerren hapa për të shmangur mbivendosje të tilla dhe për të krijuar breza mbrojtës në rastet e nevojshme.
- Bashkia Elbasan shtrihet në një pozicion strategjik të favorshëm dhe në territorin e saj kalojnë rrugë të rëndësishme kombëtare si Korridori VIII. Pjesë e këtij korridori është dhe bajpasi i qytetit, i cili pritet të ndërtohet.
- Për sa i përket transportit ndërqytetës Bashkia e Elbasan ka lëvizshmëri më të lartë me qytetin e Tiranës dhe Lushnjës.
- Si pasojë e reformës territoriale, Bashkisë së Elbasanit i është shtuar sipërfaqja e rrugëve. Si pasojë në këtë bashki mbizotërojnë rrugët lokale, një pjesë e të cilave kanë nevojë për ndërhyrje përmirësimi infrastrukture dhe rehabilitim total në disa akse.
- Në rreth 39% të popullsisë që banon në zonën rurale të Bashkisë Elbasan, nuk ka sisteme të ndërtuara të furnizimit me ujë. Më problematike në drejtim të plotësimit të kërkesës për ujë paraqiten njësia administrative Gjinar, Shushicë, Tregan, Shirgjan, Gjergjan, Funarë, Gracen dhe Labinot Mal.
- Sistemi i largimit të ujërave të ndotura duhet rehabilituar në mjaft pjesë të tij duke përdorur teknologji të reja të materialeve dhe diametra që i përgjigjen sasisë së ujërave të zeza në funksion të numrit të popullsisë që derdhin ujërat në të.
- Duhet të jetë prioritet mundësia e ndarjes së sistemit të ujërave të shiut nga ato të zeza, për të cilat duhet ndërtuar impiant i pastrimit të tyre.
- Për zonën rurale të ndërtohen gropa septike në përputhje me standardet teknike sikurse dhe në zonat që është e vështirë të ofrohet shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura me sistem kanalizimesh.
- Për të ofruar shërbimin e grumbullimit të mbetjeve në të gjithë territorin duhet të hartoj një Plan për Menaxhimin e Mbetjeve, duke marr parasysh faktin që territorit të bashkisë ës vjetër i janë bashkuar edhe 13 ish-komuna.
- Objektiv i Bashkisë duhet të jetë edhe mbyllja graduale të gjitha vend depozitimet të hapura të mbetjeve dhe trajtimi i mbetjeve në impiantin e trajtimit të mbetjeve të ndërtuar tashmë.
- Bashkia Elbasan paraqet një nivel autonomie financiare të ulët, bazuar në të dhënat financiare për pesëvjeçarin 2010-2014. Burimet financiare orientohen më së shumti në mbulimin e shpenzimeve operative dhe pagave të personelit. Në këtë kontekst, intensifikimi i punës në ndërtimin e një strategjie gjithëpërfshirëse në administrimin e të ardhurave si dhe shfrytëzimi i aseteve në dispozicion/pronësi të Bashkisë do të ndikonte pozitivisht në kahun e të ardhurave. Në kahun e shpenzimeve, nevojitet një lloj ekonomizimi në përdorimin e burimeve financiare në dispozicion, duke përcaktuar përparësitë për investimet me ndikim të gjerë në jetën e komunitetit dhe territorit nën administrim dhe uljen e nivelit të shpenzimeve operative.

1.11.2 Analiza *SWOT*

PIKA TË FORTA

- Bashkia Elbasan ka një pozicion mjaft strategjik, vendoset në akset kryesore lidhëse kombëtare, përshkohet nga Lumi Shkumbin;
- Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon se 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 20% grupmosha (0-14) vjeç. Kjo tregon se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomikisht aktive;
- PBB në bashkinë e Elbasanit është 25% më i ulët se PBB në nivel kombëtar, që tregon se Bashkia Elbasan ka rëndësi në ekonominë kombëtare;
- Sektori kryesor që kontribuon në zhvillimin ekonomik (sipas numrit të të punësuarve) janë shërbimet me 51.4%. Në zonat rurale sektori kryesor u zhvillimit ekonomik është bujqësia (vetëpunësim);
- Industria është një nga sektorët me produktivitetin më të lartë 3.72 (sipas VSHB dhe numrit të punonjësve, analiza ekonomike), që do të thotë ka potencial për të rritur numrin e të punësuarve;
- Kulturat kryesore bujqësore janë drithërat dhe drurët frutorë;
- Raporti nxënës/mësues (për shkollat 9-vjeçare) është 13.89, i ngjashëm me standardet evropiane (11.8);
- Thuajse në të gjithë territorin ofrohet shërbimi i ujësjellës-kanalizimeve;
- Transporti Ndërqytetës ofrohet me të gjitha qendrat kryesore si: Tiranë, Librazhd, Lushnjë, Durrësin dhe brenda territorit me disa njësi administrative.

PIKA TË DOBËTA

- Vetëm 29.9% e popullsisë ka arsim të mesëm dhe vetëm 10.8% ka arsim të lartë, ndërkohë që në rang kombëtar 31.4% e popullsisë ka përfunduar arsimin e mesëm dhe 11.8% arsimin e lartë. Shkalla e analfabetizmit është në nivelin 3.5% krahasuar me 2.8% që është në nivel kombëtar;
- Mungesa e institucioneve arsimore (shkolla të mesme) në ish-komuna si Bradashesh, Gjergjan, Gracen, Shushicë, Tregan;
- Zonat rurale kanë mungesë të institucioneve arsimore;
- Shkalla e papunësisë në territorin e bashkisë (pas reformës territorial, 2014) është 32.1%. Niveli më i lartë i papunësisë është në qytetin e Elbasanit (bashkia e vjetër);
- Në njësinë e Elbasanit, 67.5% të rinj të moshave 15-24 vjeç janë të papunë (përveç Funarës (12 %), i njëjti trend konfirmohet për të gjitha njësitë e tjera);
- Afërsisht gjysma e popullsisë siguron të ardhura jo nga puna e paguar ose vetëpunësimi, por nga shteti në formën e ndihmave sociale dhe pensioneve ose nga para të dërguara nga jashtë shtetit;
- Rrugët rurale zënë një sipërfaqe prej 809.7 ha, ndërsa rrugët urbane vetëm 136.7. Disa prej rrugëve kanë nevojë për ndërhyrje infrastrukturore.

MUNDËSI

- Në bashkinë e Elbasanit ndodhen dhe 57 monumente kulture të kategorisë së parë dhe 16 monumente kulture të kategorisë së dytë;
- Prek dy zona të mbrojtura me legjislacion në kufirin lindor të tij. Kuturman- Qafë Bushi është një park kombëtar (zonë e mbrojtur, kategoria IV) të shpallur me Rregullore të Ministrisë së Brendshme. Zona e Sopotit dhe Stravajt janë shpallur rezervat natyror të menaxhuar/ park natyror;
- Sipërfaqja e tokave bujqësore është rreth 181km^2;
- Në zonat e Gracen, Tregan, Shushicë, dhe Papër do të ndërtohen stacione energjetikë eolike (me fuqinë e erës) me specifikat dhe vendndodhje të përcaktuara në Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 16.8.2013;
- Bashkia Elbasan shtrihet në një pozicion strategjik të favorshëm nga ana infrastrukturore, duke parë që në këtë territor kalon Korridori VIII dhe rrugë të tjera të rëndësisë kombëtare si: autostrada Tiranë-Elbasan, rruga SH7 Rrogozhinë-Elbasan dhe rruga SH3 rrethrrotullimi i metalurgjikut Librazhd. Gjithashtu bajpasi i qytetit është në ndërtim;
- Në Bashkinë e Elbasanit mbizotërojnë rrugët me peizazhe, të cilat ndodhen kryesisht në terren kodrinor dhe malor, e cila përbën një potencial turistik .

RREZIQE

- Sipas një trendi të llogaritur për projeksionin e popullsisë në periudhën 2015-2031, popullsia e bashkisë do të ketë një rënie më 1% në vit, si pasojë e migracionit të brendshëm;
- Institucionet arsimore, kryesisht në zonat malore kanë mungesë, gjendja e infrastrukturave është problematike. Nevoja për investime luhatet nga nevoja shumë të mëdha për ndërhyrje deri në nevoja prioritate për mirëmbajtje, apo rikonstruksion i plotë;
- Raporti mjek/ banorë është 1/1266, ndërkohë që standardi evropian është 1mjek/887banorë. Në Elbasan raporti mjek/ banorë është përafërsisht 4 herë më i ulët se mesatarja evropiane. Kjo vlerë rritet në ish-komuna rurale si Funarë, Gjergjan, Labinot –Fushë, Labinot-Mal, Papër, Shushicë ku raporti mjek banorë më shumë se 1/2500;
- Vdekshmëria foshnjore është 42 vdekje për 3894 lindje ose 10.8 vdekje për 1000 lindje, krahasuar me mesataren e BE-së, e cila është 3.7/1000 lindje;
- Hyrje-daljet e rrugëve janë një nga problemet kryesore (kryqëzimet e rrugëve vendore me rrugët ndërqytetëse kryesore). Gjithsej janë evidentuar 279 pika konfliktuale, të cilat ndikojnë numrin e aksidenteve.


2. VIZIONI I TË ARDHMES PËR ELBASANIN

Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë e Elbasanit është hartuar në mënyrë organike, si rezultat i gjetjeve të analizës së përgjithshme të territorit, diskutimeve me qytetarët, takimeve me grupe interesi dhe reflektime të grupit të punës gjatë studimit të kontekstit rajonal në të cilin ndodhet bashkia e hartimit të konceptit rajonal të zhvillimit. Po ashtu, vizioni i Elbasanit bazohet në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit, sipas prezantimeve publike të realizuara nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në dhjetor 2015. Mbi këto baza, pjesëmarrësit në diskutimet lokale, nën drejtimin e grupit të punës, kanë rënë dakord për vizionin strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Elbasanit gjatë 15 viteve të ardhshme, të formuluar si më poshtë:

Elbasani një qendër shumë-funksionalë përgjatë Korridorit IIIV dhe rrugës Egnatia, qytet me qëndrueshmëri të lartë në zhvillim ekonomik dhe social, duke ruajtur e rigjeneruar vlerat mjedisore të zonës dhe rajonit. Elbasani është një nyje e rëndësishme lidhëse ekonomike dhe infrastrukturore në rajon, në të cilën harmonizohen zhvillimi bujqësor e blegtoral dhe [eko]turistik me atë hapësinor dhe industrial. Elbasani e ndërton të ardhmen e tij dhe garanton zhvillimin e qëndrueshëm duke u mbështetur në një qeverisje të udhëhequr nga njerëzit dhe për njerëzit. Zhvillimi i territorit, urbanizimi i kontrolluar, krijimi dhe shfrytëzimi i drejtë i hapësirave publike stimulojnë një klimë të shëndetshme biznesi e konkurrence të pastër, në favor të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Mbrojtja dhe përdorimit efektiv i tokës [urbane dhe rurale], respektimi i mjedisit, kulturës, trashëgimisë natyrore dhe identitetit historik, janë baza për një jetesë të shëndetshme dhe aktive dhe mundësi të reja punësimi. Përmes qeverisjes së mirë dhe transparente, bashkia krijon kushte për integrim dhe ndërveprim social, duke nxitur socializimin dhe harmoninë e komunitetit për të mirën e përbashkët.


Bazuar në vizionin për zhvillimin e ardhshëm të Elbasanit, informacionit të analizuar në kapitujt paraardhës dhe prioriteteve të administratës publike dhe banorëve, janë përcaktuar objektivat strategjike të zhvillimit të territorit të bashkisë.

Figura 73: Harta e vizionit, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 74: Qendërsitë dhe fashat e Zhvillimit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

2.1 OBJEKTIVA DHE PROGRAME

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjikë, të cilët synojnë të orientojnë dhe specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen më tej dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm **ekonomik**, duke ruajtur **balancat mes sektorëve** të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur **konkurrencën e larminë** ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar **punësim** të vazhdueshëm.

Në studimin e rajonit, pjesë përbërëse e të cilit është dhe Bashkia Elbasan, kjo bashki paraqitet si një nga dy qendrat kulmore me karakter të shumëfishtë, ndërsa tjetra është Tirana. Po ashtu, në rajon ndodhen edhe një sërë qendrash të tjera më të vogla dhe plotësuese si Librazhdi, Kuçova, Ura Vajgurore, dhe Berati, profili ekonomik kryesor i të cilave përbëhet nga një ndërthurje e dy, ose më shumë sektorëve ekonomikë. Duke qenë kryesuese nga kjo pikëpamje, Bashkia e Elbasanit është mjaft interesante nga pikëpamja e konkurrueshmërisë ekonomike në nivel rajonal.

Modeli mbi të cilin do të mbështetet zhvillimi ekonomik dhe territorial i bashkisë është ai policentrik, me qëllim decentralizimin në mënyrë plotësuese të funksioneve të ndryshme në disa qendërsi gravitacionale në territor. Bërthama urbane e bashkisë, qyteti i Elbasanit, do të vazhdojë të ketë profilin e një ekonomie aglomeruese, me mundësi densifikimi veçanërisht përmes projekteve rigjeneruese dhe mbushjes urbane, ku do të përqendrohen funksionet administrative të bashkisë, zonat urbane të banimit, disa aktivitete ekonomike me karakter të përzier përfshirë turizmin dhe shërbimet. Është e rëndësishme që të konsolidohen sa më shumë lidhjet e kësaj bërthame

urbane me akset kombëtare të lëvizjes, si Korridori VIII apo boshti qendror i jugut.


Elbasani ka ende hapësirë për urbanizim brenda territorit ekzistues urban dhe kjo mund të realizohet përmes projekteve të mbushjes urbane, rigjenerimit urban dhe rizhvillimit. Në këtë kuadër, qendra e qytetit do të vazhdojë të ruajë rolin e saj administrativ me funksione tregtare dhe banim intensiv dhe me një zemër historike. Pra i gjithë ky zhvillim do të ecë krahas investimeve dhe kujdesit të veçantë për qendrën e qytetit si një qendërsi me karakter kulturor. Për ta realizuar këtë, çdo densifikim i qendrës do të ndodhë duke ruajtur balancat me qendrën historike dhe kulturore. Përmes këtij diversifikimi në format e zhvillimit, qendra e qytetit do të jetë më vibrante duke pasur nga një anë fluks qytetarësh që do të përdorin shërbimet administrative dhe tregtare e nga ana tjetër banorë dhe turistë të shumtë që do të gjallërojnë qendrën e vizitojnë kalanë.

Si zgjatim i qendrës së qytetit drejt Stadiumit "Ruzhdi Bizhuta" në pjesën lindore të tij krijohet një tjetër nyje me rëndësi për sa i përket mundësisë për të përqendruar banim intensiv të ndërthurur me biznese/shërbime tregtare dhe industri përpunuese (ushqimore). Kjo fashë bëhet e domosdoshme për densifikimin e mëtejshëm të qytetit të Elbasanit duke qenë se ofron mundësi të mëdha për sa i përket sipërfaqeve të mëdha dhe ndërtesave ish industriale të papërdorura në mënyrë efikase deri më sot. Në këtë fashë ka mjedise çlodhëse dhe argëtuese, siç janë, Parku Rinia dhe Stadiumi, çka tregon se i ka të gjitha potencialet për të ofruar mundësi të reja për ekonominë lokale.

Për këtë objektiv strategjik janë parashikuar katër programe strategjike të cilat paraqiten më poshtë. Projektet për çdo program paraqiten në planin e veprimit në kapitullin në vijim.

- *Programi Strategjik O1P1:* Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë së rëndë dhe asaj të përpunimit në zonën e Metalurgjikut, duke nxitur përdorimin e energjisë së rinovueshme. *(Figura 74, qendërsia 18)*
- *Programi Strategjik O1P2:* Nxitje e sipërmarrjes private dhe biznesit për të rivitalizuar me aktivitetin e tyre ish-zonat industriale/ ekonomike të Elbasanit në bashkëpunim me Bashkinë si negociator kryesor për të rigjeneruar edhe hapësirën publike me anë të instrument të menaxhimit të tokës.
- *Programi Strategjik O1P3:* Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzistuese urbane të njësive administrative.
- *Programi Strategjik O1P4:* Mbështetje, marketim, promovim, përmirësim klime dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.
- *Program Strategjik O1P5:* Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Elbasanit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve.

Figura 75: Skema e Zhvillimit Ekonomik



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja dhe rigjenerimi i **burimeve natyrore** si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet **turizmit natyror dhe kulturor.**

Përtej rolit të bashkisë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore/ushqimore, edhe turizmi merr rëndësi si një sektor kyç për zhvillimin urban dhe rural. Ndërthurja e aktiviteteve të turizmit historik me atë natyror dhe bujqësor në qendrat rurale do të jetë strategjia kryesore përmes së cilës do të synohet rimëkëmbja e ekonomive lokale të njësive administrative dhe promovimi i turizmit në të. Pasuritë e mëdha natyrore, të ndodhura në pothuajse 70% të sipërfaqes së bashkisë, do të mbrohen nëpërmjet instrumenteve të menaxhimit të tokës, por dhe do të përdoren si "joshës" për aktivitete që krijojnë të ardhura për banorët e zonës.

Për të shmangur katastrofat mjedisore në të ardhmen (përfshirë ato që mund të lindin si pasojë e ndryshimeve klimatike, rrëshqitjeve të tokës, erozionit, përmbytjeve nga lumi, etj.) si dhe për të zbutur problemet ekzistuese, Bashkia Elbasan e rendit mbrojtjen dhe rehabilitimin e

aseteve natyrore si një nga objektivat strategjikë të saj. Përmes programeve strategjike dhe projekteve përkatëse do të synohet rehabilitimi mjedisor i burimeve ujore (veçanërisht lumenjtë), si një nga aspektet mjedisore më delikate dhe më të prekura nga zhvillimi në bashki. Këto programe do të synojnë jo vetëm rigjenerimin e burimit ujor, por edhe zbutjen e mundësisht eliminimin e burimeve ndotëse.


- *Programi Strategjik O2P1:* Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet dhe dalja e vazhdueshme e lumit Shkumbin nga shtrati duke rehabilituar argjinaturat ekzistuese.
- *Programi Strategjik O2P2:* Rehabilitimi i shtretërve, brigjeve lumore dhe zonave riapariane të Shkumbinit, Zaranikës, Manazderes, Paprit, Gostimës dhe Gostrimës.
- *Program Strategjik O2P3:* Përmirësimi i infrastrukturës (nëntokësore) të ujësjellësit dhe KUZ.
- *Programi Strategjik O2P4:* Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale.
- *Programi Strategjik O2P5:* Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.
- *Programi Strategjik O2P6:* Zbutja e efekteve mjedisore nga aktiviteti industrial.
- *Programi Strategjik O2P7:* Hartimi dhe vënia në jetë e planit sektorial për turizmin në nivel bashkie.
- *Programi Strategjik O2P8:* Rrjetëzim i aseteve historike.
- *Programi Strategjik O2P9:* Mbështetja me infrastrukturat e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësitë administrative Tregan, Gjinar, Labinot Mal, Funarë dhe Gracen.

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i **infrastrukturës së lëvizjes** me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë e Elbasanit

Në synojmë që Elbasani të kthehet në një bashki policentrike. Një vizion i tillë zhvillimi kërkon një mbështetje të mirë infrastrukturore dhe menaxhim të zgjuar të mobilitetit dhe transportit publik. Një mënyrë e tillë zhvillimi është një mbështetje e fortë për secilin sektor të ekonomisë, të zonave urbane dhe për mjedisin në të njëjtën kohë.

- *Programi Strategjik O3P1:* Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane me qytetin e Elbasanit.
- *Programi Strategjik O3P2:* Konsolidimi i unazës së madhe të bashkisë Elbasan e cila do të ndihmojë në uljen e trafikut ndërqytetës në qytet.

Figura 76: Skema natyrore dhe zhvillimi i turizmit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

- *Programi Strategjik O3P3:* Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive dhe lidhjes së këtyre qendrave me njëra tjetrën.
- *Programi Strategjik O3P4:* Intensifikimi i zhvillimit në njësitë administrative përreth unazës së madhe të bashkisë Elbasan, si satelite urbane të qytetit të Elbasanit apo fasha në vazhdim të tij.
- *Program Strategjik O3P5:* Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës, stacioni multimodal dhe stacioni për transportin e mallrave.
- *Program Strategjik O3P6:* Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës brenda Bashkisë Elbasan duke bërë ndërhyrje pikësore dhe për stacionet e autobusëve/ furgonë përgjatë rrugëve lidhëse.
- *Program Strategjik O3P7:* Rregullimi i trafikut të qytetit duke rehabilituar dhe trajtuar me projekte të veçanta rregullimin e rrethrrotullimeve/ kryqëzimeve kryesore në qytet.
- *Program Strategjik O3P8:* Nxitja e investimeve publike dhe private në fushën e mobilitetit të gjelbër *(Green Mobility)* për rrjetin e këmbësorëve dhe të biçikletave, itineraret natyrore dhe rekreative.

Objektivi Strategjik 4: Nxitje e sektorit të **bujqësisë dhe blegtorisë**, si sektorë kyç për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe rritjes së punësimit, dhe veçanërisht për fuqizimin e zhvillimit rural.

Burimet natyrore dhe historike të bashkisë, së bashku me pozicionimin e saj strategjik, krijojnë kushtet për të orientuar zhvillimin drejt konsolidimit të sektorëve të bujqësisë dhe turizmit natyror. Për sa i përket sektorit të bujqësisë, plani

i territorit dhe plane të mëtejshme sektoriale zbatimi, duhet të përcaktojnë mirë mënyrat e zhvillimit të territorit më funksion mbrojtjen e tokës bujqësore, sidomos asaj me kategori boniteti dhe përshtatshmëri të lartë; duke orientuar drejt zgjidhjes në këtë mënyrë edhe konfliktin me industrinë, sidomos në fushën e Elbasanit, por dhe në zonat kodrinore. Po ashtu, duhet të parashikohen investime në infrastrukturat kulluese-ujitëse, magazinuese-grumbulluese,

Figura 77: Skema e Lidhjeve Infrastrukturore



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

përpunuese dhe tregtuese të produkteve bujqësore, për të përmirësuar të gjithë zinxhirin e prodhimit. Përveç pikave ekzistuese të grumbullimit të produkteve bujqësore, do të nxitet sektori privat për krijimin e strukturave magazinuese dhe tregjeve të shumicës për produktet ushqimore në disa qendërsi të pozicionuara në periferi të qytetit të Elbasanit.

- *Programi Strategjik O4P1:* Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.
- *Programi Strategjik O4P2:* Programimi dhe hartimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës, të cilat do të orientojnë zhvillimet që nuk i shërbejnë sektorit të bujqësisë, jashtë sipërfaqeve me Kategori Bazë të përdorimit të tokës të propozuar B. Bujqësi, me qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore.
- *Programi Strategjik O4P3:* Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, kooperativa, qendra informimi, tregje javore, etj.) përmes shfrytëzimit të aseteve publike dhe private në skema të partneritetit publik-privat (PPP).

Objektivi strategjik 5: Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social.

Arsimi dhe shëndetësia do të qëndrojnë gjithmonë si dy kritere nëpërmjet së cilës bashkia jonë do të mund të sigurojë një mirëqenie sociale për banorët e saj kudo qofshin ata në territorin e bashkisë. Konsideratat e kësaj strategjie për sektorin e strehimit, shkojnë përtej ndarjes së funksioneve mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore, duke ngritur nevojën për ndërhyrje për realizimin e të cilave kërkohet krijimi i partneriteteve solide mes nivelit vendor dhe atij qendror dhe duke e parë ngushtësisht të lidhur dhe me sektorin privat për projekte të mundshme PPP.

- *Programi Strategjik O5P1:* Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale.
- *Programi Strategjik O5P2:* Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ ambulancave në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.
- *Programi Strategjik O5P3:* Çelja e disa departamenteve të arsimit të lartë publik në Bashkinë Elbasan, kryesisht me fokus mjekësinë dhe profesioneve të inxhinierisë.
- *Programi Strategjik O5P4:* Në mbështetje të dhe të politikave kombëtare të ministrisë; nxitje për arsimin profesional, përmes investimeve në tre shkollat profesionale ekzistuese dhe një të reje në Bashkinë e Elbasanit.
- *Programi Strategjik O5P5:* Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Elbasan.
- *Programi Strategjik O5P6:* Mbështetje e gjithë shtresave të popullsisë për një strehim sa më të përballueshëm dhe me kushte optimale jetese në territorin e Bashkisë Elbasan.

2.2 KONSIDERATA FINANCIARE

Bashkia e re Elbasan, ndonëse renditet e treta në vend për nga niveli i të ardhurave të gjeneruara nga burimet e veta[177], paraqet një nivel të ulët autonomie financiare gjatë pesë viteve të konsideruara. Mesatarja e raportit të të ardhurave të veta ndaj të ardhurave totale rezulton të jetë 21.6% për periudhën 2010-2014. Këto të ardhura

arrijnë të mbulojnë mesatarisht 19.8% të shpenzimeve totale të realizuara gjatë periudhës së konsideruar. Nëse në të ardhurat e veta do të shtonim edhe të ardhurat nga taksat e ndara dhe transferta e pakushtëzuar, burimet totale në dispozicion të bashkisë do të përfaqësonin mesatarisht 44.5% të të ardhurave totale dhe mesatarisht do të mbulonin 41.2% shpenzimeve totale. Në vijim të ndarjes së re administrative-territoriale dhe ligjit të ri për vetë-qeverisjen vendore, Bashkia e re e Elbasanit përballet me sfidën e menaxhimit burimeve financiare të kufizuara përkundrejt nevojave gjithmonë rritje për shërbime dhe investime kapitale. Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në kahun e të ardhurave (veçanërisht rritja e bazës së tatueshme dhe tatimpaguesve) si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato administrative dhe operative). Ligji ri për buxhetin vendor të viti 2016 solli disa risi në kuadrin nivelit, llojit dhe numrit të taksave. Përgjithësisht, në periudhën afatshkurtër efektet e heqjes së disa taksave dhe futjes/modifikimit të disa të tjera vlerësohet të do të baraspeshojnë njëra tjetrën duke u përkthyer në një efekt pothuajse neutral për buxhetin vendor.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiare si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pasi të jenë qartësuar asetet në pronësi të bashkisë përdorur në kolateralizimin e kredive); fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH, etj.) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës; fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfW, WBIF, etj.) për çështje që lidhen me trajtimin i mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

3.1 PLANI I VEPRIMIT

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën e larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.						**Fazat e zbatimit**			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O1P1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë në zonën e Metalurgjikut	Hartimi i PDV-së së Polit ekonomik 18, pranë zonës së ish-kombinatit metalurgjik		Bashkia Elbasan	Ministria e Zhvillimit Urban	Dokumenti i PDV-së i hartuar				
	Studim fizibiliteti për instalimin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike, në Bashkinë Elbasan		Bashkia, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, FZHR	FSHZH, donatorë të ndryshëm	Studimi i fizibilitetit i hartuar				
	Studimi i fizibiliteti për rehabilitimin dhe rigjenerimin e zonës së ish-fabrikës së konservimit dhe zonës së metalurgjikut		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm (Banka Botërore)	Studimi i fizibilitetit i hartuar				
O1P2: Nxitje e sipërmarrjes private dhe biznesit për të rivitalizuar me aktivitetin e tyre ish-zonat industriale/ ekonomike të Elbasanit në bashkëpunim me Bashkinë si negociator kryesor për të rigjeneruar edhe hapësirën publike me anë të instrument të menaxhimit të tokës	Rigjenerimi i hapësirave industriale brenda qytetit të Elbasanit		Bashkia Elbasan	FSHZH, donatorë të ndryshëm	Funksione të ndryshme në zonat ish-industriale				
O1P3: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzistuese urbane të njësive administrative	Rigjenerimi dhe rivitalizmi i qendrave të Njësive Administrative		Bashkia Elbasan	Ministria e Zhvillimit Urban	Funksione dhe aktivitete të ndryshme në qendrat e Njësive Administrative me				

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën e larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.						Fazat e zbatimit			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O1P4: Mbështetje, marketim, promovim, përmirësim klime dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale	Konsolidimi i fashës me karakter ekonomik-bujqësor (SME) në segmentin Cërrik-Shirgjan		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Vendosja e bizneseve të vogla dhe të mesme në segmentin Cërrik-Shirgjan				
O1P5: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Elbasanit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve	Ofrimi i Zonave, hapësirave rekreative dhe argëtuese për banorët e qytetit në polet e zhvillimit 3, 4, 5 dhe 14		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Shtimi i hapësirave të gjelbra në Elbasan				

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor.						Fazat e zbatimit			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O2P1: Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet dhe dalja e vazhdueshme e lumit Shkumbin nga shtrati duke rehabilituar argjinaturat ekzistuese	Rehabilitimi i shtratit të lumit Shkumbin dhe risistemimi i zonave përgjatë tij		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Argjinaturat përgjatë shtratit të lumit Shkumbin dhe vendosja e hpësirave të gjelbra				
O2P2: Rehabilitimi i shtretërve, brigjeve lumore dhe zonave riapariane të Shkumbinit, Zaranikës, Manazderes, Paprit, Gostimës dhe Gostrimës	Menaxhimi i integruar i lumit Shkumbin		Bashkitë nëpër të cilat kalon lumi Shkumbin, Ministria e Mjedisit	Donatorë të ndryshëm (USAID, KfW)	Pastrami i shtratit të lumit dhe ulja e ndotjes së ujërave				
	Rehabilitimi i shtratit të lumenjve Zaranika, Manazderes, Papër, Gostrimë dhe Gostimë nëpërmjet pastrimit të shtratit dhe shmangien e hedhjes së mbetjeve		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm (USAID, Banka Botërore)	Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe vendosja e argjinaturave				
O2P3: Përmirësimi i infrastrukturës (nëntokësore) të ujësjellësit dhe KUZ	Përmirësimin dhe shtimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Elbasan		FZHR, Bashkia dhe ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimeve	FSHZH, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, donatorë të ndryshëm	Mbulimi i territorit të bashkisë me sistemin e kanalizimeve				
	Ndërtimi i ujësjellësit të ri të Fushë Buallit në Bashkinë Elbasan		FZHR, Bashkia dhe ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimeve	FSHZH, donatorë të ndryshëm	Mbulimi i territorit të bashkisë me shërbimin e ujësjellësit				
O2P4: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale	Hartimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave		Bashkia Elbasan	Ministria e Mjedisit, Donatorë të ndryshëm	Masat parandaluese për prerjen e pemëve				
O2P5: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane	Programi për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Elbasan		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm (WBIK, Banka Botërore)	Grumbullimi i mbetjeve urbane në të gjithë territorin				

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor.						Fazat e zbatimit			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O2P6: Zbutja e efekteve mjedisore nga aktiviteti industrial	Rehabilitimi i vend depozitimit ekzistues		Bashkia Elbasan	Ministria e Mjedisit, Donatorë të ndryshëm	Ulja e ndotjes në tokë dhe ajër në zonën e venddepozitimit				
	Krijimi i zonave tampon për të shmangur ndotjen që mund të shkaktohet nga impianti i djegies		Bashkia Elbasan	Ministria e Mjedisit, Donatorë të ndryshëm	Mbjellja e pemëve dhe shtimi i hapsirave të gjelbëruara				
O2P7: : Hartimi dhe vënia në jetë e planit sektorial për turizmin në nivel bashkie	Përcaktimi i itinerareve dhe destinacioneve tërheqëse për turizmin në qytet në zonat kodrinore-malore duke krijuar një kalandra ngjarjesh vjetore		Bashkia Elbasan	Ministria e Kulturës	Lidhja e zonave turistike me qytetin e Elbasanit				
	Përmirësimi i ofrimit të shërbimit tregtar, hotelier dhe informacionit për turistët në pikat e turistike		Bashkia Elbasan	Ministria e Kulturës	Ndërtimi i hoteleve dhe restoraneve në zonat turistike				
O2P8: Rrjetëzim i aseteve historike	Hartëzimi i aseteve historike të bashkisë		Bashkia Elbasan	Ministria e Kulturës	Krijimi i hartave me vendndodhjen e zonave historike				
	Publikimi i broshurave promovuese për turizmin historik, natyror dhe kulturor të Bashkisë Elbasan		Bashkia Elbasan	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Printimi i broshurave promovuese				
	Identifikimi i nevojave për ndërhyrje restauruese në asetet historike dhe hartimi i projekteve teknike		Ministria e Kulturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Marrja e masave për restaurimin e aseteve historike				
	Zbatimi i projekteve restauruese për asetet historike		Ministria e Kulturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, FZhR, Donatorë të ndryshëm	Restaurimi i aseteve historike				

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë e Elbasani						**Fazat e zbatimit**			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O3P1: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane me qytetin e Elbasanit	Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Bashkinë Elbasan, rrugët që lidhin njësinë administrative me qendrën e qytetit Elbasan		FZHR, Bashkia Elbasan	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Ndërtimi i rrugëve që lidhin zonat rurale me qytetin e Elbasanit				
	Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimin e urave në Bashkinë Elbasan				Ndërtimi i urave në lumin Shkumbin				
O3P2: Konsolidimi i unazës së madhe të bashkisë Elbasan e cila do të ndihmojë në uljen e trafikut ndërqytetës në qytet	Ndërtimi i bajpasit të qytetit të Elbasanit		FZHR, Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i ***bypass***				
	Përfundimi i segmentit të korridorit 8 që kalon në territorin e Bashkisë Elbasan		Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i rrugës që është pjesë e korridorit 8				
	Ndërtimi i boshtit të jugut, segmentit që kalon në Bashkinë Elbasan		Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i rrugës që është pjesë e boshtit të jugut				
O3P3: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive dhe lidhjes së këtyre qendrave me njëra tjetrën	Ndërtimi dhe rehabilitim i dy akseve rrugore që lidhin Treganin me Gjinarin		Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme rrugore				
O3P4: Intensifikimi i zhvillimit në njësitë administrative përreth unazës së madhe të bashkisë Elbasan, si satelite urbane të qytetit të Elbasanit apo fasha në vazhdim të tij	Nxitja e bizneseve të vogëla dhye të mesme për tu zhvilluar në NjA që preken nga unaza e madhe e Elbasanit		Bashkia Elbasan Ministria e Zhvillimit Urban	Biznese të vogëla dhe të mesme	Hapja e SME-ve në NjA				

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë e Elbasani						Fazat e zbatimit			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O3P5: Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës, stacioni multimodal dhe stacioni për transportin e mallrave	Programi për zhvillimin e transportit automobilistik, ndërtimi i stacionit intermodal		FZHR, FSHZH, donatorë të ndryshëm	Bashkia Elbasan	Ndërtimi i Stacionit intermodal				
	Programi për zhvillimin e transportit automobilistik, (Rapid Bus Transit)		FZHR, PPP, Bashkia	FSHZH, donatorë të ndryshëm	Ndërtim i linjës së dedikuar për RBT				
	Programi për zhvillimin e transportit hekurudhor në Bashkinë Elbasan		FZHR, Hekurudha Shqiptare, PPP	FSHZH, Bashkia, donatorë të tjerë	Funksionimi i transportit hekurudhor për njerëzit dhe mallrat				
O3P6: Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës brenda bashkisë Elbasan duke bërë ndërhyrje pikësore dhe për stacionet e autobusëve/ furgonë përgjatë rrugëve lidhëse	Ofrimi i shërbimit të transportit urban në të gjithë territorin e Bashkisë		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Vendosja e linjave të transportit urban me të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan				
O3P7: Rregullimi i trafikut të qytetit duke rehabilituar dhe trajtuar me projekte të veçanta rregullimin e rrethrrotullimeve/ kryqëzimeve kryesore në qytet	Projekti për përmirësimin e kryqëzimeve rrugore në Bashkinë Elbasan		Bashkia Elbasan, FZHR, FSHZH	Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i nënkalimeve apo mbikalimeve në kryqëzimet problematike				
	Shtimi i zonave të parkimeve publike në qytetin e Elbasanit		Bashkia Elbasan, FZHR	Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i zonave të parkimeve publike				
O3P8: Nxitja e investimeve publike dhe private në fushën e mobilitetit të gjelbër (Green Mobility) për mjetin e këmbësorëve dhe të biçikletave, itineraret natyrore dhe rekreative.	Krijimi i zonave rekreative përgjatë shtratit të lumit Shkumbin, për të ofruar hapësira çlodhëse për banorët		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Shtimi i hapësirave të gjelbëra dhe rekreative përgjatë lumit Shkumbin				
	Rehabilitimi i parkut të qytetit, Krasta		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Vendosja e stolave dhe elementeve të tjera urbane në parkun e Krastës				
	Krijimi i kalimeve për biçikleta dhe këmbësorë, dhe itinerareve natyrore		Bashkia Elbasan	Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i korsive të biçikletave dhe rrugëve të këmbësorëve				

Objektivi Strategjik 4: Nxitje e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, si sektorë kyç për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe rritjes së punësimit, dhe veçanërisht për fuqizimin e zhvillimit rural.						Fazat e zbatimit			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O4P1: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan	Hartimi i planit për rehabilitimin e kanaleve kulluese		Bashkia Elbasan	MBZHRAU	Plani për rehabilitimin e kanaleve kulluese				
	Rehabilitimi i Kanaleve Kulluese në zonat problematike		Bashkia Elbasan	MBZHRAU	Përmirësimi i kanaleve kulluese në zonat problematike				
O4P2: Programimi dhe hartimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës, të cilat do të orientojnë zhvillimet që nuk i shërbejnë sektorit të bujqësisë, jashtë sipërfaqeve me Kategori Bazë të përdorimit të tokës të propozuar B. Bujqësi, me qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore	Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore, në një nga njësitë strukturore të përcaktuara nga PPV-ja		USAID	Ministria e Zhvillimit Urban	Dokumenti i projektit pilot për mbrojtjen e tokave bujqësore				
	Përhapja e modelit të hartuar në projektin pilot në njësi të ngjashme strukturore		Bashkia Elbasan	Ministria e Zhvillimit Urban	Hartimi i projekteve të për mbrojtjen e tokave në njësitë strukturore që kanë karakter bujqësor				
O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, kooperativa, qendra informimi, treg rajonale, tregje javore, etj.) përmes shfrytëzimit të aseteve publike dhe private në skema të partneritetit publik-privat (PPP)	Mbyllja e procesit të inventarizimit dhe hartëzimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki		Bashkia Elbasan	ALUIZNI	Krijimi i një baze të dhënash GIS për pronat publike				
	Përfundimi i procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki		Bashkia Elbasan	ALUIZNI	Regjistrimi i pronave publike pranë ZRPP				
	Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore		MBZHRAU	FSHZH	Vënia në funskion e këtyre aseteve				
	Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat e përshtatshme		FZHR, Bashkia Elbasan	FSHZH, donatorë të tjerë	Hapja e tregjeve dhe pikave të grumbullimit				

Objektivi Strategjik 5: Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social.						Fazat e zbatimit			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale	Përmirësimi i infrastrukturës së spitalit rajonal dhe plotësimi i nevojave i nevojave sanitare		Ministria e Shëndetësisë	Donatorë të ndryshëm	Zgjedhimi i spitalit rajonal dhe pajisja me teknologjinë e nevojshme				
O5P2: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ ambulancave në të gjitha Njësitë Administrative	Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në Njësitë Administrative Bradashesh, Papër, Gracen, Tregan, Shushicë, Zavalinë		Bashkia Elbasan	Ministria e Shëndetësisë	Rehabilitimi i qendrave shëndetësore				
O5P3: Çelja e disa departamenteve të arsimit të lartë publik në Bashkinë Elbasan, kryesisht me fokus mjekësinë dhe profesioneve të inxhinierisë	Ndërtimi i infrastrukturave të nevojshme për çeljen e programeve të arsimit të lartë publik		Bashkia Elbasan	Ministria e Arsimit Dhe Sportit, Donatorë të ndryshëm	Rritja e nivelit të arësimit në Bashkinë Elbasan				
O5P4: Në mbështetje të politikave kombëtare të ministrisë; nxitje për arsimin profesional, përmes investimeve në tre shkollat profesionale ekzistuese dhe një të reje në Bashkinë e Elbasanit	Ndërtimi i një shkolle profesionale në qytetin e Elbasanit		Bashkia Elbasan	Ministria e Arsimit Dhe Sportit, Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i shkollës profesionale				
O5P5: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në të gjitha njësitë administrativë të Bashkisë Elbasan	Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave 9-vjeçare në Gracen, Tregan dhe Gjergjan		Bashkia Elbasan	Ministria e Arsimit Dhe Sportit, Donatorë të ndryshëm	Ofrimi i mësimdhënies brenda standardeve të nevojshme				
	Ndërtimi i shkollave të mesme (Bradashesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë, Tregan)		Bashkia Elbasan	Ministria e Arsimit Dhe Sportit, Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i shkollave në zonat që nuk ka				

Objektivi Strategjik 5: Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social.						Fazat e zbatimit			
Programe Strategjike	**Projektet**	**Vlera**	**Burimi i mundshëm kryesor**	**Burimi i mundshëm dytësor**	**Tregues vlerësimi**	**I: '16-18'**	**II: '19-20'**	**III: '21-25"**	**IV: '25-30'**
O5P6: Mbështetje e gjithë shtresave të popullsisë për një strehim sa më të përballueshëm dhe me kushte optimale jetese në territorin e bashkisë Elbasan	Hartimi i një Plani Sektorial mbi Strehimin për Bashkinë Elbasan		Bashkia Elbasan	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Plani për strehimin e personave në nevojë				
	Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës për të mundësuar strehimin social.		Bashkia Elbasan	Ministria e Zhvillimit Urban	Përcaktimi i zonës së përshtatshme për ndërtimin e banesave sociale				
	Evidentimi i shtëpive dhe vendbanimeve që mund të jenë subjekt i shpërnguljes dhe ricaktimit të banesave për ta, për shkak të rrezikshmërisë së katastrofave natyrore dhe investimeve në infrastruktura madhor		Bashkia Elbasan	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Ndërtimi i banesave sociale				

3.2 SISTEMET E TERRITORIT

Një nga ndikimet kryesore që strategjia e territorit, plani dhe projektet strategjike sjellin në territor, është ndryshimi i mundshëm i sistemeve të territorit. Nëse në nivel planesh territoriale përgjithësisht sigurohemi që të krijojmë përdorime toke të përputhshme me njëra-tjerën, në nivel strategjik duhet të kuptohet edhe mundësia e ndryshimit të sistemeve territoriale (bujqësore, natyrore, ujërat, urbane dhe infrastrukturore), për dy arsye: 1) për të kuptuar efektet afatgjata të strategjisë dhe planit në çdo aspekt (territorial, mjedisor, social dhe ekonomik); 2) për të kuptuar, parashikuar dhe rregulluar efektet e sektorëve të ndryshëm mbi njëri-tjetrin dhe si rezultat për të marrë masa ligjore e procedurale për zbutjen e efekteve, ose për realizimin e tyre.

Si rezultat i zbatimit të vizionit të zhvillimit dhe projekteve strategjike në territor, pritet që të ndodhin edhe ndryshime të mundshme të sistemeve territoriale, pra konvertime të tokës nga një sistem në tjetrin. Këto konvertime/ transformime mund të ndodhin mbi bazën e propozimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të infrastrukturave si dhe përmes disa procedurave ligjore të vendosura në legjislacionin sektorial në fuqi (për bujqësinë, tokat natyrore, ujërat, etj.). Një ide paraprake të transformimeve të mundshme mund ta marrim që me hartëzimin e vizionit territorial të zhvillimit, duke e krahasuar atë me shtrirjen e sistemeve aktuale të territorit. Sigurisht, kjo është një ide paraprake dhe orientuese, por ende asnjë vendim transformimi nuk është marrë, sepse për këtë nevojitet të përgatitet më parë plani i përdorimit të tokës dhe infrastrukturave.

Ndryshimet që kanë pësuar sistemet e territorit në Bashkisë Elbasan kanë ardhur si pasojë e objektivave strategjikë të propozuara. Sipas VKM nr. 671/ 2015, sistemet mbeten të njëjta pra: sistemi natyror (N), sistemi urban (UB), sistemi bujqësor (B), sistemi infrastrukturor (IN) dhe sistemi ujor (U), por disa territore pësojnë ndryshime bazuar në tendencat e zhvillimit që propozohen në këtë dokument politikash të zhvillimit të territorit. Ashtu siç u theksua më lart ndryshimet e propozuara në këtë fazë janë orientuese po jo domosdoshmërisht do të ndodhin ashtu siç janë përshkruar në këtë fazë. Ndryshimet e mundshme që do të pësojnë sistemet e territorit në Bashkinë Elbasan do të rishikohen në mënyrë të detajuar në fazën e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Toka bujqësore ndërmjet rrugës SH3 dhe lumit Shkumbin mund të pësojë ndryshim duke kaluar nga tokë bujqësore dhe sistem urban (vendbanimet që janë vendosur në këtë zonë) në tokë që do të përdoret për ndërtimin e një stacioni multimodal. Transformimet në këtë zonë kanë filluar të ndodhin gradualisht për shkak të ndërtimeve që janë vendosur aty, kryesisht në mënyrë informale.

Rehabilitimi i shtratit të lumenjve Zaranika, Papër dhe Gostimë do të sjellë pyllëzimin e zonë përreth duke kaluar në sistem natyror nëpërmjet krijimit të brezave mbrojtës përgjatë brigjeve të lumenjve. Shtretërit e lumenjve në shumë raste kanë pësuar ndryshme dhe në zonat urbane është ndërtuar shumë pranë tyre. Kjo në disa raste është bërë problem për përmbytjet në sezonin e dimrit. Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve do të sjellë transformim sistemit duke e kthyer në sistem natyror, ashtu siç duhet të jetë sipas përcaktimeve të standardeve të planifikimit.

Poli 18, i përcaktuar tek harta e poleve të zhvillimit, mund të pësojë ndryshim nga zonë urbane, e cila është e vendosur aktualisht shumë pranë zonës industrialë në qendër ekonomike dhe shërbimesh, përpunim industriale. Vendosja e vendbanimeve në këtë zonë nuk është shumë e përshtatshme për shkak të afërsisë që kanë me zonën industriale të ish-metalurgjikut. Nisur nga programet strategjike të propozuara ekzistojnë mundësia e transformimit të sistemit urban në zona ekonomike.

Zona përgjatë Lumit Shkumbin, e cila duhet të rehabilitohet dhe mund të kalojë në sistem natyror. Përreth Lumit Shkumbin janë vendosur në një distancë shpesh të vogël toka bujqësore për kultivimin e bimëve. Në raste të tjera është ndërtuar shumë pranë brigjeve duke krijuar sistem urban pranë sistemit ujore. Transformimi i mundshëm i kësaj zonë është kalimi në sistem natyror, duke krijuar breza mbrojtëse përgjatë shtratit të lumit me pemë dhe shkurre. Më poshtë jepet një hartë që shpreh në mënyrë të përafërt konvertimet e pritshme të sistemeve në territorin e Bashkisë Elbasan. Vlen të theksohet fakti se në këtë seksion janë treguar prirjet e mundshme të transformimeve, ndërkohë që gjatë hartimit të planit të propozuar të tokës ato do të detajohen më tepër dhe sipas rastit do të përgatiten për procedurat ligjore për konvertim.

Figura 78: Ndryshimi i mundshëm i sistemeve territoriale, sipas propozimeve




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


4. PROJEKTET PRIORITARE TE ZHVILLIMIT

Titulli i Projektit	1. Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Bashkinë Elbasan
Përshkrimi i Projektit	Një pjesë e infrastrukturës rrugore në Bashkinë Elbasan ka nevojë për rehabilitimin (zgjerim, përmirësim) e disa akseve, të cilat do të përmirësojnë qarkullimin. Projekti konsiston në ndërtim dhe rehabilitimi. Ndërhyrjet konsistojnë përmirësim të asfaltit, zgjerim rruge, pajisje me sinjalistikën e duhur rrugore, apo ndërhyrje të tjera të nevojshme. Në segmente të caktuara është e nevojshme të ndërtohen infrastruktura nëntokësore dhe mbitokësore. Segmentet rrugore që do të rehabilitohen janë: • Rruga Ali Cungu (rruga e varrezave) • Rruga që lidh Elbasanin me Shushicën • Rruga që lidh Elbasanin me Treganin • Rruga që lidh Elbasanin me Zvalinën • Rruga që lidh Elbasanin me Labinot Malin • Rruga nga Stacioni i Trenit deri tek Ura e Zaranikës në qytetin Elbasan • Itinerari Elbasan-Godolesh-Firas-Orpen-Qafë-Labinot Mal-Sericë-Xibrakë • Itinerari Bradashesh-Karabullak-Letan-Bixellë-Funarë-Mollagjesh-Krrabë • Rruga Funarë-Cerunjë-Orpen Gjatësia totale e këtyre rrugëve, që kanë nevojë për t'u rehabilituar është 128 km
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat
Arsyetimi i Projektit	• Rritje e aksesit ndërmjet qytetit të Elbasanit dhe Njësive Administrative • Rritje e shpejtësisë mesatare të udhëtimit nga njëra zonë tjetrën. • Rritje e sigurisë në rrugë të udhëtarëve.
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë e Elbasanit
Veprimet Strategjike	• Analiza paraprake e akseve rrugore që kanë nevojë të rehabilitohen • Hartimi i projekt zbatimit • Organizimi i dëgjesave publike me grupet e interesit
Rezultatet e pritshme	• Rritja e aksesit dhe e ndërveprimit ndërmjet Njësive Administrative të Bashkisë Elbasan • Përmirësimi i kushteve të transportit për udhëtarët dhe mjetet e transportit
Rreziqet	• Zbatimi i projektit kërkon fonde të konsiderueshme për ndërmarrjen e tyre
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR

Figura 79: Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore










Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të tjerë, fonde të tjera shtetërore

Titulli i Projektit	**2. Rehabilitimi dhe ndërtimi i pjesshëm i rrugës Tregan-Trepsenisht-Shelçan dhe rehabilitimi i rrugës Çekrez-Blerimad-Stërstan-Gjinar**
Përshkrimi i Projektit	Njësitë administrativë Tregan dhe Gjinar kanë potencial turistik. Për të nxitur zhvillimin e turizmit duhet përmirësuar aksesueshmëria me këto zona, që aktualisht nuk ofrohet. Për të krijuar një akses në këto NjA është i nevojshëm ndërtimi në disa segmente dhe rehabilitim i pjesëve ekzistuese. Aksesueshmëria mund të realizohet nëpërmjet dy Itinerareve Tregan-Gjinar. Projekti përfshin: • Rehabilitimin dhe ndërtimin e pjesshëm të rrugës Tregan-Trepsenisht-Shelçan • Rehabilitimin e rrugës Çekrez-Blerimas-Stërstan-Gjinar, që kalon në pjesën jugore të luginës së Përroit të Gostimës Këto rrugë do të jenë rrugë panoramike të cilat do të jenë funksion të zhvillimit të turizmit të zonës dhe nevojave të zonave që përfshin, gjatësia totale e të cilave është përafërsisht 24.35 km. Gjithashtu projekti përfshin dhe ndërtimin e infrastrukturës ndihmëse siç është sinjalistika dhe infrastruktura mbi dhe nëntokësore të tyre.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat
Arsyetimi i Projektit	• Rritje e aksesit ndërmjet njësive administrative Tregan dhe Gjinar • Rritje e numrit të turisteve si pasojë e aksesit më të mire • Përmirësim i transportit publik dhe mobilitetit në tërësi
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë
Veprimet Strategjike	• Hartimi i detajuar i projektit teknik të rrugës Tregan-Gjinar • Sigurimi i fondeve për ndërtimin e aksit • Kryerja e punimeve
Rezultatet e pritshme	• Rritja e aksesit dhe e ndërveprimit ndërmjet Njësive Administrative Tregan dhe Gjinar • Përmirësimi i kushte të transportit për udhëtarët dhe mjetet e transportit
Rreziqet	• Zbatimi i projektit kërkon fonde të konsiderueshme
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

Figura 80: Rehabilitimi dhe ndërtimi i pjesshëm i rrugës Tregan-Trepsenisht-Shelçan dhe rehabilitimi i rrugës Çekrez-Blerimad-Stërstan-Gjinar






Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, FSHZH
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Bashkia, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, donatorë të ndryshëm

Titulli i Projektit	**3. Projekti për përmirësimin e kryqëzimeve rrugore në Bashkinë Elbasan**
Përshkrimi i Projektit	Situata e lëvizjes në qytetin e Elbasanit aktualisht ka bllokime të shpeshta trafiku, në disa kryqëzime kryesore. Projekti përfshin përmirësimin e kryqëzimeve, të cilat ndodhen jashtë pjesës qendrore të qytetit të Elbasanit dhe kanë probleme sigurie për banorët. Ndërhyrjet që do të realizohne do të përcaktohen sipas situatave për secilën ndërhyrje. Kryqëzimet që do të kenë ndërhyrje janë: • Kryqëzimin e Cërrikut • Kyqëzimin e Urës së Zaranikës • Kryqëzimin e Stacionit të Trenit • Kryqëzimin e Metalurgjikut • Kryqëzimi i rrugës së Shushicës (kryqëzimi ndërmjet rrugës Elbasan-Shushicë dhe hekurudhës)
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat
Arsyetimi i Projektit	• Rrija e sigurisë në rrugë duke përmirësuar kushtet e transportit rrugor • Lehtësimi i problemeve që krijohen për qarkullimin e automjeteve • Rritje e kapaciteteve të mbajtjes së trafikut në kryqëzime
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projekteve të detajuara në bazë të funksioneve të rrugëve që lidhin këto kryqëzime. • Aplikimi për fonde. • Blerja e tokës dhe shpronësimet si pasojë e zgjerimit të kryqëzimeve ose ndërtimit me disnivele të tyre. • Instalimi i sinjalistikës së duhur në kryqëzime. • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Lehtësim i dukshëm i trafikut në qytet dhe jashtë tij
Rreziqet	• Bashkia e ka të vështirë të kryejë investime të tilla si pasojë e buxhetit të kufizuar që ka. • Mungesa e një studimi mbi problematikat e trafikut në rajonin e Elbasanit
Faza e projektit	Koncept-Projekt

Figura 81: Përmirësimi i kryqëzimeve rrugore



Kryqëzimi te Metalurgjiku



Kryqëzimi te Ura e Zaranikës



Kryqëzimi te Stacioni i Trenit



Kryqëzimi në rr. Cërrik- Elbasan



Kryqëzimi në Byshek




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN


Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR, FSHZH
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm

Titulli i Projektit	**4. Përmirësimin dhe shtimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Elbasan**
Përshkrimi i Projektit	Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve është i amortizuar dhe në pjesë të caktuara ka nevojë për rehabilitim të tyre. Humbjet në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit arrijnë deri në 35% për zonën e qytetit, ndërsa në zonat e tjera problem thellohet akoma më shumë. Situata me problematike paraqitet në njësitë administrative Gjinar, Shushicë, Tregan, Shirgjan, Gjergjan, Funarë, Gracen dhe Labinot Mal. Qëllimi i këtij projekti është rehabilitimin i sistemit ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimeve për arsye të amortizimit. Gjithashtu në zonat ku nuk ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë duhet të shtohet sistemi i tubacioneve të ujësjellësit në zonat ku terreni e lejon. Sistemi i kanalizimeve ka nevojë për rehabilitim të tubacioneve ekzistuese dhe shtim në zonët ku mundojnë dhe terreni e lejon të vendosen.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm (në zonat ku nuk ofrohet ky shërbim si dhe rritjen e volumit të ujit në disa njësi administrativë ku ka problematika me sasinë e pamjaftueshme të ujit që i shërbehet komunitetit) • Përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha.
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë
Veprimet Strategjike	• Evidentimi i pjesëve të amortizuara dhe i problematikave (si në rrjetin e ujësjellësit dhe në atë të kanalizimeve). • Hartimi i projektit teknik për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale dhe në zonat periferike të qytetit. • Aplikimi për fonde. • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Furnizimi me ujë të pijshëm dhe me sasi të bollshme në të gjithë Bashkinë e Elbasanit • Rrjet i përmirësuar dhe pjesërisht i rinovuar i kanalizimeve
Rreziqet	• Pamundësia për të financuar ndërhyrjen në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha
Faza e projektit	Koncept-Projekt


Figura 82: Shtimi dhe përmirësimi i sitemit të ujësjellës-kanalizimeve



Risistemimi i tubacioneve të kanalizimeve të ujërave të zeza, për të shmangur derdhjen e tyre në Shkumbin



Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN


Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, Bashkia dhe ndërmarrja
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, donatorë të ndryshëm

Titulli i Projektit	**5. Ndërtimi i ujësjellësit të ri të Fush Buallit në Bashkinë Elbasan**
Sfondi i Projektit	Aktualisht Bashkia Elbasan ka probleme me ofrimin e ujit të pijshëm si pasojë e mosfunksionimit të plotë të sistemit shpërndarës, por edhe si pasojë e mungesës së burimeve ujore. Ujësjellësi i qytetit megjithëse është i mjaftueshëm për sasine e ujit që shpërndan ka një kosto shume të lartë operacionale sepse është ujsjellës me ngritje mekanike. Në këtë mënyrë ky shërbim ofrohet me kosto të lartë gjë që rendon në xhepat e qytetarëve. Në këtë situatë lind nevoja për të gjetur një mundësi për ofrimin e këtij shërbimi me një kosto më të ulët që është ndërtimi i ujësjellësit të ri në Fush Buall me rrjedhje të lirë të ujit.
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt përfshin ndërtimin e rezervuarit qendror të mbledhjes së ujit nga burimet. Ndërtimin e tubacionit nga rezervuari deri në pikën e lidhjes me sistemin shpërndarës të qytetit. Ndërtimin e një tuneli për kalimin e tubacionit.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal
Justifikimi i Projektit	• Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Elbasanit dhe zonat përreth tij. • Reduktimin e kostove të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën ku operon.
Objektivi	Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor.
Veprimet Strategjike	• Studimi i parafizibilitetit dhe lobimi për fonde. • Hartimi i projektit të detajuar teknik. • Sigurimi i fondeve për projektin. • Organizmi i eventeve informuese mbi projektin. • Kryerja e punimeve
Rezultate të pritura	• Furnizmi me ujë të pijshëm 24 ore në dite për të gjithe zonën e qytetit të elbasanit dhe zonat periferike të tij. • Ofrim i shërbimit me kosto të ulët.
Rrisqet	• Duhen fonde të konsiderueshme për ndërtimin e këtij ujësjellësi bazuar kjo në veprat inxhinierike që ka projekti. • Probleme të mundshme pronësie dhe nevojë për servitut publik.

Figura 83: Ndërtimi i ujësjellësit të ri të Fush Buallit



Ujësjellësi i ri (Pusi i Fushë Buallit)





Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN


Faza e projektit	Koncept- Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, Bashkia dhe ndërmarrja
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm


Titulli i Projektit	**6. Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimin e urave në Bashkinë Elbasan**
Përshkrimi i Projektit	Aktualisht në Bashkinë Elbasan në kuadër të rehabilitimit të infrastrukturës rrugore është e rëndësishme ndërhyhet në përmirësimin e infrastrukturës së disa urave dhe ndërtimin e Urës së Byshekut. Ky projekt do të koordinohet me projektet e tjera që janë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Gjithashtu projekti përfshin dhe vendosjen e sinjalistikës dhe mirëmbajtjen e këtyre veprave infrastrukturore. Projekti përfshin këto ura: • Ndërtimi i Urës së Byshekut (pjesë e rrugës Elbasan-Shushicë) • Rehabilitimi i Urës së Zezë • Rehabilitimi i Urës së Polisit
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Industrisë, Komuniteti lokal, Sektori privat
Arsyetimi i Projektit	• Gjendje e jo e mirë fizike e urave (amortizim i tyre) • Nevojë për ndërtimin e urave të reja • Përmirësim i kushteve të transportit në Elbasan
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projekteve të detajuara të urave në funksion të parametrave të rrugëve që lidhin. • Sigurimi i fondeve nga partnerët e projektit • Koordinimi për ndërmarrjen e projektit me institucionet e specializuara (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës)
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i kushteve të transportit në akset ku përfshihen këto ura.
Rreziqet	• Mungese fondesh për realizimin e veprave infrastrukturore
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, Bashkia
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH dhe donatorë të ndryshëm

Figura 84: Rehabilitimi i urave










Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	7. Programi për zhvillimin e transportit automobilistik, (Rapid Bus Transit)
Përshkrimi i Projektit	Lidhja ndërmjet qyteti të Elbasanit dhe Njësisë Administrative Labinot Fushë është e rëndësishme për shkak të ndërveprimit ekonomik. Rëndësia e këtij segmenti është gjithashtu për faktin se ndodhet në pjesën e aksit nacional Elbasan-Pogradec. Projekti përfshin: • Rikonstruksionin e stacionit ekzistues të trenit dhe përshtatjen për stacion të RBT (Rapid Bus Trasit) • Ndërtimin e një stacioni për RBT në Labinot Fushë. • Rehabilitimin dhe përshtatjen e linjës hekurudhore ekzistuese në linjë për lëvizjen e RBT në segmentin Stacion i Trenit-Labinot Fushë
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat
Arsyetimi i Projektit	• Ky projekt përmirëson ndjeshëm transportin dhe ndërveprimin e zonave (linja e RBT Stacioni i Trenit-Labinot Fushë) • Nxit zhvillimin e bizneseve në segmentin Stacion i Trenit-Labinot Fushë
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë
Veprimet Strategjike	• Studimi i parafizibilitetit dhe lobimi për fonde. • Hartimi projekt zbatimit dhe sigurimi i fondeve. • Promovimi i projektit në sektorin privat të transportit dhe atij të ndërmarrjeve dhe bizneseve. • Krijimi i skemave të mundshme për PPP dhe financimi përmes instrumenteve financiare për zhvillimin e tokës (rasti i zhvillimit të përbashkët-joint development) • Marketimi dhe informimi. • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Rritja, integrimi dhe përmirësimi i mobilitetit në qytet dhe në raport me NJA Labinot-Fushë • Zhvillimi i njësive ekonomike të vogla dhe të mëdha përgjatë zonës Stacion i Trenit-Labinot Fushë
Rreziqet	• Koordinimi i projektit me aktorët e interesuar privatë. • Mungesa e nismave të tilla të mëparshme dhe e përvojës në nivel vendor. • Vështirësia për të organizuar PPP të suksesshme.
Faza e projektit	Koncept- Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, PPP, Bashkia
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm


Figura 85: Programi për zhvillimin e transportit automobilistik (BRT)



Stacioni i ri Multimodal




Ndërtimi i linjës BRT



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	8. Programi për zhvillimin e transportit hekurudhor në Bashkinë Elbasan
Përshkrimi i Projektit	Elbasani është një pikë strategjike e sistemit hekurudhorë kombëtarë dhe rajonal sepse është pjesë e linjës hekurudhore Durrës-Pogradec. Me kalimin e viteve si në të gjithë sistemin hekurudhor dhe në Elbasan nuk ka pasur investime si dhe ka pasur amortizime të shumta në rrjet dhe në stacionin e trenit të Elbasanit. Kjo ka bërë që Elbasani të humbë rëndësinë e tij strategjike në lidhje me këtë rrjet. Projekti përfshin: • Transferimin e stacionit të trenit për mallrat në zonën mes metalurgjikut dhe qytetit të Elbasanit (në anën perëndimore të qytetit). • Ndërtimin e një linje hekurudhore të dedikuar për mallrat në pjesën jugore të Lumit Shkumbin nga stacioni i trenit të mallrave deri në Labinot -Fushë Ky projekt gjithashtu përfshin ndërtimin e ambienteve ndihmëse për stacionin e mallrave siç mund të jenë magazinat e ndryshme për produktet, vendparkime, ambiente çlodhëse sidhe zyra për administratën.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Hekurudha Shqiptare, Komuniteti vendor, Sektori privat
Arsyetimi i Projektit	• Ky projekt në përgjithësi forcon pozicionin e Elbasanit si pikë strategjike e rrjetit hekurudhor kombëtarë dhe rajonal. • Ky projekt zhvillon dhe nxit rritjen e transportit të mallrave duke ulur në mënyrë të ndjeshme trafikun (transferimi i stacionit të mallrave më në perëndim dhe ndërtimi i linjës së dedikuar për mallrat, lehtësojnë trafikun në zonën e stacionit ekzistues të trenit) • Projekti promovon iniciativat për transportin e mallrave pa shkaktuar ndotje në ambient
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projektit teknik si për ndërtimin e Stacionit të Trenit ashtu dhe për ndërtimin e linjës hekurudhore. • Aplikimi për fonde dhe angazhimi për të krijuar PPP për financim. • Organizmi i dëgjesave publike me aktorët e interesuar sidhe me publikun. • Shpronësimi i pronave private dhe kompensimi i tyre. • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Integrim me i mirë i Elbasanit si një pikë kyçe e rrjetit hekurudhor kombëtarë. • Zhvillimi i bizneseve dhe hapja e vendeve të reja të punës në zone.
Rreziqet	• Projekti ka investime të shumta të cilat duhet të sigurohen nga partnerë të fuqishëm financiarisht. • Mungesë zhvillimesh në përgjithësi në sektorin e transportit hekurudhor. • Mungesë përvoje në PPP për financim të transportit përmes zhvillimit të tokës.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, Hekurudha Shqiptare, PPP
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, Bashkia, donatorë të tjerë


Figura 86: Programi për zhvillimin e transportit hekurudhor



Stacioni i ri i Trenit




Zhvendosja e linjës hekurudhore




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	9. Përdorimi i energjisë së rinovueshme, energjia gjeotermale Kozani 8
Përshkrimi i Projektit	Territori i Elbasanit shtrihet në zonën gjeotermale Kruja, zonë e cila ka potencial për prodhimin e energjisë gjeotermale. Në zonën e Elbasanit kjo energji mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Fuqia që mund të instalohet në pusin Kozani 8 është 2070 kW, energji e mjaftueshme për prodhimin e energjisë elektrike. Qëllimi i këtij projekti është përdorimi i energjisë gjeotermale për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjen e banesave. Ngrohja e banesave mund të realizohet nëpërmjet lidhjes së banesave me burimin gjeotermal me tubacione, ndërasa përftimi i energjisë elektrike nëpërmjet centtraleve elektrike gjeotermale. Ekzistojnë 3 lloje centralesh elektrikë gjeotermal: ***Dry Steam Power Plant*** (avulli i nxehtë ngjitet direkt nga rezervuarët gjeotermalë në gjeneratorët e termocentralit, avulli rrotullon turbinat, të cilat gjenerojnë automatikisht energjinë elektrike); ***Flash steam plants*** (uji me temperaturë 148 – 3371 °C, nxirret nëpërmjet një rezervuari. Një pjesë e ujit shëndërrohet në avull, i cili vë në punë turbinat, në momentit e ftohjes avulli kthehet sërish në ujë duke u rikthyer në tokë); ***Binary cycle plants*** (uji gjeotermal i moderuar kalon nëpër një shkëmbyes ngrohje, nxehtësia e të cilit i përçohet likuidit (të tilla si izobutani) që ka temperaturë vlimi më të ulët se uji, kur uji vlon kthehet në avull duke vënë në ujë turbinën, nëpërmjet të cilës prodhohet energji elektrike).
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, AKBN, Sektori Privat
Justifikimi i Projektit	• Përdorimi i energjive alternative për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm të pyjeve • Ndikon në rritjen e efiçiencës energjitike dhe përmirësimi i shërbimit të ofrimit të energjisë elektrike
Objektivi	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurencën e larmishmërinë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.
Veprimet Strategjike	• Promovimi i përdorimit të energjive të rinovueshme • Prezantimi i potencialeve energjitike tek palët e interesuara • Gjetja e fondeve për të financimin e projektit • Instalimi i pajisjeve të nevojshme në zonën e zbatimit të projektit • Realizimi i projektit
Rezultate të pritura	• Rritja e efiçiencës energjitike • Zhvillimi i qëndrueshëm (shmangia e prerjes së drurëve që përdoren për ngrohje) • Krijimi i një modeli për përdorimin e energjisë gjotermale në Shqipëri
Rrisqet	• Burimet gjeotermale në vendin tonë nuk janë përdorur më parë për prodhimin e energjisë • Tërheqja e investitorëve për realizimin e projektit
Faza e projektit	Koncept – Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Bashkia Elbasan
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm

Figura 87: Përdorimi i energjisë gjeotermale




Kozani (shfrytëzimi i pusit gjotermal
për ngrohjen e objekteve)




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	10.Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat e përshtatshme
Përshkrimi i Projektit	Elbasani zotëron një territor të përshtatshëm për prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Sipërfaqja e konsiderueshme e tokës natyrore e favorizon në kultivimin e drufrutorëve. Gjithashtu Elbasani ka potencial për prodhimi e drithërave dhe perimeve. Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe magazinimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale do të ndikojë pozitivisht në ekonominë e Bashkisë Elbasan dhe do të krijojë mundësinë e tregtimit dhe përpunimit të produkteve për fermerët e zonë. Mund të ndërtohen tregje dhe pika magazinimi (për përpunimin dhe grumbullimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale) në të gjithë territorin e Elbasanit. Polet ku mund të ndërtohen janë: qendërsia 3, qendërsia 8, qendërsia 9, qendërsia 10, qendërsia 11, qendërsia 12, qendërsia 15, qendërsia 17 (harta e qendërsive dhe fashave të zhvillimit)
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Shoqata e Fermerëve
Arsyetimi i Projektit	• Bashkia Elbasan ka kapacitete prodhuese për produktet bujqësore dhe blegtorale të larta dhe duhet krijuar mundësia e përpunimit dhe tregtimit të tyre brenda territorit të bashkisë • Tregtimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore në Bashkinë Elbasan ndikon në rritjen ekonomike të bashkisë
Objektivi	Nxitje e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, si sektorë kyç për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe rritjes së punësimit, dhe veçanërisht për fuqizimin e zhvillimit rural
Veprimet Strategjike	• Sigurimi i fondeve për hartimin e projekteve për ndërtimin e tregjeve dhe pikave të magazinimit • Ndërtimi i tregjeve dhe pikave të grumbullimit dhe magazinimit
Rezultatet e pritshme	• Rritja e nivelit të punësimit, duke hapur vende të reja pune për banorët në sektorin e bujqësisë dhe shërbimeve • Rritja e të ardhurave të bashkisë, nga tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale në tregjet lokalë
Rreziqet	• Dëmtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale për shkak të mungesës së infrastrukturës mbështetëse • Zgjedhja e zonave të përshtatshme për ndërtimin e tregjeve dhe pikave të grumbullimit dhe magazinimit të produkteve bujqësore e blegtorale
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, Bashkia
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të tjerë


Figura 88: Ndërtimi i tregjeve dhe pikave të grumbullimit




Ish repartet Hajdaran, Shushucë




Segmenti Krastë-Labinot Fushë



Segmenti Krastë-Labinot Fushë




Pikë Grumbullimi dhe Tregje




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	11. Studimi i fizibilitetit për rehabilitimin dhe rigjenerimin e zonës së ish-fabrikës së konservimit dhe zonës së metalurgjikut
Përshkrimi i Projektit	Zona industriale (metalurgjiku) dhe zona e ish-fabrikës së konservimit janë zona të cilat duhet të rehbilitohen dhe më pas t'iu jepen funksione të reja për t'u zhvilluar. Kjo mund të realizohet nëpërmjet investimeve të ndryshme. Ky është një projekt fizibiliteti, i cili përcaktojë si mund të zhvillohen këto zona pasi të rehabilitohen, duke qenë se në këto zona ka pasur zhvillim të mëparshëm industrial. Projekti përfshin: • Rehabilitimin e zonave industriale • Rigjenerim urban të ish-fabrikës së konservimit, dhënies së funksioneve të reja që do të përcaktohen nga studimi i projektit
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Komuniteti lokal, Aktorët e interesuar.
Arsyetimi i Projektit	• Projekti do të ndikojë në uljen e ndotjes nga mbetjet industriale • Projekti do të ndikojë në rizhvillimin e zonave dhe pasurimin e tyre me funksione të ndryshme. • Krijimi i zonave të reja për banim dhe për zhvillim ekonomik
Objektivi	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën e larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimeve të fizibilitetit të zonave • Koordinimi i projektit me aktorët e interesuar dhe nxitja e investimeve • Përcaktimi i prioriteteve për zhvillimin e zonave ish industriale
Rezultatet e pritshme	• Ulja e nivelit të ndotjes që shkaktohet nga mbetjet industriale të ish-fabrikave • Rizhvillimi i ish zonave industriale nëpërmjet dhënies së funksioneve të reja • Përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të Bashkisë Elbasan
Rreziqet	• Mungesë eksperience mbi koordinimin dhe nxitjen e aktorëve për pjesëmarrje në projekte të tilla. • Projekti kërkon fonde të konsiderueshme për zbatim dhe kjo mund të ulë interesin e qeverisë dhe bashkisë për t'u investuar në një iniciativë të tillë.
Faza e projektit	Koncept- Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Elbasan
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm (Banka Botërore)

Figura 89: Rehabilitimi dhe rigjenerimi i ish-fabrikës së konservimit dhe zonës së metalurgjikut




Ish Fabrika e Konservimit



Ish Frigoriferi



Rehabilitimi i zonës industriale (Metalurgjiku)



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	12. Konsolidimi i fashës me karakter ekonomik – bujqësor (SME) në segmentin Cërrik-Shirgjan
Përshkrimi i Projektit	Segmenti Cërrik-Shirgjan ka tendenca për zhvillimin ekonomik bujqësor. Për të pasur zhvillim të mëtejshëm ekonomik është e nevojshme që kjo fashë të konsolidohet dhe të nxiten bizneset e vogla dhe të mesme që kanë profil ekonomik-bujqësor për të investuar në këtë zonë. Konsolidimi i fashës ekonomike do të ndikojë në uljen e nivelit të papunësisë, që aktualisht është relativisht i lartë.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për të krijuar vende pune për banorët e Bashkisë Elbasan • Nxitja e fermerëve për rritjen e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale • Krijimi i mundësisë për tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në territorin e bashkisë
Objektivi	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën e larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm
Veprimet Strategjike	• Informimi i bizneseve të vogla dhe të mesme me karakter bujqësor për potencialet e zhvillimit ekonomik në këtë zonë • Nxitja e bizneseve për të investuar në këtë zonë
Rezultatet e pritshme	• Rritja e nivelit të punësimit në Bashkinë Elbasan • Rritja e rendimentit të prodhimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale • Zhvillim ekonomik i bashkisë dhe rritja e nivelit të të ardhurave
Rreziqet	• Zhvillimi i fragmentuar dhe i pakonsoliduar • Rendiment i ulët i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Elbasan
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm

Figura 90: Konsolidimi i fashës me karakter ekonomik-bujqësor (SME)




Fasha me karakter ekonomik -bujqësor në segmentin Cërrik- Shirgjan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	13. Rehabilitimi i shtratit të lumit Shkumbin dhe risistemimi i zonave përgjatë tij
Përshkrimi i Projektit	Qëllimi i këtij projekti është të rehabilitojë një pjesë të shtratit të lumit nëpërmjet pastrimit të shtratit të tij dhe marrjes së masave për shmangien e hedhjes së mbetjeve të ngurta urbane dhe industriale dhe derdhjen e ujërave të zeza në lumë. Zona e këtij projekti fillon pranë parkut të Krastës deri në zonën e grykëderdhjes së Lumit Zaranika. Kjo zonë shtrihet përgjatë qytetit dhe grumbullon ndotjen që shkaktohet nga hedhja e mbetjeve të ngurta urbane dhe derdhja e ujërave të zeza në lumë. Nëpërmjet këtij projekti synohet kthimi i kësaj zonë argëtimi dhe çlodhëse për banorët. Kjo mund të realizohet nëpërmjet ndërhyrjes me dizajn urban dhe sistemim gjelbërimi.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, ARM Elbasan, Sektori privat, Komuniteti Lokal
Arsyetimi i Projektit	• Shmangia e përmbytjeve nëpërmjet pastrimit të shtratit të lumit • Shmangia e erozionit të brigjeve të lumit dhe si rrjedhojë mbrojtja dhe ruajtja e brigjeve të lumit • Shmangia e ndotjes së mëtejshme të lumit • Rikthimi i lumit banorëve të qytetit nëpërmjet krijimit të hapësirave çlodhëse për banorët
Objektivi	Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor
Veprimet Strategjike	• Analizimi dhe evidentimi i problematikave lidhur me rehabilitimin e lumit dhe përcaktimi i mënyrës më të mirë të rehabilitimit të tij nëpërmjet pjesëmarrjes së banorëve në projekt • Sigurimi i fondeve për hartimin e projektit • Zbatimi i projektit
Rezultatet e pritshme	• Shmangia e përmbytjeve nga lumi gjatë shirave të rrëmbyeshëm • Shmangia e erozionit në brigjet e lumit • Ulja e nivelit të ndotjes në lumë • Rritja e cilësisë së jetesës së qytetarëve nëpërmjet krijimit të zonave rekreative
Rreziqet	• Mungesa e fondeve për realizimin e projektit • Mospërfshirja e grupeve të interesuara/aktorëve në projekt
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Elbasan
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm


Figura 91: Rehabilitimi i shtratit të lumit Shkumbin




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	14. Rehabilitimi i shtratit të lumenjve Zaranika, Manazdere, Papër, Gostrimë dhe Gostimë
Përshkrimi i Projektit	Qëllimi i këtij projekti është të rehabilitojë një pjesë të shtratit të lumenjve Zaranika, Papër, Manazdere, Gostrimë dhe Gostimë nëpërmjet pastrimit të shtratit të tyre, vendosjes së argjinaturave dhe marrjes së masave për shmangien e hedhjes së mbetjeve të ngurta urbane dhe industriale, të cilat pengojnë rrjedhën e tyre normale. Zaranika dhe Manazdere përshkojnë qytetin e Elbasanit në zona të populluara dendësisht. Në rast shirash të bollshme, shtëpitë e ndodhura në afërsi të brigjeve të këtyre lumenjve rrezikojnë përmbytjen (siç ndodhi në këto ditë reshjesh në janar 2016). Lumi i Manazderes thuajse gjithmonë sezonin e dimrit del nga shtrati duke përmbytur shtëpitë e ndërtuara shumë pranë shtratit të tij. Lumenjtë Papër, Gostimë dhe Gostrimë kalojnë zona më rurale por duhet të merren masa që në këto lumenj të mos hidhen më mbetje të ngurta urbane. Zona e këtij projekti fillon: • Lumi Zaranika • Lumi i Manazderës • Lumi Papër • Lumi Gostimë • Lumi Gostrimë Qëllimi i këtij projekti është të shmangë rreziqet që i kanosen banorëve të bashkisë nga përmbytjet e lumenjve në fjalë dhe nga erozioni i brigjeve të tyre. Kjo mund të realizohet nëpërmjet ndërhyrjeve për ndërtimin e argjinaturave dhe me ndërhyrje të tjera për rehabilitim të shtratit dhe me sistem gjelbërimi. Mund të hartohen plane veprimi që të synojnë ndalimin e menjëhershëm të hedhjes së mbetjeve të ngurta dhe ujërave të ndotura në lumenj.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, ARM Elbasan, Sektori privat, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Mbrojtja e ndërtimeve përgjatë shtratit të lumit nga përmbytjet dhe erozioni i brigjeve të lumenjve • Rehabilitimi i lumenjve do të mbrojë pasurinë e patundshme të qytetarëve që banojnë përgjatë brigjeve të lumenjve, do të ruajë tokat bujqësore si dhe do të ruajë pasuritë e patundshme publike
Objektivi	Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor
Veprimet Strategjike	• Përthithja e fondeve • Marrëveshja ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Ministrisë së Mjedisi • Hartimi i projektit teknik • Zhvendosja e banesave të rrezikuara në zona të caktuara nga Bashkia • Zbatimi i projektit
Rezultatet e pritshme	• Rreziku i përmbytjeve të shtëpive të ndërtuara përgjatë brigjeve të lumenjve i shmangur • Shmangia e problemit të erozionit në brigjet e lumenjve • Rehabilitimi i lumenjve do të mbrojë pasurinë e patundshme të qytetarëve që banojnë përgjatë brigjeve të lumenjve, do të ruajë tokat bujqësore si dhe do të ruajë pasuritë e patundshme publike
Rreziqet	• Zbatimi i projektit realizohet në faza të ndryshme dhe kërkon kohë • Kërkon burime njerëzore të kualifikuar dhe fonde për realizim • Rehabilitimi i zonës do të ketë nevojë për përfshirjen e disa aktorëve, përfshirë këtu edhe pronarët e ndërtimeve apo tokës përgjatë fashës lumore. • Në këtë zonë janë të vendosur grupe të margjinalizuara si komuniteti rom për të cilët duhet siguruar strehim në rast se do jetë e nevojshme të shpërngulen nga kjo zonë.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Elbasan
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm (USAID, Banka Botërore)

Figura 92: Rehabilitimi i shtratit të lumenjve Zaranika, Manazdere, Papër, Gostrimë dhe Gostimë



Zaranikë



Papër




Gostimë



Gostrimë



Manazderë




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	15. Rehabilitimi i parkut të qytetit, Krasta
Përshkrimi i Projektit	Krasta është parku më i madh natyror që ndodhet shumë pranë qytetit të Elbasanit. Sipërfaqja që zë ky park është 2,3 km². Ofrimi i hapësirave të gjelbëruara në bashkinë Elbasan është nevojë e cilësuar nga qytetarët. Krijimi i hapësirave çlodhëse për qytetarët sjellin nevojën e rehabilitimit të këtij parku. Rehabilitimi i parkut konsiston në pajisjen me hapësira të përshtatshme për të pushuar, krijimin e infrastrukturave të nevojshme për ecje, piknik, risistemim të gjelbërimit dhe ripyllëzime sipas nevojës, apo ndërhyrje të tjera që sipas nevojës mund të dalin gjatë procesit të projektimit.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, ARM Elbasan, Sektori privat, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për të përmirësuar infrastrukturën e parkut të Krastës, duke krijuar zona të përshtatshme pushimi • Sipërfaqe e gjelbëruar në Bashkinë Elbasan sipas nevojës së përcaktuar në raport me numrin e banorëve • Risistemimi i gjelbërimit në zonën e parkut të Krastë, mbrojtja e pemëve të këtij parku nga dëmtimet e mundshme
Objektivi	Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor
Veprimet Strategjike	• Përgatitja e projektit të peizazhit dhe lobimi për fonde • Aplikimi për fonde • Realizmi me sukses i projektit duke e bërë këtë park një zonë çlodhëse për banorët dhe të frekuentuar
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i infrastrukturës së parkut të Krastës • Krijimi i hapësirave çlodhëse për banorët e Bashkisë Elbasan
Rreziqet	• Gjetja e fondeve për financimin e projektit
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Elbasan
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm

Figura 93: Rehabilitimi i parkut të qytetit, Krasta






Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	16. Rehabilitimi i venddepozitimit aktual
Përshkrimi i Projektit	Vend depozitimi aktual i mbetjeve të ngurta urbane ndodhet në zonë të papërshtatshëm dhe është jashtë çdo standardi higjeno-sanitar. Bazuar në VKM nr. 452 datë 11.07.2012, të gjitha vend depozitimet aktuale duhet të mbylleshin që në gusht të vitit 2014, për shkak të ndotjes së lartë që shkaktojnë. Sipërfaqja e tokës në të cilën ndodhet vend depozitimi aktual ka nevojë të rehabilitohet për të shmangur ndotjen e mëtejshme të ujërave të lumit Shkumbin, të ujërave nëntokësore, si dhe të tokës përreth që është shkaktuar nga depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane. Ky projekt synon shndërrimin e sipërfaqes së vend depozitimit aktual në zonë të gjelbër. Për zbatimin e këtij projekti nevojitet një studim fizibiliteti për rehabilitimit e vend depozitimit ekzistues. Ndërkohë, për të shmangur ndotjen e përditshme, që vjen si pasojë e depozitimit të mëparshëm të mbetjeve në këtë vend depozitim aktual, mund të merren disa masa të menjëhershme që konsistojnë në: • Largimin e mbetjeve nga vend depozitimi ekzistues • Gërmimin e tokës së vend-depozitimit aktual për largimin e dherave të ndotur larg lumit Shkumbin (thellësia e gërmimit do të përcaktohet gjatë hartimit të projektit) • Mbushja e gropës së vend depozitimit aktual me dhe' të pastër • Gjelbërimi i zonës, nëpërmjet mbjelljes së pemëve
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia e Basenit të Shkumbinit, ARM Elbasan, Sektori privat, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Ulja e ndotjes së tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe cilësisë së ajrit, të shkaktuara nga depozitimi i mbetjeve në vend depozitim aktual • Shtimi i hapësirave të gjelbra brenda territorit të Bashkisë Elbasan
Objektivi	Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të fizibilitetit për rehabilitimin e vend depozitimit • Hartimi i projektit për rehabilitimin e vend depozitimit • Gjetja e burimeve financiare për zbatimin e projektit
Rezultatet e pritshme	• Sipërfaqja e vend depozitimit është e përmirësuar (mbetjet janë larguar) • Cilësia e ujërave të Lumit Shkumbin dhe ujërave nëntokësorë, tokës dhe ajrit janë nivele më të pranueshme të ndotjes • Koha dhe numri i banorëve të ekspozuar ndaj ndotjes të shkaktuar nga vend depozitimi është më i ulët
Rreziqet	• Mungesa e burimeve financiare për realizimin e studimit të fizibilitetit dhe zbatimin e projektit • Ndotja e mëtejshme e tokës, ujit dhe ajrit, dhe sidomos e ujërave nëntokësorë të cilët ushqehen drejtpërdrejtë nga lumi Shkumbin.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm


Figura 94: Rehabilitimi i venddepozitimit pranë varrezave të qytetit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	17. Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave 9-vjeçare në Gracen, Tregan dhe Gjergjan
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt ka për qëllim rikonstruksionin e 3 shkollave 9-vjeçare në njësinë administrative Tregan, përkatësisht në fshatrat Kaçivel, Kaçivel i Poshtëm dhe Shënavlash dhe 3 shkollave 9-vjeçare në njësinë administrative Gjergjan, përkatësisht në fshatrat Gjergjan, Kodra Bujaras, Bujaras, të cilat kanë probleme të infrastrukturës, ku në raste të caktuara kthehet në problem për zhvillimin e mësimit. Ky projekt do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të objekteve arsimore, rritjen e ofrimit të arsimit në të gjithë territorin e Bashkisë dhe rritjen e nivelit të arsimit të popullsisë
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan (DAR), Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Fondi i Zhvillimit Rajonal, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Kushte fizike të papërshtatshme për zhvillimin e mësimit • Numri i lartë i nxënësve të shpërndarë nëpër klasa. Ndërhyrjet infrastrukturore ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies • Përmbushja e standardit të planifikimit për objektet arsimore në lidhje me sipërfaqen e nevojshme për nxënës
Objektivi	Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social
Veprimet Strategjike	• Përgatitja e projekteve teknike/arkitektonike dhe lobimi për fonde • Gjetja e donatorëve të mundshëm për financimin e rikonstruksionit të shkollave 9-vjeçare që kanë nevojë për përmirësimin e infrastrukturës • Prokurimi publik • Rikonstruksioni i shkollave brenda afateve të përcaktuara, për të rritur cilësinë e arsimit në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Elbasan
Rezultatet e pritshme	• Rritja e numrit të personave të arsimuar, me arsim 9-vjeçar, në bashkinë Elbasan • Rritja e cilësisë së arsimit në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Elbasan, duke ulur numrin e nxënësve në klasa • Përmirësimi i infrastrukturës fizike të objekteve arsimore të përcaktuara në projekt
Rreziqet	• Mungesa e fondeve për të investuar në rikonstruksionin e shkollave • Mbyllja e shkollave gjatë kohës së rikonstruksionet, rrezikon uljen e nxënësve që do të ndjekin shkollën gjatë kësaj periudhe
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR, FSHZH
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Ministria e Arsimit dhe Sportit, donatorë të ndryshëm


Figura 95: Përmirësimi i infrastrukturës dhe ndërtimi i objekteve arsimore



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	18. Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në njësitë administrative Bradashesh, Papër, Gracen, Tregan, Shushicë, Zavalinë
Përshkrimi i Projektit	Në Bashkinë Elbasan ndodhen gjithsej 17 qendrat shëndetësore që ofrojnë shërbim. Gjithashtu raporti mjek-banorë është shumë i lartë, ku 1 mjek i shërben 1266 banorëve. Bazuar në të dhënat e mësipërme, ndërhyrjet në infrastrukturën e qendrave shëndetësore është emergjente. Përkatësisht është e nevojshme të rikonstruktohen dhe pajisen me mjetet e nevojshme: 2 qendra shëndetësore në Bradashesh, 1 në Gracen, 2 në Tregan, 1 në Shushicë dhe 1 në Zavalinë.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Shëndetësisë, FSHZH, FZHR
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për të përmirësuar infrastrukturën e qendrave shëndetësore për të ofruar një shërbim shëndetësor sa më të mirë • Nevoja për të ofruar shërbimin e nevojshëm shëndetësor për të gjithë popullsinë të gjitha njësitë administrative
Objektivi	Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social
Veprimet Strategjike	• Përcaktimi i qendrave që kanë nevoja emergjente ndërhyrje • Promovimi i projekt-idesë dhe lobimi për fonde • Gjetja e donatorëve të mundshëm për financimin e projektit për përmirësimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore • Hartimi i projekteve teknike dhe sipas rastit aplikimi për fonde • Prokurimi publik dhe kryerja e punimeve
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i shërbimit shëndetësor në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan • Ulja e raportit mjek-banorë në standardet e lejuara, për të ofruar shërbimin e nevojshëm për të gjithë popullsinë
Rreziqet	• Mungesa e financimit për të përmirësuar shërbimin shëndetësor
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, FSHZH, Bashkia
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Ministria e Shëndetësisë, donatorë të tjerë

Figura 96: Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në njësitë administrative Bradashesh, Papër, Gracen, Tregan, Shushicë, Zavalinë



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Titulli i Projektit	19. Rigjenerimi dhe rivitalizmi i qendrave të njësive administrative
Përshkrimi i Projektit	Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi/ndryshimin fizik i infrastrukturës dhe/apo objekteve e shërbimeve publike në njësitë administrative me karakter rural. Aktualisht në këto qendra (qendrat e ish-komunave) janë realizuar pak investime, pjesa më e madhe e të cilave konsistojnë ndërhyrje të infrastrukturës rrugore. Realizimi i këtij projekti ka ndikim social e kulturorë në njësitë administrative të Bashkisë Elbasan dhe krijon mundësi të reja për zhvillimin ekonomik. Rigjenerimi dhe rivitalizimi i qendrave të njësive administrative është i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të territorit.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Zhvillimit Urban, AKPT, Sektori Privat, Komuniteti Lokal
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për përmirësimin e cilësisë së infrastrukturave dhe hapësirave publike në qendrat e njësive administrative • Zhvillimi ekonomik dhe territorial i mëtejshëm i të gjithë territorit të bashkisë
Objektivi	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën e larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm
Veprimet Strategjike	• Promovimi i projekt-idesë dhe lobimi për sigurim të fondeve • Hartimi i projekteve të dizajnit me konkurrim të hapur ose nga bashkia • Hartimi i projekteve të zbatimit dhe aplikimi për fonde, sipas rastit • Prioritizimi i ndërhyrjeve emergjente për infrastrukturat që e kanë të nevojshme • Kryerja e punimeve të zbatimit
Rezultatet e pritshme	• Rigjenerimi urban i qendrave të të gjitha njësive administrative dhe krijimi i një hapësire publike ftuese për aktivitete biznesi • Rritja e cilësisë së infrastrukturave (rrugore, objekte, shërbime publike) dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve
Rreziqet	• Pamundësia për të financuar projektin • Rritja e papunësisë në nivel bashkie • Zhvendosja e popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane • Ulja e cilësisë së jetesës
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, Bashkia
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm

Titulli i Projektit	20. Programi për zhvillimin e transportit automobilistik, ndërtimi i stacionit intermodal
Përshkrimi i Projektit	Elbasani nuk ka një terminal të mirëfilltë të transportit (ka vend-parkime të tyre në disa sheshe të vogla të cilat janë të pamjaftueshme dhe nuk e kryejnë mirë funksionin) kjo sjell ngarkesë trafiku. Gjithashtu nuk ka një pikë kryesore, që ndihmon transportin e udhëtarëve. Projekti përfshin zgjerimin e terminalit në stacionin e vjetër të trenit. Ky do të jetë një pol zhvillimi në qytet i orientuar drejt transportit të udhëtarëve me linja rreth qytetëse dhe ndërqytetëse e gjithashtu me linjat e transportit publik. Gjithashtu do të ketë edhe disa funksione të reja si: bare, dyqane, restorante, vende për taksi sidhe zyra për administratën për ta. Ndërsa në një fazë të mëvonshme mund të konsiderohet ndërtimi i një stacioni intermodal që do të shërbeje për mallrat dhe për njërëzit në zonën ndërmjet ish kombinatit Metalurgjik dhe qytetit të Elbasanit.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit, Komuniteti lokal, sektori privat
Arsyetimi i Projektit	• Ky projekt krijon një shërbim me efikas të transportit në përgjithësi • Lehtëson trafikun duke mbledhur në një pikë linjat e transportit ndërqytetës, rrethqytetës • Rrit ndërveprimin ndërmjet Elbasanit dhe qyteteve të tjera dhe njësive të tjera administrative të Bashkisë Elbasan
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të fizibilitetit • Sigurimi fondeve për të investuar • Promovimi i projektit në sektorin privat të transportit dhe atij të ndërmarrjeve dhe bizneseve. • Krijimi i PPP-ve të mundshme. • Nxitja e bizneseve për të investuar në këto zonë. • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Rritje e ndërveprimit të Elbasanit në raport me qendrat e tjera të banuara. • Përmirësimi i situatës së transportit ndërqytetës, rrethqytetës
Rreziqet	• Projekti ka nevojë për mbështetje nga shumë aktorë që të realizohet në mënyrë të suksesshme. • Një pjesë e banesave të ndërtuara përreth zonës së stacionit të vjetër do të duhet të shpronësohen pë zgjerimin e tij
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FZHR, FSHZH, donatorë të ndryshëm
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Bashkia Elbasan

Titulli i Projektit	21. Programi për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Elbasan
Përshkrimi i Projektit	Me ndryshimin e kufijve administrativë të Elbasanit lindin dhe sfida të reja mbi menaxhimin e shumë shërbimeve që ofron pushteti vendor. Një ndër këto sfida është edhe ofrimi i shërbimit të mbetjeve urbane në një territor më të gjerë. Në këtë situatë nevojitet një program i posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve, që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimit të mbetjeve urbane të ngurta urbane në Bashkinë e Elbasanit. Programi për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë e Elbasanit përfshin: • Hartimin e një plani lokal për menaxhimi e mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Elbasan • Ndërtimin potencialisht i të paktën 3 stacioneve transferimi për mbetjet urbane në njësitë administrative rurale (ish-komunat) Sipas analizës së infrastrukturës, distancat më të largëta, janë me njësitë administrative Zavalinë, Gracen, Funarë, Labinot Mal, Gjinar. Zonat më të përshtatshme për ndërtimin e ST-ve (stacione transferimi) janë në: 1) njësia administrative Gracen në kufi me njësitë administrative Papër dhe pjesërisht Bradashesh, 2) në Labinot Mal, në kufi me Funarën dhe Labinot Fushën dhe 3) në Gjinar, e cila do të shërbejë për mbetjet e njësive administrative Zavalinë, Gjinar dhe pjesërisht Tregan.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, komuniteti, OJF mjedisore, Bizneset e zonës
Arsyetimi i Projektit	• Projekti do ndikojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e ri të Bashkisë • Projekti do të ndikojë në përmirësimin e skemës së grumbullimit të mbetjeve duke ulur kostot (ndërtimi i 3 ST për mbetjet) • Projekti do të ndikojë rritjen e nivelit të pastërtisë në mjedis. • Projekti do ndikojë në uljen e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga rrjedhja e lëndëve toksike të mbetjeve në ujin e lumit Shkumbin i cili përdoret edhe për ujitje në bujqësi. • Projekti do ndikojë në shmangien e ndotjes së mjedisit nga mbetjet, dhe mbi të gjitha, në mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja, të cilat shërbejnë si burim për furnizimin e popullsisë me ujë • Projekti do të ndikojë në rritjen e sensibilizimit të komunitetit për trajtim në burim të mbetjeve urbane.
Objektivi	Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor.
Veprimet Strategjike	• Analizimi dhe evidentimi i problematikave të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Elbasan. • Propozimi i skemave të përshtatshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane në Bashkinë Elbasan. • Planifikimi për ndërtimit të impianteve të ndërmjetme për trajtimin e mbetjeve, siç janë stacionet e transferimit
Rezultatet e pritshme	• Bashkia Elbasan ofron një shërbim të përmirësuar të menaxhimit të mbetjeve në territorin e saj • Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve dhe skemat e ofrimit të shërbimit janë të pasqyruara në një plan, i cili është i miratuar në nivel bashkiak dhe është udhërrëfyesi i ofrimit të shërbimit • Vend depozitimet ilegale në të gjitha njësitë administrative do të mbyllen • Në bashki do të fillojë trajtimi I ndërmjetëm I mbetjeve me anë të stacioneve të transferimit
Rreziqet	• Aksesi i dobët në disa zona të thella e bën të vështirë ofrimin e shërbimit të mbetjeve në këto zona
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Elbasan
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm (WBIK, Banka Botërore)

Titulli i Projektit	22. Studim fizibiliteti për instalimin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike, në Bashkinë Elbasan
Përshkrimi i Projektit	Shqipëria është një vend me rrezatim mesatar diellor 4kWh/m². Bashkia Elbasan shtrihet ndërmjet izolinjave 1450-1550 kW/m², që tregon për kushtet e favorshme të territorit për përdorimin e energjisë diellore. Një nga mënyrat e prodhimit të energjisë diellore është nëpërmjet instalimit të paneleve fotovoltaike. Studimi i fizibilitetit mund të përcaktojë nëse instalimin e paneleve ndihmon në përmbushjen e kërkesës për energji elektrike në Bashkinë Elbasan dhe përcakton një zonë të përshtatshme për instalimin e paneleve diellore. Qëllimi i këtij projekti është të përcaktojë si mund të përdoret energjia diellore për të rritur efiçencën e prodhimit të energjisë elektrike dhe për të përmirësuar ofrimin e këtij shërbimi.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, AKBN, Sektori Privat
Arsyetimi i Projektit	• Niveli i lartë i konsumit të burimeve për prodhimin e energjisë si: uji, hidrokarburet dhe drutë e zjarrit që përdoren për ngrohje • Furnizimi me energji elektrike, pa ndërprerje • Hapësirë e mjaftueshme toke për të instaluar panele fotovoltaike
Objektivi	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën e larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm
Veprimet Strategjike	• Studimi i fizibilitetit për përdorimin e energjisë diellore në Bashkinë Elbasan • Përthithja e investitorëve për financimin e projektit • Ndërmarrja e e hapave për të nevojshëm për hartimin e një projekti për përdorimin e energjisë diellore
Rezultatet e pritshme	• Rritja e efiçencës së energjisë • Zhvillim i qëndrueshëm (shmangia e përdorimit të drurëve për ngrohje
Rreziqet	• Zënia e hapësirave të konsiderueshme për instalimin e paneleve fotovoltaike • Mungesa e fondeve për të investuar për hartimin e një projekti për prodhimin e energjive diellore
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, PPP, Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm

Titulli i Projektit	23. Ndërtimi i shkollave të mesme (Bradashesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë, Tregan), ndërtimi i një shkolle profesionale në qytetin e Elbasanit dhe ndërtimi i dy shkollave 9-vjeçare në qytetin e Elbasanit
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt konsiston në ndërtimin e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare në zonat ku mungon shërbimi. Përkatësisht është e nevojshme të ndërtohen shkolla të mesme në njësitë administrative Bradashesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë dhe Tregan, ndërtimin i një shkolle shumëprofesionale në qytetin të Elbasanit dhe dy shkolla 9-vjeçare në rajonin 1 dhe 3 të qytetit të Elbasanit. Mungesa e ofrimit të shërbimit për arsimin është me e theksuar në zonat rurale. Për të rritur nivelin e arsimit në bashkinë Elbasan është e nevojshme të kemi ofrim të mirë të shërbimit, gjë e cila do të ndikojë edhe në kualifikimin e të punësuarve.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan (DAR), Fondi Shqiptar i Zhvillimit, komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Mungesa e institucioneve arsimore • Raport i lartë mësues/nxënës, në disa zona • Numri i lartë i nxënësve në klasa • Nivel i ulët kualifikimi i të punësuarve
Objektivi	Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social
Veprimet Strategjike	• Përgatitja e projekteve teknike/arkitektonike dhe lobimi për fonde • Gjetja e donatorëve për realizimin e ndërtimit të objekteve arsimore dhe/ose aplikimi për fonde • Prokurimi publik • Kryerja e punimeve
Rezultatet e pritshme	• Rritja e nivelit të arsimimit të të rinjve në të gjithë territorin e bashkisë Elbasan • Rritja e aksesit në arsimin e mesëm
Rreziqet	• Pamundësia financiare për të përballuar kostot e projektit • Aksesi i vështirë në disa nga zonat • Probleme me pronësinë zonat ku do të ndërtohet
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR, FSHZH
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Ministria e Arsimit dhe Sportit, donatorë të ndryshëm

Titulli i Projektit	24. Pajisja e kopshteve dhe shkollave me mjete didaktike
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt ka synim të realizojë pajisjen me mjete didaktike të kopshteve dhe shkollave të Bashkisë Elbasan. Për të realizuar një mësimdhënie sa më të mirë është e nevojshme të ndërtohen laboratorët për lëndët përkatëse në shkollat ku mungojnë dhe pajisja me mjetet që mungojnë sipas rastit. Gjithashtu pajisja e kopshteve me mjetet e nevojshme është domosdoshmëri për zhvillimin korrekt të procesit edukativ.
Partnerët	Bashkia Elbasan, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan (DAR), Fondi Shqiptar i Zhvillimit, FZHR, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Përmbushja e standardeve të nevojshme për zhvillimin e plotë të mësimit • Nevoja për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe edukimin në shkolla dhe kopshte
Objektivi	Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social
Veprimet Strategjike	• Përcaktimi i kopshteve dhe shkollave, që e kanë emergjente pajisjen me mjete didaktike • Përgatitja e projekteve teknike përkatëse në rastet e krijimit të laboratorëve apo hapësirave të reja • Gjetja e donatorëve për të financuar në pajisjen e kopshteve dhe shkollave me mjete didaktike • Pajisja e të gjitha kopshteve dhe shkollave me mjete didaktike dhe kryerja e punimeve sipas rastit
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i cilësisë së kopshteve dhe shkollave në procesin mësimor • Aftësimi më i thelluar i fëmijëve dhe nxënësve
Rreziqet	• Mungesa e fondeve për zbatimin e projektit • Zbatimi i projektit edhe në zonat e thella, me akses të ulët në arsim
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Elbasan, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH

Titulli i Projektit	25. Menaxhimi i integruar i lumit Shkumbin
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt synon mbrojtjen, ruajtjen dhe rehabilitimin e basenit të Lumit Shkumbin. Me nismën e Bashkisë Elbasan dhe Ministrisë së Mjedisit (nëpërmjet Agjencisë së Basenit të Shkumbinit) duhet nxitur hartimi i një projekt–studimi për menaxhimin e lumit Shkumbin. Duke qenë se lumi shtrihet në disa bashki, projekti është i një karakteri ndërvendor dhe, si i tillë, mund të realizohet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të bashkive nëpër të cilat kalon lumi Shkumbin me njëra-tjetrën. Ndërkohë që pritet që të fillojë menaxhimi i lumit Shkumbin, Bashkia Elbasan mund të ndërmarrë një sërë veprimesh paraprake për rehabilitimin e lumit Shkumbin që kalon në territorin e saj si i) rehabilitimin e shtratit të lumit në zonat ku është ngushtuar rrjedha e tij, ii) pastrimi i shtratit nga mbetjet e ngurta urbane dhe industriale, iii) shmangia e hedhjes së mbetjeve të ngurta që pengojnë rrjedhën e tij në shtratin e lumit ose në brigjet e tij, iv) krijimi i brezit të gjelbër përgjatë brigjeve të lumit, si dhe v) pyllëzimin e zonave të pellgut ujëmbledhës të lumit, në degët e tij në zonat malore të bashkisë, që mund të ndikojnë uljen e përmbytjeve. Për arsye menaxhimi mund të fillohet me rehabilitimin e shtratit të lumit që fillon pranë parkut të Krastës deri në zonën e grykëderdhjes së Lumit Zaranika, duke qenë se kjo zonë ka më shumë zhvillime dhe zonat e banuara janë më pranë shtratit të lumit.
Partnerët	Bashkia Elbasan dhe bashkitë e tjera të prekura nga Lumi Shkumbin, Ministria e Mjedisit, ARM Elbasan, ABU Shkumbin, Sektori privat, Komuniteti Lokal
Arsyetimi i Projektit	• Shmang përmbytjet të cilat shkaktojnë dëme të mëdha në Bashki • Shmang erozionin në brigjet e lumit që çon në humbjen e sipërfaqeve të tokave bujqësore dhe urbane në Bashki • Përmirëson cilësinë e ujërave të lumit të cilat përdoren në sektorë të ndryshëm ekonomikë (veçanërisht për ujitje në bujqësi) • Krijon zonave rekreative përgjatë pasqyrës ujore në shërbim të banorëve vendas • Përmirëson shëndetin e qytetarëve nëpërmjet krijimit të zonave të gjelbra dhe shmangies së ndotjes • Pastron ajrin në qytetin e Elbasanit nëpërmjet krijimit të zonave të gjelbra në brigjet e lumit • Zbut efektin serrë në qytet (që zakonisht krijohet nga nxehtësia e çliruar në qytet nga vendbanimet dhe industria) nëpërmjet shtimit të sipërfaqes së gjelbër përgjatë brigjeve të lumit
Objektivi	Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor
Veprimet Strategjike	• Promovimi dhe hartimi i projektit dhe sigurimi i fondeve • Marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit (ABU Shkumbin) mbi hartimin dhe realizmin e projektit • Sigurimi i bashkëpunimit me njësitë e tjera vendore si partnere në këtë projekt • Marrja e masave për ndalimin e derdhjes së mëtejshme të ujërave të zeza urbane dhe industrial në lumin Shkumbin • Marrja e masave për ndalimin e hedhjes së mbetjeve të ngurta në shtratin dhe brigjet e lumit
Rezultatet e pritshme	• Shmangia e përmbytjeve në territorin e bashkisë dhe shmangia e erozionit në brigjet e lumit • Rritja e vlerës së tokave pas investimit në brigjet lumore • Rritje e cilësisë së jetesës së qytetarëve • Ulja e nivelit të ndotjes në qytet • Mundësi e përdorimit të ujit të lumit për ujitje
Rreziqet	• Zbatimi i projektit realizohet në faza të ndryshme dhe kërkon kohë • Realizimi i projektit parashikon edhe pjesëmarrjen dhe mbështetjen e shumë aktorëve të tjerë jashtë Bashkisë (Ministria e Mjedisit, ABU Shkumbin, Bashkitë e tjera) • Kërkon burime njerëzore të kualifikuar dhe fonde për realizim • Rehabilitimi i zonës do të ketë nevojë për përfshirjen e aktorëve vendorë dhe mbi të gjitha banorëve, përfshirë këtu edhe pronarët e ndërtimeve apo tokës përgjatë fashës lumore • Sigurimi i fondeve për realizimin e projekteve

Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkitë nëpër të cilat kalon lumi Shkumbin, Ministria e Mjedisit
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Donatorë të ndryshëm (USAID, KfW)

SHËNIME DHE REFERENCA

3. Sipërfaqja e matur nga GIS, Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015
4. http://www.reformaterritoriale.al/udherrefyes/dokumente, aksesuar për herë të fundit Dhjetor 2015
5. Distanca e matur nga qendra e qytetit të Elbasanit
6. Sipas studimit të INSTAT për Tipologjinë e Komunave dhe të Bashkive, 2014, mbi bazën e të dhënave të ***Censusit*** 2011.
7. Për të realizuar llogaritjet, është përdorur popullsia sipas INSTAT (Censusi 2011), pasi vetëm në këtë mënyrë mund të përfshihen në formulë disa tregues dhe të bëhen krahasimet mbi hartën e ZFU-ve dhe të aglomerateve urbane.
8. Bashkimi Evropian
9. ***European Spatial Development Perspective***- Perspektiva Evropianë për Zhvillimin Hapësinor
10. ***European Spatial Development Perspective***- Perspektiva Evropianë për Zhvillimin Hapësinor
11. ***Work catchment area***
12. Gjatë vitit 2015 Co-PLAN ndërmori një analizë të zhvillimit policentrik në nivel Shqipërie, duke ndjekur me përpikmëri metodologjinë e ESPON 1.1.1 (Projekt i European Spatial Planning Observatory Network). Kjo analizë trajton 7 tregues të policentrizmit morfologjik (fizik) të cilët të kombinuar formojnë tre indekse (madhësia, pozicionimi dhe lidhshmëria) dhe në përfundim një indeks të policentrizmit për Shqipërinë, të krahasueshëm me ato të vendeve evropiane që kanë qenë subjekt i ESPON 1.1.1. Po ashtu, kjo analizë kryhet edhe për 7 tregues të policentrizmit funksional. Për shkak të mungesës së të dhënave, policentrizmi funksional është përshkruar por nuk është analizuar i plotë (jo të gjithë treguesit mund të maten).
13. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015 (NjA Funarë)
14. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015 (NjA Gjergjan)
15. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ***Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë***, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014
16. Bashkia Elbasan 2005, ***Detyra e Projektimit për Planin Urbanistik të Bashkisë Elbasan***, Bashkia Elbasan
17. Bashkia Elbasan 2005, ***Detyra e Projektimit për Planin Urbanistik të Bashkisë Elbasan***, Bashkia Elbasan
18. Bashkia Elbasan 2005, ***Detyra e Projektimit për Planin Urbanistik të Bashkisë Elbasan***, Bashkia Elbasan
19. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015
20. Përzgjedhja e kësaj zone si rajon është bërë vetëm për arsye studimi. Në këtë territor kalojnë/ gjenden burime të shumta ujore, janë përqëndruar një pjesë e madhe e HEC-ve dhe terreni është i larmishëm, duke përfshirë zona fushore dhe bregdetare e deri tek ato malore. Pra nga ana e analizës së metabolizmit përmban të gjitha elementët e nevojshëm për analizim.
21. Instituti i Hidrometereologjisë, ***Harta e rrezatimit mesatar vjetor***, Tiranë
22. Burimi i informacionit për hartën e fluksit të energjisë është marrë nga SHGJSH (biomasa), AKBN dhe TAP (hidrokarburet, energjia e erës, energjia e diellit dhe energjia gjeotermale), ***www.riverwatch.eu*** (HEC-et), Atlasi Gjeotremal (burimet gjeotermale), Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)
23. Burimi i informacionit për hartën e fluksit të ujit është marrë nga SHGJSH (akuifere, burimet dhe shpimet), ***www.riverwatch.eu*** (HEC-et) dhe ***www.bestcountryreports.com*** (precipitimet), Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

24. INSTAT, 2015

25. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ***Atlasi i Burimeve Gjeotermale në Shqipëri***, Tiranë 2004

26. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, ***Energji të rinovueshme, energjia diellore***

27. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ***Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013-2020***, Tiranë 2012

28. INSTAT, Censusi 2011 (Grid)

29. INSTAT, Censusi 2011

30. Burimi i informacionit për hartën e fluksit të energjisë në Bashkinë Elbasan është marrë nga Ministria e Mjedisit (zonat e mbrojtura), ***www.riverwatch.eu*** (HEC-et), Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN (zonat industriale dhe sipërfaqet ujore nga analiza e përdorimit të tokës)

31. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ***Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Elbasanit***, Tiranë 2014, (Harta Hidrologjike)

32. Sipërfaqe e matur nga GIS nga harta e përdorimit të tokës, Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

33. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ***Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Elbasanit***, Tiranë 2014

34. Bashkia Elbasan dhe Valu ADD, 2015

35. Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve që ofron shërbimin e ujësjellësit në Bashkinë Elbasan

36. Bashkia Elbasan dhe Valu ADD, 2015

37. Bashkia Elbasan dhe Valu ADD, 2015

38. Burimi i informacionit për hartën e fluksit të ujit në Bashkinë Elbasan është marrë nga Bashkia Elbasan dhe Valu ADD (sistemi i ujësjellësit dhe zona e mbulimit me shërbim), ***www.riverwatch.eu*** (HEC-et), Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

39. Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit Dhjetor 2015

40. Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, analiza e përdorimit të tokës, 2015

41. Burimi i informacionit për hartën e fluksit të ushqimit është marrë nga Corine (llojet e tokave),Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Urban dhe Administrimit të ujërave (pikat e grumbullimit dhe magazinimit), Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

42. Të dhënat për kompanitë ricikluese janë marrë nga Ministria e Mjedisit, aksesuar për herë të fundit Tetor 2015

43. Vendim i KM nr.175, datë 19.1.2011, Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Në rastin e Elbasanit, nisur nga ngjashmëria që ka Bashkia e Elbasanit me Bashkinë Shkodër në numër popullsie, kemi bërë një përafrim të të dhënave me Bashkinë Shkodër

44. Vendim i KM nr.175, datë 19.1.2011, Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

45. Burimi i informacionit për hartën e fluksit të mbetjeve në Bashkinë Elbasan është marrë nga Ministria e Zhvillimit Urban (vendepozitimet), Ministria e Mjedisit (kompanitë ricikluese), Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN (zonat industriale dhe sipërfaqet ujore nga analiza e përdorimit të tokës)

46. Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore u krye për lumenjtë: Osum, Devoll, Seman, Shkumbin, Gjanicë dhe Vjosë. Monitorimi u krye në periudhën Qershor-Korrik, nga Co-PLAN, në kuadër të zbatimit të projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore. Në pellgun e Lumit Seman, marrja e mostrave të ujit për analizë u bë në 11 pika, 6 nga të cilat në Osum. Në të gjitha pikat u analizuan në laborator 13 parametra fiziko dhe bio-kimikë (pH, Light Transparency, Electric Conductivity, Total Suspended Solids (TSS), Total Dissolved Solids (TDS), Dissolved Oxygen (DO), Temperature, Biochemical Oxygen Demand (BOD), $N\text{-}NH_4$, $N\text{-}NO_3$, $N\text{-}NO_2$, sulfidet dhe Total Coliform). Ndërkohë në 7 Nga mostrat e mbledhura, disa mostra u analizuan edhe për praninë e metaleve të rënda (Pb, Cd, Mn, Ni, Zn, Cu, Co, Cr, Hg, As, Ba, Br)

47. Pikat ku është bërë monitorimi i ujërave për lumin Shkumbin nga AKM në vitin 2014 janë Qukës, Toplias (Ura e Polisit), Papër dhe Rrogozhinë

48. Parametrat e monitoruar nga Co-PLAN/PLGP dhe AKM janë pH, Oksigjeni i tretur, BOD_5, $N\text{-}NH_4$, $N\text{-}NO_2$ dhe $N\text{-}NH_4$.

49. Vlerat e lejuara të pH janë marrë nga ***Directive 2006/44/EC of 15 February 2006 concerning the management of bathing water quality and repealing Directive 78/659/EEC***

50. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

51. Standardi është marrë nga Agjencia Kombëtare Mjedisore e SHBA-së (***United States Environmental Protection Agency***)

52. Nevoja Biologjike për Oksigjen -***Biological Oxygen Demand***

53. Normat janë marrë nga Direktiva e Bashkimit Evropian ***Directive 2006/44/EC***

54. Gjetje të monitorimit të ujit të Shkumbinit të kryer nga AKM në vitin 2014

55. Normat janë marrë sërish nga direktiva e BE-së: ***Directive 2006/44/EC of 15 February 2006 concerning the management of bathing water quality***

56. Standardi është marrë nga Agjencia Kombëtare Mjedisore e SHBA-së (***United States Environmental Protection Agency***

57. Normat janë marrë nga direktiva e BE-së: ***Directive 2006/44/EC of 15 February 2006 concerning the management of bathing water quality and repealing Directive 78/659/EEC***

58. Normat janë marrë nga direktiva e BE-së: ***Directive 2006/44/EC of 15 February 2006 concerning the management of bathing water quality and repealing Directive 78/659/EEC***

59. Standardi i përdorur nga AKM është 0.12mg/l

60. Vlerat janë marrë nga USA-EPA http://www.dep.wv.gov/www/Programs/wqs/Documents/Triennial%20Review/May%2018,%202009/17155_tds.pdf

61. Vlerat e lejuara të bakteries kuliform janë marrë nga ***NIVA - Instituti për Studimet e Ujërave të Norvegjisë***

62. Vlerat e lejuara mjedisore për metalet janë marrë nga ***Direktiva 2008/105/EC*** e transpozuar në VKM 246/2014 "Për Përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë» dhe nga ***NIVA - Instituti për Studimet e Ujërave të Norvegjisë***

63. http://riverwatch.eu/en/interactive-map, aksesuar për herë të fundit në Nëntor 2015

64. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ***Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë***, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014

65. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ***Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë***, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014

66. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ***Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë***, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014

67. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ***Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë***, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014

68. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti për Gjendjen e Mjedisit***, Ministria e Mjedisit

69. Standardi orar është 350 $\mu g/m^3$ dhe standarti ditor është 125 $\mu g/m^3$

70. Monoksid Karboni

71. Dioksid Squfuri

72. Monoksid karboni

73. Oksidet e azotit

74. Dioksid karboni

75. Metan

76. Bashkia Elbasan 2006, ***Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin Urban të Bashkisë Elbasan***, Bashkia Elbasan

77. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

78. Dragoti, N. ***Rrjeti aktual i zonave të mbrojtura***, Ministria e Mjedisit

79. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015 (NjA Labinot Mal)

80. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015 (NjA Shushicë)

81. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015 (NjA Zavalinë)

82. Të dhëna janë marrë nga Bashkisë Elbasan, aksesuar për herë të fundit Janar 2016

83. UNECE

84. Odeta Tota, Bujar Huqi, Eugen Skuraj, dhe Fatbardh Sallaku, ***An investigation of the spatial variability of heavy metal concentrations in floodplain sediments around the Metallurgical Combine of Elbasan, Albania***. Research Journal of Agricultural Science, 42, 2010

85. Kadmium

86. Zink

87. Bakër

88. Odeta Tota, Bujar Huqi, Eugen Skuraj, dhe Fatbardh Sallaku, ***An investigation of the spatial variability of heavy metal concentrations in floodplain sediments around the Metallurgical Combine of Elbasan, Albania***. Research Journal of Agricultural Science, 42, 2010

89. Hysen Mankolli, Velsin Peçuli, Shpend Shahini, Agim Asllani, ***The Evaluation of Pollution of Agricultural Land by Pb, and Cr, Albania***, Research Journal of Agricultural Science, (41) 2, 2009

90. Agim Mazreku, Artan Tashko, Niko Civici, ***Environmental Impact of Metallurgy on the Soils and the Air of Elbasani City, Albania***, ***J. Int. Environmental Application & Science***, Vol. 6 (4): 471-478, 2011

91. Krom

92. Nikel

93. Plumb

94. Hekur

95. Mangan

96. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

97. Burimet e Rinovueshme të Energjisë

98. Topi, I. 2012, ***Aspects of global climate change in Albania based on analysis of several climate indicators***, International Journal of Ecosystem and Ecology Sciences (IJEES)

99. Shqipëri: ***Tipologjia e Komunave dhe Bashkive***, Maj 2014

100. Sipërfaqe e matur në GIS, Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

101. Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, ***Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania***, Agric. Econ.-Czech, 60, 2014 (6): 287–293

102. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

103. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

104. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

105. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

106. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

107. EU Commission, ***Overview of CAP Reform 2014-2020***, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5*/December 2013

108. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

109. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

110. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

111. EU Commission, ***Overview of CAP Reform 2014-2020***, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5* / December 2013

112. INSTAT, 2012

113. Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015 (Sistemet territoriale)

114. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

115. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

116. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

117. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

118. Llogaritje të autorit duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e njësi administrative me të dhënat e Censusit të popullsisë 2011

119. Niveli i popullsisë me arsim përfundimtar bazik është shprehës i nivelit arsimor përfundimtar për popullsinë dhe tregon sa % e saj nuk e ka vazhduar arsimin në nivele më të larta. Ai shpreh raportin e numrit të personave që kanë kryer arsimin fillor dhe tetë ose nëntë vjeçar, ndaj popullsisë 15 vjeç e lart, në %.

120. INSTAT (Censusi, 2011) aksesuar për herë të fundit në Tetor, 2015

121. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

122. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit në Tetor, 2015

123. Ministria e Arsimit dhe Sportit 2014, ***Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020*** (fq 67)

124. Një raport hulumtues i UNICEF për cilësinë e arsimit parashkollor në Shqipëri, rekomandon që për grupet 3-4 vjeç raport fëmijë/edukatorë të jetë 10 dhe për fëmijët në moshë pak më të rritur mund të jetë edhe më i lartë. Për më tepër shiko: http://www.unicef.org/albania/ECD-mb-standards-survey-oct13.pdf

125. http://data.worldbank.org/indicator/SE.PRM.ENRL.TC.ZS

126. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

127. INSTAT, 2015

128. http://healthgrouper.com/documents/4417/Albania_country_report-Final.pdf

129. http://ec.europa.eu/health/reports/docs/health_glance_2014_en.pdf

130. Të dhënat janë llogaritje të autorit mbështetur në informacionet e marra nga Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit në Nëntor 2015

131. Bashkia Elbasan 2010, ***Plani strategjik i Zhvillimit të Qytetit 2010-2020,*** Bashkia Elbasan (fq 82)

132. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

133. https://www.ined.fr/en/everything_about_population/data/europe-developed-countries/birth-death-infant-mortality/

134. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

135. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

136. INSTAT, Censusi 2011

137. INSTAT, Censusi 2011

138. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, AMNJ 2012

139. http://www.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf

140. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit, Tetor 2015

141. https://sq.wikipedia.org/wiki/Lista_e_rrug%C3%ABve_komb%C3%ABtare_dhe_autostradave_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri

142. https://en.wikipedia.org/wiki/File:Harta_autostrade_Shqiperia.png

143. South-East Europe Transport Observatory (SEETO), ***Multi-Anual Development Plan, Five year Multi-Annual Plan 2015*** (page 54)

144. Ligji Nr. 8378, datë 22.7.1998, Neni 2, i rishikuar në vitin 2011, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (faqe 6- 7)

145. Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015, analiza e infrastrukturës rrugore, matur nga GIS

146. Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015 (analiza është mbështetur në të dhënat e Ortofotos së vitit 2007 dhe vizita në terren)

147. http://www.albaniandf.org/Resources/Lista_e_Rrugeve_te_finacuara_nga_FSHZH_2005-2013.pdf, page 3.

148. Instituti i Monumenteve të Kulturës 2015, Lista e Monumenteve Qarku Elbasan, http://www.imk.gov.al/wp-content/uploads/monumente/lista%20e%20monumentewve/ELBASAN.pdf, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

149. Këshilli i Ministrave, ***Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020, miratuar me Vendim i KM, Nr.691, Dt.Aktit:29.07.2015***

150. Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015 (analiza e përdorimit të tokës)

151. Ministria e Energjisë dhe Industrisë 2014, ***Promovim mundësie investimi në objekte industriale,*** http://www.energjia.gov.al/files/userfiles/Industria/Promovim_mun____desie_investimi_(anglisht)INFORMATION_ON_FORMER_INDUSTRIAL_BUILDINGS_PRONE_TO_OPPORTUNITIES_FROM_INVESTORS_IN_INDUSTRY_FIELD.pdf aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

152. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përfshijnë të ardhurat nga: taksat e ndara, transfertën e kushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar.

153. Të ardhurat vendore përfshijnë të ardhura nga: taksa dhe tatime, tarifa, të ardhura nga asetet vendore, dividendë, fonde ose asete të KSHP-ve, donacione dhe hua.

154. Nëse nga totali i të ardhurave vendore do të veçonim të ardhurat nga "huat dhe donacionet" do të kishim një panoramë tjetër të financave lokale. Të ardhurat vendore (përjashtuar huat dhe donacionet) rezulton të jenë rritur me rreth 10.5% në vitin 2011. Përgjatë dy viteve pasardhëse të ardhurat vendore u karakterizuan nga një performancë negative për t'u rikuperuar në vitin 2014. Në terma vjetorë, të ardhurat vendore shënuan rritje me rreth 12.7% në terma vjetorë. Huat dhe donacionet përbënë një burim financiar të rëndësishëm në vitet 2013 dhe 2014 duke kontribuar pozitivisht në performancën e përgjithshme financiare të Bashkisë Elbasan.

155. Të dhënat për transfertën e kushtëzuar përfshijnë dhe të ardhurat nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për grantet e dhëna në programet e arsimit, kulturës, sportit, shëndetësisë, ujësjellës kanalizime, strehimit.

156. Shpenzimet e realizuara me fondet e veta rezultojnë më të larta se të ardhurat e veta të gjeneruara në vitet përkatëse dhe kjo vjen si pasojë e faktit që një pjesë e shpenzimeve vjetore përfshijnë edhe ato të financuara me fonde të trashëguara nga vitet e mëparshme, por edhe shpenzimet për infrastrukturën rrugore të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.

157. Shpenzimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore klasifikohen sipas natyrës ekonomike dhe sipas qëllimit të përdorimit të tyre (funksionit apo programe) në përputhje me standardet ndërkombëtare të zhvilluara nga Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD), të publikuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

158. Këshilli i Ministrave, ***Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020, miratuar me Vendim i KM, Nr.691, Dt.Aktit:29.07.2015*** (fq. 12)

159. Projekt-ligji për ligjin e ri Organik për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë Vendore, aprovuar nga Këshilli i

Ministrave, aktualisht në pritje për të kaluar për votim në kuvend.

160. Në përputhje me Ligjin nr. 115/2014 , datë 31.07.2014, ***Mbi Ndarjen territoriale administrative të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë***

161. Njësi të qeverisjes vendore (bashkitë dhe qarqet sipas legjislacionit në fuqi për ndarjen territoriale dhe administrative)

162. INSTAT, 2015

163. PLGP/USAID: Sistemi i transfertave ndërqeveritare dhe formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar

164. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

165. Organizata të Shoqërisë Civile

166. Vendime të KRRTRSH dhe KKT gjatë periudhës 1993- 2015, AKPT

167. Sipas ndarjes së territorit në Rajone Zhvillimi me propozim të Këshillit të Ministrave

168. Sipas leximit të Cabanes, P. et al, (2008), ***Harta Arkeologjike e Shqipërisë***, Botimet Pegi

169. Sipas ***Albanian Academy of Science***, ***History of Albanian People***, ISBN 99927-1-623-1 .

170. Viezzoli, S.J., L. (1923), Shqypnija, ***Njoftime gjeografike shtetistike-administrore***, ribotim 2014, Botimet Fishta, Tiranë

171. Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=4&Itemid=370&lang=en, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

172. Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=7&Itemid=372&lang=en, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

173. Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=8&Itemid=373&lang=en, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

174. Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=9&Itemid=374&lang=en, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

175. http://riverwatch.eu/en/interactive-map, aksesuar për herë të fundit, Nëntor 2015

176. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

177. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) 2014, ***Raporti i Gjendjes në Mjedis***, Ministria e Mjedisit

178. Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, aksesuar për herë të fundit, Tetor 2015

179. Në këtë kontekst termi të ardhura të veta i referohet të ardhurave që njësia administrative gjeneron nga taksat dhe tatimet, tarifat, të ardhura nga asetet vendore, dividendë, fonde ose mjete të KSHP-ve, donacione dhe hua. Të dhënat i referohen vitit 2014 dhe kanë si burim Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit) pranë Ministrisë së Financave